


894.933

A37

DRITERO AGOLLI

Jeta në letërsi

*Artikuj
dhe
shënimë*



891.983
1737.


**DRITËRO
AGOLLI**

Jeta në letërsi



**Artikuj
dhe
shënime**

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»



JETA DHE HISTORIA NË LETËRSI DHE ARTE

Letërsia dhe artet tona janë bërë faktor i rëndësishëm i ndikimit shoqëror, se kanë vënë në fokusin e tyre veprimtarinë e popullit, historinë e tij, revolucionin socialist, punët e përditshme, preokupimet e përhershme dhe betejën për triumfin e idealeve të komunizmit. Ato tanimë luajnë një rol të madh në formimin botëkuptimor të njerëzve, në pasqyrimin e botës shpirtërore të tyre dhe në rritjen e mendimit të përgjithshëm social të popullit. Duke u nisur nga roli i tyre në shoqëri, sa herë trajtojmë problemet kardinale të socializmit, flasim edhe për letërsinë dhe artet bashkëkohore, për këto vlera të mëdha që i ka krijuar vetë socializmi në rrugën e tij të vështirë. Prandaj Partia në Kongresin e 8-të, duke riafirmuar vijën e saj të përgjithshme në tërë fushat e jetës, në ekonomi, kulturë, e politikë, i cmoi lart letërsinë dhe artet, hapi horizonte të gjera dhe shtroi detyra të rëndësishme për gjithë forcat krijuese të vendit.

Ky vlerësim është nisur nga realiteti i krijimtarisë së viteve të fundit e nga proceset letrare e artistike në zhvillim, të cilat kanë disa tipare që i dallojnë nga periudhat e mëparshme. Cilat mund të janë këto tipare?

Në radhë të pare, pasurimi i përmrbajtjes dhe i formës së arteve ka ardhur përmes forcimit të frysës socialiste, edhe se ky proces ende kërkon një thellim të mëtejshëm. Fryma

socialiste ndihet në pasqyrimin më të gjerë të jetës së shoqërisë së sotme, si pasojë e interesimit gjithmonë e më të madh të forcave krijuar për tematikën dhe problematikën e aktualitetit socialist. Por kjo fryshtë dallohet edhe në problematikën e veprave me temë nga e kaluara historike e nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Një tipar tjetër dallues është se në krijimtarinë letrare e artistike, në përgjithësi, është vendosur një raport më i drejtë ndërmjet temës së jetës së shoqërisë socialiste dhe të së kaluarës historike, megjithëse në këtë fushë ka ende disa probleme. Por mund të pohojmë që në fillim se jeta e shoqërisë, problemet e saj të mprehta, ngritja e kulturës së njeriut, rritja e gjithanshme e personalitetit të tij dhe zgjegrimi i dijeve bëjnë presion të fuqishëm mbi krijimtarinë për të kthyer fytyrën më shumë nga jeta dhe për të vendosur raporte më të drejta ndërmjet temës aktuale dhe asaj së historisë më të hershme.

Tipar me rëndësi është se krijimtaria letrare e artistike ka marrë një zgjerim të ndjeshëm në të gjitha llojet dhë gjinitë e saj: në letërsi, kinematografi, teatër, artet figurative, muzikë e koreografi.

Hap i ndjeshëm u hodh në artet figurative, në radhë të parë në pikturen dhe skulpturen monumentale me ndërtimin e Muzeut Kombëtar historik dhe me përfundimin e disa aksioneve të mëdha artistike, siç ishin: monumentet e Dragashovicës dhe i Hysni Kapos në Vlorë, ato të Muzeut të Skënderbeut në Krujë dhe monumentet e Pezës.

Nga ana tjetër, ngjarje me rëndësi për kulturën tonë ka qenë edhe fillimi i botimit të veprave në seri të shkrimtarëve të letërsisë bashkëkohore shqiptare. Nga kjo seri shumëvillimshe tanimë janë botuar veprat e Sh. Musarajt, N. Bulkës, S. Spases, S. Çomorës etj. Edhe pse në fillimet e saj, kjo seri është nga më të arriturat dhe jep një përfytyrim më të plotë të krijimtarisë së shkrimtarëve tanë më të shquar.

Një tipar që duhet të përmendet në fushën e krijimtarisë së viteve të fundit është preokupimi gjithmonë e më i madh i shkrimtarëve dhe artistëve për formimin e tyre botëkuptimor, estetik dhe kulturor. Ky preokupim ka qenë i lidhur ngushtë me krijimtarinë e secilit. Gjatë procesit krijuar janë rrahur mendime për problemet e artit, të përbajtjes e të formës së tij dhe të parimeve të metodës së realizmit socialist në evoluim. Disa çështje të thellimit të fryshtë socialistë e të

origjinalitetit kombëtar janë trajtuar më gjerë se disa vjet më parë dhe niveli kulturor e profesional i shkrimtarëve dhe artistëve është vazhdimisht në rritje.

Vetëm nga ky ekskursion i shpejtë nëpër letërsinë dhe artet e një periudhe të shkurtër zbulohen para syve tanë arritje të pamohueshme, që lënë të kuptohet edhe perspektiva optimiste e krijimtarisë. Por, po t'i shohim letërsinë dhe artet nga lartësia që kërkon koha, do të gjendemi para mjaft problemesh, zgjidhja e drejtë e të cilave do të shpejtonte kalimin në një hop të ri cilësor të krijimtarisë ietrale e artistike.

Këto probleme mund të ndahen në tri grupe: Ç'kërkon pasqyrimi më i plotë i jetës së shoqërisë socialiste; Cili është raporti cilësor ndërmjet temës së sotme dhe të djeshme, ndërmjet artit të kultivuar dhe atij popullor; Ndërgjegjja krijuese dhe cilësia në letërsi dhe arte.

I. Ç'kërkon pasqyrimi më i plotë i jetës së shoqërisë socialiste?

Kërkesat e shoqërisë sonë për rritjen e cilësisë së letërsisë dhe arteve nuk janë të pakapshme dhe abstrakte. Cilësia nuk vjen nga një shumë e thjeshtë mjetesh shprehëse të përdorura në krijimtari, por nga një kompleks i tërë botëkuptimi, tendencë, synimi dhe mënyre, për të pasqyruar thelbin e jetës së popullit në shoqërinë socialiste dhe në të kaluarën e tij historike me vërtetësi artistike jashtë çdo trillimi artificial dhe trajtimi frazist. Kur e vemë theksin në domosdoshmërinë e pasqyrimit më të plotë të jetës së shoqërisë, do të thotë se diçka na shqetëson, se diçka kërkojmë të plotësojmë, pasi pikërisht në këtë temë të madhe të realitetit socialist janë edhe dukuritë, edhe problemet më të mprehta, që kanë të bëjnë me nivelin artistik të gjithë letërsisë dhe urteve. Realitetin socialist ne e jetojmë të gjithë dhe, kur pasqyrohet në art, e ndiem më përnjëherësh edhe bukurinë e një vepre, edhe dobësinë e saj. Ndërsa kur pasqyrohet e kaluara, dobësia në vepër ndihet më ngadalë, pasi aty për aty sugjestionohesh nga ngjarja, nga romantika dhe ekzotika. Nga ana tjetër, në pasqyrimin e së kaluarës është fituar një përvojë nga burimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Janë mësuesit e mëdhenj që veprojnë, janë klasikët me librat e tyre. Me pasqyrimin e së kaluarës edhe mund të abuzohet, pasi problematika nuk ka atë mprehtësi të realitetit të so-

tëm që e jetojmë dhe me të cilin ndeshemi ditë për ditë. Përveç kësaj, në veprat me temë aktuale druajtjet e balancimet e botuesve dhe vetë autorëve janë shumë më të mëdha se sa në ato me të kaluarën historike. Por mbi të gjitha është vështirësia e ndodhjes para kompleksitetit të realitetit, para dukurive dhe problemeve të vështira dhe të ndërlikuara, të cilat kërkojnë një formim të plotë botëkuptimor, estetik e kulturor jo vetëm nga shkrimtarët dhe artistët, por edhe nga botuesit dhe drejtuesit e veprimtarisë letrare e artistike. Formimi i gjithanshëm botëkuptimor e kulturor e çliron artistin nga paragjykimet letrareske, balancimet fraziste dhe hezitimet e tjera. Jo më kot shoku Enver në raportin e Kongresit të 8-të të Partisë citon thënien e famshme të Engelsit se «historia tregon që çdo hap i ri përparrë në rrugën e kulturës ka qenë një hap drejt lirisë». Ky hap përparrë «në rrugën e kulturës» e çliron edhe vetë artistin nga prangat e shablloneve, pasi e bën më të ndërgjegjshëm për misionin që ka në shoqëri.

1. Kështu, pasqyrimi më i plotë i jetës së shoqërisë socialiste kërkon emancipimin e mëtejshëm të shkrimtarëve dhe artistëve nga disa paragjykime letrareske, që ulin nivelin cilësor të letërsisë dhe arteve. Një nga këto paragjykime është skematizmi, i cili ndrydh mendimet e gjalla, shuan konfliktet jetësore, mënjanon problemet reale të shoqërisë dhe trillon të tjera sipas mënyrës libreske e fraziste. Bartësi i skematizmit, në fakt, është njeri frazist i paemancipuar, që u druhet problemeve të mëdha dhe ua ka frikën. Diviza e skematikut është: unë nuk them fjalën time në art, unë them frazën!

Ka libra, filma, drama, piktura e këngë me temë ngajeta e sotme që lexohen, shihen e dëgjohen dhe largohen të harruara, si një bisedë pa kripë e një njeriu të lehtë. Arsyja e kësaj harrese është mungesa e vërtetësisë, e realizmit dhe e problemit. Zbrastësia e mendimit mbushet shpesh me frazën e bujshme agitative. Në këtë rast kemi të bëjmë me konfondimin e tendenciozitetit me frazeologjinë. Arti i vërtetë është tendencioz, pasi pa tendencë artisti nuk mund të mbrojë pikëpamjet e veta dhe nuk mund të luftojë për qëllime të larta. Engelsi e shpjegon qartë problemin e tendenciozitetit. Ai, duke përkrahur këtë tipar të artit përaparimtar, thotë: «Por unë mendoj se tendenca duhet të rrjedhë vetiu nga ambienti dhe nga veprimi, se nuk duhet ta theksojmë atë posaçërisht, dhe shkrimtari nuk është i de-

tyruar t'ia japë lexuesit të gatshme zgjidhjen e ardhshme historike të konflikteve shoqërore, që ai paraqet.»¹⁾

Nga ky mendim i Engelsit nxjerrim si përfundim atë, që tendenca duhet të mishërohet në gjithë materialin e veprës dhe të mos jetë si diçka e qepur dhe e shtuar, pasi e bën artin agjitativ dhe bërtitës. Trajtimet skematike e kanë të theksuar tendenciozitetin bërtitës, të shprehur përmes frazave pompoze, përdorimi i të cilave kërkon edhe fushë pompoze, kërkon që edhe në një shkrim sado të vogël të futen gjithë idetë dhe parimet e një manifesti. Autori i mësuar me mënyrën fraziste rri e mendon: «Të fut edhe këtë ide për ta forcuar, të them edhe këtë mendim që më ka mbetur jashtë». Atëherë dhe një këngë e thjeshtë ngarkohet sa një roman.

Dukuri tjetër e skematizmit frazist është edhe lustrimi dhe zbukurimi i realitetit, idealizimi i heroit dhe i ambientit. Le të marrim, fjala vjen, komedinë e R.Pulahës «Shoqja nga fshati», që u bë pastaj edhe film nga regjisori P. Milkani, ku gjemjë elementet më shembullore të skematizmit, të lustrimit të realitetit, të situatave dhe personazheve të trilluara e të konflikteve përkëdhelëse. Fshati atje i shembellen një shtëpie pushimi, ku vetëm këndohet e bëhen shaka. Në këtë fshat gjen cdo gjë, mungojnë vetëm banonet. Atje njerëzit shëtisin me varka në mes të ditës dhe qeshin edhe kur rrezikohet t'u ngordhë kau balash. Shoqja nga fshati, që dikur ka qenë zonjë nga qyteti, tani është e lumtur dhe hallet që kishte dikur, i kalojnë një plaku tjetër, një postieri fatkeq, që na qenkësh tepër i rrezikshëm për përparimin! Kjo është ngjarja e parodizuar e «Zonjës nga qyteti». Autori, duke u rrëmbyer nga suksesi i merituar i «Zonjës nga qyteti», shpejton të na prezantojë «Shoqen nga fshati».

Në këto pak radhë flasim për një autor me përvojë, që kohët e fundit ka shkruar në dramaturgji vepra me vlera, siç është drama «Komunistët», vënë në skenë nga regjisori Piro Mani dhe luajtur me mjeshtëri nga aktorët e Teatrit Popullor.

Paragjykimet skematike ndonjëherë dëmtojnë edhe tendencat e përgjithshme pozitive të veprave të autorëve me përvojë letrare dhe të talentuar. Këto paragjykime ose nuk lejojnë që konflikteve t'u shkohet gjer në fund, ose e spostojnë pikën e gravitetit nga kryesorja në të zakon-

1) (Marks-Engels: «Mbi letërsinë dhe artin» vëll. 1, fq. 10, bot. shqip. 1976.)

shmen. Kështu në romanin e M.Qillerit «Jetë dhe dashuri», që nuk është një vepër pa vlera, vëmendja largohet nga përpjekjet, konfliktet dhe puna e gjeologëve dhe kalon në grindjet mes dashnorëve. Dashurohen dy, pastaj grinden dhe hyn një i tretë që ata i bind të zgjidhin mosmarrëveshjet. Autorin ky manovrim e ndihmon për të zgjidhur konfliktin e romanit sa më me pak telashe. Treshja: dy grinden dhe njëri me gjuhën fraziste i pajton është emblema e përgjithshme e skematizmit. E theksojmë këtë pasi ndodh në drama dhe në tregime. Nga kjo nuk kanë mbetur pa u prekur edhe artet figurative, sidomos piktura. Në pikturë më shumë i përhapur është pasqyrimi i përciptë i njeriut dhe paraqitja me përmasa të mëdha e muskujve, hekurave, betonit, çekanit, kazmës dhe lopatës në sfondet e kuqe, e të përflakura. Po edhe këtu ka ndërtimë skenash të lumtura nëpër rrugët dhe arat e fshatit. Na kujtohet tabloja e V. Halimit «Nga qyteti në fshat», ku një çift i lumtur qytetar me një fëmijë në krahë dhe me një valixhe, drejtohen me kënaqësinë e pakufishme për të jetuar mes fshatarëve. Nuk flas për temën. Ajo do të trajtohet si e rëndësishme gjithmonë nga arti. Flas për veprën që i she mbëllen një etikete ose një reklame: «Qytetarë, frekuentoni lulishtet!»

Në letërsi dhe arte, vërtet, në radhë të parë, do të evidentohen dukuritë e reja të jetës, por do të fshikullohen edhe ato që frenojnë; do të ngrihen lart njerëzit e guximshëm, ndërtuesit e socializmit, punëtorët, fshatarët e intelektualët; do të zërë vendin e nderit heroi pozitiv dhe do të dërmohen e kritikohen armiqtë, tradhtarët, memurët, servilët, dembelët dhe individualistët. Shoqëria jonë është e fuqishme edhe me luftën që bën kundër çdo vështirësie dhe dëkuive frenuese. Atmosfera e shoqërisë sonë është aq e shëndoshë, sa edhe individualisti më i tèrbuar e ka të vështirë të gjejë fushë veprimi. Njeriu ynë pothuajse gjithë jetën e kalon në kolektiv, duke filluar që nga fëmijëria: në çerdhe, në kopshte, në shkollë, në familje, në oborr, në punë, në organizatë. Dhe përherë shoqëria vepron. Por megjithëse kolektivi ynë është i mbrojtur me shumë mënyra e forma, mes tij përsëri dalin pjesëtarë që mund t'i quajmë plangprishës. Letërsia, për hir të druatjtes ndaj ndikimeve të huaja, nuk duhet t'i lërë jashtë fokusit të saj këta njerëz që bien në konflikt me kolektivin; ajo duhet t'i gjurmojë, t'i zbulojë dhe t'i verë në laboratorin e saj.

Një nga misionet e artit është të edukojë qëndresën morale, prandaj gjen atë hero që përpinqet të jetë i moralshëm jo me hatër, por me idealet e tij. Dhe ky hero le të jetë edhe i pabujshëm dhe pa efekte të jashtme.

Në pasqyrimin e njeriut të thjeshtë duhet të kemi parasysh edhe diçka tjetër. Nuk janë të gjitha anët e jetës së njeriut njëloj të rëndësishme dhe njëloj kurioze për tu pasqyruar. Njeriu në jetën e tij ka shumë gjëra e shumë veprime, por cilat nga këto u interesojnë të gjithëve dhe cilat i shërbejnë revolucionit? Kështu duhet ta shohim problemin. Duke u ndalur në disa maja të jetës së njeriut, nuk duhet të harrojmë ato që i plotësojnë këto maja, të cilat përbëjnë sfondin, lëngun. Ajo që është e përparuar te njeriu, ajo që është e re dhe e rëndësishme në karakterin e tij e në personalitetin e tij, kjo ndikon edhe në gjithë veprimet e tij. Këtë duhet ta zbulojë artisti, se kjo merr forcë edukuese. Besimi te njeriu, besimi te forca e tij, kërkon që të hidhet poshtë e vjetra në jetë, por edhe e vjetra në vetë njeriun.

Nuk mund të mos përmendim tregimet e fundit «Nisemi, djema» të N. Lerës, që përshkohen nga ndjenja e dashurisë për njeriun e thjeshtë. Në këtë varg mund të shohim edhe vëllimet «Mirazh» të A. Abdihoxhës, «Portat e dashurisë» të T. Laços, «Pëllumbat e janarit» të Z. Çelës, «Mëngjesi i një së hëne» i K. Blushit, «Mërgata e qyqeve» e N. Jorgaqit e ndonjë tjetër, ku bëhen përpjekje për të thënë fjalën origjinale, por që në disa raste nuk shkëputen plotësisht nga skemat e njohura dhe nga trajtimet libreske të realitetit. Por skemat, trajtimet më të ndjeshme letrareske dhe kapjet e sipërfaqshme momentale të realitetit ditor shfaqen më shumë në tregimet dhe vjershat që botohen në shtypin letrar, veçanërisht te «Drita», por edhe te «Nëntori».

Bota tani është kaq dinamike, sa, po të mos mësosh në mënyrë permanente, mbetesh pas edhe si artist. Sot edhe artisti më i madh gjatë jetës së tij artistike nuk mund të rrrijë pa i evoluar e pasuruar mjetet shprehëse, përndryshe koha e mënjanon. Dhe këtë evoluim të strukturave dhe formave ne e kuptojmë sipas estetikës marksiste-leniniste, pa e shkëputur nga përbajtja. K. Marks thotë: «Forma nuk ka asnjë vlerë, në qoftë se nuk është formë e përbajtjes.»¹⁾ E reja nuk qëndron në sferën e formës, por në perso-

1) (K. Marks, F. Engels, Vepra, vëll. 1, fq. 258, bot. rus.)

nalitetin e artistit, në botëkuptimin e tij. Ky personalitet dhe ky botëkuptim është në gjendje të avancojë format dhe të thyejë rutinat.

Të gjitha këto kanë të bëjnë me mjeshterinë, pa të cilën nuk mund të luftohen deri në fund letrarizmat e skematizmat. «Nuk mjafton, — thotë shoku Enver në reportin e Kongresit të 8-të, — të kapësh temën e ditës, të shkruash për heroin pozitiv, për realitetin socialist etj. Vetëm kjo, pa mjeshtërinë artistike, nuk mund të të emocionojë, të të edukojë dhe të të frymëzojë për të sotmen dhe për të ardhmen.» Për këtë detyrë artistike duhet të bëhen të ndërgjegjshëm dhe të mendojnë thellë. Shkrimtarët nuk punojnë sa duhet për stilin dhe fjalën dhe pak mësojnë nga klasikët tanë e botërorë. Ka shfaqje të diletantizmit në stil e në gjuhë. Kurse kritikët e quajnë gjë të zakonshme t'ua falësh shkrimtarëve mëkatin e varfërisë së fjalës dhe formës për hir të temës aktuale. Gjuha e veprave që analizohen nga kritikët zakonisht përmendet në frazën e fundit të artikullit ose recensionit. «Shpjegimet për gjuhën marrin një karakter të thatë e regjistrues. Mendojmë se është i palejueshëm nën-vleftësimi i formës. K. Marks, duke folur për formën, theksonte: «E vërteta është universiale, ajo nuk më takon vetëm mua, ajo u përket të gjithëve; ajo më pushton mua dhe jo unë atë. Prona ime është forma, që përbën individualitetin tim shpirtëror.»¹ Filozofikisht këtu nënkuptoher forma e pashkëputur nga përbajtja, nënkuptoher aftësia për të mishëruar në përbajtje idetë, të vërtetën që është universale dhe për të gjithë.

Duke ardhur nga fundi i trajtimit të disa anëve të skematizmit frazist dhe pasojave që sjell ai në uljen e cilësisë së artit, dua të theksoj se është e domosdoshme të luftohet më shumë dhe të bëhem i ndërgjegjshëm, se pasqyrimi i cekët i jetës së shoqërisë socialiste është një mbeturinë e së kaluarës dhe si e tillë është e huaj për metodën e realizmit socialist.

Cilësia artistike arrihet nga puna krijuese e shkrimtarëve dhe artistëve dhe nga veprimitaria e ndërgjegjshme, e kulturore dhe e apasionuar e botuesve dhe drejtuesve. Mund të mos e pranojë ftesën e skematizmit shkrimtari, por mund t'i thotë «mirë se të vish» botuesi. Prandaj pohojmë se

1) K. Marks, F. Engels; Vepra, vëll. 1, fq. 6, bot. rus.

cilësia arrihet nga përpjekjet e përbashkëta të të dy palëve. Të dy palët duhet të jenë në një front unik.

2. Pasqyrimi më i plotë i jetës së shqërisë socialiste kërkon një kuptim më të gjerë të temës aktuale. Në dukje ky problem është i thjeshtë dhe merret nga disa krijues sikur tanimë është kuptuar dhe nuk ka nevojë të preket. Tema aktuale në letërsinë dhe artet tona ka dy pamje të mëdha; atë që pasqyron Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe atë që pasqyron periudhën e ndërtimit socialist të vendit. Të dyja këto pamje përbëjnë të vetmen temë, të dyja ushqejnë njëra-tjetrën dhe të dyja vijnë duke u trajtuar gjithmonë e më me pjekuri në letërsinë dhe artet tona. Në të vërtetë shpesh me temë aktuale disa kuptojnë temën ditore ose momentale, ngjarjet e përditshme dhe arritjet e çastit të një njeriu ose kolektivi. Temë aktuale është diçka tjetër. Ajo përbëhet nga ngjarje të mëdha të jetës së shqërisë dhe të njeriut. Ngjarjet e përditshme dhe momentale janë pasoja, që formojnë vetëm sfondin e momenteve të mëdha. Po të vrapojmë pas temës ditore, të çastit e të anëve të sipërfaqshme të jetës, ia heqim artit thelbin e tij, pasqyrimin e problemit jetëgjatë ose të përjetshëm, e shndërrojmë atë në artikull të zakonshëm gazete për punët e stinës, për grumbullimin e bimëve industriale a për inaugurimin e një vatre kulture.

Arti nuk është një shumë matematike njohurish, por përgjithësim i ngjarjeve dhe i fatit të njeriut në momentet dramatike dhe të rëndësishme të historisë. Ai jep portretin e kohës sonë, luftën dhe punën e apasionuar, transformimet e mëdha në shqëri, ecjen e socializmit në qytet e në fshat. Mbi të gjitha ai ngrë lart njeriun. Vetëm duke njohur përgjegjësinë e tij ndaj njeriut, arti mund të kryejë detyrën e tij para së sotmes dhe së nesërmes. Për pasqyrimin e njeriut të kohës, e njeriut të idealeve socialiste, letërsia dhe artet tona tanimë kanë grumbulluar një përvojë të madhe. Pa numëruar këtu romanin «Kënetë» të F.Gjatës, që është nga të parët që trajton temën e ndërtimit socialist, pa u ndalur në novelën e bukur. «Isha unë Çobo Rapushi» të Sh.Musarajt, që jep figurën e një njeriu që socializmi e edukon, të vijmë te një nga veprat më përfaqësuese të dhjetëvjeçarit të fundit, «Dimri i madh» të I. Kadaresë, që pasqyron një periudhë të rëndësishme të historisë bashkë-kohore, të luftës kundër revizionizmit hrushovian, si dhe njeriun e shqërisë së re. Me këto veprat e shumë të tjera

letërsia e realizmit socialist e tregon të vërtetën jetësore në konkretninë historike dhe në zhvillimin e saj revolucionar. Këtë dukuri e gjemjë edhe në veprën kinematografike «Kur po xhirohej një film» të Xh.Kekos, por në një kënd tjetër, në këndin moral, në afirmimin e këtij morali në shoqërinë socialiste. Jetën e njeriut në shoqërinë e re shprehin vjershat e poetëve të rindërave të moshuar: B.Londos, N. Gjetjes, N.Paplekës, R.Markut, A.Istrefit, | A.Gjakovës, N.Lakos, A.Isakut, H.Aliajt e Xh.Spaçiut. Shoqëria dhe njeriu në marrëdhëniet e ngushta gjajnë mishërimin e tyre në veprat e piktorëve e skulptorëve tanë, si ato të O.Paskalit, K. Ramës, M. Dhramit, S. Shijakut, I. Lulanit etj. Këngët e bukura të A. Prodanit, L. Dizdarit, e A. Mulës i japid gjëzim dhe optimizëm jetës.

Por, edhe pse letërsia dhe artet tona kanë kontribuar shumë për të pasqyruar njeriun e kohës, punën dhe veprën e tij në ndërtimin e shoqërisë së re, edhe se e kanë pasqyruar tablonë e epokës socialiste, përsëri ndihen pamjaf-tueshmëri jo të pakta në ndjekjen e proceseve të zhvillimit të socializmit dhe të dukurive të reja të jetës. Në mjaft raste janë trajtuar proceset e thjeshta të zhvillimit, dukuritë ditore të jetës, por jo thallisëtë e tyre.

Ndërtimet e mëdha që ka ndërmarrë klasa punëtore në Koman, në kombinatin metalurgjik «Çeliku i Partisë», zhvillimi i industrisë minerare, krijimi i një zone të tërë të intensifikuar në bujqësi, puna heroike në uzina e fabrika, transformimet socialiste në fshat, zgjerimi i qyteteve, përparsi i shkencës dhe i kulturës, rritja e fuqisë mbrojtëse të atdheut, të gjitha këto janë burime të pashtershme temash pér letërsinë dhe artet. Vërejmë se ende relativisht pak vepra ka që tregojnë artistikisht punën dhe jetën në ndërtimet e mëdha të socializmit, në qytetet dhe fshatrat tona, në revolucionin tekniko-shkencor e në familje. Rëndësia e temës bashkëkohore pér zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë dhe arteve të realizmit socialist qëndron në faktin që më ritmet e ndryshimeve në shoqëri dhe në psikologjinë e njerëzve, krijimtaria artistike, si dukuri ideologjike e estetike, mbetet pas po të mos bashkëveprojë vazhdimisht me jetën që ndryshon me shpejtësi. Letërsia dhe artet tona mund të rriten cilësisht vetëm duke u ushqyer pa ndërprerje ngajeta. Ky veprim do t'u japë edhe sferën e gjerë të tematikës. Këtu qëndron edhe rëndësia e veçantë e temës bashkëkohore pér letërsinë dhe artet në etapën e tanishme të zhvillimit

të shoqërisë. Ngritja e kulturës dhe ecja përpara e arsimit pas pak vjetësh do t'i vënë letërsinë dhe artet para lexuesish e spektatorësh të rinj. Këtë perspektivë, në përgjithësi, e ndiejnë shumica e shkrimtarëve dhe artistëve, e ndiejnë edhe domosdoshmérinë e përvetësimit të temës bashkëkohore, e ndiejnë edhe domosdoshmérinë e kërkimeve novatore të mjeteve artistike, pa të cilat nuk përballohet pasqyrimi i realitetit. Prandaj, detyrat estetike, çështjet e gjuhës, stilit, ndërtimit të subjekteve, trajtimit të karaktereve, problemet e thurjes së materialit, parimet e pasqyrimit të psikologjisë së njerëzve, të gjitha këto marrin një rëndësi esenciale. Kjo është e natyrshme: përbajtja e re do të kërkojë dhe formë të re. Thellësia psikologjike është një domosdoshmëri imperative për veprat e prozës dhe të dramaturgjisë, që pasqyrojnë lindjen dhe rritjen e njeriut të ri. Po të flasësh për poezinë, duke thelluar përbajtjen, ajo gjithmonë e më tepër çlirohet nga elementet e retorikës dhe deklaracionit dhe afirmon lirizmin dhe epizmin, si lloje të analizës artistike dhe shprehje të jetës shpirtërore të njeriut.

Përveç kësaj, kjo do të ndihmojë për forcimin e origjinalitetit kombëtar të letërsisë dhe arteve. Vetë pasqyrimi i shumanshëm i jetës së shoqërisë socialiste do t'i japë tipare të reja karakterit kombëtar. Përderisa socializmi ndërtohet në një vend të caktuar e në kushte të veçanta historike, edhe letërsia dhe arti që pasqyrojnë këtë proces do të kenë tipare origjinale. Fytura e përgjithshme e letërsisë, përbajtja dhe forma e saj, është e lidhur ngushtë me origjinalitetin kombëtar, të ndërtimit të jetës, me veçoritë ekonomike, politike e kulturore; është e lidhur ngushtë me konstitucionin shpirtëror të popullit, me gjithë historinë e vendit. Origjinaliteti kombëtar i shkrimtarit reflektohet qartë në veprën e tij, në përbajtjen e saj dhe në mjetet shprehëse, në fryshtën e përgjithshme dhe në stilin.

Një nga elementet më dalluese dhe më aktive që shpreh karakterin kombëtar në krijimtarinë artistike është patriotizmi i shkrimtarit, është origjinaliteti i këtij patriotizmi. Karakteri kombëtar i letërsisë reflektohet në forcën edukuese të saj me dashurinë për vendin dhe me edukimin e ndjenjës së detyrës qytetare e militante. Shkrimtari i vërtetë është patriot që lufton për përparimin e vendit të vet. Ky patriotizëm dallohet në gjithë veprën e tij, dallohet edhe në detajet më të vogla të saj, madje edhe në mënyrën se si përshkruhet pejzazhi i vendit. Një shembull i ndritur është

Naim Frashëri, vepra e të cilit përshkohet fund e krye nga dashuria për Shqipërinë dhe për natyrën e saj, nga dëshira për ta parë atë «zonjë». E nga kjo dëshirë janë djegur gjithë shkrimtarët tanë përparimtarë e revolucionarë, të djeshëm e të sotëm. Sa herë në vjersha dhe artikuj është përsëritur atributi «zonjë» e «nënë», atribut i Shqipërisë.

Por pasqyrimi i veçorive kombëtare dhe në përgjithësi karakteri kombëtar nuk mund të qëndrojnë të shkëputur nga lufta e klasave dhe nga historia. Çështja e karakterit kombëtar në krijimtarinë e shkrimtarit është e lidhur ngushtë me tendencën ideore të krijuesit. Pozicioni ideor i shkrimtarit përcakton dhe kuqtimin e patriotizmit, edhe karakterin kombëtar. Fishta shkruante me gjuhën shqipe, përdorte me mjeshtëri tetërrrokëshin, e jepte originalitetin e ambienteve shqiptare, shfrytëzonte këngët popullore, por tendencia ideore e tij ishte reaksionare, pasi ajo përfaqëson interesat e klasave shfrytëzuese, antidemokratike dhe obskurantiste. Për Fishtën, ky ishte karakteri kombëtar dhe ky «originalitet» e bënte të dallonte në formë nga shkrimtarët reaksionarë të vendeve të tjera, por të bashkohej me ta nga tendencia ideore reaksionare. Te shkrimtari anglez Kipling karakteri kombëtar shfaqet në kolonizatorin aventurier që kolonizon popujt. Për shkrimtarin e sotëm shqiptar karakteri kombëtar shfaqet në patriotizmin, në dashurinë për atdheun e vet, në luftën për ndërtimin e socializmit dhe në fryshtë internacionliste. Prandaj themi se karakteri kombëtar lidhet ngushtë me tendencën ideore, me tendencën klasore.

Vlerësimi i rëndësisë kombëtare të shkrimtarit është i lidhur me fryshtë popullore të veprës së tij. Vepër me fryshtë popullore është ajo që shpreh në shkallë të lartë interesat dhe synimet përparimtare të popullit, që është e afërt për popullin edhe në përbajtje edhe në formë. Fryma popullore arrihet kur shkrimtari në vepër trajton probleme jetësore, që kanë rëndësi të madhe për jetën e popullit. Pa fryshtë popullore nuk mund të shprehet karakteri kombëtar. Forma më e lartë e shprehjes së fryshtës popullore në art është partishmëria proletare, kuintesanca e tendencës klasore, e ideologjisë së klasës punëtore. Partishmëria proletare e vë artin në shërbim të socializmit, në shërbim të edukimit komunist të njerëzve. Socializmi i shpreh plotësisht interesat e popullit. Prandaj arti socialist është thellësisht popullor. Karakteri kombëtar nuk është një kategori e pandryshueshme. Ai ndryshon me ecjen përpara të shoqërisë dhe

fiton tipare të reja. Pasqyrimi më i plotë i jetës së shoqërisë do ta pasurojë më tej edhe karakterin kombëtar dhe artet do të fitojnë origjinalitetin e tyre të papërsërithshëm.

Socializmi dhe pasqyrimi i tij në arte i gjallëron dhe i rifreskon gjithë qelizat e krijimtarisë letrare artistike. Nuk shتروhet problemi që letërsia dhe artet tona kanë pak vepra që trajtojnë shumanshmërinë e realitetit socialist. Vepra ka në letërsi, në kinematografi, në artet figurative e kudo. Por një pjesë e ndjeshme e tyre nuk trajtojnë anët themelore të realitetit. Fjala vjen, të marrim romanin e A. Cergës «Vëllezërit». Kritika është opinioni i lexuesve e kanë pritur mirë. Me këtë opinion edhe ne pajtohem. Sfondi i këtij romani është ndërtimi i Hidrocentralit të Fierzës. Por konflikti thjesh-tësohet nga natyra fragmentare e veprës. Graviteti i ngjarjeve dhe i problemit zhvendoset edhe shkon në pikën më të lehtë, në sferën e bisedave të këndshme dhe shakarave të shokëve e miqve. Pse ndodh kjo? Ndodh nga druajtja për kapjen e konflikteve të mëdha në sfondin e punës, atje ku afirmohet moral i ri. Ose të vijmë te filmi televiziv serial «Agimet e stinës së madhe» të A. Mingës, me skenar të V. Koreshit. Përveç trajtimit të zbehtë të njëres nga periu-dhat më kyçe të revolucionit, të Reformës Agrare, përveç pasqyrimit skemistik të mjaft karaktereve, si të sekretarit të Partisë, të fshatarëve e të tjerë, edhe në këtë vepër ka spostim të pikës së gravitetit. Reforma Agrare në Myzeqe ua mori tokën çifligarëve. Fshatarësia me ta u ndesh. Në film graviteti bie në bandat diversante dhe në kulakët. Kulakët ishin dukuri tipike e mëvonshme, me vite pas Reformës Agrare. Doemos, në film ka edhe figura me gjetje origjinale si ajo e Soll Lilit dhe Latif Borës, të cilët tregojnë mjesh-tërinë e regjisoret, kur ka materialin letrar. Filmi kishte mundësi të dilte interesant, po të punohej më mirë skenari dhe po të mos kërkoheshin rrugë të lehta pasqyrimi. Është edhe një herë, që shpesh në pasqyrimin e realitetit të sotëm e historik ndjekim rrugën më të lehtë. Dukurinë e vështirë sa e kapim, e shpiem gjer në një vend dhe e lëshojmë për të gjetur një shteg më komod për zgjidhjen e problemit. Kjo rrugë nuk të lejon të pasqyrosh shumanshmërinë e realitetit dhe rrjedhimisht sjell shpërpjestime në tematikë, ulje të cilësisë së artit e pasoja të tjera.

Për kompletimin e tablosë së madhe të epokës socialiste në art ka rëndësi rritja e ndërgjegjes së shkrimtarit përmisionin e tij. Kur shkrimtari i talentuar ndien se edhe vetë

ai është një ndërtues i socializmit, se edhe vetë ai mban përgjegjësi për misionin e tij shoqëror, atëherë e ngralart në veprat e tij epokën ku jeton. Atëherë ai nuk është indiferent ndaj zërit të Komanit ose të Myzeqesë, të Metalurgjikut ose të Malikit. Mendoj se ne kemi nevojë të bëhemë më të ndjeshëm ndaj këtyre zërave. Pak synojmë për kënaqësitë e mëdha estetike, që rrjedhin nga zbulimet e mëdha artistike. Zbulimet e vockla sjellin kënaqësi të vockla estetike.

Për kompletimin e tablosë së epokës sonë është e domosdoshme të shkruajmë me mendime të mëdha. Mjaft veprat e letërsisë dhe arteve kanë fakte të vogla dhe mendime të vogla të skematizuara. Kohët e fundit kjo dukuri është shfaqur në kinematografi, në poezi dhe në tregim, pasi tema aktuale është konfonduar me momentalen dhe ditoren e sipërfaqshme. Të sjellim në mend filmin «Një udhëtim i vështirë» të regjisoreve Petrit Llanaj dhe Xhezair Dafa. Në këtë film tregohet se si dërgohet një makineri e rëndë nga Durrësi në një vend tjeter. Tregohet vetëm udhëtimi dhe disa shqetësime të shoferit. Dihet që ngarkesa do të kalojë ura, dihet që shoferin do ta presin me lule, dihet jë do t'i japid edhe një fletë lavdërimi. Ka dramë? Të marrim romanin e Dh.Xhuvanit «Shtegu i bardhë». Pse është harruar? Është harruar pasi nuk përban temën jetëgjatë ose të përjetshme. Romani tregon për rritjen e dhive. Dhia idealizohet dhe del si shpëtimtarja e ekonomisë popullore. Shkrimitari ka marrë shfaqjen e sipërfaqshme të temës dhe këtë shfaqje e ka idealizuar. Po të shkruante për gjykimet e njeriut për dhinë, të tregonte jetën dhe psikologjinë e krahinës dhe të njerëzve të saj dhe dhinë ta kishte si një element, si një sfond pune të njeriut, atëherë tema nuk do të ishte ditore e momentale. Dh. Xhuvani, që ka një përvojë të pasur letrare, e ka treguar mjeshtërinë e tij si prozator prodhimtar me romanin me temë aktuale «Përsëri në këmbë» dhe veçanërisht me veprën e fundit «Vdekja e zotit Kaloti», që dëshmon për rritjen e tij si personalitet letrar. Romani «Shtegu i bardhë» është një përpjekje e pasuksesshme që mund t'i ndodhë çdo shkrimitari. Megjithatë, ruajtja nga skematizmi duhet të jetë një kërkësë e përhershme e çdo krijuesi. Në luftë me skematizmin ne duhet të afirmojmë më shumë njeriun dhe veprën e tij. Është e meta jonë që i vëmë më shumë rëndësi në letërsi mjetit të punës sesa njeriut që përdor këtë mjet. Mjetin e shpirtërojmë dhe njeriun e çshpir-

tërojtmë, ia heqim shpirtin. Kjo sjell skematizmin, tema shndërohet në ditore të sipërfaqshme dhe ka jetë të shkurtër.

3. Në pasqyrimin më të plotë të jetës së shoqërisë sociale kërkohet ruajtja e letërsisë dhe e arteve nga liberalizmi. Edhe ky problem ka të bëjë me rritjen e cilësisë së krijimtarisë letrare e artistike. Pa luftën e pandërprerë ndaj liberalizmit artistik nuk mund të ketë përmbajtje të pastër dhe formë të pasur e të përparuar. Me zhvillimin dhe konsolidimin e metodës së realizmit socialist ashpërsohet edhe lufta kundër paragjykimeve dhe trajtimeve libreske, të zbehta, fraziste dhe skematike të realitetit dhe të jetës së njeriut dhe bashkë me këtë rritet edhe ofensiva kundër liberalizmave artistike. Metoda e realizmit socialist është kundër çdo lloj skeme, qoftë kjo konservatore, qoftë liberale. Kjo metodë vetë është vazhdimisht në evoluim dhe nuk ka në natyrën e vet pranimin e formave të ngurta, prandaj bën një luftë të përhershme kundër skematizmit, që frenon ecjen përpëra dhe që ndrydh kërkimet novatore. Por, duke mohuar skematizmin, nuk mund të harrojmë për asnjë çast luftën kundër liberalizmave që shfaqen në formën e ndikimeve të huaja. Ne nuk e bëjmë luftën kundër skematizmit për t'ia lëshuar pak frerin liberalizmit. Përkundrazi, mospranimi i skematizmit krijon atmosferën mbytëse edhe për liberalizmin. Megjithatë, liberalizmat dhe ndikimet e huaja gjithmonë mbeten një rrezik kanosës për letërsinë dhe artet, prandaj kundërshtimi i tyre dhe lufta e papajtuar mbeten në rend të ditës për çdo shkrimitar dhe artist.

Ndikimet e huaja mund të depërtojnë në çdo lloj teme, por në aktualen sociale ato qëndrojnë përherë në gatishmëri dhe veprojnë shpejt, duke sjellë dëme veçanërisht në partishmérinë komuniste. Në temën aktuale ato shfaqen më shumë në pamjen e deformimit të realitetit e të nxirjes së tij me dashje a pa dashje. Nga mungesa e formimit të plotë botëkuptimor shkrimitari dhe artisti ndonjëherë nuk shikon kryesoren në jetë, por merr ndonjë njollë, që e gjen në shoqëri dhe e stërmadhon, duke i dhënë asaj një domethënë përgjithësuese, që nuk ia vlen barra qiranë. Tjetër gjë është kur letërsia nuk i mbyll sytë ndaj të metave në shoqëri, por u bën atyre gjyqin e saj të rreptë, e nisur nga pozitat e interesave të popullit. Në letërsinë e realizmit socialist personazhet polemizojnë, afirmojnë e mohojnë dhe ata që bëjnë gabime e krite kritikohen

e dënohen për hir të fitores së idealeve të larta. Po t'i vësh-trojmë kështu dukuritë, nuk gabojmë.

Përvoja letrare e artistike na tregon se herë pas here kemi pasur të bëjmë me shtrembërimë në prozë, poezi, muzikë, kinematografi e në artet figurative. Më të theksuara kanë qenë në poezi, ku janë shfaqur veçanërisht në sistemin figurativ të saj, në vargjet e paqarta e të palidhura, në mun-gesën e logjikës etj. Liberalizmat në poezi shfaqen edhe në formën e indisiplinimit të vargut, të shuarjes së kufirit ndërmjet prozës dhe vjershës etj. Por shfaqen edhe në manierën për origjinalitet të shprehjes, p. sh.: «Bajram Curri në Dragobi e priste vdekjen duke pirë kafe», ose «Ti që ke vjedhur dy dérrasa je një superfuqi» e banalitetë si këto. Edhe këto lloj ndikimesh e ulin cilësinë e artit, në qoftë se lejohen të shfaqen. Prandaj është e domosdoshme të ngremë nivelin e formimit botëkuptimor marksist-leninist.

Në botë sot ziejnë e veprojnë lloj-lloj rrymash e tendencash letrare, artistike e filozofike, që kanë ulur dhe dëmtuar rëndë vlerat e arteve perëndimore dhe lindore. Është një ekspansion i tërë kulturor që kanë ndërmarrë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimt Sovjetik në gjithë vendet satelite të tyre. Ky ekspansion është bërë politikë zyrtare e dy superfuqive. Nga ky ekspansion përhapen shthurjet, degjenerimet, vrasjet, skandalet dhe epshet e shfrenuara përmes letërsisë dhe arteve. Është një industri e tërë fjale, ngjyre dhe tingulli, e cila, e degëzuar në rryma, drejtime artistike e stile, vjen e mblidhet në një të vetme: në drogën kundër ndërgjegjes njerëzore që degradon njeriun. Sot janë ringjallur dhe kanë marrë forcë popullarizuese me veshje të reja teoritë subjektiviste dhe idealiste të Frojdit, sidomos ato që kanë të bëjnë me seksin dhe rolin e tij si stimulant të letërsisë dhe artit. Përhapje të tillë ka gjetur edhe teoria e tij për èndrrat dhe interpretimin e tyre, për kufirin e èndrrës dhe realitetit, ku këshillohet që në një vepër letrare ky kufi sa më shumë të shuhet, aq më dobi sjell. Në librin «Interpretimi i èndrrave» Frojdi shkruan: «Èndrra që shihet në gjumë përfaqëson realizimin e (fshe-hur) të dëshirës (së ndrydhur).» Sipas tij, trajtimi në art i tyre është shumë i rëndësishëm, pasi edhe artisti shpreh dëshirën e fshehur e të ndrydhur në veprën e vet. Prandaj në Perëndim e në Lindje shkruhen mijëra romane, në faqet e të cilave nuk dallon se ç'është èndërr e ç'është realitet. Kjo turbullon ndërgjegjen e konsumatorëve të artit.

Banditi dhe egoisti, imorali dhe narcisti janë bërë heronjtë e letërsisë perëndimore dhe lindore. Vetë kritika perëndimore pohon se narcisti i kohës moderne është njeri pa ideale, indiferent ndaj gjithë shqetësimeve. Të gjitha çështjet e rëndësishme ai i mbyll në burgun e vetes së tij.

Nëpërmjet ekspansionit kulturor e artistik kapitalizmi dhe revizionizmi përhapin edhe forma e struktura të degjeneruara. Më lejoni të sjell si shembull dy vjersha nga dy poetë të dy vendeve kapitaliste. Një poet amerikan, N.Miler, shkruan këtë vjershë me titull «Vdekje për ledin dhe fatkeqësi të tjera», të cilën po e lexoj të gjithën:

Kos,	thelb,
bubullimë,	bukë,
kishë,	vrasës,
genie,	nënë,
gjak	gjarpër
dhe	dhe masë,
dru,	

Një poet tjetër gjerman, O. Gomringen, ka këtë vjershë me titull «Ping-pong»:

Ping-pong,
ping-pong-ping,
pong-ping-pong,
ping-pong!

Edhe nga këta dy shembuj ndihet se gjer në ç'pikë të degjenerimit ka shkuar forma e artit, veçanërisht forma e poezisë. Dhe sipas estetëve borgjezë, kjo është forma e kohëve moderne. Kësaj lloj poezie ne ia kemi mbyllur dhe do t'ia mbyllim derën përgjithmonë.

Letërsia dhe artet tona, duke ngritur nivelin cilësor të tyre, duke forcuar përbajtjen dhe duke përsosur formën, nga një anë do të mbrohen më mirë nga çdo ndikim negativ dhe nga ana tjetër do të rritin autoritetin e tyre edhe në botën e jashtme. Me këtë ne do të japim kontributin tonë modest në kulturën botërore, siç po ndodh në dhjetëvjecarët e fundit. Janë një sukses i dukshëm për autoritetin e kulturës sonë botimet letrare në vende të botës, si romanet, tregimet e

vjershat e disa prozatorëve e poetëve të njohur. Gjithashtu kontribut për përhapjen e arteve tona kanë qenë turnetë e ansambleve artistike dhe ekspozitat e arteve figurative. Kjo veprimitari është vetë një formë e luftës për përhapjen e idealeve tona.

Kultura jonë, me nivelin e saj cilësor, është një kulturë vitale, e aftë për t'i transmetuar botës vlerat e veta dhe e aftë për të marrë nga bota gjithçka përparimtare, humane dhe revolucionare. Lufta kundër liberalizmave dhe ndikimeve të huaja ne nuk na ka mbyllur dhe izoluar nga kultura botërore, përkundrazi, na ka bërë më të zotët në përvetësimin e saj dialektik. Vazhdimisht ne përkthejmë letërsi të përparuar që ka krijuar njerëzimi në shekuj. Është fakt që te ne tanimë janë përkthyer gati të gjithë klasikët, që nga Homeri e gjer te shkrimitari i kohëve moderne. Por, megjithatë, është e domosdoshme të zgjedhim më shumë vepra të letërsisë bashkëkohore botërore për t'i përkthyer e për t'ua dhënë lexuesve tanë, vepra me vlera në përbajtje e në formë, pasi edhe ato luajnë rol në ngritjen e nivelit kulturor dhe ndikojnë në rritjen e cilësisë së arteve tona.

Në lexuesit tanë përhapje të gjerë ka marrë letërsia që krijohet në Kosovë. Pothuajse të gjithë shkrimitarët e Kosovës janë botuar nga shtëpia botuese «Naim Frashëri» dhe gjëzojnë popullaritet te lexuesit, shkrimitarët dhe artistët tanë. Kjo është një letërsi në zhvillim, me patos patriotik e përparimtar e me nerv të ndjeshëm. që zbulon para nesh vlera të vërteta estetike. Letërsia dhe artet e vërteta të një trungu nuk është e mundur të izolohen, sado përpjekje të bëjnë keqdashësit dhe shovinistët titistë. Ato do të përhapen vazhdimisht dhe do të kenë mijëra e mijëra lexues dhe dashamirë. Edhe ato e luajnë rolin e tyre në kulturën tonë, në pasurimin e saj dhe në rritjen e cilësisë. Dhe sa herë të flitet e të diskutohet për letërsinë shqiptare, nuk do të heshtet për pjesën e rëndësishme të saj që krijohet në Kosovë me të njëjtën gjuhë dhe me një origjinalitet të theksuar kombëtar.

II. Cili është raporti cilësor ndërmjet temës së sotme dhe të djeshme, ndërmjet artit të kultivuar dhe popullor?

Një nga kërkesat e cilësisë së letërsisë dhe arteve është edhe raporti tematik në përgjithësi dhe në veçanti ndërmjet temës së sotme dhe të djeshme. Doemos ky raport nuk mund të matet me aritmetikën e thjeshtë dhe me përqindje të zakonshme. Megjithatë, mesatarja e përgjithshme mund të ndihet, po të ndiqet me vëmendje procesi letrar e artistik i një periudhe të caktuar. Nga gjurmimet që kemi bërë, vihet re se raporti i tematikës në përgjithësi është i drejtë. Por duke u thelluar në vëzhgimet dhe studimet, dalin disa probleme, që na bëjnë të mendohemi. Këto probleme kanë të bëjnë me kërkesat e cilësisë së letërsisë dhe arteve.

1. Cilësia e arteve varet shumë nga raporti i tematikës së krijimtarisë së personaliteteve të shquara të letërsisë dhe arteve në periudha të caktuara. Dihet se artin e bën gjithë masa e shkrimtarëve dhe artistëve dhe nuk e bëjnë tre-katër veta. Kur themi të ngrihet niveli artistik i krijimtarisë, e kemi fjalën për rritjen e cilësisë së mesatares së arteve tona dhe jo të veprave të tre-katër shkrimtarëve dhe artistëve. Rritja e cilësisë së mesatares së krijimtarisë ndikon në formimin e një klime të shëndoshë novatore, duke i nxitur krijuesit në kërkime të reja të vazhdueshme. Por në rritjen ose uljen e cilësisë së mesatares së krijimtarisë dhe në harmonizimin më të mirë të raportit të tematikës, luan rol të ndjeshëm shembulli i veprave të personaliteteve të shquara të kulturës e të artit tonë. Me autoritetin e tyre shoqëror dhe artistik ata tërheqin me vete qarqe të tëra krijuesish, duke ndikuar në formimin e shijeve estetike të caktuara dhe në preferencat e temave dhe stileve, pasi kanë forcë imponuese. Kjo forcë imponuese në shije e stil vepron më shumë gjersa të dalin të tjerë personalitete dhe të rriten autoritete të shquara artistike. Po e ilustrojmë këtë mendim me disa shembuj të kohëve të fundit. Kur tre nga personalitetet e shquara të letërsisë sonë: I.Kadare, S.Godo e S.Spasë shkruan disa vepra me vlera të ndjeshme me temën e së kaluarës historike, si «Kështje-

lla» «Skënderbeu» dhe «Zgjimi», u vu në lëvizje një valë shkrimesh të kësaj natyre, disa prej të cilave ishin të suksesshme. Por vala tjetër më e madhe u ndie, përvèç arsyeve të tjera, edhe ngaqë I.Kadareja shkroi një cikël të téré me temën e lashtësisë dhe të periudhës së mëvonshme historike, si «Ura me tri harqe», «Pashallëqet e mëdha», «Kush e solli Doruntinën», «Prilli i thyer», «Nëpunësi i pallatit të èndrrave» e ndonjë tjetër. Atëherë u dukën në rrugën e proceseve artistike kalorës të tjerë, duke vrapuar me shpatën e kësaj teme. T.Laço hidhet në «Korbat mbi mermer», F.Kraja nxjerr në skenë dramën «Gjaku i Arbit» me temën e Ðoruntinës, J.Dini boton «Kështjellën mbi Barbanë», K.Błushi jep pjesën teatrale «Tragjedia e Deas», V.Koreshi shkruan «Haxhiu i Frakullës», S.Drini publikon «Vraje tradhtinë» dhe M.Zeqo, pasi kreu «Kalorësit dardanë», u mor me «Pedagogun e Kopernikut». Të kupþohemi, nuk vëmë në dyshim aspak vlerat e vërteta të disa prej këtyre veprave, pasi ato i kanë shkruar shkrimitarë me përvojë dhe të talentuar. Por duam të vërtetojmë mendimin se q'rol mund të luajnë personalitetet artistike në thyerjen e raportit të tematikës dhe në përgjithësi të cilësisë së arteve. Të mos harrojmë se pas këtyre veprave vërvshuan në shtypin letrar edhe tregime e vjersha për ilirët, Mesjetën dhe shekullin e 19-të, për figura historike e letrare të atyre kohërave. E vërteta duhet vështruar pa drujtje, në sy, se e vërteta nuk mban hatër. Edhe disa figura të shquara të letërsisë, si Sh. Musaraj e F. Gjata, për arsyet krejt objektive dhe të natyrshme të temës së tyre të preferuar të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ka vite që nuk kanë shkruar për të sotmen. Ata e kanë bërë jetësore temën e Luftës dha nuk shkëputen dot, pasi èshtë rinia e tyre. Dhe nga rinia njeriu nuk ndahet. Ata kohët e fundit botuan «Belxhiku që këndon vence» dhe «Këshilltarët», me një material të pasur jetësor nga periudha e luftës partizane dhe me nivel të ngritur artistik. Për gjithë letërsinë dhe artet tonë tema e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare èshtë dhe do të mbetet aktuale dhe askush nuk qortohet as për trajtimin e saj dhe as për atë të hershmen historike. Shoqëria kërkon cilësi dhe një përpjesëtim më të drejtë të tematikës e problematikës; kërkon që, në radhë të parë, autoritetet letrare të merren më gjerësisht me temën e ndërtimit socialist, pa i harruar të tjerat. E theksojmë këtë, pasi po ti largojmë

të gjitha këto personalitetet letrare nga fusha e temës aktuale, që përgjithësisht nuk e kanë lëvruar vitet e fundit, atëherë pesha e pasqyrimit të realitetit socialist mbetet në shkrimtarët e rind dhe të tjerë që apo janë formuar.

Doemos, ne do të vazhdojmë të shkruajmë për lashi-tësinë dhe të kaluarën tonë historike, pasi veprat me këtë temë, me tingëllimin aktual të tyre edukojnë ndjenjën patriotike e estetike, edukojnë krenarinë kombëtare dhe pasurojnë letërsinë dhe artet, por personalitetet letrare e artistike që përmendëm më lart, duhet të vënë në fokusin e krijimtarisë së tyre më shumë jetën e shoqërisë socialistë dhe problemet e saj.

Shkrimtari është njeri vital shoqëror, është bashkë-kohës i epokës së tij. Të gërmojë në histori? Të regjistrojë etapat e periudhat si historian pedant? Jo! Edhe historia duhet ta ndihmojë që ta shohë më mirë, më qartë të sotmen, e cila jeton, lufton dhe zien përreth tij. Aktualiteti i jep temës historike problemin dhe tingullin e saj. Kjo është me rëndësi të madhe. Historia jep faktin dhe temën. Po fakti dhe tema vdesin pa problemin dhe tingëllimin. Në këtë raport dialektik jetojnë temat. Kemi shembuj kuptimplotë për të vërtetuar këtë mendim. «Kështjella» e I.Kadaresë e ka temën nga historia e shkuar, por kjo temë shikohet nga lartësia e aktualitetit. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për novelën «Ura me tri harqe», botuar në vëllimin me të njëtin titull. Në rigjallërimin e materialit historik, për trajtimin e tij me një formë të shkathët bashkëkohore ai ka merita të shquara në letërsinë tonë. Por duam të bëjmë një objektion. Në veprat e fundit, si «Prilli i thyer», «Kush e solli Doruntinën» dhe veçanërisht në novelën e ripunuar «Nëpunësi i pallatit të ëndrrave» ka probleme ideore dhe estetike, me të cilat nuk mund të pajtohem tërësisht. Edhe pse nuk do të zgjatemi duke bërë analiza të imëta, do të donim të shtonim se në këto vepra ka trajtime subjektiviste të materialit historik dhe të legjendave, ka një modernizim dhe një aktualizim të tepruar, që lë shteg për interpretime të ndryshme. E shohim me vend të themi se modernizimi i legjendës dhe historisë nuk duhet të kthehet në një manierizëm, pasi shndërrohet në monotonji që dobëson vlerën e artit të vetë autorit. Aktualizimi i tepruar i ngjarjes, psikologjisë së njerëzve, fjalorit, terminologjisë dhe koncepteve bën që në vepër materiali i nxjerrë nga e kaluara të humbasë përbajtjen historike e të mbetet vetëm si një

mjet i thjeshtë për të transmetuar disa ide subjektiviste të autorit.

Mendoj se shkrimtarët e shquar, që kanë dhënë një ndihmesë të madhe në zhvillimin e letërsisë shqiptare, duhet të jenë gjithmonë të kujdeshëm dhe përherë të mësojnë nga teoria e Marksit dhe e Leninit bashkë me përvetësimin dialektik të kulturës botërore. Ta mbajmë mend një thënie të Marksit, që e citon shoku Enver në Plenumin e 15-të të KQ të Partisë më 1965: «Nga duart e mia, — i thotë Marksi Engelsit, — kurri nuk ka dalë dhe nuk do të dalë asgjë që të mos jetë e përsosur.» Dhe këtu Marksit e ka fjalën për përsosjen ideologjike të përbajtjes.

Kësaj duhet t'i vënë rëndësi jo vetëm letrarët dhe shkrimtarët e rinj, por edhe ata që kanë përvojë të madhe në krijimtari. Kur flasim se ndikimet e huaja cënojnë përbajtjen dhe ulin ciliësinë e artit, nuk ua referojmë këto fjalë vetëm letrarëve të rinj, por të gjithëve. Ndikimet nuk njojin moshë, nuk njojin talent dhe nuk njojin nomenklaturë. Ato i tremb vetëm teoria marksiste, vetëm para saj dridhen. Edhe kritika letrare nuk duhet t'i shohë moshat dhe përvojat letrare, por rezultatin e veprës. Ajo duhet t'i kërkojë vetes përsosjen ideologjike të përbajtjes, pa harruar formën dhe problemet estetike.

Kritika letrare është e domosdoshme të kthejë vëmendjen edhe ndaj dukurisë së modernizimit të lashtësisë, legjendës e historisë, megjithëse dicka ka vënë re. Ajo kur shikon se veprat kanë probleme të diskutueshme, të ndalet në to me seriozitetin më të madh dhe të mos i shpërndajë pa **menduar** dhe aq lirë epitete të **tilla, si: «akpen kyçet e historisë», «momentet kulminante», «temat madhore» etj., në një kohë kur besoj se edhe vete autori **nuk** i ka këto pretendime. Kështu, në **një shkrim**, botuar në revistën «Nëntori» nr. 12, Viti 1981, për ciklin e novelave të lartpërmendura të I.Kadaresë, pa bërë ndonjë **dallim** vepre, shkruhet se autorin e këtij cikli «e interesojnë në radhë të parë probleme dhe momente kyçe të historisë». Të njëjtën gjë, por me një ton më të ngritur, në një **artikull** tjetër botuar në gazeten «Drita», më 11 janar 1981, për librin «Gjakftohtësia», ku janë novelat që përmendëm, thuhet: «Nga tërë ky zhvillim historik, I. Kadareja ndalet sidomos në momentet kulminante, në kthesat dramatike, nxjerr prej këndeje përvojën historike dhe e jep atë të përgjithësuar artistikisht me forcë krijuese që të bën për vete, gjithnjë me originalitet, me meditime e analiza të**

holla psikologjike, me një gjuhë të figurshme të pasur dhe me neologjizma që meritojnë vëmendjen e veçantë të gjuhëtarëve.»

Bëhet pyetje, a e kuptojmë se çdo të thotë, në radhë të parë, fjala kyç, pastaj termi kyç i historisë? Po të kishte kaq shumë kyçe jeta, në njëzet e katër orë do të kalonim nga një kyç në tjetrin. Ne kemi vend se ku t'i përdorim termat kyç dhe momentet historike në letërsinë tonë, qoftë në veprat e I.Kadaresë, qoftë në veprat e autorëve të tjerë. Për temat kyçe mund të shquash ato të romaneve «Kështjella», ku pasqyrohet lufta e popullit nën udhëheqjen e Skënderbeut, «Dimri i madh», ku trajtohet lufta kundër revizionizmit hrušovian, «Gjenerali i ushtrisë së vdekur», ku del ideja se kush shkel këtë vend lë kockat. Ti, i dashur kritik dhe kolleg, pse ke qejf të gjesh medoemos momente kyçe dhe momente historike edhe atje ku nuk ka?

Pastaj kritika është e domosdoshme të jetë objektive dhe t'i përbahet kësaj kërkese gjithmonë, në çdo rast dhe moment. Ajo nuk duhet të jetë as shërbyses, as servile e personaliteteve letrare; nuk duhet të jetë gjithashtu as inatçeshë ndaj tyre; por nuk duhet të jetë e lëkundur ndaj opinionit subjektivist të njërit ose tjetrit që ka ose nuk ka simpati për këtë dhe atë shkrimitar; nuk duhet të jetë as denigruese dhe as përkëndhelëse dhe lajkatare; më në fund, edhe shkrimitari të mos e shikojë kritikën me këtë moral: Më thuaj se ç'mendim ke përmua, që të të them se cili je.

Pas këtij introduksioni le të vazhdojmë më tej me problemen e veprave me temë nga e kaluara, të cilat ndonjëherë gabimisht i quajmë historike. Për këtë nuk ka nevojë të zgjatemi. Të vijmë vetëm te romani i T.Laços «Korbat mbi mermer» e me radhë dhe të përpinqemi të ngremë ndonjë problem në dritën e mësimeve të Partisë.

Në romanin «Korbat mbi mermer» T.Laço u hodh pas veprave me temë aktuale «Tokë e ashpër» dhe «Përballimi», ku tregoi konsolidimin e personalitetit të tij letrar, konsolidim që erdhi përmes trajtimit të temës së shoqërisë sociale, të cilën e pat njohur. Pa i matur si duhet forcat, pa qenë i sigurt në rezultatin, u hodh në temën e së kaluarës. Kjo hedhje nuk ishte aq e këndshme, se i mungonin stërvitjet. Romanit «Korbat mbi mermer» nuk i mjafton materiali i gjallë dhe, mbi të gjitha, problemi, që është lokomotiva e çdo vepre në prozë. Prandaj, romani nuk ka domethënienie dhe filozofi. Atje ka një stërvitje për përdorimin

e fjalës mbi faktin e pamjaftueshëm, stërvitje për ornamentin e kësaj fjale jashtë konkretësisë. Për të gjitha këto romani s'ka emocione, ashtu si nuk kanë emocione sendet arkeologjike pa i ekspozuar për njerëzit. Po flas në këtë mënyrë, pasi problemi ka temë nga arkeologjia. Për emocionin Lenini thotë: «pa emocione njerëzore kurrë s'ka pasur, s'ka dhe s'do të ketë kërkim njerëzor të së vërtetës».¹⁾ Si përfundim, zhurma e temës të së kaluarës, që vjen nga të tjerët, nuk duhet ta rrëmbejë një shkrimtar që ka treguar zotësi në fushën e pasqyrimit të aktualitetit. Largimi nga fusha e njojur mirë dhe hedhja në një fushë tjetër pa i matur forcat, pa bërë stërvitje, pa dërguar zbuluesit dhe pararojën, të bën që të humbasësh betejën.

Tani po bëjmë një përgjithësim që na takon të gjithëve. Populli, që është më i madhi nga të gjithë, na ka dhënë legjendat, ndodhirat, folklorin, arkeologjinë, faktet e jetës dhe historinë. Ai na i ka dhënë për t'i mbajtur mirë, për t'i nikoqirur mirë dhe për t'i shfrytëzuar mirë. Ðhe populli nuk dëshiron që këto t'i shpërdorojmë kur t'i shkruajmë, pasi vjen një kohë që të thotë: «Djalë, mblidh mendjen, se këto që kam krijuar unë nuk të lejoj t'i bësh si të duash. Madje, edhe ato që krijon ti vetë, do të më pyesësh mua dhe do të më respektosh mua, se ta heq veshin pastaj.»

Ta ndjekim më tej problemin. Janë shkruar edhe romane të tjera nga e kaluara dhe historia, si «Mic Sokoli» i S.Krasniqit, «Kështjella mbi Barbanë» i J.Dinit, «Vraje tradhtinë» i S. Drinit, «Atentat në Paris» i S. Këlliçit, «Sos për mua a për ti» i M.Kallamatës e me radhë, të cilat, kush më shumë e kush më pak, kanë vlera, sidomos njoħeše, dhe janë ndjekur me interes nga lexuesit. Nga këto menjdoj se shquhet më tepër «Mic Sokoli» i S.Krasniqit, që vërtet nuk ka shumë zbulime të reja artistikë, por ka material të pasur, historia merr jetë përmes pasqyrimit të karakteristikave dhe figurave të gjalla të lëvizjes patriotike të popullit tonë.

Tema historike nuk ka një mënyrë trajtimi, mënyrat janë të shumanshme dhe nuk duhet t'u japim autorëve receta. Marks thoshte se trëndafilit nuk duhet t'i kërkojmë që të mbajë erë manushaqe. Ndryshe e trajton temën historike I.Kadare, ndryshe Dh.Shuteriqi, ndryshe S.

1) (V.I. Lenin: Vepra të plota, vëll. 25, fq. 112, bot. rus.)

Spasse ndryshe S.Godoja etj. Kryesorja qëndron në përbajtjen e shëndoshë dhe në formën e përsosur. Nuk duhet të nisemi nga modat letrare. Ne kemi përvojën tonë. Doemos do të shfrytëzojmë në mënyrë krijuese edhe përvojën e përparuar botërore, por jo modën botërore!

Interesimi gjithmonë dhe më i madh pér temën e jetës së hershme të popullit dhe të historisë së tij lidhet ngushtë me disa faktorë favorizues, që janë në vetë shqërinë tonë bashkëkohore socialiste. Me zhvillimin e socializmit në Shqipëri, me ngritjen e nivelit të përgjithshëm të kulturës, me ecjen përpëra të arsimit, shkencës, letërsisë e arteve dhe me përvetësimin gjithmonë e më të mirë të diturive dhe të teorisë marksiste-leniniste, kërkesat e njerezve pér ta njojur më gjerësisht të kaluarën, etninë, vlerat shpirtërore, pasuritë e folklorit, legjendat, gojëdhënat dhe ngjarjet historike, luftërat dhe përpjekjet pér liri e pavarësi të vendit, u shtuan dhe u bënë nevojë e domosdoshme. Kur shoqëria konsolidohet dhe maturohet, kërkon të dijë gjithçka. Ndodh si me njeriun. Kur rritet e mençurohet i shtohet kurioziteti dhe kërkon të dijë pér origjinën e tij familjare, interesohet pér gjyshërit e stërgjyshërit, pér prejardhjen e tyre, pér jetën dhe luftërat që kanë bërë. Nga ana tjetër, presioni i ideologjive të huaja borgjeze e revisioniste mbi vendin tonë është bërë më i ashpër. Armiqtë, duke luftuar socializmin që ndërtohet nën udhëheqjen e Partisë sonë, duke luftuar në përgjithësi marksizëm-leninizmin, janë vërsulur edhe kundër së kaluarës sonë historike dhe vlerave shpirtërore të popullit tonë, gjë që na bën edhe ne t'u përgjigjemi me gjuhën tonë dhe t'i tregojmë botës së vërtetën. Është edhe një faktor tjetër i rëndësishëm. Shkencat tona sociologjike e historike tanimë janë zhvilluar dhe dokumentet e faktet janë pasuruar më shumë se disa vjet të shkuar. Rrjedhimisht, edhe letërsia dhe artet kanë një material më të pasur pér ta pasqyruar në krijimtarinë e tyre. Doemos në pasqyrimin e së kaluarës dhe historisë ka edhe mangësi, ka edhe kuptime të cekëta, disa prej të cilave i përmendëm, por tendenca kryesore është pozitive, ajo ka dhënë fryte dhe do të japë edhe më shumë. Këtu vetëm kërkohet që temal historike të pasqyrohet si kërkesë e ndërgjegjshme e shkrimitarit dhe jo të vijë si imitim i veprave të suksesshme të autorëve të tjerë. Pastaj duhet të mbahet parasysh edhe raporti i drejtë

i gjithë temave dhe të mos ketë shpërpjestime. Ne do ta pasqyrojmë vazhdimisht temën historike. Ka momente në jetë që ajo merr një përhapje më të madhe se zakonisht. Për shembull, sivjet, që do të festojmë 70-vjetorin e Pavarësisë, tema historike do të zërë një vend të rëndësishëm, do të botohen libra e do të hapen ekspozita të arteve figurative, do të bëhen simfoni e balete. E gjithë kjo merr një tingëllim të fortë aktual, tingëllim që është i domosdoshëm për çdo vepër historike.

Jetën e shoqërisë së kaluar me kontradiktat, lëvizjen përparimitare dhe revoltat shoqërore e politike e kanë pasqyruar vitet e fundit herë në një aspekt e herë në një tjetër, pothuajse të gjitha artet tonë. Një nga shkrimtarët tanë më të mëdhenj të realizmit socialist, J.Xoxa, shkroi romanin «Lulja e kripës», ku pasqyrohen konfliktet shqërore e politike, idetë revolucionare dhe ndeshja e tyre me pikëpamjet regresive, ku pasqyrohet edhe lëvizja punëtore para Çlirimit të vendit në mënyrë realiste. Ngjarje dhe figura nga shoqëria e shkuar dhe historia, gjithashtu, pasqyrohen edhe në librin me tregime të Dh.Shuteriqit «Maratonomaku ynë». Shoqëria e atëhershme me dallkaukët, memurët dhe servilët vihen në lojë edhe nga L.Qafëzezi në komedinë «Tufan në dovlet».

Në artet figurative, sidomos në ekspozitën e vitit 1978, në 100-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, tema historike kaloi në një hop të ri cilësor me veprat e A.Buzës, S.Kamberit, I.Lulanit, S.Shijakut, G.Madhit, N.Jonuzit, M.Fushekatin e plot të tjerëve. Këto vepra janë përshkuar nga një tingëllim i theksuar aktual, i cili rrit vlerat e tyre për të sotmen. Me temën e së kaluarës kanë dalë mjaft filma me nivel artistik, si: «Gjeneral gramafoni» i V.Gjikës, «Udha e shkronjave» i V. Priftit, «Mësonjëtorja» i M.Fejzos dhe «Koncert në vitin 1936» i S.Kumbaros. Me të njëjtën gjuhë mund të flasim për muzikën e koreografinë me veprat e N.Zoraqit, T.Daisë, Ç.Zadesë, F.Ibrahimit, A.Aliajt, P.Kanaçit, B.Zekthit etj.

Është e natyrshme të theksojmë se nga vendet kryesore në gjithë letërsinë dhe artet e zë tema e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, e cila mban edhe nivelin më të lartë artistik. Përveç romaneve të përmendura shpeshherë nga kritika jonë, vjershave dhe poemave të Ll.Siliqit, F.Arapit, V.Zikos, K.Petrinit e më të rinjve, dramave «Baca e Gjetajve»

e F.Krajës e «Komunistët» e R.Pulahës, opera «Komisari» i N.Zoraqit e «Mulliri i Kostë Bardhit» i T. Harapit, me vlera të vërteta janë filmat «Lulëkuqet mbi mure» i Dh. Anagnostit dhe «Nga mesi i errësirës» i K.Dhamos. Por mendojmë se edhe në temën e Luftës Antifashiste Nacionalçirimitare ka ardhur koha të kalohet në një hop të ri cilësor dhe të thyhet njëfarë monotonie në trajtimin e personazheve, heronjve dhe ambienteve. Edhe nga kritika është vënë re se tipat e karakteret e komisarëve e komandantëve përsëriten nga një vepër në tjetrën. Pastaj ndihet edhe një trajtim i sipërfaqshëm i luftës dhe shpesh ka pavërtetësi. Lufta herë-herë pasqyrohet si lojë me mjete e forma të varfra artistike. Nuk ndihet ai heroizmi dhe epizmi i madh e Luftës Antifashiste Nacionalçirimitare, heroizëm që çlironte energji të mahnitshme. Po japid një shembull të freskët:

Kohët e fundit doli në ekran filmi i I.Muços dhe K. Mitros «Në prag të lirisë», sipas romanit të njojur të SH. Musarajt «Para agimit». Filmi është i mbushur i téri me skema të njoitura, të para dhe të stërpara, me figura shabllone që nuk të ngjallin asnje mendim dhe asnje emocion. Duke parë këtë film, të vinte keq për romanin e shquar të Sh.Musarajt «Para agimit», të cilit ia kishin humbur krejt fryshtë origjinale, patosin e mendimet. Ekranizimi i veprave të rëndësishme të letërsisë duhet të merren me seriozitet dhe me përgjegjësi të lartë. Regjisori dhe skenaristi doemos do të krijojnë mbi to, por nuk u lejohet shkujdesja dhe liria e plotë për t'u sjellë me një vepër sipas dëshirës. Ndryshe, kjo do të thotë të shpërdorosh firmën tënde në paraqitjen e një vepre që e ka bërë tjetërkush e i menduar thellë shumë vite me radhë. Lufta Antifashiste Nacionalçirimitare dhe heronjtë e saj në asnje mënyrë nuk duhen sheqerosur. Heronjtë e saj nuk kanë bërë një jetë të lehtë dhe heroizmi i tyre nuk ka ardhur me një të shkrepur të kobures. As formimi i tyre si heronj nuk u bë vetëm përmes një mbledhjeje, duke dëgjuar agitatorin. Për ta kuptuar më mirë problemin e pasqyrimit të heronjve, le t'u kthehem i herë pas here klasikëve të marksizëm-leninizmit. Marks na mëson: «Do të ishte me se e dëshirueshme që njerëzit që kanë qenë në krye të partisë së lëvizjes, qoftë para revolucionit në shoqëritë e fshehta ose në shtyp, qoftë në periudhën e revolucionit, si zyrtarë, të piktuoheshin, më në fund, me ngjyra të ashpra, si ato të Rembrandit në tërë vërtetësinë e vet reale. Në të gjitha përshkrimet e deritanishme këta njerëz nuk paraqiten

kaluara dhe të ezauruara. Ato shfaqen herë pas here në forma të ndryshme, kur nënveftësohet lidhja dialektike që duhet të ketë arti i kultivuar me folklorin. Kjo lidhje është e domosdoshme, pasi i jep muzikës atë originalitet të papërsëritshëm kombëtar që nuk e gjen në popujt e tjerë. Dhe lidhja me folklorin arrihet me shumë mënyra e forma, që nga mbështetja krijuese në të e gjer te përpunimi. Por përpunim nuk do të thotë sjellje e lirë dhe e papërfillshme e kompozitorit me melodinë popullore, se pastaj kalojmë në shtrembërime dhe shformime.

Për çështjen e dytë, rrezikun e vënies së barazisë ndërmjet artit të kultivuar dhe popullore. Edhe kjo dukuri po të lihet të nxjerrë krye, shuan shpirtin kërkues dhe e ngurtëson krijimtarinë artistike të kultivuar, në radhë të parë në muzikë, pasi e bën atë një derivat të folklorit dhe nuk lë të zhvillohen format e tjera si të operës, baletit, muzikë simfonike dhe këngës, krijon një monotoni dhe një uniformitet anakronik që është i huaj për socializmin. Prirje të kësaj barazie janë shfaqur herë pas here vitet e fundit, mbi të gjitha në këngë dhe në koreografi, por edhe thjesht në planifikimin e programeve të Radiotelevizionit, të konceriteve të institucioneve kulturore artistike dhe të Teatrit të Operës e Baletit. Në këto programe herë-herë ka një nënveftësim të muzikës së kultivuar dhe mbi-vlerësohet folklori. Madje, ndodh që edhe kur transmetohen vepra të muzikës së kultivuar, ekzekutuesit dhe interpretuesit vishen me kustume kombëtare dhe vënë qelleshe. Një tendencë e tillë ndihet edhe në grupet artistike që shkojnë në turne jashtë shtetit, në vende të tjera të botës, ku rrallë përcillen vepra të kompozitorëve tanë. Të gjitha këto rrjedhin nga njëfarë mosbesimi që vihet re në disa kuadro të kulturës për artin e kultivuar muzikor dhe nga njëfarë intelektualizmi dhe nihilizmi. Por kjo rrjedh edhe nga preokupimi i paktë për të nxitur e përkrahur muzikën e kultivuar, nga indiferentizmi dhe nga praktikat artizanale, për t'i ndërtuar shpejt e shpejt programet.

Për çështjen e tretë, të ruhem i nga imitimi i thjeshtë i artit popullore. Vitet e fundit kjo është prirja ndofta më e përhapur, në radhë të parë, në fushën e muzikës. Vëmë re që disa kompozitorë dhe koreografë i marrin pothuajse të gatshme këngët dhe vallet popullore të krahinave të vendit dhe u vënë emrin e tyre, si për shembull, «Vallja e Librazhdit», kompozitor filani, «Vallja e Kukësit» kompo-

zitor akëcili, «Kënga e Elbasanit», kompozitor ipsiloni etj. Në të vërtetë këto janë melodi autentike popullore. Pastaj nga imitim i drejtپërdrejtë i muzikës popullore këngët e 5-6 kompozitorëve dalin të njëllojta, pasi nisen nga i njëjtë burim i transplantuar në të ashtuquajturat veprat e tyre origjinalë.

Arti i popullit është madhështor si natyra. Imituesin e marrim me mend se q'mund të jetë. Por ka edhe shkrimtarë që marrin përrallat e popullit, ua heqin bukurinë dhe i bëjnë siç duan vetë nën parullën e aktualizimit; mbretin e bëjnë kapitalist, qerosin punëtor revolucionar, lepurin korrier dhe dhelprën e futin në shërbimin e spiunazhit. Ka të tjerë që legjendat i bëjnë poema ose në vargje të lira, ose me bejte e kështu me radhë, duke i shtrembëuar sipas «unit» subjektivist të tyre. Veprime të tillë ulin cilësinë e arteve, prandaj nuk duhet të përsëriten.

Problemi i raportit të drejtë ndërmjet artit të kultivuar dhe popullor është sa i rëndësishëm aq edhe i vështirë. Ai duhet kuptuar drejt që të mos ndodhin shtrembërimet. Folklori dhe krijimtaria e lëvizjes amatore do të vazhdojnë të zhvillohen. Për hir të mbajtjes së raportit të drejtë me artin e kultivuar nuk duhet frenuar procesi i zhvillimit të tyre. Përkundrazi, arti i kultivuar duhet të ecë përpara përt'u ngritur në lartësitë që i takon dhe të mos i thotë folklorit: prit pak se nuk të arrij dot, prit se më prish raportin!

III. Ndërgjegjia krijuese dhe cilësia në letërsi dhe në arte

Cilësia e letërsisë dhe e arteve është një çështje e përbashkët e gjithë forcave krijuese, e kritikës, e shtypit, e shtëpive botuese, e institucioneve kulturore e artistike dhe e gjithë drejtimit të krijimtarisë letrare e artistike. Është një çështje e përbashkët e gjithë shoqërisë, e lexuesve, spektatorëve dhe e tërë atyre që përvetësojnë artin. Kur të bëhet problem i përbashkët dhe aksion i përbashkët, atëherë do të krijohet një atmosferë e shëndoshë, që do të ndikojë jo vetëm në rritjen e nivelit të artit, po në gjithë kulturën tonë. E gjithë kjo ndërmarrje e madhe kërkon rritjen e ndërgjegjes qytetare e artistike të cilidho që me-

rret me letërsinë dhe artet, që drejton këtë veprimitari shoqërore dhe që përvetëson artin. Rritja e nivelit të letërsisë dhe artit, në radhë të parë, varet nga ata që krijojnë në këto fusha. Por krijuesit nuk mund ta shpien gjer në fund cilësinë e veprimitarisë së tyre pa e kuptuar këtë domosdoshmëri edhe ata që kanë në dorë çelësat e botimit, ekzekutimit dhe ekspozimit, se mund të ndodhë që ajo që është cilësi për shkrimtarin ose artistin, të mos jetë cilësi për botuesin ose drejtuesin e këtyre punëve.

1. Në ngritjen e nivelit të letërsisë dhe arteve rol të ndjeshëm luan kritika dhe shtypi letrar e artistik i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve. Për këtë kritika dhe shtypi i specializuar letrar është e domosdoshme të luftojnë që të bëhen më të gjallë, më luftarakë, më të thellë dhe më të mençur, duke u pastruar nga trajtimi frazier i dukurive dhe problemeve, nga kjo sëmundje ngjitëse tepër e rrezikshme dhe nga kjo mbeturinë e së kaluarës. Kritika dhe shtypi letrar, duke dhënë gjendjen e vërtetë të arteve, problemet e tyre, arritjet dhe ngecjet, të sotmen dhe perspektivën, do të bëjnë që shkrimtarët dhe artistët të mësohen të pranojnë edhe lavdërimet, edhe kritikat. E vëmë në dukje këtë, pasi një njeri që është mësuar vetëm me lavdërim jo vetëm që i kërkon vazhdimisht elozhet, por nuk ngopet me to, dëshiron edhe të tjera. Dhe kritiku i gjorë mendon se e kënaqi, pasi kujtoi se e kreu detyrën me lavdërimin që i bëri. Por në të vërtetë gabohet, se përsëri e ka inatosur, meqë i mësuari me lajkën është i pangopur. Prandaj, e mira e të mirave është të thuhen gjërat me vërtetësi objektive, që kritiku ta ketë ndërgjegjen të pastër.

Kritika është amvisë e letërsisë dhe e artit. Ajo e ruan dhe kujdeset për të, duke vënë në vendin e tyre ato vlera që janë të vërteta, pas një pastrimi nga mbeturinat që fshehin këto vlera. Gjithmonë kjo amvisë shoshit, nxjerr kokrrat veç, kashtën veç dhe bykun' veç. Kjo bën, kjo s'bën, kjo mund të bëjë po të shoshitet edhe një herë. Me këtë shoshitje zbulon para njerëzve edhe ato pasuri, që ndofta nuk janë vënë re prej tyre. Por kjo amvisë di edhe të parandiejë pasuritë që do të vijnë. Fatkeqësisht, kritika jonë shpesh nuk punon si amvisë, me vështirësi nxjerr në pah vlerat e vërteta; prandaj edhe mezi parandien pasuritë që do të vijnë në të ardhmen. Ajo me vështirësi i zbulon talentet e reja që hyjnë në arte, me

vështirësi i seleksionon, i zbulon dhe me zor tregon kujdesin prej amvise për t'ua kultivuar talentin premtues.

Me talentet e reja jo vetëm kritika, por gjithë Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve duhet të bëjë një punë të madhe e të ndërgjegjshme, me ndjenjën e një përgjegjësie të lartë qytetare. Është e domosdoshme t'u bëjmë një trajtim më të mirë e më të kujdesshëm, t'i mësojmë të njohin jetën dhe kulturën, t'i përkrahim dhe t'i nxitim për të kriuar, të sillemi me urtësi e mençuri me ta, se ka raste kur jemi indiferentë. Le të kujtojmë rininë tonë letrare e artistike, se sa nevojë kishim për ndihmën e shkrimtarëve dhe artistëve të dëgjuar! Prandaj shkrimtarët, piktorët, skulptorët e kompozitorët me përvojë e me zë në letërsi e arte duhet të shkruajnë më shumë për talentet e reja dhe t'i shohin ato si e ardhmja e krijimtarisë. Por, përveç kësaj, duhet të jemi objektivë me ta. Të mos u bëjmë shumë lëshime dhe të mos i lavdërojmë me vend e pa vend. Për këtë shoku Enver na ka porositur disa herë. Po citoj një thënje të tij në prill të vitit 1979: «Nuk dua të përmend emra, por ne kemi edhe ndonjë konstatim të hidhur që ndonjë të riu, i cili akoma nuk ka dalë mirë nga «veza», kur bën ndonjë «vjershë» apo «përrallë», i bëhet një recension i fryrë me aq shumë elozhe, sa vlerësimi me shkrim është tri herë më i madh se «përralla» e botuar, që nuk vlen ose vlen më pak. Këto mburrje të tepruara prishin punë, në vend që të ndreqin¹).»

Kjo këshillë e shokut Enver duhet mbajtur gjithmonë parasysh nga shtypi ynë letrar «Drita» dhe «Nëntori», pasi lavdërimet pa baza e hutojnë talentin e ri dhe nuk e lënë të ecë përpara.

Organet e shtypit letrar të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, «Drita» e «Nëntori», e kanë ndjekur procesin e krijimtarisë dhe kanë ngritur nivelin e tyre teorik, publicistik e artistik. Ato kanë luftuar për pastërtinë e letërsisë dhe të arteve dhe për cilësinë e tyre. Megjithatë, kërkesat e kohës janë në rritje dhe detyrat e tyre janë të mëdha. Edhe në të ardhmen ato duhet të luftojnë për një nivel më të lartë teorik e kulturor.

2. Ngritja e nivelit të letërsisë dhe arteve është e domosdoshme t'i vërë më shumë në lëvizje shtëpitë botuese, Radiotelevizionin, Kinostudion, teatrot dhe gjithë in-

1) (E. Hoxha, «Raporte dhe fjalime», 1978-1979, f. 247).

stitucionet kulturore e artistike, të cilat vjelin krijimtarinë dhe e shpérndajnë atë në popull.

Me gjithë punën e mirë që bëjnë këto institucione, sidomos në mbajtjen e pastërtisë së përbajtjes dhe në përpjekjet për të siguruar krijimtarinë letrare e artistike, me gjithë kujdesin që tregojnë për të gjetur forma të reja bashkëkohore, përsëri lejojnë botime, ekzekutime, ekspozime dhe transmetime me nivel që lë shumë për të dëshiruar. Shpeshherë ato i rrëmben rutina e përditshme dhe koncepti për të mbushur boshllëqet, pavarësisht nga cilësia e artit. Por kërkesa e kohës sot është që të rritet ndërgjegjja dhe përgjegjësia dhe të kuptohet thellë porosia e Partisë se pa kulturë të lartë e pa nivel shkencor në çdo punë nuk mund të ecë përpara shoqëria me ritmet që kërkon socializmi në etapën e sotme të ndërtimit të tij. Fjala vjen, këto nga dy vjet kinostudioja «Shqipëria e re» ka nxjerrë disa filma nën nivelin mesatar të krijimtarisë. Kjo është një anë. Tjetra është se ka edhe një ritëm prodhimi të çrrëgullt e të shpërpjesëtar. Kjo aritmikë është e dëmshme, pasi në fund të vitit filmat bëhen shpejt e shpejt dhe bie cilësia. Redaksitë e Kinostudios është e domosdoshme të preokupohen vazhdimit për të pasur njerëz aktivë dhe në aktivitet të rritin autoritetin e tyre. Edhe Lidhja e Shkrimitarëve dhe e Artistëve mban përgjegjësinë e saj, pasi, si një organizatë frysmezuese duhet të punojë më shumë dhe më mirë me shkrimitarët dhe artistët për siguriqin e skenarëve, të rekomandojë tregime e romane që mund t'i shërbejnë kinematografisë, t'u japë leje krijuese më tepër skenaristëve, të diskutojë krijimtarinë kinematografike dhe të forcojë bashkëpunimin me kineastët. E njëta gjë mund të thuhet edhe për teatrot, që, megjithëse gjendja e tyre është më e shëndoshë se disa vjet të shkuar, përsëri ato shfaqin edhe drama të dobëta, përvëç që kanë edhe mungesa në repertor. Hop të ndjeshëm nga gjithë teatrot dhe estradat mendojmë se kanë bërë estrada e Fierit, që po na jep një humor të kulturuar jashtë shablloneve të zakonshme.

Në cilësinë e arteve një rol të madh luan shtëpia botuese «Naim Frashëri», e cila, me gjithë punën e kualifikuar është e domosdoshme të forcojë veprimtarinë e redaktorëve dhe të ngrejë nivelin botëkuptimor, teorik dhe kulturor të tyre, për ta kuptuar në mënyrë të gjithanshme

letërsinë, se pa këtë nuk do të jenë në gjendje të bëjnë një seleksionim shkencor të dorëshkrimeve që u venë. Gjithashtu duhet të rritin ndërgjegjen dhe të mos lejojnë botime pa vlerë për hir të hatëreve dhe sentimentalizmave. Edhe shkrimtarët që marrin vepra për rekomandim e për recensionim në shtëpinë botuese «Naim Frashëri» të jenë më objektivë dhe të respektojnë më shumë nderin e letërsisë. Me këtë gjuhë mund të flasim edhe për Galerinë e Arteve, e cila duhet të pranojë ato veprat që kanë vlera të vërteta dhe të mos e mbushë fondin e saj me gjëra pa cilësi, të imponuara nga dëshira subjektiviste. Po të veprojmë kështu, kërkesa për cilësi konkretizohet me veprim dhe jo me fjalë të përgjithshme fraziste.

3. Formimi i një opinioni të shëndoshë nga gjithë degët e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve dhe nga gjithë sektorët e komisionet e saj luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e krijimtarisë letrare e artistike dhe në rritjen e cilësisë së kësaj krijimtarie. Është e qartë, se kjo kërkesë nuk është formale dhe e pabazuar. Sot Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve, me zgjerimin e saj, me përhapjen e degëve të saj në gjithë rrëthet e Republikës dhe me veprimitarinë e saj të shumanshmë, ka rritur autoritetin në shoqëri dhe është bërë një qendër e rëndësishme jo vetëm për edukimin ideor e estetik të forcave krijuar, por luan një rol të ndjeshëm në gjithë kulturën tonë. Veprimitaria e degëve dhe komisioneve të saj, diskutimet krijuar, mbajtja e temave për edukimin estetik, të gjitha këto i shërbejnë ngritjes ideologjike, formimit botëkuptimor dhe rritjes profesionale të shkrimtarëve dhe artistëve. Por kërkesat e sotme të shoqërisë janë në rritje. Kultura e lexuesve dhe spektatorëve është ngritur. Rrjedhimisht, edhe drejtimi i veprimitarisë së Lidhjes me gjithë forumet, degët dhe sektorët e saj është e domosdoshme të vihet në baza më të shëndosha shkencore. Sot nuk mund të veprohet e drejtobet si në disa vjet të shkuara, kur Lidhja kishte vetëm 500 anëtarë dhe dy-tri degë. Në gjirin e saj tani aderojnë mbi 1500 anëtarë e kandidatë. Pra, edhe metoda e punës drejtuese duhet të shkojë në harmoni me këtë rritje. Për këtë arsyë diskutimet krijuar, temat ideoartistike, format për t'i nxitur shkrimtarët dhe artistët të njojin jetën dhe të jetojnë intensivisht me problemet e shoqërisë, kanë nevojë të jenë në një nivel më të lartë teorik e praktik.

Shpesh diskutimet tona dhe rrahjet e mendimeve janë të vakëta; mungon debati i vërtetë dhe kemi ndruajtje t'i themi shoku-shokut të vërtetën sy ndër sy. Kjo pastaj e bën atmosferën ndonjëherë të fjetur dhe të plogësh.

Përveç këtyre, një kujdes më të madh duhet të tre-gojmë për degët tona. Këto degë zhvillojnë një aktivitet të ndjeshiem dhe dalengadalë po kthehen në vatra fry-mëzuese për zhvillimin e letërsisë dhe arteve. Disa prej tyre, si e Shkodrës, Korçës, Vlorës, Tepelenës, Librazhdit, Gramshit, Sarandës, Fierit e ndonjë tjetër kanë një ve-primitari të gjallë. Ato diskutojnë krijimtarinë dhe ndihmojnë gjallërimin e jetës kulturore e artistike në rrethe. Megjithatë, puna e tyre duhet të forcohet më tej. Për këtë duhen ndihmuar më shumë nga kryesia e Lidhjes, nga komiteti drejtues i saj. Nga ana tjetër, shkrimtarët dhe artistët më me përvojë është e domosdoshme të shkojnë më shpesh në degët, duke ndihmuar në mbarëvajtjen e punës së tyre. Vetë ne kemi nevojë të njihem më gjë-rësisht me krijimtarinë dhe problemet e degëve, të bash-këpunojmë me komitetet e partisë dhe ekzekutive në rre-the dhe të përpinqemi për t'u hapur horizont, si njerëz të specializuar të letërsisë dhe arteve. Pa mbarëvajtjen e punës në degët, nuk mund të jetë e plotë edhe veprimitaria e përgjithshme e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve dhe nuk mund të realizohen siç duhet detyrat e Kongresit të 8-të të Partisë. Këtë duhet ta kemi të qartë. Disa degë, si e Kolonjës, Burrelit, Gjirokastrës, Pogradecit, Lushnjës, Kukësit, Peshkopisë e ndonjë tjetër çalojnë në veprimitarinë e tyre. Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve nuk mund të qëndrojë indiferente. Prandaj kërkohet që të bëhen disa analiza të studiuara dhe të gjenden rrugët e përmrësimit të punës.

PËR SPECIFIKËN E HUMORIT DHE SATIRËS

(*Nëpër vështirësitë e gjinisë*)

Në fushën e humorit e të satirës, letërsia jonë e re nuk ka edhe aq shumë vepra me vlera të qëndrueshme. Veprat e vërteta në të cilat mund të ndalesh dhe të arsyetosh janë të rralla. Ato kanë dalë në intervale relativisht të gjata vitesh dhe nuk janë ndjekur vazhdimit prej shoqesh të tjera. Rjedhimisht, në rrugën e humorit dhe të satirës janë krijuar herë pas here gropat e zbrazëta. Kështu, pas daljes së «Epopesë së Ballit Kombëtar» të Shevqet Musarajt, që është pa dyshim një kulm ende i paarritur, u desh një kohë e gjatë që të vinin «Karnavalet e Korçës» të Spiro Çomorës dhe tregimet e Qamil Buxhelit «Faraonë dhe firaunë». Më vonë, pas shumë vitesh, u duk edhe komedia e Ruzhdi Pulahës «Zonja nga qyteti». Tregimet, romanet, komeditë dhe shkrimet e tjera që janë shfaqur në dritë mes intervalave që janë shkruar vepurat që përmenda, me përjashtime të rralla, kanë qenë me vlera të kufizuara dhe jetëshkurtra. Atëherë, duke u nisur nga gjendja konkrete dhe reale e humorit dhe satirës, mendja na shkon në vështirësitë e kësaj gjinie.

Kjo na detyron t'u kthehemë e rikthehemë problemeve ideoestetike në këtë fushë më pak të lëvruar të letërsisë sonë. Vështirësitë, të metat e dobësitë janë të natyrave të ndryshme: të pamjaftueshmërisë së forcave krijuese të kualifikuara, të nënvyftësimit, të keqkuptimit të gjinisë edhe nga krijuesit edhe nga drejtore të teatrove dhe redaksitë botuese e të tjera. Cilat mund të jenë këto probleme?

1. Në humor dhe satirë ka ndonjëherë një keq-kuptim të asaj që quhet tipike

Ndonjëherë mendohet se po kritikove një dukuri negative ose një bartës të kësaj dukurie, është irrezik të nxish realitetin dhe të bësh përgjithësime që cënojnë atmosferën e tërësishme pozitive të shoqërisë sonë. Fjala vjen, po fshikullove një agronom, një inxhinier, një artist, një fshatar, një punëtor me të meta, një drejtor ose një drejtues të paaftë, atëherë duket sikur kritikohen gjithë shtresat shoqërore dhe gjithë nomenklaturat përkatëse. Në këtë rast nuk kuptohet se shkrimitari kur flet për një punëtor indiferent, përtac, ose shpërdorues nuk e vë fokusin e pasqyrimit në gjithë punëtorinë tonë, por në atë kategori njerëzish të saj që ajo vetë i kritikon dhe i edukon. Të njëjtën gjë mund të themi për agronomët, fshatarët ose mjekët. Nja dy-tre vjet më parë, për shembull, komisioni i repertorit në estradën e Fierit nuk e pranonte një skeç që bënte humor me një kirurg të paaftë, me arsyetimin se «kirurgët e qytetit tonë janë të aftë dhe kur ta shohin do të fyhen». Kjo kur ndodh në një estradë të përparuar, kuptohet ç'ndodh me të tjerat. Harrohet kështu jo vetëm objekti i satirës dhe humorit, që është dukuria negative, e cila të ngjall të qeshur, por edhe ngatërrohet personazhi letrar me persona konkretë në mënyrë banale dhe naivë. Me kohë, dihet që humori dhe satira e nxjerrin nga jeta atë dukuri shoqërore-komike që i bën njerëzit për të qeshur, dukuri që në dukje paraqitet si e shenjtë dhe në thelb është qesharake. Dikur, para Çlirimtës së vendit, në qarqe të caktuara të shoqërisë, «baballarët e kombit» respektoheshin dhe numëroheshin si patriotë dhe si njerëz me peshë dhe ndikim. Në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare shenjtëria e këtyre njerëzve ra. Shevqet Musaraj me «Epopenë e Ballit Kombeitar» ata i bëri qesharakë. Nëse Shevqet Musaraj do të vinte në qendër të poemës ndonjë xhandar ose ballist të thjeshtë, e qeshura do të ishte e vogël dhe e papërfillshme. Duhej diçka që merrej si e shenjtë dhe kësaj t'ia hiqje cipën e shenjtërisë për të nxjerrë thelbin komik. Servantesi në «Don Kishotin» e famshëm vuri në qendër kalorësinë që numërohej fisnikë dhe e guximshme, që i këndonin këngë dhe i thurnin poema, siç bëri Torkuato Tasoja me

«Jerusalemin e çliruar». Në «Don Kishotin» u bë e qartë se kalorësia tanimë ishte kthyer në dukuri shoqërore komike.

Por le të kthehemë përsëri te keqkuptimi i tipikes në humor dhe satirë. Nga frika e keqkuptimit të tipikes, disa herë vetë shkrimitarët gjithë personazheve negative u vënë nga pas edhe nga një personazh pozitiv, sipas nomenklaturës nga rrjedhin. Ky personazh pozitiv i kundërvihet negativit dhe fillon e agjiton: dale se nuk e ke drejt, se shoqëria jonë ecën përpara etj. Nuk mjafton vetëm me kaq. Fillojmë të numërojmë personazhet negative dhe ato pozitive dhe të bëjmë peshimin me kandar: këtej kemi katër negativë dhe andej një pozitiv. S'jemi në rregull! Duhet një negativ dhe katër pozitivë ose fundja t'i barazojmë! Në këtë mënyrë, me të filluar llogaritja humbin shkëndijat e humorit dhe vendin e zenë skemat. Këtu harrohet se përveç bartësit të konfliktit me të keqen, në satirë e humor ëshë vetë e qeshura, vetë e tallura, pra qëndrimi ideoemocional i lexuesit dhe i shikuesit ndaj dukurisë së dëmshme dhe bartësit e saj luajnë rol pozitiv dhe nuk është gjithnjë një rregull i domosdoshëm dhe rigoroz që si kundërpeshë të së keqes, të vëmë një hero. Në qoftë se do të kërkoni nga Spiro Comora në «Karnavalet e Korçës», që çdo personazh negativ ta shoqëronte me një pozitiv, pas Nikollaq Jorganxhiut, tregtarit të manifakturës, ai do të vinte një punëtor kryengritës; pas Olimbisë, gruas së tij, do të lëshonte një rroba qepëse revolucionare; pas Vehipit, prefektit të qytetit, do të thërriste një intelektual të përparuar që ta kundërshtonte e kështu me radhë. Në këtë mënyrë, nuk do të kishim një komedi, por një përzierje bastarde.

Ideali pozitiv, mendimi i përparuar dhe tendenca e autorit në veprën humoristike nuk realizohen vetëm me një mjet e vetëm me personazhin pozitiv, por edhe me shumë komponentë të tjera, me vënien e bartësve të dukurisë negative në situata komike dhe qesharake, me ironinë, me sarkazmën e lojën e fjalëve.

Dëm të madh krijimtarisë satiriko-humoristike i sjell një koncept dhe një praktikë e gabuar, kur për paqartësi ose për të qenë «brenda», redaksitë, këshillat artistikë dhe kritika kërkojnë nga një vepër që t'i japë përgjigje për tërë gamën e problematikës. Sipas këtij koncepti ose praktike të gabuar, kërkohet, për shembull, që në një vepër të shkruar për kolektivizimin, të thuhet diçka edhe për Reformën Ag-

rare, edhe për aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë, edhe për mbjelljet dhe korrjet, edhe për luftën kundër thatesirës ose përmbytjeve, meqë këto probleme preokupojnë rrëthim ose vendin dhe janë në rend të ditës në kohën që autori dorëzon veprën për botim, ose për shfaqje.

Kësijoj koncepti ynë rrëth komikes dhe rrugëve të mishërimit artistik të saj nuk duhet futur në skema të ngurta, duke absolutizuar vetëm një mënyrë paraqitjeje, përndryshe krijojmë stereotipe dhe shabllone antiletrare që e zhvleftë-sojnë humorin dhe satirën.

2. Në humor dhe satirë ka shpesh një përfytyrim të vulgarizuar të personazhit pozitiv

Nganjëherë kujtohet se mjaft që në një vepër letraro-artistike të hyjë heroi ose personazhi pozitiv dhe me një «deus ex machina» u zgjidh problemi. Por nuk është kështu. Për këtë dëshmon letërsia borgjeze. Aty ndeshim të ashtuquajtur heronj e personazhe pozitive, por qëndrimi që mban autori ndaj tyre është jo i drejtë, tallës, poshtërues. Fakti që këta heronj ose personazhe janë edhe intelektualë, edhe punëtorë, s'mjafton që këto figura të fitojnë vlerat e duhura pozitive. Për tu bërë këta heronj ose personazhe pozitive, mbasi kanë hyrë në vepër, luan rol vendimtar tendencia e autorit, qëndrimi emocional i tij, i cili shprehet në tërë përbërësit artistikë të veprës, duke filluar që nga zgjedhja e temës, e heroit, e konfliktit, e mjeteve shprehëse etj. Kërkuesat për këtë personazh nga disa drejtues teatrosht e komisionesh, si dhe nga ndonjë redaktor, ndodh që janë të njëlljoja si për letërsinë që nuk është humoristike. Këtë personazh e kërkojnë të jetë një hero serioz me fjalë të mëdha e luftarake, që ta demaskojë bartësin e dukurisë negative, si në mbledhje. Nuk kuptohet që personazhi pozitiv në humor e satirë është edhe ai i veçantë, edhe ai të ngjall të qeshura me ironinë e sarkazmën e tij, me situatat komike që krijon, me shakatë që bën. Ne duhet ta kuptojmë se ky ka nevojë të jetë personazh i natyrës së humorit e satirës, të veprojë brenda situatës komike e të flasë me gjuhën e saj, dhe, si të thuash, të hyjë në garën komike, që të mos duket si element dhe material i

huaj në organizmin e një trupi. Në qoftë se personazhi pozitiv në një komedi do të veprojë me seriozitetin dhe gjuhën e dramës dhe do t'ia qajë hallin tjetrit me dhembje e këshilla, atëherë ai do ta tërheqë edhe personazhin negativ në një garë dramatike. Është afërsisht kështu: një i mençur kur hyn në mes të budallenjve, nuk mund të flasë me atë gjuhë që flet me të diturit. Edhe në një vepër humoristike, ku veprojnë personazhe, që me sjelljet e tyre të bëjnë për të qeshur, personazhi pozitiv nuk duhet të flasë e të mbahet si mes njerëzve seriozë. Përndryshe, na del një frazist dhe llafazan i padurueshmë që nuk gjëzon simpatinë e lexuesit ose spektatorit. Në folklorin tonë, pozitiv, për shembull, është Qerosi. Ai i vë në lojë të këqijtë. Por Qerosi nuk është frazist. Ai i lejon edhe të tjerët të qeshin me të, se është qeros. I lejon, po, kur u kthehet, i dërrmon me talljen dhe me mençurinë e tij. Pasi u bë shkrimtar i madh, Mark Tueni u kthyte në fshat. Një bashkëfshatar e pyet kështu afërsisht:

— More, a e njeh njëfarë Mark Tueni?

— Mos e ke fjalën për atë budallanë e fshatit, që iku që këtej e shkoi në Nju-Jork?.... Si nuk e njoh! U bë i dëgjuar qerratai në Nju-Jork, se gjeti atje më budallenj se vetja! — iu përgjigj Mark Tueni.

E kemi fjalën që personazhi pozitiv në satirë dhe humor nuk ka frikë të tallet edhe me veten, kur është e domosdoshme për të hyrë në garën komike dhe për të fituar. Atëherë ai bëhet simpatik dhe i dashur mes lexuesve ose shikuesve.

Daj Ceni i «Epopesë së Ballit Kombëtar» nuk u drejtohet ballistëve me fjalë pompoze, por me tallje. Sala i komedisë «Zonja nga qyteti», sido që nuk ka gjuhë komike, vepron me Ollgën me një mjet tjetër: me krijimin e situatës komike, për t'ia hequr Ollgës mendimet e shtrembra që ka për fshatin. Mirpo në disa vepra të tjera, dhe këto janë pak, personazhet pozitive janë artificiale, fraziste dhe jashtë garës komike. Edhe në një komedi të tillë të konceptuar në grotesk si «Kartela e verdhë» e Haxhi Ramës, punëtorët u kundërvihen dy tifozëve të sëmurë dhe qesharakë me fjalë moralizuese. Vetvetiu simpatia jonë anon nga të dy tifozët, sepse ata na bëjnë të qeshim e të argëtohem, kurse personazhet pozitive na mërzitin dhe as i dëgjojmë fare.

Nganjëherë, në disa pjesë satirike, sidomos me temën nga e kaluara, hasim edhe skemën e vjetër të komedisë klasiciste të Molierit e të Goldonit: zbulohet një shërbëtor që

mundohet të vërë në lojë zotërinjtë. Këtë skemë, për shembull, e gjejmë në «Tufan në dovlet» të Luan Qafëzezit e në të tjera. Ndonëse në këto vepra personazhet janë konceptuar e veprojnë brenda natyrës së komikes, prapë dalin dy probleme: e para, përsëritja e së njëjtës skemë që ka rrezikun e njëloj varfërie artistike dhe e dyta, disa herë personazhit pozitiv këtu i lehtësohet barra artificialisht nga absurditeti dhe injoranca e figurave negative. Në komedinë klasiciste personazhet negative janë shpesh skllevër të një vesi si të kopracisë, laksmisë etj., por ata nuk janë budallenj dhe që t'i vësh në lojë nuk është punë e lehtë. Prandaj këto vepra të autorëve klasikë kanë një shtrat realist e jetësor të pranueshmë, kurse në disa nga tonat ndodh që në emër të hiperbolës të luhet shumë me injorancën anadollake të autoriteteve dhe kështu trualli ku duhet të mbijë edhe hipertoba, varfërohet.

Një anë tjetër e problemit është rasti kur edhe në komedi ose në prozë kërkohet heroi pozitiv i plotë dhe ideal dhe nuk kuptohet se në satirë dhe në humor ai është më i kufizuar në gjerësinë e tij, ndryshe nga ai i dramës ose i romanit të zakonshëm. Hero pozitiv ideal për ne, për shembull, është Marks, se është i shenjtë për botëkuptimin tonë. Në një dramë e në një roman ose film Marks ne mund ta trajtojmë si hero pozitiv, siç është trajtuar Lenini. Por në një komedi, edhe pse Marks është pozitiv mbi pozitivët nuk mund të trajtohet, pasi nuk mund të qëndrojë mes njërzve të ndodhur në situata komike. Prandaj ne theksojmë se personazhi pozitiv në satirë e humor dhe në komedinë e mirëfilltë është i veçantë dhe shpeshherë është krejt i natyrshëm që ai të ketë edhe një cen apo një dobësi që të bën për të qeshur, siç përmendëm pak më parë. Qerosi, fjala vjen, është i zgjuar, është i shkathët dhe kundërshtarët i vë në lojë, por ka një cen se është qeros dhe ndonjëherë e tepëron me gënjeshtra. Këto cene për ne janë simpatike dhe ia falim, pasi ai sjell një dobi të madhe: i vë në pozita qesharake kundërshtarët. Të njëjtën gjë mund të themi për Shvejkun e romanit të Hashekut «Ushtari i mirë Shvejk». Ai është pozitiv dhe fshikullon rendin e kalbur, ushtarakët e gjeneralët dhe luftërat imperialiste. Por ai është pak shemballa, pak tuaf ose hiqet si i tillë. Shvejku nuk është pozitiv i njëlojtë me Pavël Vllasovin e «Nënës» së M. Gorkit. Personazhi pozitiv i veprës humoristike mund që edhe të mos ketë cene, ai mund të jetë thjesht një njeri gazmor, me

sensin e komikes të zhvilluar si një dhunti natyrore, prathelbi i tij mund të jetë serioz, por veprimi konkret dhe gjuha që përdor duhet t'i përshtaten plotësisht situatës. Personazhet e Çaplinit në thelb janë dramatikë. Le të kujtojmë filmin «Kohët moderne», por drama e tyre zhvillohet në situata komike dhe ndërsa ata për vete vuajnë, ne na detyrojnë të vëmë buzën në gaz dhe të mendohemi njëkohësisht. I tillë është edhe Fanfan Tulipani i De Kosterit etj. Kështu ndodh edhe në disa vepra tonat në prozën humoristike, si në «Një ndodhi në plazh» dhe «Faraonë dhe firaunë» të Q.Buxhelit ose «Fshati midis ujërave», i K.Jakovës.

Vetë mjeshteria e ndërtimit të personazheve, e skemave të pasqyrimit të tyre, ka sjellë monotonë edhe në gjithë satirën dhe humorin. Zbulimet origjinale dhe novacionet janë tepër të rralla në këtë fushë.

Është krijuar skema e shefit dhe drejtorit, skema e burokratit dhe frazistikës, skema e dëmtuesit të pasurisë socialiste dhe e dembelit. Drejtori dhe shefi gjithmonë do të dalin burokratë dhe gjithmonë të dëmshëm. Rrallë gjen ndonjë drejtor që të luftojë përmbarëvajtjen e punës dhe përparrimin, që vetë ai t'i fshikullojë keqbërësit me humorin e tij, me ironinë dhe sarkazmën. Ky trajtim i njëanshëm nuk jep një përfytyrim real të jetës së shoqërisë sonë dhe të begatisë së realitetit socialist. Doemos, ka drejtues të dobët, me të meta dhe me formim burokratik, por shumë drejtues, shefa e drejtorë janë të zotërit dhe luftojnë për ecjen përpëra të shoqërisë dhe duhet ta kenë vendin e tyre edhe brenda kërkësave të humorit e satirës si personazhe pozitive.

Njëanshmëria vihet re edhe në ndërtimin e pjesëve humoristike, tregimeve, skeçeve, komedive e romaneve. Pothuajse të gjitha kanë të njëjtin ndërtim e të njëjtën strukturë. Në fund të tyre personazhi negativ shkarkohet nga përgjegjësia, qarkullon ose demaskohet në mbledhje. Ndodh edhe që përmirësohet dhe kthehet në qytetar të ndershëm. Të tjera zgjidhje rrallë se gjen në veprat tonë të humorit e të satirës. Një dukuri e tillë rrjedh nga njohja e paktë e jetës së shoqërisë, nga ndjenja konformiste, nga druajtja ose frika që të mos bëhen gabime dhe nga keqkuptimi i specifikës së gjinisë, i mjeteve shprehëse të saj.

Është e domosdoshme që humoristët dhe satirikët ta zotërojnë me themel mjeshtërinë e armës së të qeshurit: ndërtimin e veprës, veçorinë e personazheve, tiparet e gjuhës dhe

të gjitha mjetet e tjera shprehëse. E themi këtë, pasi shpeshherë nuk mbahet parasysh mënyra e veçantë e ndërtimit të tipit ose karakterit në satirë e humor. E dimë se ndryshe nga drama ose romani epiq, ose lirik, në humor e satirë personazhet janë dhe pranohen më shpesh si figura të formuara, që zbulohen në situata të ndryshme e në dinamikën e tyre, por mund të mos kenë domosdo zhvillim e ndryshim cilësor. Don Kishoti i Servantesit është i formuar si karakter, ashtu edhe Shvejku i Hashekut ose Hlestakovi i Gogolit. Këta vetëm e zbulojnë karakterin e tyre në zinxhirin e situatave komike. Në dramë karakteri rritet e zhvillohet, ndryshon pér të mirë a pér të keq. Edhe në satirë e humor personazhi mund të ndryshojë në thelbin e tij, mund t'i vijnë mendtë, por ai do të mbetet komik dhe karakter i tillë. Te «Don Kishoti» personazhet kryesore konvergojnë drejt njëri-tjetrit, Sançoja kalon nga realiteti i tij fshatar te absurditeti kalorsjak i ustait të tij, por prapë ai mbetet figurë komike pér ne. Në tregimin «Njeriu që ndal kohën» Qamil Buxheli vë në lojë një tip që ndalon traktoret dhe makinat rrugës dhe kërkon të mbushë çakmakun me benzinë. Autori e vë në lojë këtë tip që pengon ecjen e shoqërisë përpara, por ai nuk ushqen tek lexuesi idënë se problemi u zgjidh me kaq. Në fund të tregimit personazhi negativ, edhe pse traktoristi Luto e ka tallur, ai prapë vazhdon avazin e vjetër: sa ndahet nga Lutoja, del i zë rrugën një makine tjetër, dhe i kërkon t'i mbushë çakmakun... Autori në këtë rast, pasi fshikullon dukurinë negative, bën thirrje pér vigjilencë, se tipa dhe dukuri të tillë ekzistojnë e duhen luftuar. Këtu qëndrojnë edhe disa nga veçoritë e gjinive. Ndërsa ne shpesh i përzgjedhemi gjinitë, e fillojmë si komedi dhe e mbarojmë si dramë. Doemos, elementët e një gjinie janë të pranishëm edhe te tjetra. Ka plot drama që bartin situata e personazhe komike, mirëpo megjithatë specifika themelore e një gjinie që ka të bëjë me mënyrën e veçantë të pasqyrimit, duhet mbajtur kurdoherë parasysh.

3. Në humor dhe satirë nuk ka gjithmonë një koncept të qartë për specifikën e konfliktit

Konflikti është i domosdoshëm për të gjitha veprat letarre. Nuk ka vepër në prozë e në dramë, por edhe në poezi, që të mos e ketë konfliktin e së mirës me të keqen, e së resë me të vjetrën, e përparimtares me të prapambeturën. Por në gjini e lloje të ndryshme të letërsisë ky konflikt ka specifikën e vet. Kjo specifikë është shumë e dukshme në humor dhe satirë. Në humor dhe satirë konflikti mes forcave ndërluftuese shoqërore-historike nuk jepet si në veprën epike ose lirike, nuk tregohet se si këto forca luftojnë dhe si përfundon kjo luftë. Meqë vepra satirike ka në qendër të saj konfliktin komik, edhe përplasja do t'i nënshtronhet kësaj specifike. Vërtet satira zbulon kontradiktën ndërmjet së resë dhe së vjetrës, por paraqet edhe konfliktin ndërmjet lustrës së jashtme dhe zbrazëtisë së brendshme të kësaj së vjetre, që mund të hiqet edhe si fisnike dhe e përparuar. Është konflikti ndërmjet formës së jashtme të një dukurie me përbajtjen e vërtetë të tij. Në «Karnavalet e Korçës» forma e familjes së Nikollaq Jorganxhiut është e ndritshme dhe njeriu mendon se kjo është forca që drejton qytetin. Ndërsa në brendësi ajo është e kalbur. Ose të marrim Zylon në romanin «Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo». Ai në sipërfaqe është mbrojtës i parimeve të socializmit dhe besnik i idealeve të tij. Por në brendësi është një njeri që e keqkupton luftën për ndërtimin e socializmit. Domethënë, forma e dukurisë nuk përputhet me përbajtjen e vet. Dhe në këtë disharmoni lind e qeshura. Ky është konflikti që ne e quajmë komik. Ai buron nga vetë kontradiktat e jetës. Në këto kontradiktë satira shkon me specifikën e vet për t'i pasqyruar.

Konflikti ndërmjet formës dhe përbajtjes së dukurisë bëhet realitet artistik vetëm përmes konfliktit të subjektit, që edhe ky ka specifikën e tij në veprat e humorit dhe të satirës. Në dramën dhe romanin epik ose lirik zakonisht konflikti i subjektit ndërtohet duke kundërvënë personazhet pozitive me ato negative. Në këtë kundërvënie fillon edhe evo luimi i tyre. Vepra humoristike dhe satirike shumë herë konfliktin e subjektit, konfliktin e rrëfimit e ka ndërmjet personazheve të tij njëjtës natyrë, ndërmjet personazheve negative.

Duke u vënë kundër shoku-shokut personazhet negative bëjnë autodemaskimin e tyre. Shembull tipik pér këtë éshtë konflikti në komedinë «Revizori» të N.Gogolit. Në komedi Hlekstakovi, një aventurier batakçi, bie në konflikt me drejtuesit dhe zyrtarët e qytetit, që edhe ata janë batakçinj dhe injorantë. Edhe në komedinë e Spiro Çomorës «Karnavalet e Korçës» konflikti kryesor i subjektit, megjithëse tepër i fshehtë, éshtë mes Nikollaqit, një tregtar dorështrënguar dhe gruas së tij, Olimbisë, një mikroborgjeze mendjeshkurtër, pér çështjen e fejesës të së bijës. Nikollaqi pér të kursyer paratë, ngurron ta fejojë të bijën dhe dhëndurët largohen. Po jap një skenë me një monolog të Nikollaqit përballe gruas së tij:

Nikollaqi — (Thérret.) Më hodhe laku në fyt! Ma more shpirtin! E harrove? Mbrëmë, kur mbaroi çaji dhe prefekti doli pa asnjë përgjigje timen, më llomotite një orë të tërë! (E imiton, sarkastik) «Jepja, Nikollaq, t'u bëftë Olimbia! Jepja! S'na doli gjë puna e profesorit! Ai do marrë Ditkën! Nikollaq, mos na prish fatin e çupës! Nikollaq, mos na transferohet doktori, se do të prishet krushqia! Nikollaq, unë s'e jap çupën jashtë Korçës! Nikollaq, më nxive jetën! Nikollaq, do veremosem! Nikollaq, mos ia zbrit paratë e pianos nga prika!» «Mirë, Olimbi, do t'i paguaj....» «Nikollaq, shko shpejt ne prefektë, përpara se të niset, dhe jepi njëzet e pesë napolona!» (Thérret:) Se nuk të dhimbet, Olimbi, kamja, djersa, gjaku im! Ta bëra qejfin! Nxora nga zemra ime njëzet e pesë pikë gjaku dhe ia dhashë! (Me pikellim) Ç'ka kësметi që më ndjek kështu, xhanëm?... Ç'gjynahe kam pér të larrë?... Thashë të shpëtoja njëqind napolonat e pianos, dhe më shkuan pér dhjamë qeni njëqind e njëzet e pesë... (Thérret.) Fol! Kush doli i qerdhepsur?

Olimbia — Pse thua pér dhjamë qeni, more Nikollaq! Pse ndjell të keqen?

Nikollaqi — Se Nikollaqi nuk i zë besë asnjeriu!

Olimbia — As prefektit?

Nikollaqi — As mbretit! Prefektin do më mburrësh tinë? I sillem si mik, se éshtë i madhi i Korçës dhe ia kam nevojën! E sa pér nderet që më ka bërë ia kam paguar dhjetëfish! Ka luajtur me malifatin tim, siç i ka dashur qejfi! Dua tre metra stofë pér gruan.. Na!

Dua për çupën... Na! Dua për vete... Na! Dua t'i bëj një peshqesh të mirë zonjës së Musa efendiut... Na, merr zoti Vehip, mos u ngopsh kurrë, edepsëz! Pa do t'i paguaj më vonë, se tashti s'më ndodhen... Peqe, zoti prefekt! Më ka akoma për të dhënë njëzet e shtatë napolona, Olimbi!

Olimbia — Do të t'i japë, pse nevrikosesh... Nuk është nga ata...

Nikollaqi — E me kë flet, moj ti? Mua më thua ti se ç'mall është ai? Anadollak ryshfetçi! Mbaje mend! Nga njëzet e pesë napolonat e mia që do t'ia japë, demek, një nëpunësi të lartë të Ministrisë së Brendshme, i cili do t'i prishë, gjoja, transferimin, më therrtë mua po s'ia hodhi gjysmat xhepit të tij! Sikur e shoh me këta sy! Po ç'ti bëj? Më ka zënë rrota bishtin!(Pauzë. Me pikëllim) Ime bijë do të më lërë fukara...

Doemos, konflikti i subjektit në satirë dhe humor nuk është gjithmonë i tillë. Ai është edhe i drejtpërdrejtë: forcat pozitive ndeshen me forcat negative si në veprat e zakonshme. Por edhe në këtë rast ai duhet të jetë konflikt komik, që të ngjall të qeshura. Dhe e qeshura nuk duhet të ngjallet nga veprime banale, duke u zënë për flokësh personazhet ose duke u rrahuar me çibukë.

Konflikti i subjektit ndërmjet personazheve pozitive dhe negative ose me të meta është më i përhapur në satirën dhe humorin tonë. Ky lloj konflikti, për shembull, qëndron në bazë të komedisë «Zonja nga qyteti», të kinokomedisë «Kapedani», të poemës «Epopeja e Ballit Kombëtar» e me radhë. Por si në formën e konfliktit ndërmjet personazheve negative, ashtu edhe mes atyre pozitive dhe negative në satirë dhe humor ka një veçori shumë të ndryshme nga epika ose lirika. Konflikti në humor dhe satirë është i dyfishtë. Njëri është konflikti i subjektit dhe tjetri është ai i thelbit social. Po e shpjegoj. Konflikti i subjektit në komedinë «Karnavalet e Korçës», siç thamë, është mes Nikollaqit dhe Olimbisë, të dy personazheve negative. Konflikti i «padukshëm» shoqëror është mes pamjes së jashtme të tyre, si të ndershëm dhe të rregullt, me thelbin e brendshëm, si batakgjinj që për paranë çdo gjë mund të bëjnë. Edhe në mungesën e dytë të trajtimit të konfliktit të subjektit mes heronjeve

pozitivë dhe negativë ose me të meta, përsëri kemi dyzimin e tij. Në komedinë «Zonja nga qyteti» Ollga është në konflikt me fshatin dhe njerëzit e tij. Ky është konflikti i subjektit. Me këtë ne qeshëm. Ndërsa konflikti shoqëror dhe ideor është i padukshëm. Ollga ka paragjykime konservatore dhe patriarchale, të cilat bien ndesh me të renë në fshat, me përparimin. Ky konflikt i padukshëm është tragjik, ai nuk të bën të qeshësh, por të trishtohesh dhe të kesh një keqardhje: përse të ndodhin këto gjëra. Me një fjalë, në epikë konflikti nuk dyzohet, kurse në satirë dhe humor ai është i dyzuar: i subjektit nga një anë dhe i thelbit të brendshëm shoqëror nga ana tjetër, d.m.th. i mospërputhjes së formës së dukurisë me përmbytjen e vërtetë të tij. Kjo specifikë e konfliktit të dyzuar kërkon edhe specifikën e personazheve, harmoninë e tyre komike e të tjera, për të cilat folëm gjerë e gjatë që në fillim të këtyre shënimeve.

Specifika e konfliktit dhe personazheve të humorit dhe satirës kërkojnë edhe origjinalitetin e gjuhës. Largimi nga specifika sjell edhe prishjen e gjuhës dhe dëmton harmonizimin e saj me gjithë mjetet shprehëse të gjinisë së satirës. Atëherë gjuha del jashtë gjinisë dhe mbetet larg garës komike të personazheve. Prandaj trajtimi, keqkuptimi i tipikes dhe paqartësia e personazhit pozitiv kanë ndikuar edhe në varfërimin e gjuhës së humorit dhe të satirës, në tharjen e lëngut të saj dhe në zbehjen e koloritit. Gjuha e gjallë e popullit, humori i shëndetshëm, ironia, sarkazma dhe e folura alegorike, që janë aq të dukshme te njerëzit e thjeshtë, te fshatarët, te punëtorët, te intelektualët, te studentët, shumëherë mungojnë në veprat humoristike. Vendin e gjuhës së shkathët e të zgjuar, me shprehje të mprehtë e të mençur, e zënë frazat klische, banale e pa kripë. Kemi përshtypjen se humoristët nuk e njojin sa duhet edhe humorin e popullit, edhe gjuhën e tij. Dhe dihet se pa këtë gjuhë nuk mund të ketë humor dhe satirë të vërtetë. Gjuha e popullit mësohet, kur të njoħeš njerëzit dhe punën e tyre. Gjeneratori i humorit e satirës është udhëtimi në mes të njerëzve, vëmendja e shkrimtarit ndaj tregimeve të tyre. Njerëzit tanë janë të zgjuar e me një humor të mprehtë. I zgjuari di të bëjë humor, budallai s'di të bëjë shaka; ai është objekt i shakasë, por jo prodhimtar i saj. Veçori e gjuhës së humorit janë shprehjet e zgjuara me nënteks

thumbues dhe shpesh të papritura, që arrijnë ndonjëherë gjer në paradoks. Ato e ngjallin humorin, i japin dritë dhe e ngrenë lart.

Humori dhe satira në letërsinë tonë i kanë mundësitë të ecin përpara. I fuqishmi qesh. Populli dikur ishte i shtypur, por ishte i fuqishëm dhe këtë fuqi e tregonte edhe me armën e humorit dhe të satirës. Ai tallej me bejlerët, agallarët, hoxhallarët, priftërinjtë, tregtarët dhe pushtuesit. I vinte në lojë, tregonte histori komike, nxirrte fjalë të urta. Ne sot jemi të plotfuqishëm. Socializmi është fitimtar dhe nuk ka frikë të qeshë, të tallet e t'i vërë në lojë dobësitë e të metat në shoqëri, duke i fshiku-lluar me armën e satirës.

RINIA PËRGATIT TË ARDHMEN E LETËRSISË DHE TË ARTIT

Shkrimtarët dhe artistët e rind do ta çojnë përpara artin dhe nesër shumë prej tyre do të janë në pararojë të krijimtarisë sonë kombëtare. Brezat në letërsinë dhe artet shqiptare kanë thënë fjalën e tyre, duke përfaqësuar periudha të tëra në historinë e krijimtarisë. Letrarë të rind kanë qenë në fillim De Rada e Naimi, Migjeni e Noli, por ata u bënë shkrimtarë të vërtetë dhe hynë në traditën tonë. Ndërkokë kanë qenë edhe novatorë. Novatorja përbën thelbin e traditës. Me një fjalë, ajo që sot është novatore, nesër kthehet në traditë. Kështu ka ndodhur dhe ndodh edhe me letërsinë dhe artin e realizmit socialist. Të gjithë kolegët tuaj të moshuar që shikoni në këtë konferencë, kanë qenë letrarë dhe artistë të rind dhe kanë marrë pjesë në kuvende të tilla pas Çlirimt të vendit.

Krijimtaria letrare e artistike e letrarëve dhe artistëve të rind është pjesë përbërëse e letërsisë dhe arteve tona. Ajo luan rol të rëndësishëm në edukimin komunist të njerëzve dhe në freskimin e gjithë arteve. Mbi gjashtëdhjetë për qind e gjithë prodhimit letrar e artistik të vendit përballohet nga rinia, nga mosha tetëmbëdhjetë e njëzetepesë-vjeçare. Kjo moshë sot mbizotëron me poezinë, me baletin, me lojën në skenë dhe në ekran dhe me pikturen. E ndjeshme është edhe krijimtaria në prozë, në muzikë, në kinematografi, në filmin televiziv e në skulpturë. Këngëtarët që

shohim ditë për ditë në ekranin e televizorit të gjithë janë të rinj. Janë vënë me të vërtetë në lëvizje energji të mëdha krijuese, që me siguri do ta ngrenë në një stad të ri zhvillimi. E gjithë kjo është rrjedhim i ngritjes së kulturës së masave të gjera punonjëse, e zhvillimit të letërsisë dhe arteve, e përhapjes së arsimit dhe diturive, e rritjes së mirëgenies së popullit dhe e emancipimit të përgjithshëm të njeriut në shoqërinë socialiste. Kushtet për t'u marrë me letërsi dhe me art tanë janë më të mira dhe më të favorshme se disa vjet të shkuar. Këto kushte i kanë dhënë edhe krijimtarisë letrare e artistike të rinisë disa tipare të reja që mbajnë vulën e kohës.

E para, kjo krijimtari është shumë e gjerë, është shumë masive. Me qindra shkruajnë, luajnë në skenë, piktuojnë, këndojnë e kompozojnë. Ky pasion është kthyer në kërkesë shoqërore e në mënyrë jetese, që pasuron figurën morale të të riut tonë, që e bën atë njeri me botë të begatë dhe ia rrit personalitetin në shoqëri. Ai kryen detyrat ndaj shoqërisë me punën e përditshme të tij, por bës edhe një veprintari të panormuar, të lirë. Të jetosh do të thotë të plotësosh detyrën. Vërtetë të plotësosh detyrën, por jo vetëm detyrën e normuar. Të jetosh, do të thotë të plotësosh edhe detyrën e panormuar. Prandaj ne themi se këta të rinj dhe të reja që merren me letërsi dhe arte, që shkruajnë, piktuojnë, kompozojnë, skalitin e vallëzojnë, edhe sikur të mos bëhen të gjithë të shquar në krijimtari (dhe s'ka se si të bëhen) prapëseprapë ata do të bëhen të shquar në jetë. E tillë është puna me artin: të sjell dobi në jetë. Dhe sa më shumë njerëz të kemi që merren me artin, aq më të bukur e bëjmë jetën dhe aq më shumë i afrohemë komunizmit.

E dyta, krijimtaria e të rinjve që hyjnë sot në letërsi dhe arte ka një nivel të përgjithshëm kulturor më të ngritur se ajo e dy-tre dhjetëvjeçarëve të mëparshëm. Në poezi të rinjtë nuk vijnë me bejte, siç vinin shumë nga moshatarët e brezit tonë, e brezit të pesëdhjetëvjeçarëve të sotëm. Në poezinë e të rinjve të tanishëm ndihet vargu i kulturuar, mendimi i freskët, ritmi dhe asociacionet e kohës. Kur lexojmë librat «Emrat tuaj» të Preç Zogajt, «Atdheu fillon te zemrat» të Petrit Rukës dhe miaft të tjerrëve të këtij brezi, vërejmë një poezi me një sintaksë poetike dhe me një figuracion të ndryshëm nga të të kolegëve të tyre paraardhës. Disa nga paraardhësit e tyre, që ende

janë të rinj, kanë një varg disi bërtitës, kurse dy poetët që përmenda, bashkë me Ilirian Zhupën, Skënder Rusin e Besnik Mustafanë, në poezinë e tyre synojnë drejt mendimit, drejt arsyetimit për botën dhe njeriun.

Për nivelin kulturor tregojnë mjaft krijime të të rinjve në gjithë fushat e artit. Fjala vjen, suita simfonike e Sokol Shupos «Vite të vegjëlisë», e frysmezuar nga libri i shokut Enver me kujtime, të ngjall emocione të thella, se është shkruar me nivel artistik dhe me kulturë. Plot shpresë është edhe krijimtaria muzikore e Thoma Simakut, që tanimë ka dhënë prova në muzikën e filmit dhe të lehtë. Me optimizëm mund të flasim edhe për disa piktorë e skulptorë të rinj, si për Hilmí Kasemin që gatoi shtatoren e Enver Hoxhës me mjaft mjeshtëri, vepër kjo e vështirë dhe me ndjenjë përgjegjësie. Peisazhet e Bashkim Ahmetit dhe të Anastas Kostandinit, të dy piktorëve që në përgjithësi janë të rinj e pasqyrojnë realitetin të rikrijuar dhe nuk janë kopje të hollësishme dhe të imëta të natyrës. Të rinjtë e talentuar e kuptojnë se në art realiste është ajo që ka një ekzistencë estetike bindëse. Nivel kulturor tregon edhe loja në balet e Albana Sulejmanit, Ilir Kernit dhe Ludmill Çakallit, pasi ekzekutimi i veprave të baletit prej tyre të krijon gjendje emocionale dhe të jep kënaqësi estetike. Ka të rinj të tjerë që ende nuk kanë botuar libra, por në vjershat e tyre është embrioni i poetëve të ardhshëm. Këtë vizion të jatin vargjet e së resë Mimoza Ahmeti të botuar në gazetat e revistat letrare. Janë vargje me dendësi përbajtje dhe intensitet.

Duke e ndjekur krijimtarinë e këtij brezi të ri, duke ndjerë përmes saj kulturën artistike, dallon në horizontin e artit poetët, piktorët, skulptorët dhe kompozitorët e ardhshëm. Këto nuk janë silueta artistësh, por artistë të gjallë në formim.

E treta, karakteristikë e krijimtarisë të të rinjve, pas masivitetit dhe kulturës së krijimit, është fryma progresiste dhe militante. Kjo është një krijimtari me përbajtje të shëndoshë, e angazhuar me qëllime të larta shoqërore. Krijuesit e rinj janë patriotë dhe militantë, me një dashuri të nxeh të përvendin dhe me një besim të fortë në idealet komuniste dhe në vijën e Partisë sonë. Ata nisen në krijimtarinë e tyre nga qëllime fisnike për t'i shërbyer njeriut, ndërtuesit të shoqërisë së re socialiste, Artin nuk e bëjnë për interesa të vockla dhe egoiste, por e bëjnë për

interesa të gjera. Prandaj ky art nuk është i ngushtë, por është me hapësirë dhe optimizëm, që të fton pér punë të mëdha. Të rintjtë kanë edhe në artin e tyre moral të lartë. Këtë moral ua ka brumosur marksizëm-leninizmi, mësimet e Enver Hoxhës dhe vetë letërsia dhe artet tona. Nga arti ynë njerëzit edukohen, pajisen me mendime të mëdha, nxitin përfytyrimet.

Në rininë tonë letrare e artistike nuk ka zëré regresivë dhe trumpeta që trumpetojnë shthurjen morale. Mund të ketë mungesa mjeshtërie, mund të mos mjaftojë njohja ose kultura e përgjithshme në disa raste, por qëllimi përparimtar dhe morali i kulluar mbeten të paturbulluar, mbeten të bukur. Të rintjtë, edhe kur priren ndonjëherë nga motivet e një bote disi arkake, ndaj përshkrimeve me patetikë të bjeshkëve ose të kohërave të shkuara, nuk nisen nga qëllimi pér t'u arratisur nga realiteti në një botë me legjenda, por pér të thënë diçka romantike. Natyrisht, kjo me moshën kalon.

Krijimtaria e pasur dhe e bukur e të rindjeve është burim frymëzimi edhe pér ne më të vjetrit. Nuk merrni vetëm ju nga krijimtaria jonë. Edhe ne marrim nga krijimtaria juaj, por jemi më «dinakë» dhe ju nuk na i vini re. Ju merrni nga ne pa dinakëri, se jeni të singertë dhe ne ua vëmë re me «dinakërinë» tonë.

Doemos, kjo krijimtari e të rindjeve ka edhe mjaft probleme që ziejnë përbrenda dhe që herë-herë dalin mbi si-përfaqe me forcë. Duke i zbuluar dhe trajtuar problemet aktuale të letërsisë dhe arteve që bën rinia, ne nuk e vëmë krijimtarinë e saj para bankës së gjykimit si gjykatës, por shtrohem bashkërisht pér të diskutuar dhe pér të rratur mendime se si të gjejmë rrugë pér ta çuar përpara.

Ashtu si pér gjithë letërsinë dhe artet, problemi i parë që qëndron para krijimtarisë së letrarëve dhe artistëve të rindje, është ai i njohjes së jetës. Fjalët «njohja e jetës» janë përsëritur shumë. Nuk ka artikull, diskutim dhe raport pér letërsinë dhe artet që këto fjalë të mos përsëriten në formë nga më të ndryshmet. Me këtë shprehët edhe rëndësia që ka njohja pér artistin dhe artin. Njohja është hapi i parë dhe themelor pér t'u pajisur me dije dhe me ide. Pa njohje nuk ka ide; ajo qëndron në bazën e filozofisë materialiste. Njohja gjatë praktikës krijuese është vendimtare pér shkrimtarin e talentuar. Shoku Enver në veprimtarinë dhe në veprën e tij njohjes së jetës i jep një rëndësi të jashtë-

zakonshme. Ai vazhdimisht i ka këshilluar dhe i ka porositur shkrimtarët dhe artistët dhe veçanërisht të rinxjtë për ta njojur popullin, punën, luftën, mënyrën e jetesës, zakonet, folklorin dhe historinë e tij. Njohja e jetës së popullit ka qenë dhe është në praktikën e punës së Partisë sonë. Ajo pse e njoju veprimtarinë dhe jetesën e popullit, shprehu interesat e tij që në lindjen e saj. Shembull për njojen e gjithanshme të jetës, kulturës dhe historisë së popullit ne kemi Enver Hoxhën. Merrni problematikën e veprave të tij dhe shikoni si zien; merrni gjuhën e librave të tij dhe vini re si rrjedh me tërë ngjyrat dhe nuancat e gjuhës së popullit. Librat e tij «Titistët», «Kur lindi Partia», «Vite të vegjëlisë», «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë», «Kur u hodhën themelët e Shqipërisë së re», «Mes njerëzve të thjeshtë» e me radhë, janë tërë jetë, prandaj kanë edhe ide të mëdha përgjithësuese. Shkrimtarët tanë më të shquar e kanë njojur jetën, folklorin dhe historinë e popullit, ndaj kanë krijuar vepra me vlera të larta ideore e artistike dhe me personazhe dhe heronj biindës.

Heronjtë dhe personazhet e një libri veprojnë në fushën ekonomike, ideologjike dhe shoqërore. Po nuk i njohe këto tri fusha, heronje dhe personazheve nuk ke se ç't'u japësh, nuk ke se me ç'probleme, me ç'mendime dhe me ç'ide t'i ndeshësh. Ata mbeten hije të njerëzve dhe nuk qëndrojnë si njerëzit. Jeta njihet që në rini. Sa më shumë jetë interesante dhe të pasur me ngjarje të ketë bërë shkrimtari dhe artisti në fëmijérinë dhe rininë e tij, aq më tepër vepra me vlerë jep, aq më shumë lëng jetësor ka ndër to. Ne duhet të mësohami të jetojmë sa më tepër në mënyrë interesante plot me shqetësimë, plot me përpjekje dhe kërkime. Ai shkrimtar që ka jetuar një fëmijéri dhe një rini pa kokëçarje, një fëmijéri dhe një rini mes karameleve, gjalpit dhe zbavitjeve bo-she, kurrë nuk mund të bëhet talent i vërtetë. Mund të botojë edhe libra, por ata do të jenë pa vlerë, pasi do të krijohen për t'u englendisur, për t'u zbavitur, për modë dhe për inerci. Prandaj shkrimtarët e vërtetë zakonisht dalin nga gjiri i popullit, nga etërit dhe nënët e thjeshta plot halle dhe punë, dhe nuk dalin në përgjithësi nga një jetë dhe ambient i përkëdhelur. Vetëm kur njeriu bëhet shkrimtar, ka nevojë për përkëdheli.

Jeta duhet njojur siç e njeh punëtori i Partisë, siç e njeh drejtuesi, historiani dhe filozofi. Nuk duhet njojur siç e njeh njeriu i zakonshëm. Letrarët dhe artistët e rinj mes

jetës jetojnë dhe nuk mund të themi që nuk e njohin. Me gjithatë, shpesh në krijimet e tyre nuk ndihet jeta e gjallë e njerëzve. Kjo ndodh pasi ata nuk dinë të këpucën në valët e jetës atë dukuri dhe atë problematikë dhe temë të rëndësishme për artin. Atëherë në librat e tyre ndihet realiteti i librit dhe jo realiteti i jetës. Është njëloj sikur bleta ta bëjë mjaltin prej mjaltit, siç thotë një shkrimtar i njohur. Mjaltin bleta e grumbullon nga shumë lule, nga shumë realitete lulesh. Nga njohja e paktë e jetës si shkrimtar dhe artist, na ndodh ndonjëherë në praktikën letrare që libri i dytë ose i tretë i një poeti është më i dobët se i pari. Në të parin poeti i shpenzoi të gjitha përshtypjet e jetës, e shpenzoi gjithë sëndukun e thesareve që quhen njohuri dhe nuk i mbeti gjë për të tjerët. Grumbullimi i përshtypjeve të jetës u ndërpre ose u dobësua jeta, nuk vazhdoi të bëhej për ta interesante. Ndodh edhe e kundërta. Libri i parë i Ilirian Zhupës nuk ra në sy të lexuesve dhe admiruesve të poezisë. Në të mungonte jeta e vërtetë, kishte vetëm hije të jetës. Libri i dytë i tij shkëlqeu. Autori u pasurua me jetë dhe me kulturë artistike.

Në të gjitha artet është e domosdoshme njohja e jetës, pasi ajo ngacmon fantazinë dhe jep material të begatë për krijimtarinë. Edhe poezi, që është koncentrat dhe s'ka nevojë për rrëfim, i duhet njohja e realitetit.

Megjithatë, ka disa raste, siç është proza, që e duan jetën me shumicë. Proza pa jetë diskretohet shpejt, bëhet e mërzitshme dhe e padurueshme. Prozatorët e rinj këtë duhet ta kuptojnë dhe ta ndiejnë thellë. I riu Thani Naqe, që punon si ekonomist agrar në një kooperativë bujqësore të Korçës, këtë e di mirë. Prandaj në tregimet e tij ka përshtypje të freskëta nga realiteti i sotëm i fshatit.

Mungesën e njohjes së jetës ne e vëmë re edhe në pikturën e të rinjve. Shpesh në të ka një reflektim mekanik dhe fotografik të jetës, mungon interpretimi i saj, gjykim i dhe meditimi mbi të. Në kanavacë herë-herë reflektohen rregullat shkollore të vizatimit dhe pikturnimit. Tablotë, portretet dhe peizazhet duket sikur janë realiste, por në fakt konfondohet realizmi me fotografimin e realitetit. Në to nuk është ajo ekzistenza bindëse estetike që e bën pikturën. Fjala vjen, kur pikton një qen në kanavacë dhe mundoresh ta bësh me realizëm të plotë, po nuk të ngjalli kënaqësi estetike, realitet estetik, ai mbetet qen natyror. Qeni në realitet të kafshon, të ha. Por kjo nuk do të thotë që të

dalë nga tabloja duke lehur dhe të të hajë. (Ta bësh aq realist sa të të hajë!)

Problemi i dytë, është ngritja e cilësisë së krijimtarisë letrare dhe artistike. Cilësia e artit nuk është diçka abstrakte që nuk e dimë nga vjen. Cilësia, në radhë të parë, kërkon talent. Por kërkon edhe njohjen e jetës që e përmendëm pak më lart dhe plus kulturën e profesionit dhe të përgjithshmen. Në letërsinë dhe artin që krijojnë të rintjtë nuk shkon gjithçka në harmoni si në Eden e në parajsë. Në to ka shumë probleme që kërkojnë vëmendje të vecantë. Në poezi, për shembull, ka nevojë për zgjerimin e motiveve dhe për largimin nga stereotipet poetike të krijuara me kohë dhe të shpërdoruara si proverbat. Stereotipe të tillë, si «një copë qelli», «me një këngë në buzë», «kostelacion fjalësh», «konture qytetesh», «kodra të shqyera nga luftërat», «meteorië në qiejt e largët» etj., etj. formojnë shtresa dhe nënshtresa në poezi siç depozitohen fletët e rëna të pyllit nga një vjeshtë në tjetrën. Vetë përdorimi i një mënyre vargëzimi të lirë, pa variacion vargjesh dhe strofash, vetë sintaksa poetike e njëllotë nga një libër në tjetrin formon një monotonji që kthehet në zakon poetik, që bëhet konvencion i pathyeshëm dhe s'lejon të futen ide të mëdha. Vargu i lirë shkatërrohet dhe zhduket pa nervin poetik. Nervi poetik është temperimi i intonacionit oratorik të vargut ose përroi i metaforave. Poeti kur çlironhet nga strofa dhe shkon drejt vargut të lirë, në të njëjtën kohë duhet nga vargu i lirë të shkojë drejt strofës. Ta çlironjë poezinë nga konvencioni dhe përsëri ta sjellë drejt rregullshmërisë, disiplinës dhe harmonisë, ashtu siç bën deti që i shtyn dhe i mbledh valët pérherë, nga harmonia shkon në disharmoni dhe nga disharmonia në harmoni. Këtë punë mund ta bëjë ai poet që e njeh si bukën mjeshterinë, metrikën, sintaksën poetike dhe në përgjithësi teorinë e poeziës.

Niveli artistik i krijimtarisë së letrarëve dhe artistëve të rinj është i pashkëputur nga tematika dhe problematika. Zgjerimi i tyre, por aq sa u kërkohet të rinjve, është i domosdoshëm dhe jetik për këtë krijimtar. Ambientimi me një tematikë të ngushtë është i dëmshëm, pasi bëhet zakon, dhe pjell mediokritetin. E drejta e tematikës së gjërë nuk është pronë e shkrimitarëve dhe e artistëve të njohur dhe të afirmuar. Ajo është një për të gjithë. Shoku Ramiz Alia në takimin e tij me shkrimitarët dhe artistët korçarë nën vizion: «Art i vërtetë është ai që ecën në një hap me preokupimet

e rëndësishme të popullit dhe që i ngre shoqërisë problemet që dalin në jetë, duke treguar dhe zgjidhjet e tyre. Këto cilësi i vëmë re në krijimtarinë tonë më të mirë. Duke u mbështetur në këtë traditë të pasur duhet të mënjanohen ato raste kur shumë çështje të temës aktuale preken në mënyrë të cekët, monotone, kur nuk rriven probleme të rëndësishme të kohës»¹). Në mënyrë të cekët e monotone pasqyrohet shpesh realiteti në disa tregime të të rinxve, të cilët janë të stisur dhe pa jetë. Tregimet plot jetë të Ilir Zhillës të botuar në revistën «Nëntori», dallohen mes zbrazëtisë të disa të tjera. Proza kërkon shumë jetë, kërkon analizë të dukurive dhe nuk mjaftohet vetëm me rrëfimin e ngjarjes pa ndonjë synim të qartë ose me mbështjelljen e kësaj ngjarjeje me lëvozhgën e padepërtueshme të fjalëve pompoze të zbuluar ose të fryra me agitacionin e zakonshëm politik. Kjo mënyrë trajtimi i fsheh problemet, i mbulon kontradiktat dhe ia hap shtegun skematizmit. Me këtë mënyrë bërtet tendenca. Tendenca nuk duhet të bërtasë. Tendencën bërtitëse e vëmë re here herë edhe në pikture me pozat e figurave, me krekojen dhe muskujt e tyre për t'iu dhënë gjoja «frymë revolucionare». Në fakt, kjo mënyrë e varfëron pikturen dhe e bën që të mos ndihet estetikisht. Trajtime të tillë tregojnë dobësitë e përgatitjes mjeshtërore dhe kulturore. Prandaj shoku Enver këshillon: «Nuk mjafton të kapësh temën e ditës, të shkruash për heroin pozitiv, për realitetin socialist etj. Vetëm kjo, pa mjeshtërinë artistike, nuk mund të të emocionojë, të të edukojë dhe të të frymëzojë për të sotmen e për të ardhmen. Rritja e cilësisë në artet është një kërkësë që vjen nga rritja e nivelit kulturor dhe e shijeve estetike të masave të gjera punonjëse, nga kushtet e sotme të zhvillimit të shoqërisë sonë.»

Cilësia e prodhimit letrar e artistik të rinisë ka të bëjë edhe me shkollën, me njohuritë që merren atje, me mësuesit dhe pedagogët, me tekstet shkollore dhe universitare. Mësuesi i letërsisë është shoqëruesi i parë i shkrimitarit të ardhshëm. I pari ai e zë për dore dhe e shpie në kështjellën e artit këtë shkrimitar të ardhshëm, duke i ngjallur dashuri, respekt dhe kuriozitetet për fshehtësitë e saj. Mësues plot pasion kanë qenë Nonda Bulka, Sterjo Spasse, Aleks Buda e të tjera, që, siç tregojnë moshatarët e mi, kur shpjegonin në orën e lëndës së letërsisë, ndizej fantazia dhe kapercante muret e ftohta të klasës, duke fluturuar larg, në një botë të madhe, që quhet art. Në Gjirokastër, nga fundi i viteve dyzet dhe në fillim të viteve pesëdhjetë, ishte mësues i gjuhës dhe i letërsisë Thoma

Papapanoja, njeri i apasionuar pas fjalës së kulluar shqipe, dhe Vehbi Bala, që atëherë ishte i ri dhe plot pasion për letërsinë. Dashurinë e parë për poezinë dhe për letërsinë në përgjithësi ata na e ngjallën mua dhe shokëve të mi, nxënës të atëhershëm. Edhe sot shkolla jonë ka mësues të zotë të letërsisë, që bëjnë një punë të madhe. Për shembull, Koci Petriti, si mësues i letërsisë në shkollën e mesme të Librazhdit, ua bën nxënësve orën e letërsisë të bukur dhe tërheqëse, pasi edhe vetë është poet dhe i do të rinjtë.

Shkolla jonë tanë është forcuar dhe jep dituri të pasura. Por edhe kërkesat janë rritur, pasi jetojmë në pragun e shekullit të 21-të. Dhe ndodh në jetën e shkollës që mësuesit e letërsisë dhe të arteve të tjera nuk kanë atë pasionin e nevojshëm dhe shpjegojnë thatë, pa u ngjallur të rinjve dashurinë për krijimtarinë artistike. Edhe temat e hartimeve i zgjedhin të përgjithshme dhe i kërkojnë të trajtohen me fraza pompoze dhe agitative vulgare. Atëherë kjo frazeologji e hartimeve futet padashur në krijimtarinë e mëvonshme, në artikujt e në diskutimet, pasi kthehet në zakon dhe i shtyn të rinjtë të ambientohen me të. Gjithashtu, tekstet e letërsisë dhe të arteve të teorisë dhe historisë së tyre shpesh kanë ujë frazeologjik, lumë fjalësh dhe pak esencë. Këto tekste nuk janë të këndshme për t'u lexuar dhe herë-herë s'japin informacion_dhe dituri. Ky është një problem që duhet të na preokupojë më shumë, veçanërisht Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës, Universitetin, kritikët e studiuesit dhe vetë shkrimtarët dhe artistët. Mendimin e ri dhe të gjallë për letërsinë dhe artet ne duhet të përpinqemi ta futim në tekstet dhe të mos lëmë në to arsyetime të thata tradicionale.

Niveli artistik i krijimtarisë së të rinjve është i pandarë edhe nga puna e redaktorëve ose kërkesave të institucioneve kulturore. E themi këtë, pasi redaktori dhe përgjegjësi i institucionit ka të bëjë drejtpërdrejt me veprën dhe krijimtarinë e të riut. Në praktikën letrare ndodh që veçanërisht poetit të ri i hiqen nga libri vjershat më të mira, pasi redaktorit i duken si gjëra të jashtëzakonshme dhe s'i mbushet mendja që një djalosh ose një vajzë e re të shkruajë gjëra që janë jashtë normës, me të cilën është mësuar përgjegjësi. Ky përgjegjës mendon se këto gjëra mund t'i shprehë vetëm një poet i afirmuar, me emër të madh dhe s'i kanë hije një të riu. Kështu, mjaft vjersha të një poeti të ri, që janë ndofta nga më të mirat, redaktori ia ka hequr nga libri dhe ai i ka bo-tuar pastaj në «Zërin e rinisë» dhe në «Drita» ose «Nëntori».

Ose disa të tjera ia ka shkurtuar dhe ka bashkuar strofa heterogjene në përbajtje dhe në formë. Poeti i ri, duke dashur ta botojë librin, ka rënë në kompromis të heshtur. Por kjo të gjithëve na ka ndodhur. Mua nga libri i parë më kanë hequr vjersha të mira dhe pastaj i kam botuar në të dytin, pasi redaktori i kishte harruar. Vjershat që më kanë hequr nga libri i dytë i kam botuar në të tretën dhë disa në të fundit, kur redaktorët e mi dolën në pension. Prandaj ju mos u dëshpëroni. Vjersha e mirë e nxjerr në pension redaktorin!

Ndikimi i redaktorit është i rëndësishëm edhe në anën tjetër të problemit. Ai duhet të dijë të seleksionojë dhe ta orientojë drejt autorin. Për këtë duhet kulturë e gjerë, madje kulturë më e madhe se e poetit. Ne kemi redaktorë të zotë, që bëjnë një punë të lavdërueshme. Vërejtje do të ketë nga poëtët. Konflikti poet-redaktor është i përjetshëm. Vetëm Homeri nuk ka pasur redaktor. Ne kemi, se s'jemi si Homeri. Edhe qaramanë shumë nuk duhet të bëhemë; pasi jo çdo gjë që del nga dora jonë është flori. Kalon pak koha dhe ne ndaj vetes bëhemë më të rreptë se redaktori që e kemi sharë. Redaktori duhet të jetë i rreptë, kur është çështja e mbrojtjes së parimeve ideologjike në art. Këtu s'ka asnjë lëshim! Dhe të mos ketë asnjë shpresë për lëshim. Kemi përvojën e hidhur para Plenunit të 4-t të 1973-së që na ka mësuar shumë.

Problemi i tretë dhe i fundit është ai i përgatitjes ideopolitike dhe i brumosjes botëkuptimore të letrarëve dhe artistëve të rinj. Formimi ideologjik e botëkuptimor i jep shkrimitarit dhe artistit kyçin për të hyrë dhe për t'u orientuar në dukuritë e ndërlikuara të jetës së shoqërisë dhe për t'i pasqyruar drejt ato. I armatosur me teorinë marksiste, letrari di të kapë kryesoren mes dukurive, mes kontradiktave, mes ngjarjeve dhe sendeve. Marksini, Engelsini, Leninin dhe gjithë mendimtarët marksistë shkrimitari dhë artisti i realizmit socialist duhet t'i dijë me themel. Dhe kryesorja, të njohe théllë veprën e begatë dhe të madhe të Enver Hoxhës, se atje është edhe teoria dhe praktika e ndërtimit socialist të vendit dhe proceseve të zhvillimit të revolucionit tonë. Nga ana tjetër, është e domosdoshme të lexohen dhe të studiohen libra sociologjikë dhe ekonomikë, teorikë dhe historikë, se duke i njojur këto realiteti pasqyrohet në gjerësi dhe në thellësi. Në veprat letrare e artistike hyn më shumë gjykimi dhe vështrimi filozofik dhe bëhet më e thellë analiza psikologjike e personazheve, i jepet më shumë frysma marrje «unit» poetik dhe arsyetimit mbi faktet dhe dukuritë. Formimi botëkupti-

mor të ndihmon për të jetuar intensivisht me jetën dhe me situatat e brendshme dhe të jashtme, politike dhe ekonomike. Kjo i jep jetëgjatësi veprimtarisë artistike të shkrimtarit dhe nuk e lë të shterrojë shpejt pas dy-tri librave. Ata shkrimtarë dhe artistë që janë plakur herët, që në moshën dyzetyjeçare, dhe kanë krijuar shkrime dhe punime mediokre, kanë humbur interesin për jetën politike dhe ideologjike të shoqërisë, janë tërhequr mënjanë me komoditetin dhe qetësinë patriarkale ose mikroborgjeze, kanë humbur mes sendeve dhe janë shndërruar në sende frymore. Letrarët dhe artistët e rindëruar nuk duhet ta pushojnë veprimtarinë politike e shoqërore. Të marrin pjesë në diskutime e debate, të shkruajnë artikuj e reportazhe në gazeta e revista, të mbajnë fjalime e referate, të shkojnë me ekipe në fshatra e në qytete të ngarkuar nga komitetet e partisë dhe të Bashkimit të Rinisë. Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve dhe veçanërisht sektori i letrarëve dhe artistëve të rindëruar pranë saj, duhet të bëjë më shumë për talentet e reja, të mbajë seminare, diskutime krijuese, kolokiume e simpoziume, gjithashtu të ndihmojë konkretisht, kur letrarët sjellin dorëshkrime. Vetë të rindjtë të bëjnë një jetë më të pasur intelektuale, t'ia lexojnë njëri-tjetrit vjershat dhe tregimet, të diskutojnë për to, të gëzohen kur botohet nga kolegët e tyre diçka e mirë dhe të mos janë kurrë indiferentë. Indiferentizmi në art është i dëmshëm, pasi lind amullinë dhe mërzinë. Dhe organizatat e rinisë duhet ta shohin punën me letërsinë dhe artet si veprimitari të tyre, si pjesë të edukimit komunist, pasi në përgjithësi pak merren me krijimtarinë e të rindjve. Organizatat e rinisë duhet të edukojnë te letrarët dhe artistët e rindëruar ndjenjën dhe shpirtin e kërkimit të përhershëm kundër komoditetit të lehtë vetjak. Të mos kënaqemi dhe të biem në eufori me botimin e librit të parë, duke menduar se u bëmë të famshëm. Poeti vërtet duhet të synojë të bëhet i madh dhe jo mesatar, por këtë dëshirë nuk duhet ta lërë të bërtasë nëpër pazar dhe nëpër redaksi: «unë do të bëhem i madh!». Ky njeri që bërtet asnjëherë nuk bëhet i madh. Puna dhe talenti kurrë nuk bërtasin. I madhi gjithmonë është modest. Vetëm i madhi i përkohshëm nuk është modest. Ne jemi artistë të tipit të ri, shprehim interesat e popullit, rrojmë me popullin dhe nuk murmuritim: jemi «yje». Ylli kemi popullin! Arti është i gjatë dhe rruga e tij është shumë herë më e vështirë se sa e mendojmë. Të respektojmë traditën dhe shkrimtarët e artistët më të vjetër dhe të mos mendojmë se nga

ata nuk kemi se ç'mësojmë. Ngecja në vend e disa të rinjve para këtij brezi që po diskutojmë, i ka shkaqet edhe në mendjemadhësinë dhe në përbuzjen e krijimtarisë së disa shkrimtarëve dhe artistëve të njohur. Këta që ngecën morën për model një ose dy shkrimtarë, u bënë epigonë të tyre dhe mbeten tërë jetën nën hijen e të tjerve. Një shkrimtar mund ta duash dhe të mësosh prej tij, por duhet të dish edhe si të largohesh dhe të mos biesh në gjunjë para tij. Imitimi ta humb personalitetin. Me imitim mund të shkëlqesh me dritë aty për aty, por kjo dritë është e marrë nga tjetërkush dhe të ikën shpejt. Më mirë këtë dritë ta kesh më të vogël dhe fënden, se sa ta huash nga një i dytë. Në duam sa më shumë shkrimtarë dhe artistë të ndryshëm. Letërsia jonë do të ishte më e dobët, po të kishte dy Naimë dhe asnje Çajup, megjithëse Naimi është poeti ynë më i madh. Me një lloj zogu pylli do të ishte i varfér edhe sikur ky zog të ishte më i bukur i botës. Në pyll ne duam edhe bilbilin, edhe larashin, edhe qukapikun, edhe mëllenjën, edhe gushëkuqin, edhe shqiponjën. Kështu është puna edhe me poetët dhe artistët, me prozatorët dhe piktorët, me kompozitorët dhe skulptorët. Duam shumë zëra dhe nuk duam vetëm një zë. Vetëm me violinën e parë nuk bëhet asnje koncert simfonik, megjithëse kjo është violina më e rëndësishme.

Në formimin ideologjik rëndësi të ndjeshme ka shtypi i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve dhe i Bashkimit të Rinise. Ai duhet të bëjë një punë të diferencuar, të dijë të zbulojë dhe të përkrahë talentet e vërteta, të shkruajë për ta, të rencionojë dhe të dallojë librat e tyre, t'ua ndjekë hap pas hapi krijimtarinë. Në këtë mënyrë duhet të veprojë edhe për piktorët, kompozitorët, skulptorët dhe artistët e rinj të skejnës, ekranit, baletit dhe operës. Ëshë e domosdoshme që shtypi të jetë më i ndjeshëm ndaj krijimtarisë dhe veprimtarisë së tyre, pasi ata janë vlera kombëtare të mëdha, janë e ardhmja e letërsisë dhe arteve të Republikës. Shtypi, duke i mbajtur pranë dhe duke u kujdesur për veprën e tyre, ndihmon në ruajtjen e pastërtisë së krijimtarisë në luftë kundër çdo ndikimi të huaj borgjez e revisionist. Ndaj këtyre ndikimeve ne duhet të mos e flemë mendjen. Rreziku i tyre është i përhershëm. Letërsia dhe artet në botën perëndimore dhe lindore janë të mbushura me lloj-lloj produktesh, që helmojnë ndërgjegjen e njerëzve. Droga si material fizik dhe si send dhe droga si ide dhe art sot janë dy armët më shkatërruese të trurit dhe të ndërgjegjes së njeriut. Drogën-send ne nuk e lëmë

të kapërcejë kufirin, pasi e kapim konkretisht, por me drogën art e kemi më vështirë, pasi ajo bredh nëpër eter përmes valëve të radios dhe figurave dhe zërit të televizorit. Për këtë drogë art ne kemi armën e botëkuptimit tonë marksist, armën e formimit tonë ideologjik dhe politik. Sa më të fortë të jemi ideologjisht aq më në shenjë qëllojnë me këtë armë.

1985

LETËRSIA DHE REALITETI

Në arritjet e shquara të shoqërisë socialiste zënë vendin e tyre të merituar edhe arritjet e letërsisë, e kësaj pjese të pandarë dhe të rëndësishme të kulturës sonë amtare. Këto arritje përfshijnë gjithë gjinitë dhe llojet letrare, që nga më të voglat gjer në më të mëdhatë, prandaj ne pohojmë se zhvillimi është harmonik dhe i gjithanshëm. Letërsia tani vjen më e plotë, pa mangësi gjinish e llojesh, që është karakteristikë e një krijimtarie të zhvilluar e të përparuar. Diskur e kishim poezinë, po na mungonte skenari letrar i filmit, e kishim tregimin, po na mungonte romani, e kishim këngën po na mungonte opera... Ndodhte përafërsisht si me industrinë e përpunimit të minierave me ngjyrë si dhe me hidro-energjetikën: e kishim shkrirjen e bakrit, po na mungonte teli, e kishim hekur-nikelin, po na mungonte çeliku, e kishim energjinë e fjetur të lumenjve, po na mungonte energjia elektrike. Tani cikli i përpunimit të tyre ka mbaruar dhe kërkon rendiment e cilësi.

Ecja përpara e harmonizuar e letërsisë dhe arteve tona ka bërë që gjithë gjinitë dhe llojet e krijimtarisë të kenë lidhje reciproke dhe të ndihmojnë njëra-tjetren. Kështu, zhvillimi i poezisë dhe krijimi i disa kulmeve të vërteta poetike, përparrimi i tregimit dhe thellimi i tij në analizën e shoqërisë, ndikuan në forcimin dhe konsolidimin e romanit si gjini e madhe letrare. Por romani krijoi një bazë të shëndoshë për

lindjen dhe zhvillimin e filmit artistik, e artit më të ri dhe me perspektivë të madhe në vendin tonë. Letërsia dhe kinematografia u dhanë nxitje arteve figurative dhe muzikës për të fituar dinamizëm e për t'u rifreskuar. Nga ana tjetër edhe artet figurative nuk qëndruan të mbyllura në vërvete, por vepruan mbi letërsinë dhe kinematografinë. Ky zhvillim harmonik vjen nga vetë natyra e socializmit. Çdo fushë e jetës së socializmit zhvillohet harmonikisht, ashtu si çdo krahinë, rrëth, fshat e qytet, ashtu si gjithë ekonomia dhe kultura jonë.

Në këtë zhvillim të gjithanshëm dhe harmonik të letërsisë kanë dalë vepra të shquara, që pasqyrojnë realitetin historik dhe aktual të vendit dhe që janë bërë pronë e vërtetë e njerëzve tanë. Veprat letrare të çerekut të fundit të shekullit të njëzetë janë më problematike, kanë më tepër mendime filozofike, analizë të shoqërisë, gjykime dhe arsyetime dialektike, duke iu larguar dalngadalë deskriptivizmit të thjeshtë dhe shprehjeve klishe të agjencionit të rëndomtë. Për këtë kanë punuar bashkërisht të gjithë brezat, që nga më të vjetrit gjer në më të rinjtë dhe nuk ndodh që të heshtë një brez më i vjetër dhe të krijojë vetëm brezi më i ri. Dikur, për vetë kushtet shoqërore, shkrimitari në moshën 35-vjeçare pushonte së shkruari ose përsëriste veten, shkruante gjëra pa vlerë dhe deziluzionohej. Sot mosha mesatare e jetës krijuese është rritur dhe mund të themi se është dyfishuar. Merrni si shembull Shevqet Musaranë, Adburrahim Buzën dhe Odhise Paskalin. Ata po venë 70 e 80-vjeçarë po nuk e ndërpresin krijimtarinë, sepse u jep jetë socializmi, duke ua mbajtur artin të freskët. Këtë dukuri nuk e gjenim në të kaluarën, kur njeriu plakej para kohe dhe krijimtaria mbetej përgjysmë si një shtëpi e pambaruar. Pothuajse gjithë shkrimitarët tanë të së kaluarës kanë vdekur të rinj ose e kanë ndërprerë krijimtarinë në moshë të re, duke filluar që nga Naim Frashëri.

Zhvillimi harmonik i llojeve dhe gjinive nuk është i shkëputur nga zhvillimi harmonik i tre funksioneve të artit: funksionit njohës, edukues dhe térheqës. Edhe në këtë sferë ne kemi një zhvillim të harmonizuar. Gjithmonë arti ynë i ka pasur parasysh funksionet e tij dhe nuk ka lejuar të prishet ekuilibri i tyre. Prishja e ekuilibrit do të sillte dëme të pallogaritshme. Në qoftë se i jep rëndësi, p.sh., vetëm anës njohëse, e kthen letërsinë në histori. Po edhe sikur t'i japësh rëndësi vetëm funksionit edukues, do ta kthesh një roman në tekst didaktik, në një tekst pedagogjje. Edhe më e rrezik-

shme do të ishte të anoje vetëm në funksionin têrheqës, zbatitës. Ne për hir të anës zbavitëse e têrheqëse, nuk mund të harrojmë funksionin njohës dhe edukues. Arti i vërtetë duhet të formojë në shoqëri mendimin dhe botëkuptimin duke vepruar mbi ndërgjegjen e njerëzve.

Njeriu ynë ka etje për art të lartë, për art që ta bëjë të mendojë, ta bëjë të jetojë e të punojë më mirë. Ai që ndërton Fierzën e Komanin, nuk mund të kënaqet me një roman të thatë si një procesverbal, me një vjershë si një parullë, me një këngë si një gërvishtje e menteshës së palyer të derës, me një skeç si shakatë pa kripë të bakejve. Në shkrime të tilla ai nuk gjen veten, nuk gjen shokët e tij. Socializmi ka formuar një njeri që është shumë më i pasur, shumë më i ndërlikuar, shumë më i fortë dhe shumë më delikat se sa hija e tij që duket në faqet e ndonjë libri. Prandaj është e domosdoshme që ta pasqyrojmö këtë njeri në mënyrë më të gjithanësme e më të plotë dhe të mos e skematizojmë jetën e tij. Vërtet ai nuk është një qaraman që rri duke u ankuar ditë e natë, por vallë nuk mund t'i dhëmbë ndonjëherë koka, nuk mund t'i sëmuret gruaja, nuk mund t'i vdesë shoku? Ne duhet të tregojmë edhe atë se si ky njeri e mposht hidhërimin. Dhe këtu, në mposhtjen e hidhërimit qëndron edhe një forcë e tij. Kurse ka romane e tregime ku njeriu paraqitet vetëm duke punuar e duke qeshur, vetëm duke i shpënë së shoqes lule dhe vjehrrës pasta e kafe, nëpër një rrugë me diell pranveror. Neve na pëlqen filmi i Xh. Kekos «Kur po xhirohej një film», pasi në të pasqyrohet jeta e njeriut të sotëm, pasqyrohen shqetësimet dhe mendimet e tij dhe nuk trajtohet realiteti sipas skemave të zakonshme dhe të njohura me kohë. Njeriu ka punë të mëdha, ka preokupime dhe halle, se jeton në një botë me shumë trazira, jeton në bllokadën e egër imperialisto-rezisioniste. Jeta e tij nuk kalon përmes kopshëve të lulëzuara, ku këput vetëm lule dhe u mban erë. Shoqëria ka shumë probleme që shtrohen për zgjidhje, probleme ekonomike e morale, shoqërore e ideologjike. Është e domosdoshme që letërsia të mos kalojë anash këtyre problemeve. Pa probleme nuk ka letërsi të fuqishme. E dimë të gjithë se letërsi do të thotë të ngresh probleme të shoqërisë dhe ta ndihmosh zgjidhjen e tyre në jetë, përndryshe arti bëhet uniform, skematik, monoton dhe i palexueshëm. Ka romane të tjera që i paraqitin partizanët në luftë si në valle, ku ballistët e gjermanët sa i shohin, ikin të tmerruar dhe të lebetitur. Për këtë shoku Enver në librin «Kur lindi

Partia» tërheq edhe një herë vëmendjen: «Armiku okupator dhe tradhtarët, — shkruan Ai, — nuk ishin aq frikacakë dhe aq budallenj, siç po i pëershkruanjë disa që mendojnë se këshiu ngrenë zotësinë e trimërinë e Partisë dhe të tyren. Partia dhe populli ynë natyrisht ishin më të zotë dhe më trima se armiqtë, se lufta jonë ishte e drejtë, bëhej për një kauzë të madhe, kurse ajo e armiqve jo, por nuk u duhet besuar disave që shkruajnë ose tregojnë se të gjithë ballistët ishin si lepuj.»

Ka ardhur koha që krijimtarinë artistike të mos e bëjmë shpejt e shpejt dhe me kërkesa të ulëta artistike, por ta marrim me seriozitetin më të madh dhe me pretendimin më rigoroz ndaj vetes. Elefanti e mban në bark fëmijën njëzet-edy muaj dhe lind elefant, kurse lepuri e mban më pak se dy muaj dhe lind lepur. Prandaj, është më mirë që një shkrimtar ta mbajë romanin njëzetedy muaj dhe të bëjë një roman elefant, se sa ta mbajë dy muaj e të bëjë një roman lepur. E kam fjalën, që përderisa për gjithë fushat e jetës së shoqërisë sonë kërkohet nivel i lartë cilësor, edhe letërsia, si një veprimtari shoqërore, nuk mund të bëjë përjashtim nga këto kërkesa. Për këtë është e domosdoshme ngritja e vazhdueshme e nivelit ideologjik e kulturor të forcave krijuese dhe të kuadrit drejtues të letërsisë, të redaktorëve e botuesve, në mënyrë që të mos lejojnë vepra të dobëta e të zbehta, pasi ato prishin shijet estetike të njerëzve. Shkrimtarit i falet të qëndrojë i vettmar veç në tavolinën e tij të punës. Jashtë kësaj tavoline shoqëria nuk ia fal vëtminë, se duhet të jetë mes njerëzvë të punës, mes mendimit të gjallë të shoqërisë.

Ngritja ideologjike e kulturore, bashkë me njojhen më të thellë të jetës, do të bëjnë që të pasqyrohet më gjérë realiteti ynë socialist, epoka e madhe dhe heroike e Partisë. Duhet ta tregojmë vetë jetën e bashkëkohësit, se atëherë do t'i ndihmojmë më mirë brezat që vijnë. E them këtë, pasi ne e njohim më shumë se kushdo bashkëkohësin tonë, njohim punën, përpjekjet dhe psikologjinë e tij dhe nuk duhet të presim që për ne të shkruajnë brezat që vijnë. Ata do të shkruajnë se në çdonjërin nga ne jeton një histori e tërë. Por ne vetë duhet të tregojmë historinë tonë socialiste.

Ne e pritnim një libër të tillë enciklopedik për lindjen e Partisë, për luftën e komunistëve, për formimin e saj, siç është vepra e shokut Enver «Kur lindi Partia». Do të ishte një mungesë e madhe për brezat që vijnë, sikur ne të mos shkruajmë jetën e socializmit, enciklopedinë e jetës socialiste.

Për këtë duhet ta vrasim mendjen më shumë dhe të punojmë si militantë. Ne të gjithë e marrim punën e Partisë si veprimtari frymëzuese, ideologjike dhe shkencore, por edhe emocionuese dhe poetike. Bëjmë ndonjëherë edhe gabime, por gabimet tona nuk janë si të shkrimtarëve borgjezë që har-tojnë listën e personazheve të botës së vdekur. Lenini, duke kritikuar të metat që viheshin re në shoqërinë e re ruse të porsalindur, thoshte: «Në qoftë se kundërshtarët tanë na vënë në dukje dhe thonë se ja vetë Lenini e pranon që bolshevikët kanë bërë një numër shumë të madh marrëzirash, unë dëshiroj t'u përgjigjem: po, por a e dini ju se marrëzitë tona janë, sidoqoftë, krejt të ndryshme nga tuajat?»

Në letërsinë borgjeze e revisioniste mbretëron kulti i egos, humbja e interesit për të kaluarën dhe mungesa e kuptimit të së ardhmes. Skematizmi borgjez në letërsi dhe arte ka arritur kulmin më të madh që ka njojur gjer më sot historia e krijimtarisë. Lakuriqësia e trupit të femrës është kthyer në kult, në ikonë, në metaforë. Atë e gjen klishe në çdo roman. Gratë janë bërë si feniksë: mijëra herë vritten dhe mijëra herë ngjallen nëpër fletët e romaneve borgjeze dhe në ekranet televizive dhe kinematografike. Erotizmi, epshi, kriminaliteti, banditizmi dhe përshkrimi i kriminelëve kanë hyrë në gjithë mekanizmin e letërsisë borgjeze dhe kanë formuar një skemë monotone dhe uniformë. Po të lexosh tre-katër romane nga kjo letërsi, e merr vesh mekanizmin e njëqind romaneve, pa i shfletuar fare. Ky është skematizmi i plotë dhe i vërtetë, jo ai që mundohen të na atribuojnë estetët borgjezë. Ne e kritikojmë skematizmin tonë, se ai është mbeturinë e artit borgjez dhe si i tillë është i dëmshëm. Por skematizmin nuk e ka krijuar socializmi, ai e ka origjinën nga borgjezia, e cila me këtë skematizëm i mëson njerëzit që në fëmijërinë e tyre. Vetë kritikët borgjezë shkruajnë se që në moshën tre ose katërvjeçare fëmijët kanë dëshirë t'u këndosh këngë nga emisionet televizive, ku reklamohen sapuni dhe lotaria. E ne nuk vërshëllejmë në rrugë një këngë nga qejfi se kemi blerë sapun, ose nga gëzimi që na ka shkuar mbarë pazari ose nga entuziazmi që kemi fituar në bixhoz ndonjë shumë të madhe. Ne e këndonj më këngën se kemi një gëzim njerëzor të një natyre tjetër, të një natyre thellësish humane.

Duke folur për domosdoshmërinë e paraqitjes më të gjerë të jetës së shoqërisë socialiste, ne nuk mund të lëmë mënjanë pasqyrimin e së kaluarës sonë patriotike e revolucionare, e

përpjekjeve dhe luftërave pér liri të gjyshërve dhe stërgjyshërve tanë. Por si në pasqyrimin e jetës së shoqërisë socialiste, ashtu edhe të së kaluarës është e domosdoshme të kuptohen dhe të përvetësohen më thellë parimet e estetikës sonë pér raportin ndërmjet përbajtjes socialiste dhe karakterit kombëtar të letërsisë. Edhe përbajtja socialiste, edhe karakteri kombëtar janë në lidhje dialektike njëra me tjetrën, përderisa socializmi ndërtohet në një vend të caktuar, në një popull me një konstitucion shpirtëror të ndryshëm nga të tjerët, në një popull me veçori origjinale ekonomike, kulturore, zakonore e morale. Vetë ekzistенca e karakterit kombëtar dhe e përbajtjes socialiste të letërsisë presupozojnë asimilimin dhe vlerësimin e gjithë traditave përparimtare të së kaluarës. Por ndonjëherë në studimet tona e prishin raportin e vlerësimit të traditës së kaluar dhe traditës së sotme socialiste. Kemi maninë të shkruajmë studime e monografi më shumë pér të kaluarën se sa pér të sotmen. Duhet të ndodhë e kundërtë, pasi socializmi ka krijuar një traditë të madhe e të fuqishme që meriton një vend më të nderuar në studime. Edhe me raportin folklorik dhe muzikë e kultivuar përafërsisht ndodh si me studimet. Ne e respektojmë folklorin, se respektojmë traditat tonë të mrekullueshme. Por duhet të tregojmë vëmendje më të madhe pér muzikën e kultivuar, duke e asimiluar më thellë folklorin dhe duke mos e përsëritur mekanikisht në këngë dhe simfoni.

Arti ynë është një art vital, siç është gjithë kultura jonë. Këtë vitalitet e ka treguar gjithmonë. Ai i lidh ngushtë detyrat e tij me gjithë ngjarjet e mëdha të brendshme dhe të jashtme. Edhe këtu qëndron vitaliteti i tij. Shovinistët serbë me ngjarjet në Kosovë u turrën jo vetëm kundër politikës, ideologjisë dhe kulturës sonë, por edhe kundër letërsisë dhe arteve. Ata, duke treguar egërsinë e tyre ndaj vëllezërve kosovarë, u vërsulën edhe mbi vlerat shpirtërore kombëtare të popullit tonë, mbi historinë, mbi letërsinë dhe artet, siç mund të veprojnë vetëm barbarët e shekujve të zyntë, duke na thënë se qenekeshim kthyer pas në «romantizëm historik» e në «ngushtësi nationale». Me këto veprime dhune, terrori, djallëzie dhe injorance, as vëllezërit e Kosovës nuk përkulen, as ne këtu në Republikë nuk hutohemë dhe nuk biem në pesimizëm. Ngjarjet në Kosovë treguan edhe diçka tjetër. Treguan atë që sa krenarë janë shkrimitarët dhe artistët tamë, sa patriotë, sa fisnikë e sa të dhimbshëm pér kolegët e tyre në Kosovë. Treguan atë që sa të drejtë ka pasur Partia, kur

ka theksuar se demokracia dhe humanizmi pannjerëzor jugosllav janë fals, se tolerancat dhe «liritë» për njerëzit e letërsisë dhe arteve në shoqërinë e Titos janë fjalë tullumbaka me ngjyra të bukura, por sa ngrihen pak, fillojnë e pëlcasin.

Orientimet e Partisë sonë dhe mësimet e shokut Enver i kanë hapur horizont të gjërë zhvillimit të gjithanshëm të kulturës, letërsisë dhe artit tonë. Ato kanë bërë që letërsia dhe artet tonë të përhapen edhe jashtë kufijve të Atdheut dhe të luajnë një rol të rëndësishëm në popullarizimin e arritjeve të shoqërisë sonë socialistë. Me këtë ne tregojmë se vërtet jemi të rrethuar, por nuk jemi të izoluar. Përkundrazi, i izoluar është reaksiuni.

Për kujdesin dhe respektin e thellë që ka Partia ndaj letërsisë dhe arteve dëshmojnë gjithë dokumentet e saj, dëshmon edhe Kongresi i 8-të i saj. Raporti që mbajti shoku Enver është një riafirmim i drejtësisë së vijës së përgjithshme të Partisë sonë dhe një zhvillim i mëtejshëm i mendimit praktik e teorik të saj në gjithë fushat e jetës, në ekonomi, ideologji e politikë. Në raportin e shokut Enver ne gjejmë dinamikën e lëvizjeve përpëra të socializmit, gjejmë mendimin vital të Partisë, të bazuar në mësimet e marksizëm-leninizmit dhe në përvjetorin shumëvjeçare, në ligjet shkencore të zhvillimit të shoqërisë. Nga ky raport, nga punimet dhe nga vendimet që do të merren në Kongres, ne shkrimtarët e artistët do të nxjerrim detyra të rëndësishme për t'i çuar më përpëra letërsinë dhe artet, për të ngritur edhe më lart nivelin e tyre ideor e artistik dhe për të rritur forcën vepruese, në mendjet dhe zemrat e njerëzve, në edukimin e tyre komunist.

1981

EPOKA SOCIALISTE NË QENDËR TË LETËRSISË DHE ARTIT

Në tablonë e epokës socialiste pesëvjeçarët lënë gjurmë të thella, lënë monumente të pavdekshme të përparimit njerezor, që e mbajnë lart moralin e bashkëkohësve dhe e rritin krenarinë e pasardhësve. Edhe se shumë gjëra nuk na bëjnë përshtypje, se jemi mësuar e ambientuar me këtë tablo, kur hyjmë me mendimet tona në brendësinë e saj, gjithçka dimë ta vlerësojmë me ndërgjegje, se jemi vetë autorë të kësaj vepre të qytetërimit të shekullit të njëzetë, që quhet socializëm. Atëherë dimë të nxjerrim domethënie të mëdha dhe nga fraza të zakonshme relacionesh, si: «Pesëvjeçarin e gjashtë vazhdoi pa ndërprerë procesi i thellimit të industrializimit socialist të vendit; u rritën degë të reja si ajo e metalurgjisë së zezë, e përpunimit të thellë të naftës, e ferrokromit; u zhvillua në një shkallë më të lartë industria energjetike; u hodhën hapa të rëndësishme në intensifikimin e prodhimit bujqësor etj. etj.» Këto fragmente mendimesh telegrafike i konfrontojmë me realitetin e gjallë dhe gjemë mishërimin e tyre në vepra konkrete. Industrializimi socialist dha kombinatin metalurgjik «Çeliku i Partisë» dhe hidrocentralin «Drita e Partisë.» Intensifikimi i bujqësisë dha bukën dhe qumështin. Të gjitha së bashku ngriten mirëqenien e njerëzve, i pasuruan më tepër materialisht e shpirtërisht, u dhanë më shumë shkencë, kulturë dhe art, i bënë më të lumtur dhe më të lirë.

Arkeologët kanë të drejtë të lavdërohen me zbulimet e lashta ilire në Koman, që në histori kanë marrë emrin e njohur «Kultura e Komanit»; kanë të drejtë të admirojnë Kalanë e Elbasanit, që është një dëshmi e hershme historike; kanë të drejtë të shkruajnë për rrugën Egnatia, që lidhë vendin tonë me fqinjët; kanë të drejtë të entuziazmohen me monumentet e Apolonisë, që tregojnë për një qytetërim të zhvilluar të shoqërisë antike. Por kemi edhe më shumë të drejtë të krenohemi me kulturën e Komanit socialist, që mban mbi supe makinerinë dhe teknologjinë më moderne; me korpuset industriale që quhen Azotik afër Apolonisë antike; me kështjellën e çeliktë që e thérresin Metalurgjik; me hekurudhën e rinisë pranë Egnatias; me monumentin e madh të bukës, qumëshitit e sheqerit me emrin Maliq. Këto janë kultura të qytetërimit të madh e të ri socialist, që na bëjnë të mburremi mijëra e mijëra herë më shumë sesa me një kokë të gurtë që nxjerr buldozeri në Myzeqe, me një shpatë të hekurt që zbulon ekskavatori në Bradashesh, me një poçe qeramike që shkul në brazdat e Maliqit traktori i Kombinatit të Autokraktorëve të Tiranës, pa përqmuar aspak vlerat e pasurive arkeologjike.

Me të drejtë dhe me objektivitet shkencor, Kongresi i 8-të i Partisë porositi njerëzit e letërsisë dhe të arteve që me veprat e tyre të kompletojnë tablonë e madhe të epokës socialiste në Shqipëri dhe ta vënë më shumë se gjë tanë në fokusin e krijimtarisë. Kjo porosi na bën më tepër të mendohemi dhe ta shohim me gjakftohtësi shkencore procesin letrar e artistik, të korrigojmë disa nga të metat dhe të shohim në një perspektivë më të largët. E thashë, kur krahasova kulturat e lashta ilire e mesjetare me monumentet madhëشتore të socializmit, se aspak nuk dua të nënyleftësoj krenarinë që kemi për Apoloni më apo kulturën e Komanit. Por nuk është me vend dhe as e kulturuar që brenda dy vjetëve vetëm për monumentet arkeologjike të Butrintit e Apolonisë të shkruhen katër vepra, të dalë romani «Korbat mbi mermer», drama «Tragjedia e Deas», filmi artistik «Dëshmorët e monumenteve» e të jepet edhe një skenar për film televiziv; kurse ende bëjmë shumë pak për monumentet e kulturës më të madhe të shekullit, Fierzës, Komanit, Metalurgjikut, Azotikut, Ballshit, Plasës dhe për njeriun që i ka ngritur këto

monumente. Dukuri të tillë çekuilibruese vijnë edhe ngaqë imitohet ndonjë vepër e suksesshme e ndonjë shkrimtari me këtë lloj teme të së kaluarës së lashtë. Duke e kujtuar këtë temë si bartëse të filozofisë dhe kulturës së lartë, disa letrarë nuk e quajnë veten të afirmuar po nuk bënë një vjershë për Butrintin, për një urë magjistrale, ose për De Radën dhe «Miloshon» e tij. Një veprim i tillë në art mund të quhet provincializëm artistik, pasi provincialin artistik e çudit një bust i vogël dhe një urë mesjetare më shumë se një hidrocentral dhe një kombinat, sepse imiton njerëzit e pseudokulturuar, që pshërëtijnë në dhomën e tyre me ca qilimka e raftka: «Ua, ç'kulturë fshihet në këtë statuetkë!» Në të vërtetë njerëzit me kulturë solide e kanë të qartë se vlera e artit rritet kur ai kthen ftyrën më shumë nga tabloja e epokës socialiste, se ajo është më e pasura, më e gjera dhe më problematikja. Sado të përsosura të jenë ato vepra që kanë në qendër të njëjtin objekt të së kaluarës, siç është Butrinti që përmendëm këtu, nuk i shpëtojnë dot monotonisë. Gjeli i detit është i mirë, por, po të hash gjithmonë gjeldeti, të vel dhe të mërzitet, madje edhe natën e dytë të Vtitit të Ri i humb pak rëndësia e shijimit.

Tabloja e epokës socialiste është e madhe, me një dendësi ngjarjesh të fuqishme, nga çlironen energji të papara ndonjëherë në historinë tonë. Këto energji e kanë burimin në revolucionin tonë popullor, dhe burimi i pavdekshëm gjithmonë i shtyn për të shpërthyer me shkëlqim të ri nga një etapë e ndërtimit socialist në tjetrën, i shtyn siç shtyjnë rrymat e nënujshme hapësirën e oqeanit. Prandaj ne themi se, vërtet Lufta Nacionalçlirimtare zgjati vetëm katër vjet, por valët e saj të fuqishme çlironjë energji të reja edhe tanë në shoqërinë e sotme dhe do të çlironjë edhe në të ardhmen. Shkrimtarët e artistët, duke shkruar për të sotmen, zbulojnë valët e djeshme të viteve të revolucionit, èndrrat e njerëzve që janë bërë jetë. Duke shkruar për kohën e revolucionit e çmojnë më shumë të sotmen dhe shtojnë besimin në të ardhmen.

Gjithmonë në kyçet e ngjarjeve të mëdha çlironen energji të mëdha. Artisti i vërtetë synon që këto kyçe t'i pasqyrojë në veprën e vet se është i ndërgjegjshëm për vlerën e madhe që do të ketë kjo vepër. Ngjarjet e kthesave të mëdha his-

torike bartin heroizëm të madh e probleme të mprehta. E themi këtë, pasi ky heroizëm është pjellë e realitetit socialist, ai përcakton me karakteristika të vecanta edhe individin e ri, që di se në emër të c'idealeve ndeshet dhe kryen heroizma. Ky individ nuk është i shkëputur nga masa; vullneti i tij përpushton me ecjen e historisë. Ky hero është në qendër të letërsisë së realizmit socialist. Por kjo nuk do të thotë që letërsia jone i shmanget pasqyrimit të anëve negative, të kontradiktave dhe të anëve tragjike të jetës. Ajo i pasqyron edhe këto fenomene, me të cilat ndeshet heroi. Por tragjizmi në letërsinë tonë nuk poetizohet dhe nuk ngrihet në absolut si në ekzistencializëm. Shkrimitari për hir të heroikës zbulon rrënjet shoqërore të konflikteve dhe të katastrofave të rënda. Në letërsinë tonë njeriu është aktiv i historisë.

Në hopet e reja cilësore që kapërcen shoqëria duket edhe vitaliteti i letërsisë, arteve dhe kulturës. Pasqyrimi i këtyre hopeve e ngre edhe cilësinë e artit, e bën atë më të gjallë dhe më novator. Të marrim një fakt. Në pesëvjeçarin e shtatë do të rritet më tej shkalla e intensifikimit të bujqësisë dhe parashikohet intensifikimi më i lartë i prodhimit në zonën fushore të rretheve Fier, Lushnjë, Berat, Elbasan, Durrës e Tiranë. Ky do të jetë një hop i ri cilësor i bujqësisë sonë. Pasqyrimi në letërsi dhe arte i këtij hopi do të ngrejë më lart edhe cilësinë e krijimtarisë. Do të dalin vepra me probleme të mprehta të kohës dhe me heronj të rinj, që kanë interesa të larta dhe botë shpirtërore të ndërlikuar. Ndërrojnë koncepte të tëra për fshatarin, tokën dhe bukën. Tani nuk merret me tokën dhe bukën vetëm fshatari, merren agronomi e inxhinieri, shkencëtarë e mjeku, mësuesi e shkrimitari, politikani e ideologu, historiani e ekonomisti, diplomi i tregtarë. Në ditët tona nuk ka kundërvënie fshatar-qytetar as në filozofi as në praktikë. Në ndonjë libër ose në ndonjë shkrim edhe mund të ketë pasur ndonjë koncept të till por kjo ka ardhur nga mosditja e vështrimit të gjërave esenciale të epokës dhe nga dëshira për të parë vogëlsirat e parëndësishme. Sipas legjendës së «Biblës», Noja, që ndërtoi varkën dhe shpëtoi farën njerëzore nga përmbytja katastrofike, kishte tre djem: Simin, Hamin dhe Afetin. Djali i dytë, Hami, shikonte te Noja vetëm vesin e të pirit dhe nuk dallonte gjennialitetin e të atit të tij, ndërtimin e varkës që shpëtoi botën! Kjo ç'na mëson? Na mëson që të shohim thelbësoren në epo-

kën tonë dhe të mos kapemi pas vogëlsirave, se pastaj imitojmë Hamin.

Në epokën tonë ndodh një transformim i tërë koncepcione, transformim që gjallëron, freskon dhe pasuron artin me mendime të mëdha dhe që ngre cilësinë e kulturës në përgjithësi. Me këtë vështrim dialektik duhet parë kërkesa e Kongresit të 8-të të Partisë për rritjen e cilësisë së kulturës, jo me sositjen provinciale të ndonjë këndi agroteknik të vjetruar në qoshe të ndonjë vatre kulture. Pra, t'i shëtrojmë vetes pyetjen: Ç'duhet të ndërmarrim për të rritur cilësinë e kulturës dhe forcën vepruese të saj në kushtet e intensifikimit të mëtejshëm të bujqësisë. Dikush ka thënë: të marrësh 20 kv grurë për hektarë, nuk kërkohet ndonjë gjë e madhe në mendime, të marrësh 40 kv grurë për hektarë, nevojitet kulturë; të marrësh 50 kv grurë për hektarë, duhet kulturë dhe talent. Fusha e kulturës dhe artit nuk duhet të marrë 20 kv cilësi art për hektarë, por 50 kv cilësi art për hektarë, se përndryshe mbetet e paintensifikuar! Qeveria bën programin e saj konkret e të llogaritur për masat që duhen marrë që nga përmirësimi i strukturës së tokës e gjer tek rrjeti ujitës e seleksionimi i farërave. Po kultura dhe arsimi? Shkolla e lartë që nxjerr agronomët, a konfrontohet me kooperativat dhe ndëmarrjet bujqësore, duke bërë gjurmime për nivelin e dijeve të tyre në kushtet e intensifikimit? A pyet: si ju duken këta agronomë që nxjerr unë, ku i kanë zotësitë dhe zbrazësitë? A i shkojnë, fjala vjen, Plasës dhe a e pyesin: ti që ke arritur mbi 50 kv grurë për hektarë, për ç'literaturë origjinale dhe të huaj ke nevojë, për ç'dije të tjera shkencore, divulgative, historike e letrare ke dëshirë? Ne mendojmë që duhen këto e këto! Ç'thuai ti? Pastaj gjallërimi dhe cilësia e kulturës arrihet edhe kur merr në qendër a në Tiranë ata kuadro që nuk të luten dhe nuk të mbijnë në derë si qaramanë, por ata që janë të zotët, që nuk e shuanjë zjarrin e terrenit, përkundrazi e ndezin më shumë atje ku venë. Nejse, diskutimi im është prej një letrari, por kryesorja është që ngritjen e cilësisë së kulturës duhet ta kuptojmë shumë më gjerë dhe të mendohemi më thellë për materialet e Kongresit të 8-të të Partisë. Edhe letërsia dhe artet duhet të zgjerojnë më shumë gamën e tematikës dhe problematikës për ta parë realitetin në gjithë kompleksin e tij. Dhe ne kemi shembuj të shquar të arritjeve të larta në letërsi, pikturë, skulpturë,

muzikë e kulturë në përgjithësi. A nuk dëshmojnë për këtë botimet, filmat, ekspozitat e arteve figurative, koncertet e shfaqjet e tjera? A nuk dëshmojnë për konkretizimin e ideve të Partisë veprat e kohëve të fundit të tilla «Drashovica» dhe shtatorja «Enver Hoxha» të skulptorit M. Dhrami, monumenti «Hysni Kapo» i skulptorit K. Rama etj.; për një nivel të lartë kulture tregon edhe Muzeumi Historik Kombëtar i Tiranës Përvoja e pasur e letërsisë dhe arteve të realizmit socialist, e grumbulluar vite me radhë, është një bazë e shëndoshë për arritje të shquara dhe për hope të tjera cilësore. Duke u nisur nga kjo bazë, shoku Enver në raportin e Kongresit të 8-të theksoi: «Përbajtjes së shëndoshë, tematikës revolucionare duhet t'u përgjigjet një formë dhe një nivel i lartë realizimi artistik.»

Cdo shkrimitar e artist e ka të qartë se ngritja e nivelit të arteve është e lidhur ngushtë edhe me ruajtjen e pastërtisë së tyre nga ndikimet e huaja moderniste dhe nga presioni i ideologjive idealiste borgjeze e revisioniste. Në botën e artit borgjez sot mbretëron një konfuzion që nuk e kanë parë ndonjëherë shekujt. Shkrimitari i kësaj bote ndodhet në një situatë të ndërlikuar e pa rrugëdalje. Standarte ekonomike, politike dhe ideologjike i qëndrojnë përherë mbi kokë dhe bëjnë që të standartizohet edhe krijimtaria e tij. Këto standarde nuk e lënë shkrimitarin të ngrihet mbi artin tregtar dhe konformist, por e shtyjnë vazhdimisht drejt uljes së cilësisë artistike. Jo vetëm kaq. Bota e standardeve dhe e inflacionit, e shthurjeve dhe krizave, ka ulur edhe vetë vlerën e shkrimitarit si njeri dhe si artist. Kur e pyetën V. S. Pritçetin, një figurë me influencë në qarqet kulturore britanike, se a mundet që një shkrimitar anglez të jetojë me ato që fiton nga letërsia, ai u përgjigj: «*Natyrisht që jo!* Në Angli vetëm gjashtë njerëz mund të ushqehen me ato që *nxjerrin nga shkrimet*.» Mendimi i borgjezisë për shkrimitarin është po ai i gjeneralëve të saj të dikurshëm. Le të kujtojmë frazën e gjeneral Buasesë, kur pas një revoltës në radhët e ushtarakeve iu drejtua ushtarëve me këto fjalë: «*Ushtarët janë ushtarë dhe nuk janë ca lapangjözë si artistët.*» Ky mendim për njerëzit e artit mbretëron edhe në borgjezi me gjithë frazat demagogjike të lirisë së plotë të shkrimitarëve dhe artistëve, të lirisë së pakufizuar të krijimtarisë, të nxitjes së talenteve etj. etj. Por ai tek ne nuk ka ekzistuar dhe nuk do të ekzistojë kurrë.

Pozita socialiste e artistike e shkrimtarëve dhe e artistëve tanë në pushtetin e popullit është e shëndoshë dhe e fortë. Vepër vlerësohet lart nga shoqëria, personaliteti rritet dhe figura e tyre nderohet dhe respektohet nga të gjithë. Për këtë janë të ndërgjegjshëm gjithë shkrimtarët dhe artistët tanë, ndaj nën veprat e tyre ata ngrënë lart revolucionin dhe socializmin.

1982

KULTURA E TË SHKRUARIT

(*Shkrimet në gazeta dhe revista*)

Gazetaria është një fushë e veprimtarisë shoqërore që u takon të gjithëve, u takon gazetarëve që punojnë nëpër redaksitë, u takon korrespondentëve profesionistë dhe vullnetarë dhe mijëra të tjerëve, duke përfshirë edhe njerëzit e prodhimit, të teknikës, shkencës, arsimit, kulturës letërsisë, artit dhe mbrojtjes. Por mbi të gjitha u takon masave të gjera punonjëse, të cilave u drejtohen gazetat, revistat, Agjencia Telegrafike Shqiptare, Radioja dhe Televizioni; masave të gjera punonjëse që shkruajnë edhe vetë, duke marrë pjesë aktive në shtyp dhe duke e mbajtur të gjallë atë. Ka njerëz që mund të mos lexojnë romane e poema, por nuk ka njerëz që të mos lexojnë gazeten, të mos dëgjojnë radion dhe të mos shohin televizorin. Me këtë shtypi ka hyrë në mënyrën e jetesës sonë dhe është bërë pjesë e saj e pandarë. Sikur papritur të ndodhte një gjë dhe të na mungonte shtypi, ne nuk do të mundnim të jetonim si njerëz, se do të na çrrullohej gjithë jeta dhe gjithë mënyra jonë e jetesës. Kështu, ky interes i madh për shtypin i ka dhënë nxitje zhvillimit të tij dhe në të njëjtën kohë ka rritur kërkuesat për nivel të lartë në përbajtjen dhe në formën publicistike. Është një kontroll kolosal i përditshëm dhe një presion kolosal popullor prej mijëra e mijëra atmosferësh që s'ka aparaturë të matë, që po ta mendosh mirë ti që punon në shtyp, nuk të zë gjumi natën.

I gjithë shtypi ynë, bashkë me Agjencinë Telegrafike dhe Radiotelevizionin, ka arritje të padiskutueshme, ka mendim të ri dhe informacion të freskët. Disa gazeta e revista, si «Hosteni», «Sporti», «Skena dhe ekrani»; disa reportazhe të Televizionit që jep Alfons Gurashi e të tjera, tregojnë se gazetaria jonë ka mundësira për ta ngritur më lart nivelin e saj cilësor. Artikuj e informacione të mira gjen herë pas here në gjithë gazetat dhe revistat. Por vetë zhvillimi ynë na ka rritur ndjenjën e kërkesës së lartë dhe duam më shumë prej shtypit, duam të jepet më i plotë portreti i pullit në kohën e sotme, kur vetëm pesëmbëdhjetë vjet na ndajnë nga shekulli i 21-të.

E para, në shtyp shpesh mendimet nuk janë të qarta e të plota. Ato fshihen prapa frazave të përgjithshme monotone dhe të përsëritura si parafabrikat. Ndërmjet këtyre frazave mendimi ose humbet, ose del në fund të shkrimit ose artikullit si batutë pa një koherencë. Dhe lexuesi ka përshtypjen se ky mendim i ka ardhur rastësish gazetarit dhe është kujtuar ta hedhë në mes ose në fund të shkrimit. Kjo vjen nga që ai nuk e ka përpunuar mendimin dhe nuk e ka të qartë që kur nis t'i hedhë në letër fjalët. Për shembull, dy-tri ditë para se rrëthi i Korçës të përfundonte nga të parët mbjelljen e grurit, në një artikull kritikohej për prapambetje. Pas pak ditësh vetë gazeta e lavdëroi si rrëth në pararojë. Ose gjatë verës, pa filluar korrija e grurit, gjithë shtypi, duke përfshirë edhe Radiotelevizionin, disa herë në javë botonte dhe transmetonte artikuj e reportazhe për arritjet në rrëthin e Krujës. Dihet, që Kruja ishte nga rrëthet më të prapambetura në planin e grurit. Kështu, mendimi në shtyp ishte i pasaktë, i rastësishëm dhe jo shkencor.

Nga ana tjetër jo rrallë mendimi jepet i tërthortë ose hermetik. Aty përpara në një gazetë ishte botuar një shkrim me titull të përafert «Kjo nuk është figurë për një shkrimit skematik», ku tregohej për një inxhinier që bëhet drejtore punon mirë. Diku nga mesi i shkrimit shkruhej fjalia: «kjo nuk është figurë për një shkrimit skematik». Dhe kaq! Masa e gjerë e lexuesve as e kupton këtë frazë. As ne nuk e kuptojmë. Pse një stërhollim i tillë? Ke dëshirë të flasësh për një shkrimit skematik, fol qartë dhe jo në mënyrë metaforike dhe batutale në një shkrim ku nuk të shkon ky mendim. Pastaj, moralisht, nuk ke të drejtë të thuash «shkrimit skematik», pasi ka vepër skematike dhe jo shkrimit skematik. Nga ana tjetër, shkrimi në fjalë është

eklektik dhe nuk kuptohet se cili është qëllimi kryesor: Lufta kundër skematizmit apo rritja e një njeriu në kudhrën e punës? Një mënyrë e tillë e të shkruarit u ngjan bisedave shkel e shko që hidhen degë më degë!

Mendimet e cekëta, të pasakta dhe të rastësishme vijnë edhe ngaqë disa nga ne gazetarët kemi njohuri dhe kulturë më të paktë sesa njerëzit për të cilët shkruajmë. Një konstruktor i shquar digash, për të cilin ne shkruajmë, ka njohuri të mëdha dhe ne nuk arritmë ta kuptojmë. Atij ia reduktojmë mendimet, e barazojmë me veten dhe ai në gazetë del si portreti ynë. Mendimet e tij i varfërojmë, se të varfra i kuptojmë. Ato që flet ky konstruktor ne nuk i mbajmë dot shënim, pasi nuk e marrim vesh. Duhet të kesh kulturë që të mbash shënime. Plaka Xhixho mua nuk di të m'i mbajë shënim ato që flas. Ne ndonjëherë ndaj konstruktorëve, inxhinierëve, teknikëve dhe njerëzve të përparuar jemi si plaka Xhixho, prandaj nuk mbajmë shënime të pasura. Dhe themi: digë e madhe, gjigante sa mali. Mendja jonë një digë vetëm me malin di ta krahasojë. Domethënë, mendja e heroin tonë bën sintezë, por sintezën ne nuk e kuptojmë dhe biem në deskriptivizëm primitiv. Dikur unë kam shkruar një shkrim për Lezan Pislin, një rritës të shquar dhish, që, sipas përvojës së vet, bënte edhe seleksionimin racor. Shkrimi nuk ishte i keq. Lezan Pisli takohet me shokun Enver nga viti 1968. Ndër të tjera shoku Enver i flet për racat e dhive, i thotë edhe për një dhi nga Pakistani dhe Hindia, nga Kashimiri, nga leshi i së cilës bëhet stofi kazmir. Dhe i shpjegon Lezanit se nuk e kemi këtë dhi që është edhe për lesh. Unë këtë gjë nuk e dija, pasi pak kisha studiuar për dhinë. Kur lexova bisedën e shokut Enver me Lezanin, më pushtoi një keqardhje për veten. C'përfitim do të kishte shkrimi po t'i vija edhe këto fakte e këto mendime! Por kjo kërkonte informacion e kulturë!...

E dyta, në shtypin tonë vihet re herë-herë një reduktim gjinish dhe në të njëjtën kohë një përzierje e tyre. Në përgjithësi ne sot kemi lajmin, artikullin, korrespondencën, që është shpesh një informacion i zgjeruar dhe reportazhin që përzihet me artikullin letrar, korrespondencën dhe përshkrimin. Mungojnë përshkrimi i vërtetë, fejtoni, pamfleti, skica, korrespondencia e gjallë, intervista e mençme, fotoreportazhi, trafiletoja, shënimini dinamik i ditës, mbresat e udhëtimit e të tjera. Një pjesë e reportazheve dhe e përshkrimeve mund ta mbajnë kokën e gjinisë, por në fakt nuk janë reportazhe. Ato

janë të mbushura me letrarizma, me letërsi primitive, që nuk japid informacion e njohuri. Janë tepër bërtitëse, tepër mburëse, tepër patetike.

Edhe kur shkruajmë një reportazh nga Myzeqeja e sotme, thérresim: «O trojet e Myzeqesë! O tokë e stërgjyshërve! O gjysh!» E gjithë kjo ka bërë që të humbë reportazhi e përshkrimi problemor, ai që i transmeton lexuesit një gjë të menjë dhe interesante. Bisedoja me një mjeshtër të prodhimit të misrit në kooperativën bujqësore të Maqellarës, me një brigadier që merr mbi 100 kv misër për hektar. Tek ai kishte shkuar Ahmet Osja, kërkues i njohur në fushën e hibriveve të misrit bashkë me Hysen Laçin. Ahmeti, kur mori vesh se ky brigadier kishte mbjellë 130 mijë fidanë misër për hektar, kur norma shkencore është 70 000 për hektar, u skandalizua dhe i tha se misri do të asfiksohet kur të rritet. Brigadieri e kundërshtoi dhe i tha se ajo tokë, ajo mikroklimë e klimë nuk e kërkonte me 70 000 por me 130 000. Erdhi vjeshta. Brigadieri mori 100 e ca kuintalë për hektar. Atëherë Ahmeti shkon te brigadieri, e zë për dore, dhe i thotë:

— Faleminderit, profesor!

Figuren e këtij shkencëtarit në reportazh ne do ta fshihnim mes frazave: «Misër, misër, kjo legjendë! Ahmetit i kujtohet Migjeni!» Ahmetit aspak nuk do t'i kujtohej Migjeni në këtë rast, megjithëse ai e di dhe e ndien Migjenin ndofta më mirë se ne. Rrjedhimisht, kërkohet një luftë këmbëngulëse kundër frazeologjisë letrareske që të mos bëhet si epidemi. Nuk ka gjë më të keqë sesa epidemia e frazeologjisë letrareske. Tani edhe letërsia po e përzë këtë frazeologji dhe nuk duhet që ajo, duke emigruar nga letërsia, të gjejë strehim në gazetari. Letërsia përdoret në gazetari, por ka një kufi. Edhe kur përdoret duhet të zërë vend në frázat e zgjaura, në frazat e shkathëta, në një mënyrë tepër origjinale, me plot espri! Edhe Marksia e përdorte letërsinë, por e përdorte bukur. Shoku Enver e ka përdorur letërsinë në librat politikë me mjeshtëri të rrallë.

Reportazhi ynë është e domosdoshme të ngrihet. Pajisja e redaksive të gazetave me automobil duhet ta kishte ndihmuar përparimin e reportazhit dhe përshkrimit, pasi, po të përdorej mirë, do të kishte mundësi të mblidhje më shumë fakte. Por kështu sic përdoret, unë mendoj se me futjen e automobilit në redaksi, ra reportazhi. Makinës ne i gëzohemi si provincialë, vërtitemi rrëth saj, hapim e mbyllim dyert, shtrohemë në kolltuk dhe nga andej marrim disa

të ashtuquajtura faktë. Kështu që të dhënët merren shpejt e shpejt dhe peizazhi vështrohet nga xhami i makinës. Peizazhi duhet pushtuar me këmbë. Në luftë një tokë nuk quhet e pushtuar po nuk hyri këmbësori. Gazetari duhet të jetë këmbësor. Makina nuk mund të shkojë në gjithë rrugët e atdheut. Atdheu është i madh dhe ka shumë shtigje. Unë e dua teknikën, makinat dhe magnetofonët, aparatet fotografike dhe kinematografike apo televizive, i dua edhe helikopterët, por ata duhen përdorur mirë që të kenë efektivitet. Gazetarët duhet të hyjnë në popull. Të dinë kulturën popullore. Shpesh gazetarët nuk dinë të hyjnë në kuvendim. Nuk dinë të thonë:

— Si je zotrote, ç'fëmijë ke, i ardhur je apo këtu denbabaden, a e njihje filanin, a të kujtohet kënga:

*Doli Rrapoja në Sinjë,
Primë, o Isuf beu, primë!...*

ta zëmë se ky personazh është nga Sinja e Beratit.

Të ngresh një shtëpi, duhet të kesh qerestenë, tullat a gurët, trarët, llaçin, gozhdët, xhamat, bravat, dyert e me radhë. Për ngritjen e reportazhit ne marrim vetëm xhamat. Qerestenë nuk e kemi. Dhe pastaj e mbushim me fjalë. Suksesi i disa reportazheve që kanë shkruar Astrit Nuri e Përparim Xhixha në «Zérin e popullit» qëndron në mbledhjen e materialit të pasur dhe në punën e tyre për këtë material. Por reportazhi më i dobët shkruhet fatkeqësisht nga shkrimtarët. Ai shkrimtar që nuk di të shkruajë reportazh, edhe romanin me temë aktuale nuk e shkruan mirë.

E treta, gazetat apo revistat ndodh që nuk ruajnë profilin e tyre dhe destinacionin e tyre dhe nuk marrin parasysh lexuesin që i drejtohen. Është e vërtetë, që gazetat dhe revistat tonë janë për të gjithë. Çdo njeri mund t'i lexojë. Megjithatë, kanë edhe një specifikë. «Zëri i rinisë» nuk mund të bëhet si «Puna» si «Zëri i popullit», apo si «Bashkimi». Ndonjëherë ka një përzierje me njëra-tjetrën, ose një imitim të njëra-tjetrës. Gazetat duhet të mësojnë nga njëra-tjetra, por jo të imitojnë njëra-tjetrën. Fillon gazeta «Drita» të botojë një rubrikë me intervista nga shkrimtarë dhe artistë për përvojën letrare e artistike. Këtë rubrikë, që është në natyrën e gazetës «Drita», e mori edhe një gazetë tjeter, duke i vënë okielon «Me njerëzit e përparuar». Por përbajtja është e njëjtë. Shtypi të ngrejë probleme se si

shfrytëzohet përvoja e kulturës botërore dhe se si bëhen studimet për këtë kulturë. Por jo të më thotë se kur lindi Goja apo El Greko, apo Bethoveni dhe ç'punë bëri. Në nuk e studiojmë Leonardo da Vinçin për të mësuar se si bëhet topi, se ai ka bërë skica edhe për këtë armë. Këto skica neve nuk na vlejnë, se janë të kapërcyera nga koha. Ne e studiojmë për pasionin e tij, për èndrrën e tij të madhe, për dëshirën për kërkime. E kam fjalën, që ne duhet të dimë të bëjmë një propagandë të zgjuar që të ketë efektivitet, që t'u mësojë njerëzve gjëra të reja. Shoku Ramiz thotë: «Tani agitatorët dhe propagandistët duhet të bëjnë shumë më tepër, duhet të bëjnë atë që nuk e arrin individualisht çdo punonjës.»¹⁾

Dua të shtoj edhe diçka tjetër. Gazetari nuk është në-punës i zakonshëm, nuk është një zyrtar me një post e zyrë të caktuar. Ai është agitator i vijës së Partisë, është militant dhe njeri i apasionuar i fjalës së shtypit. Kudo që të ndodhet ai është gazetar. Shpesh ne jemi vetëm tetë orë gazetarë. Kur jemi në zyrë, jemi gazetarë. Kur dalim nga zyra shndërrrohemë në njerëz të zakonshëm. Kur transferohemi nga gazeta dhe zëmë një punë tjetër, harrojmë të shkruajmë. Kjo do të thotë se disa nga ne nuk e kanë pasionin e gazetarit. Shoku Enver ishte redaktori i parë i shtypit popullor revolucionar. Shkroi në numrin e parë të «Zërit të popullit», është themelues i Partisë, ishte Sekretari i Parë i KQ të Partisë, vazhdoi, të shkruajë artikuj, botoi shkrime gjer në fryshtë e fundit. Mbeti gazetar e publicist për tërë jetën. Ne largohemi nga gazeta, na zhdukët emri, nami dhe nishani! D.m.th. ato vite në redaksi i kemi bërë si nëpunës. Kush e ka pasion gazetarinë, mërzitet po të mos ndiejë erën e tipografisë në numrin e freskët të gazetës. Edhe sikur të jetë në një punë tjetër, ai do të vrapojë drejt redaksisë. Disa gazetën e kanë si tramplinë për të kërcyer në punë të tjera, në letërsi, në studime, në zyra më të qeta, në pedagogji...

Edhe Bashkimi i Gazetarve luan rol në edukimin e pasionit dhe dashurisë për gazetarinë. Kohët e fundit është gjallëruar veprimtaria e këtij Bashkimi. Por unë mendoj se më shumë punë duhet bërë për formimin profesional e publicistik të gazetarëve. Nuk mjaftojnë vetëm takimet e konfe-

1) (Ramiz Alia «Te populli — forcë jonë», fq. 191-192).

rencat për problemet ekonomike dhe të politikës së jashtme. Duhen zhvilluar edhe tema dhe diskutime të profesionit të publicistikës. Duhen bërë botime për publicistikën, për historinë dhe teorinë e saj, për gjinitë dhe publicistët e shquar tanë dhe të huaj përparimtarë, botime të gazetarëve etj. Të ndihet që ka një organizatë gazetarësh dhe të rritet autoriteti i saj. Shumë nga ne nuk e dinë fare terminologjinë e publicistikës, e përzgjedhës atë me terminologjinë e letërsisë dhe arteve. Fjala vjen disa diskutantë folën për tipizimin në gazetari. Kjo nuk është as e saktë, as e vërtetë. Gazetaria nuk tipizon. Tipizon letërsia. Gazetaria pasqyron të vërtetën e jetës, bashkëkohësin dhe ngjarjen. Po të tipizonte, do të krijonte ngjarje me fantazi. Kur shkruan për një hero të punës socialiste, atë nuk e tipizon, por e paraqet, nuk e trillon se ai ka adresë të caktuar. Në gazetari merren ngjarjet, dukuritë, njerëzit më të rëndësishëm, që janë më tipikë në jetë, por nuk tipizohen. Kështu na mëson teoria e gazetarisë.

1985

PSIKOLOGJIA E AMBIENTIMIT ME NIVELIN MESATAR DHE LUFTA KUNDËR SAJ

Për letërsinë flitet dhe diskutohet gjithmonë e më shumë. Flitet në çastet kur dalin në dritë vepra të mira, flitet edhe në çastet kur ato mungojnë dhe vendin e tyre e zënë shkrimet mesatare dhe të dobëta. Për të parat shprehet kënaqësia dhe për të dytata *kegardhja* dhe shqetësimi. Kjo do të thotë se shoqëria jonë e përparuar nuk është indiferente ndaj krijimtarisë letrare; shkrimtarët il ndjekin hap pas hapi mijëra sy dhe janë nën kontrollin e njerëzve dhe nën presionin e pérhershëm të kërkesave të tyre. E gjithë kjo është një dukuri e re shoqërore që shpreh etjen dhe dëshirën për një letërsi të nivelit të lartë ideor dhe artistik, e gjithë kjo është një karakteristikë e re e kohës, një vëçori e popullit të kulturuar, që kërkon edhe një ushqim shpirtëror të cilësisë së parë. Prandaj kërkesat për krijimtar letrare të nivelit të lartë shkrimtarin e vërtetë nuk e dëshpërojnë, por përkundrazi e nxitin dhe ia shtojnë besimin në frytet e ardhme të punës së tij krijuese. Dhe është fakt që kërkesat në rritje të shoqërisë ndaj kulturës e kanë nxitur letërsinë të ecë përpara dhe të pasurohet me vepra me vlerë në gjithë llojet dhe gjinitë e saj. Në veprat më të mira pasqyrohetjeta e shoqërisë socialiste dhe lufta për liri e socializëm, përpjekjet për kapërcimin e vështirësive dhe puna e njeriut të emancipuar. Në to shprehet qartë lidhja e

ngushtë e shkrimtarit me problemet e ndërtimit socialist të vendit, shprehët uniteti i idealit shoqërор me idealin socialist të tij. Edhe në ato vepra që kanë vlera të kufizuara artistike dhe që mund të mungojnë shumë gjëra të formës dhe të stilit, vetëm një gjë nuk fshihet: *dëshira* për t'i shërbyer edukimit të njeriut dhe tendencia e përgjithshme militante.

Letërsia jonë ecën drejt zhvillimit të saj të mëtejshëm sipas orientimeve të Partisë dhe mësimeve të shokut Enver, sipas programit të gjerë perspektiv që ka përpiluar ajo për gjithë kulturën tonë. Për këtë arsyе arritjet e letërsisë janë të mëdha po t'i marrim periudhat e zhvillimit të saj të pashkëputura nga njëra-tjetra. Është e natyrshme, që ka vite kur vihen re edhe dobësi dhe prapambetje në gjini të vëçanta. Kështu, fjala vjen, në panoramën e gjerë letrare këto dy-tre vjetët e fundit duken disa dobësi e shpërpjesëtime që kërkojnë një vëmendje të veçantë për t'i njojur, analizuar dhe mënjanuar. Është e vërtetë se krijimtaria është shtuar. Shkruajmë shumë dhe botojmë shumë. Veçse në këtë sasi të prodhimit letrar ende nuk ka sa duhet vepra të nivelit të të lartë artistik dhe herë herë të krijohet përshtypja se je para një sheshi pa maja. Ndërsa në vitet 70 ne kishim romane të tillë, si «Dimri i madh» i I. Kadaresë, «Skënderbeu» i S. Godos, «Shembja e idhujve» i S. Drinit, «Përballimi» i T. Laços e plot të tjera, kohët e fundit të tillë vepra ose mungojnë, ose janë të rralla. Gjatë këtyre pesë vjetëve mund të janë botuar mbi dyzet romane, por fare pak prej tyre kanë mbetur; shumica është harruar. Panorama e tregimit është më ndryshe. Tregimet e Nasi Lerës, Zija Çelës, Kiço Blushit, Vath Koreshit apo Anastas Kondos kanë tërhequr vëmendjen e mjaft lexuesve. Megjithatë, edhe tregimi shpesh ecën në rrugë të njoitura dhe ka pak jetë të vërtetë, pak mendim dhe pak vështrim filozofik të dukurive të shoqërisë. Në poezi ka një përpjekje më serioze për nivel artistik dhe për kërkime të reja. Ka poetë të rinj që janë kërkues ndaj vetes dhe përpiken të zgjerojnë horizontin e tyre, ndiehet ajo që quhet garë poetike, e cila patjetër do të japë përfundime me vlera. Poetë të tillë të rinj, si Ndoc Gjetja, Petrit Ruka, Ilirian Zhupa, Rudolf Marku, Ndoc Papleka ose Bardhyl Londo kanë ende shumë për t'i thënë lexuesit. Për arritje mund të flasim edhe në kinematografi nga kanë dalë filma të një cilësie të lavdërueshme artistike.

Megjithatë, mjaft nga krijimet në prozë, poezi, dramaturgji dhe kinematografi të kohëve të fundit vuajnë nga një

nivel mesatar dhe i ulët artistik. Ato të kujtajnë shpeshherë disa sajime kolektive impersonale, që harrohen në çast, ende pa kaluar ditë dhe javë. Në to nuk ndihet kërçimi dhe mundi i shkrimtarit, nuk ndihet individualiteti i tij i veçantë. Kur i lexon, të duket sikur është bërë një marrëveshje për të thënë të njëjtat mendime, të duket sikur të gjithë kanë «kulotur» në një livadh ose kanë punuar në një arë dhe kanë nxjerrë një prodhim monokulturë. Bletët që mbledhîn nektarin vetëm në duhan, e kanë mjaltin të njëllojtë, mjalti i tyre vjen erë duhan dhe nuk vjen erë trëndelinë, luleshqerrë, çaj mali ose sherebeli. E njëjta gjë ndodh edhe me shkrimtarët që ushqehen nga i njëjti material dhe e asimilojnë në të njëjtën mënyrë. Kjo mënyrë formon psikologjinë e ambientimit me mesataren, që është e papranueshme për kulturën tonë. Ajo sjell dëme të mëdha në kulturë dhe në art, pasi me kalimin e kohës, po të mos luftohet, kthehet në mënyrë jetese, kthehet në zakon dhe është vështrimë të çlirorës nga përqafimet e saj.

Materiali i ambientimit me mesataren formon disa psikologji të dëmshme te shkrimtarët, redaktorët dhe drejtuesit. Njëra nga këto është psikologjia e komoditetit të shpejtë, të arritur pa mundim. Poeti dhe prozatori me lehtësi e botojnë librin, pa vështirësitet e kërkimit, pa lodhjen e rëndë dhe netët pa gjumë. Me ta botuar librin e parë, letrari mendon për komoditetin personal: kërkon të bëhet anëtar i Lidhjes, të marrë leje krijuese, të fitojë orar të reduktuar dhe të ketë përfitime të tjera. Në këtë mënyrë, ai punën letrare e quan një gjë të thjeshtë, pasi suksesi i vjen lehtë. Kështu ndonjëherë nuk mendohet thellë për ato kushte lehtësuese që i ka krijuar shoqëria socialiste: botimin, lejen krijuese, orarin e reduktuar e të tjera. I ngopur nga këto shpesh ai bëhet i pallëvizshëm, pasi vetëkënaqësia nuk e lejon të kërkojë edhe të jetë gjithmonë në lëvizje, ia heq interesin për gazetën letrare, nuk e lë të vlerësojë punën e të tjerve, minatorëve, shofëreve, naftëtarëve, kooperativistëve. Jeta i duket shesh me lule dhe e përshkruan po kështu meqë nuk jeton sa duhet me situatat ekonomike dhe politike të vendit.

E pandarë me psikologjinë e komoditetit të menjëhershëm është edhe psikologjia e nuhatjes së kérkesave dhe shijeve të redaktorit dhe drejtuesit. Ka letrarë që në dukje janë si të leshtë, por në të vërtetë janë psikologë të mëdhenj! Ata e psikologjisën me imtësi dhe thellësi redaktorin, studiojnë kérkesat e tij, moralin e tij, sjelljen e tij dhe shijet e tij. Pas-

taj lëshojnë në rrugë drejt redaktorit, drejtorit të teatrit ose institucionit librat dhe dramat e tyre. Prandaj, është e domosdoshme që redaktori dhe drejtuesi të janë njerëz të përgatitur ideologjikisht dhe të kenë kulturë të gjerë letrare dhe të gjithanshme. Ata duhet ta kuptojnë thellë përgjegjësinë e tyre të madhe që kanë ndaj shkrimtarit dhe lexuesit.

Është e vërtetë se nga sasia del cilësia. Por edhe vetë cilësia është sasi. «Të gjithë duhet ta kenë të qartë, — thotë shoku Ramiz, — se më shumë se në çdo fushë tjetër të jetës, në art cilësia është sasi. Por ka jo pak vepra artistike që s'i qëndrojnë gjatë kohës, gjë që tregon se realizohen pa përgjegjësinë e duhur krijuese. Nga disa institacione krijuese, botuese dhe ekzekutuese nuk kuptohet thellë dëmi i veprave artistike mesatare dhe të dobëta». Dhe vërtet, edhe sikur thjesht nga ana numerike të nisesh, do të nxjerrësh përfundimin se është më mirë të botosh një roman me vlera të larta artistike në katërmëbëdhjetë mijë kopje, sesa shtatë romane të dobëta me nga dy mijë kopje! I pari do të lexohet nga katërmëbëdhjetë mijë njerëz dhe do të kalojë dorë më dorë, kurse shtatë të tjerët do të mbeten të pašfletuar.

Një psikologji tjetër që nxit ambientimin me mesataren është ajo e përshtatjes me kërkesat e një publiku me shije mesatare. Dihet, se ndërmjet masave të gjera punonjëse me shije të përparuar, ka edhe një qark njerëzish që kënaqet me filma e drama familjare sentimentale, me romane gjysmë-detektive dhe me skeçe dhe tregime të një humorit banal. Shkrimtari i këtyre prirjeve e njeh mirë këtë psikologji dhe hidhet në veprim konkret; shkruan ndonjë dramë se si ndahen dy të rinj të sapomartuar ose ndonjë roman të këtij modeli. Me këto lloj shkrimesh u shkohet anash problemeve të mëdha të kohës, nga të cilat dalin edhe ide të mëdha dhe përgjithësime të gjera. Doemos, që problemet e familjes së re socialiste do të janë objekt i letërsisë, pasi janë pjesë e jetës sonë, por ato do të zënë vendin që u takon dhe nuk do të janë qendra e krijimtarisë. Në një kohë problemet e familjes bashkë me ato shoqërore disi mungonin ose trajtosheshin pak në letërsinë tonë. Atëherë u fol që edhe këto të zinin vendin e tyre. Por ç'ndodhi? Menjëherë filloi një vërsim i papërbajtur i tyre në dramaturgji, kinematografi dhe në prozën e shkurtër. E keqja është se këto vepra nuk sillnin ndonjë gjë të re në trajtimin e temës së familjes, por përsëritnin të njëjtat gjëra nga e para deri tek e fundit. Natyrisht, shkrimtarët e kuptojnë se detyra jonë kryesore sot

është që të pasqyrojmë në mënyrë sa më të plotë jetën e shoqërisë socialiste, duke trajtuar problemet kardinale të ndërtimit të socializmit.

Letërsia duhet t'u hyjë problemeve të jetës me stilin dhe metodën e punës së Partisë, me militantizëm të lartë, me principialitet, me qëllim të madh dhe me ndjenjën e perspektivës. Partia, me forcën e saj, e transformon shoqërinë dhe nuk e lë siç e ka gjetur, kërkon rrugë të reja për ecjen e saj përpara. Me këtë fryshtë e domosdoshme të luftojë dhe të punojë edhe shkrimtarë. Në veprimtarinë e shoqërisë sonë synohet që të shfrytëzohen gjithë rezervat e energjive njerëzore në dobi të ndërtimit të socializmit. Edhe rezervat e fjalës artistike janë të mëdha dhe ende të pashfrytëzuara gjer në fund. Fjala ka shumë rezerva dhe mund të kthehet në energji të fuqishme njerëzore. Por duhet të kuptohemi: Në energji të fuqishme njerëzore kthehet vetëm fjala e nivelit të lartë artistik. Për këtë, në radhë të parë, dihet që kërkohet talent, por nevojitet edhe kulturë, edhe njohje e jetës dhe problemeve të shoqërisë, edhe guxim dhe sakrificë. Kjo kërkohet nga shkrimtarët, por edhe nga redaktorët dhe institucionet kulturore e artistike. Ndonjëherë redaktorët dhe drejtuesit e teatrove nuk kërkojnë vepra me probleme të mprehta, me kontraste, me kontradikta të vërteta jetësore dhe me guxim qytetar, që t'u paraprijnë dukurive, por kënaqen me «konflikte anësore» dhe të lehta skematike. Nga ana tjetër, shpesh shkrimtarët nuk sjellin në shkrimet e tyre jetën e gjallë të njerëzve, pasi nuk e njohin sa duhet mënyrën e jetës së popullit, kulturën e sjelljes, zakonet, këngën, punën, jetën shpirtërore dhe psikologjinë e tij. Vetë redaktori u kalon këtyre veprale përciptazi dhe nuk i thotë shkrimtarit haptazi: «Ti nuk e njeh jetën e popullit. Shko, njihe, më sill material të gjallë, pastaj të ta botoj!»

1985

BOTA E EPOSIT

Si pasqyrohet bota në epos dhe në përgjithësi jeta? Edhe herë të tjera më ka shqetësuar ky mendim. Mua më duket se bota në epos pasqyrohet, si ta themi, e qëndrueshme, e ngritur një herë dhe përgjithmonë, e ndërtuar mirë dhe bukur me heronj epikë të qëndrueshëm, si një botë e stërgjy-gjyshërve idealë dhe e brezave idealë. Për atë që interpreton, domethënë për rapsodin, bota e epikës, e eposit është një botë e myllur, ajo nuk lëviz, ajo qëndron si monument. Bota epike e eposit kurrë s'ka qenë bota e sotme, por e largët edhe e shkuar. Rapsodi e shikon këtë botë epike nga larg, nuk i afrohet se mahnitit prej saj, ka frikë ta sjellë në të sotmen se mendon që e sotmja nuk e nxë, nuk ka se ku ta futë; nuk e sjell dot Mujin në këtë tryezë të simpoziumit ku jemi mbledhur, se bën kërdinë. Prandaj e shikon nga larg, tregon për çudirat e tij dhe duket sikur thotë: «Mos u afroni, dëgjojeni se c'mrekullira ka bërë!» Por kjo ka edhe një kuptim tjetër, që po mundohem ta shpjegoj më poshtë.

Në qoftë se romani, si gjini epike, e pasqyron jetën në lëvizje dhe lexuesi kuvendoron me personazhet, i kap, i sjell në dhomë dhe rri me ta, eposi jetën e ka të ngrirë, të fikuar, të formuar njëherë e përgjithmonë, heronjtë i ka të paarritshëm dhe rapsodi i interpreton dhe i këndon si të paarritshëm. Prandaj eposi na mahnit edhe na magjeps, duke na ngjallur shijen estetike të së madhërishmes. Kjo duket sikur na largon, po kjo shije e së madhërishmes prapë na

afron. Në vështrim të parë duket si paradoks, po në të vërtetë është dialektike. Ky largim në të njëjtën kohë është edhe atrim. Një fenomen i tillë ka tërhequr vëmendjen e mjaft shkrimtarëve, artistëve e piktorëve.

Në epos lidhur me këtë, mendoj se duhet parë edhe cikli i ditëve dhe i netëve, cikël që cakton dhe përkufizon ngjarjet. Për shembull, në vërsuljet dhe kanosjet e qenieve të çuditshme, siç është kali që bën çudira, apo siç janë gërmimet në varrin e babait, ose të të dashurit, është nata që përcakton ngjarjet e çuditshme. Këto ngjarje të mrekullueshme bëhen natën, natën thurren intrigat; nata zgjat kohën për të menduar heroi kreshnik se ç'do të bëjë më tej. I keqi natën bie në mendime për tu bërë ose i mirë, ose më i keq se ç'është. Kreshniku natën përgatit kalin, natën pastron armët, natën bën planet e udhëtimit, natën i shfaqen gjërat e çuditshme. Nata është, si ta themi, e filozofisë dhe e meditimit, dita është e dëfrimit dhe e udhëtimit, se ditën kreshniku s'ka kohë të filozofojë dhe të mendojë. Kjo në epos është tepër e qartë. Tashti, në epos, duke parë këtë gjë, ka edhe ngatërrresë kohësh, domethënë koncepti i kohës është i mjegullt dhe i papërcaktuar. Brenda shtatë vjetësh heroi lind edhe rritet, rrëmben armën edhe merr hakun. Për shembull, djali i Mujit e merr hakun për babanë dhe xhaxhanë brenda shtatë vjetësh nga lindja. Në shtatë vjet ai bëhet burrë. Ndonjëherë ngatërrohet èndrra me realitetin: heroi fle një-qind vjet, pastaj zgjohet dhe thotë: «Paskam fjetur një orë.» Të gjitha këto elemente janë shfrytëzuar shumë nga romancierët modernë. Kanë dalë edhe romane të mira me këtë konceptim. Të marrim romanin e Ismail Kadaresë «Gjenerali i ushtrisë së vdekur». Personazhi i plakës Nicë nxjerr kockat nga varri i italianit dhe ia hedh gjeneralit. Natën bien në mendime prifti dhe gjeneralit; natën bëhen të gjitha gjërat më paradoksale dhe më të çuditshme.

Shfrytëzimi indirekt i eposit nga shkrimtari është më i efektshëm sesa përsëritjet dhe imitimet e ngjarjeve. Imitimet e peripeticë fantastike të eposit ishin në stadin e parë të letërsisë sonë. Tani eposi asimilohet filozofikisht. Këtu nuk i marr si shembull ato tregime për fëmijë që i banalizojnë heronjtë e eposit tonë, pasi ato nuk meritojnë vëmendje. Kështu, në epos bota e largët, e ngurtë dhe e ngirirë në dukje, vjen dhe afrohet drejt nesh përmes ndjenjës të së madhërishmes.

Baladat, këngët historike dhe gojëdhënët janë të stadir

të mëvonshëm, domethënë, pas formimit të eposit. Por në folklorin tonë ato kanë bashkëjetuar me eposin. Në baladat materiali fantastik dhe materiali legjendar është material poetik dhe nuk paraqitet si në eposin arkaik. Materiali poetik nuk do të thotë që balada për Rozafën ka lindur në atë kohë kur po ndërtohej Rozafa. Më vonë është marrë si material nga ai që ka bërë baladën, nga anonimi. Autori anonim nuk i beson asaj që thotë, por e merr si material poetik, si material për të thënë një gjë tjetër, kundër asaj bote të mbyllur feudale, kundër asketizmit. Në epos rapsodi i beson asaj që tregon, kurse balada është me material poetik dhe këngëtari anonim nuk u beson atyre që rrëfen.

1984

FËMIJËT DHE LETËRSIA E TYRE

E gjithë letërsia jonë u shërben fëmijëve dhe të rinjve. Fëmijët mund të marrin e të lexojnë çdo libër që botohet në Shqipëri, pa u trembur nga prindërit. Librat prindërit i lexojnë dhe i lënë mbi tryezë dhe nuk ua fshehin fëmijëve. Në vendet kapitaliste dhe revizioniste prindërit jo çdo libër mund ta lënë mbi tryezë. Një libër pornografik nuk mund t'uajapin fëmijëve të tyre, prandaj e fshehin. Ne nuk fshehim ndonjë libër. Dhe fëmijët i lexojnë të gjitha, vetëm të dinë t'i kuptojnë. Prandaj mos kujtojmë se fëmijët tanë edukohen vetëm me letërsinë për fëmijë? Ata edukohen me gjithë letërsinë tonë.

Por ne, megjithatë, kemi edhe atë letërsi që e quajmë për fëmijë, pasi ajo ka disa veçori dalluese që u përshtatet më shumë të vegjelëve nga përbajtja e nga forma, që ka situata dhe heronj të afërt me natyrën e të vegjelëve, e veçanërisht gjer në moshën dhjetë-e njëmbëdhjetëvjeçare. Kjo letërsi ka marrë zhvillim të gjithanshëm në vendin tonë. Ajo sot i ka të gjitha gjinitë e saj dhe ka mundësi të pakufishme zhvillimi. Brenda saj janë formuar edhe personalitete letrare që njihen nga të gjithë. Në ditët e sotme shoqëria jonë është në kërkim të vazhdueshëm për ta çuar socializmin përpara. Kërkohet në industri, kërkohet në bujqësi, kërkohet në kulturë. Revolucioni tekniko-shkencor thellohet për të marrë rendimente të larta në prodhimin industrial e bujqësor; bëhen

eksperimentime duke u përdorur gjerësishët shkenca. Arsimi lufton që të ngrejë cilësinë e tij, që të përgatitë njerëz me kulturë më të gjërë. Kultura gjithashtu ngre gjithnjë nivelin e saj. Gjithë njerëzit tanë janë në përpjekje të vazhdueshme pér të ngritur nivelin cilësor të punës dhe të veprimtarisë së tyre. Prindërit dhe fëmijët, bashkërisht, po kalojnë në një etapë të re zhvillimi, në një nivel të ri cilësor të kulturës dhe mësimit. Po letërsia pér fëmijë që u takon edhe fëmijëve dhe prindërve, a do të kalojë në një shkallë të re përparimi? Prindërit dhe fëmijët janë qindra e mijëra. Shtatëqindmijë njerëz venë vetëm në shkollë. Po ata që dinë të lexojnë, sa janë? Kurse shkrimtarë pér fëmijë ka shumë e shumë herë më pak. Ata që janë shumë e kanë më lehtë të nxjerrin edhe shumë njerëz që ta ngrenë cilësinë e punës dhe veprimtarisë. Shkrimtarët që janë më pak e kanë më vështirë, prandaj përpjekjet duhen shumëfishuar.

Në këtë diskutim do të shtroj disa kërkesa pér letërsinë pér fëmijë, kërkesa që na i drejtojnë shoqëria, prindërit dhe të vegjelit.

1. Të krijojmë libra térheqës pér fëmijë, libra me tension të fuqishëm veprimi, që të ngjallin kuriozitetin e të vegjelëve.

Kjo kërkesë shtrohet, pasi një pjesë e librave pér fëmijë nuk janë térheqës, por të hallakatur e të mërzitshëm, të mbushur me didaktikë si traktate morali. Në ta ngjarjet janë të njohura, të përsëritura, të mbushura me moralizime e të përcjella me një gjuhë pa ngjyra. Në ta nuk ka fantazi krijuese dhe nuk ka çudira e të papritura. Këta që duhet të jenë më térheqës sesa librat pér të rritur, janë më të mërzitshëm. Atëherë fëmijët i braktisin ata dhe thonë: «Këta janë pér të vegjël. Dmth vetë fëmijët krijojnë mendimin se librat e mërzitshëm janë pér fëmijë. M. Gorki thotë: «T'u flasësh fëmijëve me gjuhën e thatë të predikimit, kjo do të thotë t'u ngjallësh mërtzi dhe neveri shpirtërore pér temën e predikimit.»

Cilat veti e bëjnë librin pér fëmijë térheqës? Në radhë të parë, e bën ngjarja, subjekti, mënyra e të treguarit me plot peripeci, me situata të papritura, herë prekëse e herë komike, përmes të cilave kalon heroi. Dhe ky hero duhet të jetë trim i pamposhtur, që i mund edhe kundërshtarët më të fortë e më dinakë. Nga ana tjetër, kur i mund i bën qesharakë. Përsëri dua të sjell një thënie të M. Gorkit. Ai thotë: «Historia e zbulimeve të mëdha dhe e shpikjeve duhet t'u

tregohet fëmijëve lehtë dhe në mënyrë zbatitëse. Kjo histori e vërtetë njerëzore përmban në vetvete shumë drama të ënda, por bashkë me këto ajo fsheh shumë budallallëqe dhe injoranca të klasave drejtuese. Është e domosdoshme, që fëmijët ta dinë mirë historinë se si idiotizmi i njerëzve, të cilët janë përpjekur në shekuj të sigurojnë mirëqenien e tyre, e vështirësoi zhvillimin e kulturës njerëzore, por e pengoi edhe zhvillimin kulturor të vetë këtyre idiotëve.»

E kemi fjalën që, kur japim guximin e trimërinë e heroit, zgjuarësinë dhe përpjekjet e tij, të tregojmë edhe idiotësinë e atyre që thotë Gorki. Por këtë idiotësi të mos e paraqitim në mënyrë shabllone e banale, ta paraqitim me zgjuarsi e fantazi. Heroi i dashur i fëmijëve nuk është njeriu frazi, që ka mësuar përmendsh disa formula të moralit dhe të propagandës e agitacionit, por ai që bart origjinalitet në sjellje e në veprime, që ka shpirtin e kërkimit dhe peripecisë. Por heroi i librit për fëmijë nuk është vetëm fëmija, moshatari i lexuesit. Ai është edhe i rrituri, bile edhe plaku. D. Arantanjani në «Tre mosketierët» e Dymasë është heroi i fëmijëve. Edhe Robinson Kruzoja i Defo-së është heroi i fëmijëve. Ne duhet të zgjerojmë larminë e heronjve të librave për fëmijë. Nga kjo larmi do të dalin edhe tipa letrarë, që të mbahen mend nga lexuesit e vegjël, siç është, fjala vjen, Tom Sojeri i Mark Tuenit. Letërsisë sonë për fëmijë tanë për tanë i mungojnë këta tipa, këto personazhe, të cilët i dëshirojnë shumë të vegjlit. Në rapsoditë tona janë tipa të tillë, si Muji, Halili e Gjergj Elez Alia, në përralla janë Qerosi. Ded Alia e Gjysmagjeli, në balada janë Kostandini e Doruntina e të tjera. Fëmija madje ka dëshirë t'i ketë tipat e tij të dashur në seri të tëra librash, që bëjnë çudira përmes veprimeve të habitshme. Pak çudira kanë bërë partizanët tanë me italianët, gjermanët e ballistët? Në pak situata komike i ka vënë heroi partizan ballistët? Pak çudira kanë bërë kaçakët e maleve para Çlirimt? Pak çudira bëjnë sot fëmijët në qytete, fshatra e konvikte? Po në konviktet e para, menjëherë pas Çlirimt, pak çudira kanë bërë fëmijët? Por ka autorë që fëmijët duan t'i nxjerrin si lektorë, si komisarë e si njerëz që çdo fjalë duhet ta matin me kandarin e moralit. Atëherë u humb lëngu jetësor librave dhe bëhen të thatë, bëhen tekste me rregulla, me këshillime e me diktate të mërzitshme. Fëmija kërkon të hyjë në botën e madhe, se ai rritet, se ai do të çajë, të ecë, të kërkojë, të synojë. Është si kërcelli që del e vrapon drejt dritës me shpejtësi e me forcë të madhe të

papérmbajtur. Ne duhet ta ndihmojmë tē voglin, duke ia bërë fēmijérinë tē bukur, duke ia mbushur me kuriozitate e me dritë. Pēr këtë eshtë e domosdoshme t'u largohemi skemave dēmprurëse. Dhe këtu tē vijmë te kërkesa e dytë.

2. Tē luftojmë me ashpërsi skematizmin nē letërsinë pēr fēmijë, pērndryshe pengohet ngritja e nivelist tē saj cilësor.

Ndërsa nē letërsinë pēr tē rritur skematizmi eshtë një herë i dëmshëm, nē letërsinë pēr fēmijë eshtë dhjetë herë më i dëmshëm. Pse e them këtë? Skematizmi nē letërsinë pēr fēmijë eshtë i dëmshëm se ndihmon tē rritet nē djep burokrati i ardhshëm, duke i kënduar: nina-nana, burokrati i nënës!... Këtë duhet ta kenë mirë parasysh edhe shkrimtarët, edhe botuesit e redaktorët. Ne kemi arritur nē atë stad zhvillimi shoqëror, sa tē kuptojmë se q'është skematizmi. Ai eshtë sistem skemash që i vihet veprimit tē heroit, eshtë mohimi i kontradiktës dhe konfliktit, eshtë shterpësi e fantazisë dhe mendimit, eshtë formimi i shkretëtirës nē horizontin e librit, ku nuk mbin as bari, as pema. Skematizmi i bën njerëzit si kukulla e si robotë. Eshtë thellësisht subjektivizëm, pasi bota nuk paraqitet siç eshtë, por siç do autorët dhe redaktori.

Shpeshherë skematizmi vjen edhe nga theksimi artificial i tendencës dhe i pikëpamjes së autorit, nga shkëputja e kësaj tendencë nga materiali letrar. Nisesh medoemos që tē bësh agjitation pēr moralin dhe trimëritë e heroit, pēr kohën dhe situatën. Le ta kemi parasysh një mendim tē Engelsit, i cili thotë: «Por unë mendoj se tendencia duhet tē rrjedhë vetiu nga ambienti dhe nga veprimi, se nuk duhet ta theksojmë atë posaçërisht, dhe shkrimtari nuk eshtë i detyruar t'i japë lexuesit tē gatshme zgjidhjen e ardhshme historike tē konflikteve shoqërore që ai paraqet.»

Po do tē thoni ju se kemi tē bëjmë me fēmijë dhe Engelsi s'e ka parasysh atë hall që kemi ne pēr t'iа dhënë tē gatshme zgjidhjen tē vegjëlve? Po pse i trashë eshtë fēmija ynë, sa t'i thuash kur ai ha bukë; «Haje, bir, se këtë bukë, na e ka sjeillë pushteti popullor...». Pēr këtë lloj tendencë e ka fjalën Engelsi.

Duhet tē pranojmë se kemi mjaft skematizëm, veçanërisht nē vjersha pēr fatosa, nē tregime, por edhe nē romane. Shkruhet, siç u tha nē diskutime, një novelë, ku tregohet se si nē breg tē lijenit fēmijët gjejnë një varkë. Varka eshtë e prishur dhe ata e ndreqin. Bukuri gjer këtu! Lexuesi i vogël prei

tani se çdo të bëhet me këtë varkë. Por autor i shuan menjëherë kuriozitetin, duke treguar se si këtë varkë fëmijët ia dhanë xhaxhi peshkatarit. Po si nuk e provuan një herë vetë këtë varkë, si nuk bënë një udhëtim, si nuk patën një aventurë dhe pastaj t'ia jepnin këtij xhaxhi peshkatarit! Jo! Kjo varkë lundron në valët e moralit të autorit dhe s'mund të lundrojë në valët e liqenit! Ky është një skematizëm trashaman, që nuk duhet lejuar. Ose në një shkrim tjetër përshkruhet një lejlek që vjen nga vende të ngrohta dhe bën një çerdhe. E ku e bën çerdhen thoni ju? E bën në oxhakun e furrnaltës së Kombinatit Metalurgjik! Ama, pemë! Në oxhakun e furrnaltës! Lejleku nuk është aq budalla, se ai e njeh mirë jetën lejlekore, kurse shkrimitari s'ka haber fare nga furrnalta.

Që në titull, nxjerr disa herë krye skematizmi. A mund të të tärheqë pér ta lexuar një roman me titull: «Shqipëri. Atdhe i dashur», edhe pse është i mirë? Cili nga ne nuk e do Shqipérinë? Po ky titull është pér ndonjé vjershë, pér ndonjé poemë ose pér ndonjé kantatë muzikore. Nuk është pér një roman pér të vegjël.

Skematizmi ka hyrë edhe në përralla, në atë kështjellë ku është shumë vështirë të hyjë, dhe megjithatë ka hyrë. Kafshëve vërtet u vëmë disa veti njerëzore, por këto yeti shpesh i zgjedhim sipas skemave dhe nuk i ngremë në fantazi. Në një përrallë me viça dhe arushë, fare mirë mund t'ua ndërrrosh emrin kafshëve dhe t'u vësh emra njerëzish dhe përralla të qëndrojë. «Viçi kthehet nga shkolla e zhytet në baltë», mund ta zëvendësosh me «Arifi kthehet nga shkolla dhe zhytet në baltë», sepse krijimi nuk ka fantazi. Atëherë ç'duhet që ta bësh përrallë?

Skematizmi lind edhe nga kërkimet skematike të autorit, edhe nga kërkjesat skematike të redaktorit dhe të botuesit. Ngjarja dhe heroi herë-herë kërkohet të jenë siç do autor iose siç do redaktori dhe jo siç e dojeta dhe e vërteta. Kërkohet të mos dalë asnjë e metë në karakterin e heroit dhe personazhit, të jenë këto ideale, se na u prishkan fëmijët. Por ku ka gjë më të mirë se sa ajo që fëmija ta shohë se si luftohet vesi dhe fitohet virtyti i ri?

Prandaj është e domosdoshme të kërkojmë maksimum përbajtje dhe maksimum art. Këto të dyja e largojnë skematizmin, i cili e degradon temën, sado e gjetur të jetë, dhe e dëmton përbajtjen.

Dhe më në fund, le të flasim pér kërkësen e tretë.

3. Të njohim jetën e popullit dhe veçanërisht jetën e fëmijëve.

Ashtu siç e ka specifikën e saj, letërsia për fëmijë ka edhe veçanësinë e njohjes së jetës. Shkrimtari i letërsisë për fëmijë duhet të jetë një njeri me kulturë të gjërë e të gjith-anshme, të njohë jetën e psikologjinë e popullit, por të njohë edhe botën e fëmijëve. E them këtë, pasi heroi i letërsisë për fëmijë nuk ka moshë të caktuar: ai është edhe i rritur, edhe adoleshent, edhe fëmijë. Por që të pasqyrohen këto, duhen njohur thellësish. Shkrimtari bën dialog me fëmijët, është mësues i tyre. Mësuesi i njeh fëmijët, njeh karakteret, temperamentin, virtytet e veset. Unë mendoj se më shumë duhet të përpinqemi për t'i njohur këta njerëz, që nesër do të marrin shtetin socialist në dorë, punëtorët, kooperativistët, intelektualët e udhëheqësit e ardhshëm, për të cilët ne do të duartrokasim. T'i njohim qysh tani, në mënyrë që t'i pasqyrojmë në librat tanë me vërtetësi. Një shkrimtar për fëmijë duhet të ketë sa më shumë miq të vegjël, të rrijë me ta dhe të zbulojë virtytet e tyre, jetën e habitshme të tyre. Të njohë shkollën, konviktin, qytetin dhe fshatin ku ata jetojnë. Është detyra jonë që të jetojmë me problemet e kohës që kanë fëmijët tanë, shkolla jonë, familja jonë, rruga dhe shoqëria. Letërsia do të thotë edhe të ngresh probleme. Sa probleme ngajeta e fëmijëve ne i kemi ngritur shoqërisë? Ende pak. Janë të shpeshta rastet kur ne vetëm tregojmë ngjarje të zakonshme, por nuk tregojmë ngjarje problematike. Ne tregojmë, midis të tjera, për guximin e trimërinë, për sjelljen në shtëpi e për notën në shkollë. Por sa probleme ka ky njeri i vogël që rritet, ky adoleshent që kërkon miqësi e dashuri mes shokësh e shoqesh, sa gjëzime e trishtime? Po sa herë ai dëshpërohet i fyter nga më të mëdhenjtë? Po sa herë nga ky dëshpërim bën marrëzira? Po sa herë gjëzohet? Po marrëdhëni e tij me prindërit, mësuesit, shokët! Po ai që është i ndarë nga babai apo nëna? Po ai që ka vese dhe duhet edukuar?

Shkrimtari për fëmijë është pedagog, psikolog e shkencëtar. Ai të gjitha duhet t'i dijë: barërat dhe lulet, kafshët dhe insektet, përrallat dhe legjendat, se përndryshe nuk shkruan dot. Por, mbi të gjitha, duhet të njohë njerëzit.

MUZIKA NË JETËN E FËMIJËVE

Muzika për fëmijë dhe për pionierë ka rëndësi të vencantë në edukimin patriotik dhe estetik të fëmijëve dhe në përgjithësi të njerëzve tanë. Edhe ne të rriturit, kur dëgjojmë një këngë a një melodi për fëmijë, hidhemi në një botë tjetër, në botën e pastër të të vegjelje dhe kujtojmë fëmijërinë tonë. Të parën që kemi dëgjuar në jetën tonë, muzikën përfëmijë, e duam të gjithë. E para është «nina-nana». Këtë këngë, që është në embrionin e muzikës përfëmijë, e kompozoi populli. Dhe po të duam që të mos dalim nga natyra e muzikës përfëmijë, ta kemi parasysh gjithmonë këngën e parë «nina-nana», që është aq e bukur me thjeshtësinë e saj.

Në muzikën përfëmijë ka arritje, ka vepra që kanë mbetur në fondin e artit tonë. Me këtë muzikë merren shumë kompozitorë, të vjetër e të rinj, dhe japid një ndihmesë të ndjeshme në përparimin e saj. Atë e transmetojnë fëmijët në festivalë, në veprimitari të përbashkëta dhe në shoqëri ndërmjet tyre. Tingujt e saj e bëjnë jetën të gëzuar dhe ngjallin shpresë e optimizëm përditë më të bukura dhe më të lumtura.

Por krahas arritjeve, si edhe në fushat e tjera të artit, vihen re edhe dobësi, të cilat duhen mënjanuar. Arritjet dhe të metat jetojnë bashkërisht. Duke jetuar bashkërisht fillon ambientimi. Dhe ambientimi me të metat është i rrezikshëm, pasi formon edhe shije estetike ambientuese. Prandaj edhe kompozitorët dhe artistët, duke u shqetësuar, luftojnë përmë-

njanimin e dobësive. Në këtë luftë dalin në horizontin e muzikës pér fëmijë disa probleme, që duhen marrë parasysh.

E para, lind nevoja të kërkojmë një këngë dhe muzikë më të individualizuar, më konkrete artistikisht. Arti ka ligjet e veta. Pa individualitet artistik nuk ka art. Këtij ligji i nënshتروhet edhe muzika pér fëmijë. E themi këtë, pasi mjaft këngë janë harmonizim tinguish të përgjithshëm, pa adresë vendi dhe njeriu. Një nga arsyet që ka ngjashmëri mes këngëve, është mungesa e individualitetit artistik. Duke dëgjuar disa këngë, ke përshtypjen sikur i ka shkruar një kompozitor. Ku e ka burimin kjo dukuri? Mendoj se e ka burimin në lehtësinë me të cilën e marrim muzikën pér fëmijë. Na duket se kjo është një punë kalamajsh, një punë pér konsum të çastit, pér konsum brenda një veprimtarie ose manifestimi tradicional. Në këtë rast mungon ndjenja e përgjegjësisë qytetare dhe serioziteti ndaj fëmijës. Fëmijët kërkojnë seriozitet, pasi ata çdo gjë e marrin me gjithë mend. Burim tjetër i mungesës së individualitetit është puna me fushata, puna me fazë dhe jo në një proces të vazhdueshëm krijues, si gjithë krijimtaria, si poezia apo lloje të tjera të artit. Mjaft kompozitorë shkruajnë këngë pér fëmijë vetëm në prag festivalesh. Frymëzimi nuk lind gjatë një procesi të vazhdueshëm, por detyrohet nga kushtet organizative. Ky frymëzim nuk ka lëng, pasi thahet nga kërkesa e ditës, piqet shpejt e shpejt si një pemë nga një diell i përnjëhershëm, përvëlues. Gjithashtu, shkak kryesor i këngës pa individualitet është se nuk aktivizohen sa duhet kompozitorët e vërtetë, ata që kanë një përvojë të pasur krijuese. Prandaj është e domosdoshme t'i kushtojmë të gjithë vëmendjen muzikës pér fëmijë dhe të merremi me të me ndjenjën e përgjegjësisë qytetare.

E dyta, muzika pér fëmijë me gjithë gjinitë e saj, ka nevojë të jetë më e thjeshtë artistikisht. Fëmijët e duan të thjeshtën e bukur dhe nuk pranojnë ndërlikime. Madje ndërlikimi nuk pranohet as në këngën pér të rritur. Që të synojmë drejt thjeshtësisë artistike, duhet ta shfrytëzojmë në mënyrë më krijuese folklorin, traditën kombëtare dhe përvojën botërore. Folklori i jep muzikës pér fëmijë origjinalitet të papërsërithshëm kombëtar, e afron fëmijën drejt muzikës dhe edukon dashurinë pér këtë art aq të domosdoshëm pér formimin e gjithanshëm të personalitetit të njeriut. Kur them të shfrytëzohet folklori, nuk e kam fjalën vetëm pér «ninan-nanat» dhe këngët e lodrave dhe riteve, por pér gjithë krimtarinë popullore. Fryma e festivaleve kombëtare të Gji-

rokastrës, që kanë një begati të mahnitshme, është e domosdoshme të hyjë në këngët dhe muzikën pér fëmijë. Këtë domosdoshmëri, në radhë të parë, duhet ta ndiejnë kompozitorët e rinj. Folklori pér ta duhet të jetë universitet. Mbështetja në folklor mbron muzikën pér fëmijë nga ndikimet e huaja dhe forcon origjinalitetin kombëtar.

E treta, në muzikën pér fëmijë është e nevojshme të hyjnë sa më shumë kompozitorë të rinj. Ishte pozitiv fakti që në festivalin e sivjetshëm të këngës pér fëmijë u aktivizuan mjaft kompozitorë të rinj. Pjesëmarrja e tyre do të freskojë muzikën pér fëmijë dhe do ta pasurojë me gjini të reja. Aktualisht gjinitë e muzikës pér fëmijë janë disi të varfra. Vëmendja është përqendruar pothuajse vetëm te kënga. Muzika skenike është e kufizuar, edhe gjinitë e tjera janë të pakta. Mbështetje edhe kjo ngjall ndjenjën e monotonisë. Por monotoninë herë herë e shton edhe njëanshmëria tematike. Tematika shpesh është mjaft didaktike, me një përbajtje agitative dhe propagandistike, aspak interesante pér fëmijët. Është si skematizmi i marrë nga arti pér të rritur. Ky skematizëm, kur hyn në muzikën pér fëmijë, bëhet shumë i dëmshëm, pasi edukon që në fëmijëri një shije artizane, banale dhe anti-artistike. Skematizmin e përforcojnë edhe tekstet moralizuese dhe frazi të pompozitet gjoja patriotik. Mendoj se kompozitorët duhet t'i shtojnë kërkesat ndaj poetëve dhe të mos pranojnë tekste që prishin shijet e fëmijëve dhe të rriturve. Kompozitorët nuk duhet të bien në kompromis me vlerat gjysmake të poezisë, nëse duan që vepra e tyre të jetojë. Monotoninë e nxitin ndonjëherë edhe organizatorët e festivalit me kërkesat e tyre skematike.

Problemët e muzikës pér fëmijë është e domosdoshme të bëhen më shumë objekt diskutimi. Për këtë duhet të diskutojmë, të bëjmë debat, të shkruajmë në shtypin letrar e artistik dhe në shtypin e rinisë. Në këtë mënyrë do të ndihmojmë pér ecjen përpëra të muzikës pér fëmijë, pér ngritjen e nivelt të saj artistik.

PIKTURA DHE SKEMAT

Ne po diskutojmë gjerësisht për pikturen, e cila ka arritje të ndjeshme, që nuk i errësojnë aspak vërejtjet që po bëhen këtu dhe kërkesat që po shtrohen. Këto arritje duken veçanërisht në pasqyrimin e jetës dhe të natyrës së vendit tonë, të luftës dhe punës së njerëzve. Në pikture ëdalngadalë po bëhet gjithmonë dhe më i plotë portreti i Shqipërisë. Në peizazhet, portretet, tablotë e grafikat shprehët dashuria për Atdheun, patriotët dhe bashkëkohësit tanë. Sot anembanë Shqipërisë punojnë e krijojnë shumë piktorë, të moshuar dhe të rinj, me ndjenjën e përgjegjësisë së piktorit militant. Në punë krijuese janë afirmuar personalitetë të shquara artistësh, të cilët me veprat e tyre luajnë rol të rëndësishëm në edukimin e njerëzve me shije të përparuara estetike, me dashurinë për vendin, me dashurinë për socializmin. Por hapat e këtij përparimi kanë nxjerrë edhe disa probleme që duhet të na bëjnë të mendojmë.

1. Është e domosdoshme të luftojmë skematizmin në pikture, i cili, në fund të fundit, është një subjektivizëm, pasi e bën jetën skemë, e varfëron atë. Skematizmi është steril, është pa pjellori. Ai krijon disa shtampa që përsëriten, e zbuluron realitetin dhe me këtë ia heq lëngun pikturen, si thatësira lëngun e pemëve. Duhet çliruar piktura nga fraza konvencionale, domethënë nga kompozimi konvencional i figurave të buzëqeshura, të krekosura, të zbuluruara nga krenaria pompoze, pa mendim të thellë.

Skeinatizmi krijon monotonji, krijon një mënyrë të ngrirë të vendosjes së figurave pa peshë, të figurave që duken të lehta si pendë, që nuk vijnë erë materiali, erë jete. Ai është i rrezikshëm pasi përhapet si gripi në të gjithë pikturën tonë, përhapet më shpejt se në letërsi për vetë specifikën e arteve figurative. Skematizmi në pikturë, siç duket shpejt, me një vështrim, ashtu edhe përhapet shpejt dhe futet menjëherë në mes të kornizave. Prandaj rrufeshëm duhet luftuar, që të mos na bëhet mënyrë jetese në krijimtari, që të mos na bëhet zakon.

2. Krahas skematizmit të luftojmë fotografimin e jetës, që është në të vërtetë një kopjim i natyrës dhe i veprimeve të njerëzve. Fotografimi ndryshon nga skematizmi në moslodhjen e mendjes, pasi çdo gjë e gjen në natyrë. Skematiku e lodh mendjen për të krijuar skema. Fotografiku kopjon dhe lodhet vetëm nga të kopjuarit nëpër fotografi dhe në natyrë. Edhe skematizmi, edhe fotografimi ndodh që pranohet nëpër ekspozita, pasi nuk kanë «gabime». Janë mediokre. Mediokri nuk bën asnjë «gabim», ai është vetëm mediokër.

Edhe skematizmi, edhe fotografimi luftohet kur të kemi kulturë të gjerë dhe fantazi prej krijuesi. Piktoreve herë herë u mungon fantazia, prandaj fotografojnë. Realiteti nga artisti krijohet dhe nuk fotografohet. Prandaj, është e domosdoshme të jemi novatorë dhe t'i shtojmë kërkimesat për novatorizëm. E theksoj këtë pasi vitet e fundit e kemi humbur interesin për novatorizëm dhe bëjmë siç kemi bërë, ecim siç kemi ecur. Mjetet shprehëse nuk i kemi ripërtërirë dhe nuk i kemi revolucionarizuar, kemi ato mjete që na kanë lënë të parët. Kjo na ka ambientuar me mesataren. Kur nuk ka kërkime novatore, ka ecje të pandjeshme mes ambientimit. Kështu që pikaturat tona nuk ngjallin debat, nuk të bëjnë të mendohesh. Një pikturë nuk e kundërshtojnë me zjarr kur paraqitet në ekspozitë dhe as e pranojnë me zjarr. E kundërshtojnë me zë të ulët dhe e pranojnë pa ngjallur debate. Në karikaturë çështja qëndron pak më ndryshe. Ajo ka më shumë fantazi se piktura, prandaj ngjall diskutime dhe vështrohet me kuriqitet. Ekspozitat e karikaturës janë të një niveli të ngritur dhe ndiqen me interes nga vizitorët. Prandaj nga fantazia dhe mjeshtëria e karikaturës kanë ç'të mësojnë edhe piktoret, madje edhe poetët.

3. Të luftojmë më shumë që të prishim disa zakone dhe disa rite në krijimin dhe në pranimin e pikturës. Këto rite janë kërkimesat didaktike për pikturën, se si ajo duhet të jetë,

se si duhet ta ketë dorën figura, se si duhet ta ketë hundën, veshët, sytë e shpatullat, ose palat e pantallonave. Këto rite didaktike nuk lejojnë që të hyjë jeta sa më e plotë e konceptuar filozofikisht, përmes një mendimi më të thellë; të hyjë aktualiteti historik, puna dhe jeta e njeriut. Kjo jetë nuk duhet të hyjë në mënyrë diskriptive, në mënyrë përshkruese. Të pasqyrosh aktualitetin nuk do të thotë të pikturossh çdo gjë, edhe një veprim të castit, si spërkatjen e vreshtave, heqjen e plehut nga stallat, ngarkimin e kafshëve etj. Nga realiteti do të marrësh atë çast që të jep mundësi të ngjallësh një mendim. Dhe ky mendim nuk jepet duke i bërë figurat si fotografi, me simetri të plotë. Më duket se në pikturë vuajmë nga pikturimi i plotë, nga një pikturim ku duken edhe kopsat nga larg, duken qimet, duken qostekët. Në qoftë se një pikturë nuk e ka këtë simetri dhe këtë imtësi, ndodh që nuk e pranojmë në ekspozitë. Ne, pranuesit, nuk e kemi pra të qartë destinacionin e pikturës. Të vërtetëtë e pikturës e kërkojmë si të vërtetëtë e fotografisë. Ne kërkojmë nga një lopë e piktuuar aq realizëm sa të dalë nga korniza e pikturës, ta mjelim dhe të mbushim kusinë me qumësht. Ky mentalitet i administratorëve, i pranuesve dhe i vlerësuesve të pikturës, ka ndikuar keq dhe ka formuar një stil, një prirje, një mënyrë pikturimi drejt një vërtetësie vulgare. E bëj këtë vërejtje, pasi nuk duhet të edukojmë shije estetike vulgare në popull. Njerëzit me këtë lloj arti mësohen dhe pastaj nuk rimësohen aq lehtë me atë çka është me të vërtetë nivatore.

4. Përshtatja me një mënyrë të piktuari ka ndikuar edhe në forcimin e zakonit të një lloj pune, të punës vetëm për ekspozita dhe jo të asaj pune të përditshme si kërkeshë shpirtërore. Mjaft piktorë nuk kanë piktura në studio e në shtëpi. Të vjen keq që edhe piktorë të shquar dhe skulptorë me emër, si: Sali Shijaku, Myrteza Fushekati, Skënder Kamberi, Danish Jukniu, Ismail Lulani, Kristaq Rama apo Mumtaz Dhrami, shpesh, punojnë në kohë ekspositzash apo angazhimesh të mëdha dhe nuk punojnë sa duhet ditë për ditë edhe për kënaqësi të tjera shpirtërore. Me një fjalë, ne duhet të bashkojmë dy lloje punësh në një të vetme, të punës për ekspozita me punën e përditshme. Sot edhe puna prodhue se është shndërruar në krijimtari, pasi ngjall kënaqësi shpirtërore, se është e çliruar. Aq më tepër piktura duhet t'i ngjallë piktorit kënaqësi shpirtërore. Duke punuar ditë për ditë

me kënaqësi shpirtërore, piktura do të hyjë më shumë nëpër shtëpitë e popullit, nëpër shtëpitë tona.

5. Hyrja e piktureës në shtëpitë tona ka një rëndësi të veçantë. Ajo e mëson njeriun tonë ta dojë të bukurën dhe në jetesën e tij të hyjë e bukura. Socializmi e do të bukurën dhe duhet të jetë domosdo më e bukur se çdo rend tjetër shqëror. Artet e tjera, letërsia, muzika, gdhendjet dhe qëndrismat kanë hyrë kudo. Nuk ka shtëpi pa libra e pa këngë. Kurse shtëpi pa pikture ka. Nuk duhet ta lëmë pikturen vetëm në ekspozita, por që të mos e lëmë vetëm në to, duhet të bëjmë pikturna të mira e të larmishme dhe me përmasa të ndryshme, jo vetëm me përmasa të mëdha, pasi nuk e nxënë muret e dhomave tona.

1986

† DY FJALË PËR KOREOGRAFINË

Koreografia jonë ka arritur suksese të dukshme. Është krijuar një stil, një karakter i veçantë me frymë popullore dhe origjinalitet kombëtar. Vlerësimet që i bën populli ynë dhe vlerësimet që i bëjnë popujt e tjerë dëshmojnë për arritjet në këtë fushë. Por ky nivel i arritur tani ka ardhur koha që të kapërcehet. Kemi arritur te lijeni i Ulzës dhe te lijeni i Vaut të Dejës, duhet të arrijmë te Fierza dhe te Komani. Edhe tek Komani s'do të mbetemi, do të vemë tek Skavica e me radhë. Kjo s'duhet të na bëjë të dëshpërohem, por përkundrazi të gjëzohemi.

C'mendime kam unë si njeri i letrave për koreografinë.

Ne kemi bërë katër festivale të mëdha folklorike në Gjirokastër: 1968, 1973, 1978 dhe 1983. Janë katër shkolla të mëdha të paraqitjes së folklorit tonë. Nga njëra dhe tjetra ka një ngjitje të madhe. A kemi ecur ne me këtë ngjitje? Koreografia e festivalit të 1968-ës, koreografia e festivalit të 1983-shit, a kanë ecur barabar? Nuk kanë ecur barabar, por në ngjitje. Hapat e popullit janë shumë herë më të mëdha. Pas 1968-ës doli vepra «Festë të madhe ka sot Shqipëria». A ka një vepër të tillë të këtij niveli? Jo. Ne u ambientuam me këtë. Kërkuaam pak në folklor. S'hymë me mençuri në këtë thesar, që ka variacion të mahnitshëm.

Që të shfrytëzosh thesin e popullit, që ta asimilosh atë, që ta rikrijosh, kërkohet një kulturë e madhe nga koreografi, kulturë popullore dhe kulturë teorike, kulturë kombë-

tare dhe botërore. Koreografi duhet ta dijë kulturën kombëtare në majë të gishtërinjve. Por edhe kulturën koreografike botërore. Koreografi t'i dijë të gjithë ansamblet popullore të Evropës, të shohë se si ata i ripërtërijnë. Mendoj se disa koreografë nuk e njohin sa duhet as kulturën e popullit dhe pa folur më për kulturën botërore, nuk kanë kulturë profesionale. Kënaqen me disa arritje të thjeshta. Mes gjë-rave të thjeshta lodhen shumë. Lodhen se nuk i bëjnë me pasion.

Pasioni është për gjëra të mëdha. Gjëja e madhe të jep pasion të madh. Gjëja e vogël të bën më qejf, por nuk të jep pasion. Kultura të jep fantazi dhe art pa fantazi nuk ka. Në Institutin e Lartë të Arteve shkojnë ata që dinë disi të kërcejnë, por pak dinë të mendojnë. Janë me mesataren më të ulët dhe me kulturën më të ulët të gjithë rinisë. Këta mbarojnë shkollën, por nuk kanë kulturë. Të paktë janë ata që kanë kulturën e Panajot Kanaçit e Agron Aliajt e ndonjë tjetri, njerëz që dinë të të flasin për gjithë llojet e artit, duke përfshirë edhe letërsinë. Një pjesë e madhe janë zanatçinj, artizanë.

Ndërmjet koreografëve shpesh mungonjeta intelektuale, jeta e këmbimit të mendimeve, e debatit, e bashkëpunimit, e ndihmës për shoku shokun. Kjo ka sjellë një punë të mbyllur, punë që nuk gjëzon shokun. Ka një ndjenjë mikrobor-gjeze, ndjenjë e pronarit të vogël. Pra, hapësira e mendimit përplaset me kodrat e vogla të egoizmit dhe nuk shtrihet gjerë. Kjo pastaj kalon në simpatitë krahinore, në vërtitjen në dy-tri krahina. Këtu cënohet militantizmi, dashuria për gjithë krahinat. Koreografi është si gjeologu. Ai kërkon mineralin kudo. E kërkon se shikon dobinë për Atdheun dhe është militant. Koreografi duhet të kërkojë pra mineralin — valle në gjithë krahinat për dobinë e Atdheut. Të kërkojë bashkë me vallen edhe valltarin.

Problemi tjeter: Është e domosdoshme të thyejmë monotoninë. Kemi pak variacion. Të vëmë edhe valle burimore. Kemi mjaft pompozitet. Mburrje në valle, superkrenari, supertrimëri, superbesë. Nuk jemi modestë si populli. Kjo bën që edhe gruaja të bëhet burrë. Atëherë humbet mendimi në valle. Në vallen me temë pune dhe mbrojtje, ka ushtrime taktillo-rreshtore, ka banalitet, nuk të ngjall ndjenjë estetike. Kërcejnë të ngarkuar me armë, me kazma e me lopata. Këtë le ta bëjë gjimnastika. Vallet tematike nuk kanë fabul, nuk kanë tregim. Bëhen valle pllakateske. Kjo ul cilësinë.

Koreografia jonë shpesh është pa detaje, është valle ide përgjithësi, por jo me detaje. Mungon hollësia artistike që e bën artin. Për shembull, kur ulet myzeqari dhe vë pëllëmbën në tokë, kjo është një hollësi, kur bën sikur bie devolliu, kjo është një hollësi. Në vallet e koreografëve shpesh harrohen këto hollësi. Janë valle të përgjithshme, globale. Ose në disa të tjera ndodh që nuk ka koherencë, fillon ndryshe, mbaron ndryshe. Këto duhen shpjeguar në kritikën tonë dhe në diskutimet e seminaret.

Koreografia jonë duhet të luftojë ndrojtjen, ngurtësinë. Në valle, valltarët mezi i afrohen vallëtareve, janë tepër namusqarë. Prandaj shpesh mungon vallja e vërtetë lirike. E fundit, kritika teorike e praktike duhet të gjallërohet e të ketë më tepër libra pér koreografët.

1986

KOHA E LIRË DHE ARTI

Letërsia dhe arti kryesisht krijohen në kohën e lirë dhe përvetësohen në kohën e lirë. Në qoftë se kjo kohë e lirë do të përdorej vetëm nga shkrimtarët dhe artistët për të shkruar libra, për të piktuuar tablo e peizazhe e për të kompozuar simfoni e këngë dhe nuk do të shfrytëzohej nga lexuesit, spektatorët dhe dëgjuesit, atëherë nuk do të kishte asnje vlerë, pasi librat nuk do të lexoheshin, muzika nuk do të dëgjohej dhe piktura nuk do të shijohej. Po të ndodhët kjo, shkrimtarët dëhe artistët do të bëhen indiferentë, do të binin në dëshpërim dhe nuk do ta shfrytëzonin kohën e lirë për krijimtari. Pra, artisti e përdor kohën e lirë, sepse e përdor kohën e lirë lexuesi, punonjësi, ai njeri për të cilin edhe bëhet krijimtaria.

Pse e ka rritur dhe shtuar socializmi krijimtarinë letrare-artistike? E ka shtuar dhe rritur, pasi ka formuar një lexues me interesa të mëdha për artin, një lexues që pas punës, në kohën e tij të lirë, lexon letërsi, dëgjon muzikë dhe shijon pikturen ose skulpturen. Sot në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve ka 1300 anëtarë. Shqipëria këta 1300 anëtarë mund t'i kishte dhe para Çlirimt, pasi kishte 1 milion banorë. Por nuk i kishte, përveç të tjerave, pasi nuk kishte këta dhjetëra e dhjetëra mijë lexuesish. Në atë periudhë të historisë, regjimi kohën e lirë nuk ua rezervonte njerëzve për letërsi e arte, por për gjëra të tjera. Ato 2700 kisha e xhami, teqe e manastire,

ai regjim i kishte për kohën e lirë të njerëzve. Ajo shërbente për t'i turbulluar njerëzit dhe jo për t'i bërë të mendojnë. Edhe sot në botë letërsia detektive, muzika zhurmuese, kinematografia, emisionet televizive, klubet e natës, teatrot e kabaretë, institucionet fetare e gjer partitë politike janë mjete për t'ua zënë njerëzve kohën e lirë, për t'i droguar e për t'ua humbur mendjen që të mos mendojnë për të sotmen dhe të ardhmen e shoqërisë njerëzore.

Koha e lirë në kushtet e sotme të zhvillimit të shoqërisë sonë përdoret për dobitë e njeriut, për ta bërë atë më të kulturuar, për ta pasuruar me mendime të mëdha, për t'a fisnikëruar ndjenjat e për ta parë të nesërmen me optimizëm e besim. Çdo orë e lirë është në dobi të prodhimit të të mirave materiale e shpirtërore të vendit. Kjo «liri», si ta themi, ka një larmi të madhe shfrytëzimi: dikush merret me shkencë, dikush me zbulime në teknikë, dikush me sporte, dikush me shah, dikush me udhëtime për t'u pasuruar estetikisht nga natyra e bukur e vendit. Por letërsia dhe artet hyjnë në çdo kohë të lirë, edhe ai që merret në kohën e lirë me teknikë, nuk mund të mos lërë ndonjë orë për t'u kënaqur me krijimtarinë letrare e artistike. Për këtë të gjithë krijuesit, të vjetër në moshë ose të rinj fare, kanë një përgjegjësi të madhe morale e qytetare: të krijojnë një art me vlera të vërteta ideore e artistike, se kështu do të respektojnë lexuesin dhe spektatorin dhe kështu do t'ua bëjnë kohën e lirë më të gëzueshme dhe më të bukur.

Ne sot kemi një letërsi e art të zhvilluar në gjithë llojet dhe gjinitë, letërsi dhe art me nivel të lartë artistik e me forcë edukuese, që çdo vit pasurohet, konsolidohet dhe maturohet. Disa forma të këtij arti, si kinematografia, muzika simfonike e operistike, baleti dhe telefilmi lindën krejtësisht në epokën e Partisë. Të tjera, si proza, poezia, pikitura, skulptura dhe kënga u pasuruan, u rritën dhe u zhvilluan më tej në jetën e shoqërisë sonë.

Duke parë nivelin e kulturës së njeriut tonë dhe veçanërisht të rinisë, kërkohet një cilësi artistike më e lartë, që të asimilohet më shpejt e më me dobi nga të gjithë. E themi këtë, pasi ka edhe vepra të zbehta, me mendime të cekëta, që nuk ngjallin emocione të fuqishme. Ndonjëherë ka vjersha me vargëzim të zakonshëm, pompoze e bërtitëse, që duken sikur i ka shkruar një dorë, pasi u mungon individualiteti krijues. Ka edhe këngë, përvëç të mirave, që të mbeten në për gojë dhe nuk i këndon dot. Ato nuk mund t'i këndojë

rinia në një mbrëmje familjare ose në një piknik. Edhe në estrada ka raste që jepen skeçe, kuplete e parodi, që nuk na vlejnë për të kaluar kohën e lirë. Ndonjëherë ato janë vulgare ose nuk interpretohen mirë.

Koha e lirë e punonjësit, e të moshuarit dhe e të riu, është flori dhe kërkon flori. Ky flori na shtyn ne shkrimtarët dhe artistët të ngrejmë nivelin artistik të krijimtarisë, sidomos të asaj krijimtarie që pasqyron jetën e shoqërisë socialiste. Jeta jonë është e pasur me ngjarje dhe mendime. Njeriu ynë është i zgjuar dhe i kulturuar dhe kërkon të mësojë gjëra të reja, që nuk i ka dëgjuar. Në disa nga veprat tona përsëriten ato që lexuesi i di me kohë. Prandaj koha e lirë për shkrimtarin dhe artistin nuk është vetëm për të shkruar, por edhe për të fituar kulturë, për të njobur jetën e shoqërisë, për të takuar njerëz, për të ndenjur me ta në një sofër.

Shkrimtari dhe artisti kohën e lirë e përdor për të jetuar intensivisht me jetën politike e shoqërore të vendit, për të lexuar, për të njobur realitetin dhe për të shkruar. Një pjesë të kohës së lirë shkrimtari dhe artisti ka nevojë ta përdorë për talentet e reja, për të ndenjur pranë tyre, për t'u dëgjuar mendimet e për t'u dhënë ndihmë. Talentet e reja duhet t'i shohë si vazhdimi të vetes së vet, si personalitetë të ardhshme të letërsisë dhe arteve. Atëherë ai do të shkruajë edhe vetë libra të mirë. Talenti i ri në kohën e lirë nuk kërkon vetëm librin e kolegut të tij më të vjetër, por kërkon të shkëmbejë me të mendime, ta ndjejë ndihmën dhe të përvetësojë përvojën. Prandaj çdo shkrimtar e artist i njobur është e domosdoshme të ketë rrëth vetes disa shokë e miq letrarë e krijues të rinj, ta ndjekë veprimtarinë e tyre, të bëjë vërejtje, të shkruajë gazeta e revista për ta me dashuri. Edhe vërejtjet t'i bëjë me dashuri dhe të mendojë vreten e vet, kur ka qenë si ata.

Rol të rëndësishëm për të nxitur masat për shfrytëzimin e letërsisë në kohën e lirë, kanë edhe punonjësit, e vatrave të kulturës në fshatra. Në këtë drejtim puna e tyre ka përmirësimë. Megjithatë duhet këmbëngulur për të patur në këto vatra njerëz më të pasionuar e me arsim të përshtatshëm. Edhe letrarët e rinj, që kemi në çdo krahanë e në çdo rrëth, është mirë të punojnë në vatrat e shtëpisë e kulturës. Po të veprohet në këtë mënyrë, të jemi të sigurt që puna kulturore do të ecë më përpara dhe do të ngrihet niveli i saj.

Përdorimi i kohës së lirë për letërsinë dhe artet bëhet

individualisht dhe kolektivisht. S'do mend që romani nuk lexohet kolektivisht. Por teatri, piktura, muzika, filmi shihohen në përgjithësi, kolektivisht. Ato janë si futbolli që po ti shohësh vetëm, mërzitesh.

Në mbledhjet e zakonshme të organizatave të rinisë mund t'u kushtohet vëmendje më e madhe letërsisë dhe artit. Ne kemi anëtarë të BRPSH-së që janë letrarë e artistë. A nuk është interesante dhe me dobi sikur në një mbledhje të organizatës së rinisë të diskutohet pér krijimtarinë e një të riu, anëtar të saj? Pa mund të ftohet edhe një shkrimtar pér të dëgjuar e pér të folur. Edhe pér artet e tjera mund t'ë veprohet në këtë mënyrë. Pér muzikën mund t'ë flasim duke e ilustruar fjalën tonë me magnetofon. P.sh., merr një këngë që kompozitori është ndikuar nga folklori, vëre në magnetofon edhe këngën e kompozitorit, edhe burimin nga e ka marrë. Dhe thua: «E shihni se si shndërrrohet e asimi-luar muzika popullore? Ja, si janë ligjet e krijimit!»

Koha e lirë pér letërsinë dhe artet është nga vlerat më të mëdha, është thesar pa fund. Balzakun e pyetën kur po vdiste: «Çdo të dëshiroje?» Dhe ai u përgjigj: «Të jetoja edhe një ditë, mund t'ë bëja akoma më shumë. Të shfle-toja librat e mi dhe t'ë hiqja pjesët e dobëta».

Arkimi duke shëtitur nëpër rërë në breg të detit, bënte me shkop rrathë gjeometrikë. Ajnshtajni me bashkë-studentët e tij në pushim, në tavolinat me mermer të kafeve të vogla të qytetit shkruante formula matematike dhe kamerieri i fshinte me leckë në mëngjes, pa e ditur se ç'do të sillnin këto zhgaravitje të bëra në pushim, duke pirë një kafe!

Sa kalojnë vitet aq më e pasur shpirtërisht bëhet koha e lirë në shoqërinë tonë. Por edhe aq më shumë ajo bën pre-sion mbi letërsinë dhe artet. I riu dhe e reja, këta shfrytë-zues t'ë etshëm të kohës së lirë, na nxitin që t'ë bëjmë një letërsi e një art sa më t'ë madh dhe t'ë bukur.

MADHËSHTIA E FIGURËS DHE E VEPRËS

1

Në historinë shumëshekullore të Shqipërisë ndritin figura të shquara trimash e udhëheqësish, kapedanësh e komandantësh, dijetarësh e shkrimitarësh, mësuesish e mendimtarësh. Ata kanë dalë në truallin tonë valë-valë bashkë me ngjarje të mëdha, në momente kthesash historike dhe kanë luajtur rol të rëndësishëm në ndërgjegjen kombëtare, në luftërat përliri, pavarësi e përparim shoqëror. Të gjithë bashkë ata janë pjesë e pandarë e biografisë së Shqipërisë dhe shkëlqejnë në anketat e kësaj biografie të pasur. Por figura më e madhe e historisë sonë, figurë me dimensionet e një epoke, është Enver Hoxha.

Në histori ka epoka konkludive, ka edhe figura personalitetesh që janë konkluzion epokash. Ato lindin rrallë, lindin në momentet kur përgatiten kthesa dhe përbysje të mëdha në jetën e shoqërisë, kur janë grumbulluar energji kolosale që presin çastin përf të shpërthyer. Atëherë ato ndritin me tërë madhështinë e tyre në qellin e historisë dhe bëhen forcë e fuqishme lëvizëse e energjive njerëzore. Shoku Ramiz Alia, duke folur përf figurën e Enver Hoxhës, thekson: «Jeta dhe veprimitaria e shokut Enver Hoxha është historia e gjallë e popullit shqiptar në këta 50 vjetët e fundit. Ajo është historia e themelimit të Partisë dhe e rritjes

së saj, historia e ringjalljes së Shqipërisë dhe e ndërtimit të jetës së re, historia e luftës kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm dhe e fitores mbi ta.»¹⁾

Enver Hoxha doli nga gjiri i popullit që ziente nga dramat dhe vuajtjet, nga lëvizjet dhe përpjekjet, nga revoltat dhe luftërat, nga dëshirat dhe ëndrrat. Duke dalë nga ky gji i madh në vlim, ai mishëroi në figurën e tij esencën e virtuteve më të larta të popullit: trimërinë dhe guximin, patriotizmin dhe besnikërinë, dashurinë për vendin dhe për njërit, etjen për përparim, respektin për traditat e mira dhe shpirtin kërkues të së resë. Virtytet bashkë me kulturën dhe me vlerat shpirtërore të popullit ai i asimiloi dialektikisht dhe u dha shkëlqim të ri. Çdo njeri mahnitet me njohuritë e tij të thella për folklorin dhe poezinë popullore, ku ai zbulonte shpirtin e popullit; mahnitet me respektin e madh për trimat, luftëtarët, patriotët dhe rilindasit; çdo njeri admirin dashurinë e tij për gjuhën shqipe, të cilën e shkruante me aq bukuri dhe me aq lëng e ngjyra. E mrekullueshme ishte vëtia e tij për të zbuluar në histori njërit e thjeshtë, ata që ndofta pak ishin dëgjuar publikisht e zyrtarisht. Duke i zbuluar dhe evidentuar, fliste me ndjenjën e dashurisë dhe e përgjithësonte mendimin se historinë nuk e bëjnë vetëm disa njëz të shquar, por masa e gjërë, ata luftëtarët e thjeshtë, bijtë dhe bijat e popullit. Kjo veti shprehet qartë në librat dhe në veprimtarinë e përditshme të tij. Akoma më hapur këtë e tregojnë letrat drejtuar njëzve të thjeshtë në gjithë Republikën tonë. Më kujtohet një ngjarje e vogël më 1968, kur punoja në redaksinë e «Zërit të popullit». Një shoku ynë, që ishte korrespondent i gazetës në Elbasan, shkroi një shkrim të shkurtër për një brigadier nga fshati Sojnik i Gramshit, që quhej Alo Qosja. Brigadieri bënte një punë të lavdëruar në bujqësi edhe duke drejtuar brigadën, edhe duke dhënë shembullin e vet. «Vështirë të dalloje brigadierin nga kooperativistët në punë», — shkruante «Zëri i popullit». Në andrallat dhe zhurmën e redaksisë ky shkrim kaloi me qetësi nëpër sytë tanë. Ndërsa shoku Enver atë e kishte dalluar dhe veçuar nga të tjerët. Dhe menjëherë i dërgoi letër Alo Qoses: «Të çoj shumë të fala të përzemërtat. Me punën tënde u njoha nga shkrimi i korrespondentit të «Zërit të popullit»,

1) Ramiz Alia, «Enver Hoxha dhe vepra e tij rron e do të rrojë përjetë». fq. 4, Tiranë 1985.

Jorgji Papa, i cili shkruan realisht për ty dhe me entuziazëm¹). Ne u detyruam ta lexonim përsëri shkrimin që bënte fjalë për heroin e thjeshtë të viseve të thella të Gramshit.

Lidhjet e ngushta të Enver Hoxhës me njerëzit e thjeshtë dhe me popullin u bënë forcë edukuese për vetë popullin. Populli rriti besimin në komunistët dhe njohu fuqinë e socialistit. Nga këto lidhje mësuan të gjithë, komunistët dhe vetë Partia. Ato hynë në metodën e punës sonë dhe u bënë e po bëhen ngaherë e më shumë mënyrë jetese. Enver Hoxha u bë një universitet i tërë komunist për ne. Kështu që trashëgimi i virtuteve më të larta të popullit tek Enver Hoxha nuk ishte një stoli. Këto virtute ai përsëri ia ktheu popullit, duke u dhënë forcë të madhe edukuese. Virtytet e larta ia mori hua popullit dhe ia ktheu pastaj me vlera të tjera kolo-sale. Këtë mendim Ai e shpreh në adresë të shkrimitarëve, por ky i shkon më shumë vetë Atij. Duke folur për vlerat e artit tonë, Ai nënëvizon: «Kjo ngjet sepse arti ynë revolucionar frymëzimet i merr nga populli dhe ia kthen ato prapë atij, të përgjithësuarë e në format më të bukurë...»²). Por në figurën e tij mishërohen edhe mësimet, idetë dhe virtytet më njerëzore të klasikëve të marksizëm-leninizmit, të atyre që hodhën bazat e komunizmit shkencor dhe e zbatuan konkretisht revolucionin. Me këto mësimë të asimiluara dhe të përvetësuarë në mënyrë krijuese ai themeloi Partinë dhe i hapi rrugën ndërtimit të socializmit në Shqipëri. F. Engelsi, kur flet për K. Marks-in që zbuloi ligjin e zhvillimit të historisë njerëzore, se prodhimi i mjeteve materiale imediate të jetës dhe bashkë me të çdo shkallë e caktuar e zhvillimit ekonomik të një populli ose epoke përbëjnë bazën mbi të cilën ngrihen institucionet shtetërore, pikëpamjet juridike, arti madje dhe idetë fetare; kur flet për K. Marks-in që zbuloi gjithashtu ligjin e veçantë të lëvizjes së mënyrës së sotme kapitaliste të prodhimit, ligjin e mbivlerës, arrin në përfundim: «Dy zbulime të tillë do të ishin të mjaftueshme për të mbushur një jetë të tërë. I lumtur do të ishte edhe ai, i cili do të kishte mundur të bënte qoftë edhe vetëm një zbulim të tillë.»³) Në qoftë se na lejohet ta perifrazojmë këtë shprehje të F. Engels-it, ne do të thoshim se vetëm themelimi i Partisë do t'i mjaftonte Enver Hoxhës të mbetej i pavdek-

1) Enver Hoxha, «Letra të zgjedhura», vëll. I, f. 187.

2) Enver Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin», f. 314-315.

3) Marks, Engels, «Vepra të zgjedhura», bot. shqip, 1985, f. 156

shëm. Dhe i lumtur do të ishte ai që do të kishte bërë një akt të tillë në historinë e një populli!

Në jetën tonë të përditshme tanimë ka hyrë përcaktimi i bukur përgjithësues i shokut Ramiz për Enver Hoxhën, «Arkitekt i Shqipërisë së Re». Ky përgjithësim është kuptimplotë, prandaj është përvetësuar shpejt nga populli dhe kalon gojë më gojë në të gjithë njerëzit. Shumë mjeshtër të shquar kanë punuar e krijuar për Shqipërinë, prandaj ajo është mbajtur gjallë e në këmbë përmes shekujve; kanë punuar që nga Skënderbeu e gjer tek Abdyli, Naimi, Samiu e Ismail Qemali. Por ajo nuk u ndërtua e re që nga themellet, siç është sot. Enver Hoxha, si ndjekës i zjarrtë i traditave më të mira kombëtare dhe botërore, do të mbështetej edhe në këta mjeshtër, të shquar të Shqipërisë. Dhe, si arkitekt i tipit të ri, në ballë të komunistëve dhe të popullit, iu përvesh luftës dhe punës për ta ndërtuar të re Shqipërinë, të re me njerëz të rinj. Kur ajo ishte nën thonjtë e fashizmit, shtypësve dhe tradhtarëve, ai mendoi i pari se ç'duhej të bënte populli për ta shpëtuar dhe rinuar. Dhe në ditët e nëntorit të 1941-së Ai themeloi Partinë. Me themelin e saj vetëtui shpresa. Nisi kthesa e madhe historike e shekullit të njëzetë. Energjitet e mëdha njerëzore të grumbulluara dhe të fermentuara në kazanin gjigant të shekujve u vunë në lëvizje të papërbajtur. Lufta për çlirim kombëtar u shkri me revolucionin popullor. Dhe këto dy forca titanike në atë kohë të vështirë mund t'i shkrinte vetëm Enver Hoxha. Ai nuk ishte udhëheqës dhe teoricien kabinetesh, as orator amfiteatrosht e sallonesh, por pjesëmarrës i drejtpërdrejtë i ngjarjeve dhe ndeshjeve shoqërore. Udhëhiqte në male dhe në qytete luf-tën për liri e socializëm, me pushkë në krah dhe penë në dorë. Mes fërshëllimës së plumbave e lidhë teorinë me praktikën, atje ua mësonte komunistëve dialektikën dhe marksi-zmin, atje ua mësonte edhe oratorinë. Me këtë stil drejtimi dhe udhëheqjeje ai bëri për vete një popull të tërë. Deviza e tij ishte: «Gju më gju me popullin». Me këtë devizë ai zbatoi Reformën Agrare dhe rindërtoi vendin, projektoi he-kurudhat dhe hidrocentralet, hapi shkollat dhe Universitetin, shtëpitë e kulturës dhe Akademinë e Shkencave, ndërtoi shtypshkronjat dhe bibliotekat, Kinostudion dhe Radiotelevizioni... Prandaj shoku Ramiz thotë: «Shoku Enver Hoxha është arkitekt i Shqipërisë së Re, organizator dhe udhëheqës i drejtpërdrejtë i gjithë atyre transformimeve revolucionare që janë bërë pas Çlirimt, frysëzues i gjithë atyre veprave mo-

numentale që ia kanë ndryshuar pamjet vendit tonë.»¹⁾

Në shtetin tonë të ri, që në themellet dhe organizmat më të vogla, është mendimi dhe djersa e Enver Hoxhës. Ai hartozi e përcaktoi vijën ekonomike të Partisë, sipas së cilës u zbatua industrializimi, kolektivizimi dhe modernizimi i bujqësisë, që i siguruan vendit pavarësinë dhe sovranitetin. Gati në vazhdën e një gjysmëshekulli të tërë ai forcoi çast më çast rolin udhëheqës të Partisë, e kaliti atë ideologjikisht, e fuqizozi organizativisht dhe ia brumosi unitetin, duke na e lënë të madhe dhe të pastër, të lidhur ngushtë me masat. Në krye të saj ai rriti një klasë punëtore të fortë me një ideologji të plotpushtetshme që udhëheq gjithë vendin. Me mësimet e tij u ndërtua një kulturë e re dhe një art i ri në Shqipëri, një kulturë dhe një art me frysë popullore dhe përmbytje të shëndoshë socialiste.

2

Edhe në kulturë, ashtu si në revolucionin dhe në ndërtimin socialist, Enver Hoxha ishte udhëheqës dhe pjesëmarrës aktiv, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në proceset e saj me mendimet konkrete, me veprat dhe librat e tij. Vetë librat e tij janë pjesë e rëndësishme e kulturës sonë dhe ndikojnë gjallërisht në zhvillimin e saj. Ata luajnë rol të ndjeshëm edhe në orientimin dhe përparimin e letërsisë dhe arteve. Shoku Enver i ka qëndruar ngahera pranë letërsisë dhe artit dhe ka treguar kujdes të veçantë në proceset e gjithë krijimtarisë. Një nga hallkat më kryesore nga u nis shoku Enver, hallkë që ishte vendimtare për zhvillimin e letërsisë marksiste, e quan njohjen-pasqyrim të botës objektive. Bazë e gjithë procesit të njohjes nga përftohen dituritë është praktika. Njeriu e njeh realitetin në procesin e veprimtarisë praktike. «Në qoftë se futim kriterin e praktikës në themelin e teorisë së njohjes, atëherë ne patjetër do të kemi materializëm²⁾ — thotë Lenini. Enver Hoxha këshillonte gjithmonë me forcë që çdo shkrimitar dhe artist duhet të njohë jetën

1) Ramiz Alia, «Enver Hoxha dhe vepra e tij rron e do të rojë përfjetë», f. 11, Tiranë, 1985.

2) V. I. Lenin, vell. 14, f. 127, bot. rus.

pëmës praktikës letrare e artistike. Pa këtë njohje nuk mund të ketë art të vërtetë, por fantazi të trilluar. Jetën e popullit ai e quante thesar të paçmuar për shkrimtarët dhe artistët. Për këtë porosiste: «Në popull ata duhet të gjejnë fryshtëzimin e krijimit, tingujt e këngës, ritmet e valles, pastërtinë e gjuhës, hovin e punës, shembullin e heroizmit e të sakrificës, virtytet e larta të thjeshtësisë dhe drejtësisë popullore etj. Shkolla u mëson shkrimtarëve, aktorëve, muzikantëve etj. shumë gjëra, por atë që u mëson atyre jeta dhe përpjekjet e popullit, ndjenjat dhe shprehitë e tij, talenti dhe zotësia krijuese e popullit nuk mund t'u mësojë asnjë profesor e regjisori. Jeta dhe lufta revolucionare e popullit dhe e Partisë, plot vrull e entuziazëm, janë autorët, mësuesit e regjisoret më të mirë që mund të bëhen!»¹⁾

Zbatimi në praktikën letrare e artistike i këtij mësimi u dha dhe u jep arteve tona freskinë dhe vitalitetin e vazhdueshëm. Ato u lidhën ngushtë me jetën e popullit dhe me problemet e tij në ndërtimin e socializmit. Ky mësim jo vetëm i pasuroi letërsinë dhe artet me përbajtje të shëndoshë dhe u rriti origjinalitetin kombëtar, por edhe edukoi shkrimtarë dhe artistë të tipit të ri, edukoi ndjenjën e dashurisë për njerëzit, shtoi etjen dhe dëshirën për të qenë pranë popullit dhe për të jetuar me modesti si populli vetë. Nuk krijuan shkrimtarët e artistët tanë një shtresë së privilegjuarish, një élite të shkëputur nga populli, disa «yje», siç ndodhi në vendet ku sundon revizionizmi. Për këtë shoku Enver thotë: «Unë, për artistët dhe autorët, sado të talentuar që të jenë, nuk do të përdor kurrë termin borgjez se ata janë «yje», jo. Ata s'mund të jenë «yje» përpëra talentit, zotësisë krijuese të popullit tonë. Prandaj këta «yje», në qoftë se humbasin lidhjet me tokën, humbasin çdo shkëlqim.»²⁾ Prandaj ngulimi i Enver Hoxhës për njohjen e jetës ka rëndësi të dyfishtë: në zhvillimin e drejtpërdrejtë të letërsisë dhe arteve dhe në formimin botëkuqtimor dhe moral të vetë shkrimtarit dhe artistit. Problemin e njohjes së jetës, siç thashë pak më lart, ai e shtriu në gjithë komunistët dhe kuadrot me moton përgjithësuesë: «Gju më gju me popullin». Por këtë njohje Enver Hoxha nuk e kufizon vetëm në ndjekjen nga afërtë proceseve aktuale të zhvillimit të jetës së shoqërisë. Me njohje ai nënkupton edhe përvetësimin e traditave më të vyera të popullit, të kulturës, të letërsisë dhe arteve të së ka-

1) Enver Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin», f. 254.

2) Po aty, f. 222.

luarës historike. Traditën ai e vështronte dialektikisht si një dukuri të gjallë, që jeton e lidhur ngsushtë me të sotmen dhe që ka forcë vepruese. I nisur nga kjo, shoku Enver nënvizon: «Letërsia, arti, kultura jonë socialiste nuk kanë lindur në një vend të zbrazët, por mbi bazën e zhvillimit të gjatë historik të shoqërisë sonë, të jetës së saj shpirtërore, të traditave të shquara e më të mira kulturore-artistike të popullit tonë. Mbështetja në këto tradita të kultivuara e popullore të së kaluarës dhe të kohës sonë, është një çështje me rëndësi të madhe, pa të cilën nuk mund të bëhet fjalë për krijimin e vlerave letrare artistike, për krijimin e origjinalitetit të kulturës, të artit dhe të letërsisë shqiptare, për respektimin dhe zbatimin në jetë të parimit marksist-leninist që arti dhe kultura jonë të jenë socialiste nga përmbajtja dhe kombëtare nga forma.»¹⁾

Shoku Enver, duke u bazuar në teorinë marksiste në vlerësimin e traditës, si vazhdim dhe zhvillim i bazave ideo-re të artit të përparuar të së kaluarës, ka kritikuar dhe dënuar çdo tendencë nihiliste dhe çdo prirje të idealizmit të saj. Tendenca e parë mohon traditën dhe u hap rrugën rrymave dhe izmave moderniste dhe e dyta e ngurtëson dhe e frenon artin. Për këtë arsyе ai kritikoi ashpër mendimet avangardiste dhe moderniste të F. Paçramit, T. Lubonjës dhe ihtarëve të tyre. Ata qëllimi shkuputur nga problemet e ndërtimit socialist të huaj, të shkuputur nga problemet e ndërtimit socialist të vendit. Në të njëjtën kohë shoku Enver e trajtoi qartë edhe raportin e traditës me novatorizmin, duke ardhur në përfundim se të dyja këto nocione pasqyrojnë një proces të vetëm dialektik: çdo epokë, çdo shoqëri dhe çdo klasë krijon artin e saj të ri. «Është gabim, — thotë shoku Enver, — të kuptohet novatorizmi si luftë kundër traditës. Marksistë-leninistët mbajnë ndaj traditës një qëndrim dialektik. Ne çmojmë, ruajmë dhe zhvillojmë nga arti dhe letërsia e së kaluarës gjithçka është e mirë, është e afërt me idealet dhe me aspiratat e punonjësve dhe u shërbën atyre. Nga trashëgimia artistike e letrare ne vëçojmë pozitiven, progresisten, nga ato negative.»²⁾ Dhe këtë mendim e zhvillon më tej: «Ne jemi si kundër mohimit të thjeshtë, jodialektik të traditës, ashtu edhe kundër hyjnizimit dhe gjunjëzimit përrapa saj. Mohimi të shpie në qëndrime metafizike, nihiliste.

1) Enver Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin», f. 257-258.

2) Enver Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin», f. 288.

Në pozitat e mohimit të plotë të traditës ndodhen sot modernistët, të cilët janë armëmbajtësit kryesorë të borgjezisë në art dhe në letërsi. Hyjnizimi i traditës gjithashu është i dëmshëm, ai çon në konservatorizëm dhe në shkëputje nga realiteti¹⁾

Trajtimi i problemit të raportit ndërmjet traditës dhe novatorizmit dhe bashkë me këtë edhe ai i heroit të letërsisë hodhën dritë në përgjithësi në metodën e realizmit socialist dhe në evoluimin e saj. Novatorizmi nga shoku Enver u analizua si dukuri që pasuron krijimtarinë artistike me ide të përparuara, me tema dhe heronj të rinj, me mënyra dhe mjete shprehëse të një cilësie të lartë. Epoka e socializmit që bart në thelbin e saj novatorizmin, ngre para artit probleme të reja dhe detyra të reja, që zgjidhen përmes heroit të ri të kohës, në figurën e të cilit mishërohet ideal i ri estetik. Kështu që shfaqja në letërsi dhe arte e heroit të ri është një nga shprehjet kryesore të novatorizmit. Ai është bartës i ideve socialist, i ideve të revolucionit. Vetë pasqyrimi i këtij lloji të heroit, të panjohur më parë, vetë konfliktet e reja në shoqërinë e re, kërkojnë edhe rigjallërimin dhe revolucionarizmin e mënyrës së të krijuarit dhe të mjetave shprehëse. Domethënë novatorizmi i përbajtjes jetësore kërkon edhe novatorizmin e formës së artit.

Zhvillimin e letërsisë dhe të arteve shoku Enver e ndiqte me vëmendje të madhe, e ndiqte si udhëheqës, si historian, si shkencëtar dhe si teoricien. Në të njëjtën kohë e ndiqte edhe si shkrimitar, pasi e ndjente thellë artin dhe ishte vetë stilist i madh. Duke ndjekur hap pas hapi proceset letrare e artistike, ai dallonte tendencat e së ardhmes dhe nuancat më të padukshme. Atëherë me pasion dhe me forcë i përkrahte dhe nxiste këto tendencia që të zhvilloheshin më tej. Me këtë vështrim e shihte edhe metodën e realizmit socialist. Këtë metodë ai e merrte në evoluim të përhershëm dhe jo si një dogmë statike. Kështu, një nga kolonat më të rëndësishme të metodës, që është heroi i veprës, shoku Enver e vështronë në kompleks, si në jetën reale. Për heroin shoku Enver mendonte që nuk duhet idealizuar, ai është njeri dhe si i tillë është e domosdoshme të pasqyrohet. Në qoftë se idealizohet, ai shkëputet nga masa dhe rrjedhimisht shkëputet nga realiteti. Ky vështrim hidhte dritë në evoluimin e metodës së realizmit socialist, e cila në fillimet e saj heroin

1) Enver Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin», f. 288.

ndonjéherë e trajton disi të zbuluar, me romantizëm të theksuar. Në evoluim e vështron te edhe karakterin kombëtar, që është një nga aspektet me rëndësi të metodës. Për shokun Enver, si teoricien dhe marksist i madh, karakteri kombëtar nuk është një kategori estetike dhe historike e ngurtë dhe statike; ai zhvillohet vazhdimi. Këtë zhvillim ia jep përmbytja socialiste. «Kur flitet për realizmin socialist, — nënvizon shoku Enver, — kjo çështje nuk duhet kuptuar si një formulë e thatë që përsëritet tej e tëhu, mbi të cilën thuren teorira dhe shumë herë nxirren formula akademike. Realizmi socialist është pasqyrimi me besnikëri i jetës socialiste që po ndërtojmë në të gjitha aspektet e saj, i transformimeve kolosale materiale dhe me temp revolucionar që pëson vendi ynë, shoqëria jonë, njerëzit tanë në bazë të teorisë marksiste-leniniste dhe në bazë të masave e vendimeve të përpunuara nga Partia jonë. Por ky realizëm socialist nuk paraqitet aspak në forma statike, të ngurta; ai zien, është në zhvillim të përhershëm e të vazhdueshëm, nëpërmjet një lufte të kundërtave, nëpërmjet një lufte klase, nëpërmjet luftës së resë kundër të vjetrës.»¹⁾

Në Kongresin e 8 të Partisë shoku Enver u kthehet përsëri raportit të karakterit kombëtar dhe frymës socialiste në art. Ai thket se fryma socialiste i jep tipare të reja edhe karakterit kombëtar. Të gjitha këto e të tjera kanë të bëjnë me evoluimin e metodës së realizmit socialist. Prandaj ato kërkojnë studime serioze për t'u zbërtyer konkretisht, duke ndjekur zhvillimin e letërsisë dhe arteve tona.

3

Para Kongresit të 7 të Partisë, ndërmjet punëve të parnumërtë, shoku Enver shkruante edhe kujtime për fëmijërinë e tij dhe duke shkruar i vinin në mend shokët dhe njerëzit e thjeshtë të popullit. Për këtë shënon në librin e tij «Vite të vegjëlësë»: «Pse po më kujtohen kështu këto gjëra të popullit sot? Pse tash që po përgatitim Kongresin e 7-të të Partisë dhe na zien koka, unë gjej kohë të shkruaj edhe këto gjëra?». Dhe më tej vazhdon:

1) Enver Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin», f. 292-293.

«Unë i shkruaj po ashtu këto gjëra, pse nga këta njërz, nga ky popull, nga këto vuajtje, sakrifica dhe he-roizma doli Partia dhe luftoi. Ne jemi bijtë dhe bijat e këtij populli, që nuk mund ta ndajmë të kaluarën nga e tashmja, pse nga ky unitet do të ndërtohet e ardhmja e ndritur, komunizmi.» Në këto radhë shprehet pasioni dhe qëllimi fisnik dhe i madh i krijimtarisë së shokut Enver, i veprave dhe i librave të shkruar prej tij. Tek ai mishërohen vetitë e udhëheqësit dhe krijuesit. Udhëheqës dhe krijues në të vetmin shërbim, në shërbimin e popullit; edhe drejtonte, edhe krijonte. Mendja e tij e ndritur punonte në të gjitha anët. Dhe të gjitha anët mblidheshin dhe bashkoheshin në një: pér popullin e vet, se ishte bir dhe mësues njëkohësisht. Pér të sotmen dhe të ardhmen e popullit shkroi dhjetëra mijëra faqe. Në këto faqe gjëmon hapi i historisë së Shqipërisë, i luftërave, përpjekjeve, punëve, ndeshjeve dhe revolucioneve. Në to ziejnë problemet e gjithë fushave të veprimitarës njerëzore në Shqipëri dhe jashtë saj. Dhe janë veprame pasuri të madhe përmbajtjeje dhe forme. Vepra teorike e historike, oratorike e publicistike, debate e diskutime, shënimë e memuare. Ato përfshijnë të gjitha problemet e gjysmës së shekullit të njëzetë; idetë e tyre hidhen në shekujt e kaluar dhe kapércejnë kufijtë e shekullit të njëzetë; janë pér brezat e sotëm dhe pér ata që do të vijnë. Atje gjejnë shqetësimet e tyre punëtori e fshatari, inxhinieri e agronomi, shkencëtarë e shkrimtarë, pionieri dhe i riu, gruaja dhe veterani, komunisti dhe drejtuesi. Në çdo etapë të zhvillimit të luftës, të revolucionit dhe ndërtimit socialist të vendit shoku Enver ka kapur problemet më të mprehta të kohës, zgjidhja e të cilave shpejtonte rrjedhën e ngjarjeve. Le të marrim fushën e letërsisë dhe arteve. Më 1949, kur ende kishte pak shkrimtarë, ai ngrinte me forcë problemin e shtimit të radhëve të tyre përmes letrarëve të rinj. «Vëmendja kryesore, — thoshte Ai, — nuk duhet përqendruar në 6-7 shkrimtarë të njoħjur, që dallohen me shkrimet e tyre, po në problemin e madh të ngritjes së literaturës sonë të re përparimtare, si dhe në përkrahjen e talenteve tona të reja.»¹⁾ Dhe lidhur ngushtë me këtë çështje trajtonte po në atë vit edhe problemin e atyre shkrimtarëve më të vjetër që nuk kishin marrë pjesë në Luftën Nacionalçlirimtare ose që

1) Enver Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin», f. 29.

nuk kanë pasur pikëpamje socialiste e komuniste. Me ata duhej bërë një politikë e matur për t'i mbajtur pranë. Prandaj i këshillonte drejtuesit e atëhershëm të Lidhjes së Shkrimtarëve: «Një politikë e tillë duhet bërë nga ana juaj me shkrimtarët e vjetër pa parti, ndryshe këta pa u afruar me ju, pa marrë pjesë në diskusionet tuaja, pa njojur pikëpamjet tuaja etj., nuk ka si të orientohen drejt dhe të aktivizohen.»¹⁾ Disa vjet më vonë, më 1955, kur forcat e reja letrare po shtoheshin, por hasin pengesa në botimin e librave të tyre, pasi nuk gjykoreshin objektivisht, ngaqë redaktorët ishin mësuar me një lloj mënyre të të shkruarit, shoku Enver në Plenumin e 13 të atij viti këshillon: «Shkrimtarët e afirmuar e kanë për detyrë t'i ndimojnë shkrimtarët e rinj, por ata nuk kanë asnje të drejtë që kjo ose ajo vepër të mos shtypet. Ndërmarrja e botimeve le të batojë veprën e një shkrimtari. Më vonë, po të ketë ndonjë kritikë nga Partia ose nga Lidhja e Shkrimtarëve, le t'ia bëjnë veprës. Në raste se do të veprohet si deri tanë, do të jetë një frenim për zhvillimin e letërsisë dhe të talenteve të reja.»²⁾ Këto mendime ruajnë ngjyrën e kohës dhe problemet e saj, por njëkohësisht në momente të caktuara bëhen aktuale. Për shembull, sikur sot të kërkojmë nga librat përsosmëri të pastër dhe të mos u batojmë të rinjve, do ta frenonim letërsinë.

Për ta plotësuar mendimin se shoku Enver gjithmonë u ka prirë dukurive që do të nxirrte koha në arte, le të marrim fillimin e viteve 60. Në këto vite doli një plejadë e re poetësh, piktorësh e kompozitorësh, që do ta ngrinte letërsinë dhe artin në një stad të ri. Dalja e kësaj plejade pati edhe reaksion, si gjithmonë kur lind një kërcell i ri. Atëherë shoku Enver ndérhyri përnjëherësh me mendimet e tij dialektike. Në mbledhjen me shkrimtarët dhe artistët në korrik të 1961-së, ndër të tjera, ai tha: «... Si komunist dua me gjithë shpirt të shoh se si rinia ecën përpëra, krijon vepra të bukura për popullin, për atë popull që ajo e do me aq zjarr, patriotizëm dhe shpirt djaloshar, që nuk do të plaket kurrë.»³⁾ Por në të njëjtën kohë ai kishte vënë re se në arenën e artit po lindte një prirje që nuk shkonte, që po të lihej të trashej, do të sillte dëme të madhe. Kishte filluar të nxirrte kokën problemi «të rinj» dhe të «vjetër». Shoku

1) Po aty, f. 31.

2) Po aty, f. 75.

3) Enver Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin», f. 137.

Enver më taktin dhe urtësinë e tij të rrallë po në atë mble-dhje u shpreh: «Kur dëgjova diskutimet e disa shokëve, të them të drejtën, veç për një gjë nuk më erdhi mirë, që doli sikur çështja shtrohet «të rinj» dhe «të vjetër». Në fakt, disa nga ju janë të rinj, disa të tjerë janë të kaluar nga mosha, por unë mendoj se te ne nuk është problem çështja «të rinj» dhe «të vjetër».»¹⁾

Ecja përpara e socializmit, revolucionarizimi i mëtejshëm i jetës, përhapja e nismave të mëdha të punonjësve, irritja e klasës punëtore, lufta kundër paragjykimeve fetare, kundër konservatorizmit dhe liberalizmit, kundër burokratizmit dhe teknokratizmit nxirrin probleme të reja në sferën e letërsisë dhe arteve. Koha kërkonte që të pasqyrohej më gjerë jeta e klasës punëtore, lufta dhe puna e saj, mendimi dhe ndërgjegjja e heroit të ri. Në atë periudhë, shoku Enver orientoi për pasqyrimin e jetës me tërë madhështinë dhe kontradiktitë e saj. Kështu, në Kongresin e 6 të Partisë më 1971 ai shtroi detyrën: «Pasqyrimi i realitetit të ri socialist në zhvillimin e tij revolucionar dhe me kontradiktat e kohës, që i japin letërsisë dhe artit dramaticitetin dhe konfliktet e nevojshme — këtu qëndron përbajtja e re që i jep forcën letërsisë e artit tonë të realizmit socialist. Dhe një përbajtje e tillë patjetër çon edhe në kërkime e në gjetje formash të reja.»²⁾

Duke trajtuar problemet kardinale të letërsisë dhe arteve, shoku Enver nxiste edhe gjinitë dhe llojet e tyre të portsalindura, siç ishin opera, baleti, filmi kinematografik dhe televiziv. Ai e ndiente që në këto lloje të arteve në fillim kishte edhe vepra që nuk ishin të përsosura, por nxiste, duke e thënë fjalën e mirë, se kishte besim në të ardhmen. Në fjalimet, diskutimet e librat e tij përmendte emra shkrimtarësh dhe artistësh, i entuziazmuar nga krijimtaria e tyre. Në faqet e veprës së tij do të gjesh dhjetëra emra krijuarish që sot janë në pararojë të arteve tona. Ndofta shoku Enver ka përmendur më shumë emra sesa përmendim ne vetë që merremi drejtpërdrejt me letërsinë dhe artet. Zemra e Enver Hoxhës ishte e madhe dhe kishte vend për të gjithë.

Etapë pas etape, me zhvillimin e shoqërisë, dilnin probleme të reja edhe për letërsinë dhe artin. Këto probleme shoku Enver i kapte në kohë dhe i shtronte për t'i zgjidhur para shkrimtarëve dhe artistëve. Ato ishin të shumta, delikate

1) Po, aty, f. 137.

2) Enver Hoxha. «Mbi letërsinë dhe artin», f. 321.

dhe të vështira, por forca e fjalës së tij ishte e plotpushtueshme. Ajo e bënte efektin e saj dhe ngrinte peshë zemrat e krijuesve me forcën e logjikës dhe të emocionit, pasi dilte nga një terren konkret dhe nga probleme reale. Por në të njëjtën kohë ajo ka bukuri të rrallë, ka mendim të thellë dhe ngjyrë të pasur. Stili i saj është sintetik dhe analistik. Shoku Enver në veprën e tij analizon e sintetizon, duke arritur në konkluzione dhe në përgjithësimë të gjera përmes një fjale të kulluar, të qartë dhe të zjarrtë. Veprat e tij pas-qyrojnë vetvetiu edhe figurën poliedrike të autorit, të njeriut me një kulturë të madhe kombëtare dhe botërore. Ato pas-qyrojnë atë që thotë shoku Ramiz: «Rrallë mund të jetë bashkuar te një njeri mendimtari marksist dhe udhëheqësi i revolucionit, Komandanti Ushtarak dhe burri i shtetit, diplomat i dhe publicisti, intelektuali erudit dhe edukatori i masave, oratori fjalëzjarrtë dhe miku i njerëzve të thjeshtë.»

Ne gjithmonë do të ulim ballin mbi veprën e Enver Hoxhës dhe nga shkronjat e saj do të vetëtijë pérherë histori. Me këtë vepër vazhdimi shi do të brumosim botëkuptimin marksist, do të pasurojmë dijet dhe kulturën tonë dhe do të edukohemi me idealet komuniste. Ajo ngaherë do të mbetet vatile dhe aktive dhe do të na hedhë në veprime konkrete revolucionare. Para saj do të heqin kapelën të gjithë brezat që do të vijnë.

1985

HISTORIA E GJALLË DHE E PAPËRSËRITSHME

(*Për librin «Kur lindi Partia»*
të shokut Enver Hoxha)

Vepra shumëvëllimshe e shokut Enver, e krijuar në një hapësirë të gjerë kohe, është e pasur dhe poliedrike. Në fakt e saj gjëmojnë ngjarjet më të mëdha të gjysmës së parë të shekullit të njëzetë dhe ato të gjysmës së dytë, që kanë luajtur rol vendimtar në jetën e popullit tonë dhe popujve të tjerë dhe që kanë një ngarkesë të fuqishme epiko-dramatike. Kjo vepër shumëvëllimshe është historike e teorike, studimore e publicistike, memoriale e letrare. E krijuar gjatë një periudhe më se dyzetvjeçare, ajo pasqyron jo vetëm rrjedhën e kohës së jetuar nga autori, por edhe themelisë e shekujve të historisë së vendit. Përmes kësaj vepre të gjithashme ne kuptojmë thelbin e revolucionit tonë socialist, rrugën dhe perspektivën e tij; mësojmë jetën e shoqërisë sonë bashkëkohore dhe të hershme, luftën dhe paqen dhe, mbi të gjitha historinë e Partisë. E gjithë vepra e shokut Enver tanimë është bërë pjesë e pandarë e kulturës sonë. Seria me vëllime, e pasuruar me libra të veçantë teoriko-filozofikë dhe historiko-memorialë, si: «Imperializmi dhe revolucioni», «Eurokomunizmi është antikomunizëm», «Vetadministrimi jugosllav-teori dhe praktikë kapitaliste», «Shënimë për Kinën», «Me Stalinin» etj. të vënë në mendime për atë veprimitari të një potencë të madhe intelektuale,

të një metode krijuese rreptësish sistematike dhe të një njoheje të pashembullt të historisë, filozofisë dhe kulturës kombëtare dhe botërore. Në fordin e kësaj vepre poliedrike vend të veçantë zë libri me kujtime «Kur lindi Partia», libër me një origjinalitet të theksuar në përbajtje dhe në formë, në strukturë dhe në gjuhë, në gërshtim të ngjajrave dhe në kolorit të fjalës, që lexohet nga çdo njeri me një frymë duke tē ngjallur mendime të mëdha, emocione, dashuri dhe krenari për vendin, popullin, Partinë dhe komunizmin. I gjithë libri u kushtohet përpjekjeve të komunistëve shqiptarë për krijimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, kurorëzimit të këtyre përpjekjeve më 8 Nëntor 1941 dhe ngjarjeve kryesore të jetës dhe veprimtarisë së PKSH gjatë viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçirimitare, u kushtohet njerëzve të thjeshtë të popullit me botën e tyre të madhe shpirtërore. Ndaj këtij libri të pasur me ngjarje, fakte, mendime e konkluzione, të shprehura me një gjuhë të begatë e të fuqishme, për asnjë çast nuk mund të qëndrosh indiferent; ai të rrëmbej dhe ti, qofsh intelektual i lartë a akademik, qofsh punëtor i thjeshtë a bujk, jeton bashkë me autorin vitet e zjarrta të fillimit të epokës më të ndritur të historisë së vendit tенд.

Cila është arsyja që libri «Kur lindi Partia» të rrëmbej dhe ti nuk ndahesh dot prej tij? Këtë pyetje nuk e bën vetëm ai që ka shkruar libra dhe që ka një përvojë krijuese, por e bën edhe një lexues i zakonshëm, që ka lexuar edhe letërsi politike, edhe letërsi artistike. Mendoj se një forcë e padukshme, që nuk të lë ta lëshosh librin nga dora, e ka burimin pa dyshim në materialin e pasur historik e jetësor, që zbulohet gradualisht herë nga ngjarja më e vogël gjer te më e madhja dhe herë nga ideja përgjithësuese gjer te zbërthimi dhe konkretizimi i saj. Por nuk është vetëm kjo. Materiali historik e jetësor gatuhet me mjeshtëri artistike përmes fjalës me ngjyrë që transmeton mendime të thella, që u jep jetë dhe dinamikë. Kjo fjalë tē vërtetën historike e jetësore nuk e lë të flerë, as nuk e bën të dalë e përgjumur, por e nxjerr në relief dhe i jep lëvizje. Atëherë ne e kuptojmë gjithë idenë e gjithë mendimin dhe nuk humbim në shkurret e frazizmit, siç na ndodh kur lexojmë në ndonjë shkrim nëpër gazeta që nuk marrim vesh se për çfarë bëhet fjalë.

Të marrim pasqyrimin e përpjekjeve dhe luftën për bashkimin e grupeve komuniste dhe themelimin e Partisë, që

në libër zë vendin kryesor. Për bashkimin e grupeve dhe për themelimin e Partisë kemi lexuar shumë, kemi lexuar histori, kumtesa, artikuj e kujtime të pjesshme. Nga këto kemi formuar një ide, kemi njojur pikëpamjet e tyre etj. Megjithatë një tablo të plotë, të gjallë e në lëvizje që të na duket sikur është vështrojmë me sy, sikur jemi edhe vetë pjesëmarrës në këtë luftë e në këto përpjekje, nuk e kemi parë dhe nuk e kemi ndier. Ndërsa në librin «Kur lindi Partia» ne i ndiejmë debatet e këtyre grupeve, kuuptojmë ndryshimet e pikëpamjeve dhe pikat e takimit. Ndjekim veprimtarinë e Degës së Tiranës, të Grupit Komunist të Korgjës, që nën drejtimin e shokut Enver, luajti një rol vendimtar për t'i bindur komunistët e grupeve të tjera që të sheshonin mosmarrëveshjet dhe të bashkoheshin në një Parti të vetme, siç ndodhi më 8 Nëntor 1941.

Në mes të faqeve të librit e kuuptojmë se me pushtimin fašist të 7 prillit 1939 u krijua një situatë e tillë revolucionare, e cila kërkonte një udhëheqje të vërtetë, të zonjën për t'i ngritur masat e gjera punonjëse në luftë për Çlirimin e vendit.

Për t'ia arritur këtij qëllimi, shoku Enver punoi me ditë e me net. Me një emocion të thellë përshkruhen takimet me Vasil Shanton, Qemal Stafën, Branko Kadinë të Grupit Komunist të Shkodrës, për të realizuar bashkimin. Për një nga këto takime shoku Enver shkruan: «Një të diel, tek po shëtitja në një rrugë të Tiranës, një djalë me bicikletë u ndal në krahun tim, zbriti, më dha dorën, e duke më përshtendetur me emër, më tha:

- Jam Vasil Shantoja.
- Të njoh, — iu përgjigja.
- Bëjmë një copë rrugë tok dhe shkëmbejmë disa fjalë? — më propozoi Vasili.
- S'kam kundërshtim, — i thashë, — po ç'keni për të më thënë?

Vasil Shantoja, duke më vështruar me ata sytë eëmbëlëndërrimtarë, më tha:

— Shoku Enver, kështu do të vazhdojmë ne, të zihemi e të grindemi? Ne as të takohemi me njëri-tjetrin nuk guxojmë!»

Dhe më poshtë, kur përshkruan takimin e dytë me Vasil Shanton në shtëpinë e Spiro Lazrit e të Bojkës, shoku Enver kujton: «Si komunist, si intelektual kisha lexuar

mjaft dhe nga ato që kisha mësuar më erdhi ndër mend një shprehje e një psikologu francez: «Sytë janë pasqyrë e ndjenjave të brendshme». Instinktivisht i thashë vetes: «Enver, Vasil Shantonja, është njeri i mirë, ai është proletar, është komunist. S'ka si të jetë ndryshe. Ne themi se këta bëjnë gabime, po ne, vallë nuk bëjmë? Duhet ta gjykojmë njëri-tjetrin dhe secili vetveten.»

I rashë me pëllëmbë në gju Vasilit gjithë dashamirësi dhe i thashë:

— Duhet medoemos të merremi vesh.»

Në këto dy episode del ideja e përpjekjeve për bashkim përmes një përshkrimi thellësisht të ndjerë. Pas përshkrimit të episodit kemi një meditim psikologjik për Vasil Shanton. Ndërsa pak më parë jepet me kolorit të gjallë gjendja shpirtërore e heroit: «... Kështu do të vazhdojmë ne, të zihemi e të grindemi? Ne as të takohemi me njëri-tjetrin nuk guxojmë!»

Është një veçori e stilit të shokut Enver në kujtime, të cilin e ndiejmë edhe në librin «Me Stalinin», që pasi jep një ide përgjithësuese, e zbërthen në një episod, pastaj jep një përfundim. Në rastin me Vasil Shanton ai, përmes dialogut, shprehet: «Atëherë, — shtova unë, — ne duhet të bashkohemi se komunistët nuk mund të luftojnë të përqarë.» Dhe përmes kësaj forme, mendimin e ngre në një shkallë më të lartë: «Duhet të luftojmë të formojmë edhe ne Partinë tonë Komuniste.» Pastaj përsëri këtë mendim ia kundërvë gjendjes reale të grupeve: «Në këto kushte kur ne e quajmë Grupin tonë të Korçës «parti», ju të Shkodrës, thoni «jemi ne partia» nga ana tjetër Andrea Zisi deklaron se «vulën e Kominternit» e ka ai etj., nuk mund të arrijmë asgjë.»

Me pak radhë, duke lënë vetëm fjalët e domosdoshme, mendimi del në relief e nuk fundoset, del i gjallë, i plotë dhe veprues në ndërgjegjen e lexuesit. Fjalët: «parti», «partia» (me shkronjë të vogël) e «vula e Kominternit» jaspin gjendjen e grupeve dhe njëkohësisht zemërimin ndaj kësaj gjendjeje.

Koloriti i fjalës në libër rritet edhe nëpërmjet përshkrimit të portreteve me karaktere e pikëpamje të kundërtë. Ndërsa Vasil Shanton, p.sh., e përshkruan me «sytë e ëmbël e ëndërrimtarë», Anastas Lulën e portretizon: «Anastas

Lula, të cilin nuk e njihja për fytyrë, po shëtiste përballë nesh, kur atë çast Koçoja më tha:

— Mos e lëviz kokën, se njëri nga ata të dy që po vijnë, ai zeshkani i shëmtuar me syze është Anastas Lula, po mos e shiko.

Unë ia qepa sytë Anastasit, i cili m'u duk me të vërtetë njeri i ndyrë edhe në të parë.»

Por edhe portretizimin shoku Enver e bën shkallë-shkallë. Kur e njeh mirë Anastas Lulën, atëherë ia përshkruan të plotë figurën e jashtme: «Anastasi ishte një katran nga fytyra, me koqka të zeza, sikur lëkurën t'ia kishte përcelluar baruti.»

Faqet më të fuqishme të librit të ri të shokut Enver janë ato që pasqyrojnë debatet e ndezura në ditët e netët, kur po lindte Partia, 8-14 Nëntor 1941. Përmes këtyre fakteve ngrihen figurat e shquara të shokëve Enver Hoxha, Qemal Stafa, Vasil Shantoja e të tjera, pasqyrohet lufta e madhe dhe konsekiente e atyre që hodhën poshtë pikëpamjet disfatiste e likuidatore të A. Lulës e S. Premtes dhe dhanë një kontribut të shquar në triumfin e ideve marksiste-leniniste për krijimin e Partisë, për pajisjen e saj me një vijë të drejtë, me një program të vërtetë revolucionar.

Autori e jep të plotë atmosferën e atyre ditëve dhe neteve epike, shqetësimet, emocionet, gjëzimin dhe optimizmin komunist. Ai zbulon me mjeshtëri të rrallë karakteret e njërzve realë, gjendjen psikologjike dhe botën e tyre shpirtërore. Arsyetimet, logjika e fortë e fakteve, qëndrimet emocionale të autorit dhe gjuha e mprehtë e polemikës, në seancat e mbledhjes, gërshtetohen në unitet me episodet në pushimet brenda dhe jashtë Shtëpisë historike ku u formua Partia. Shoku Enver shkruan: «Kështu, natën e 8 Nëntorit 1941, lindi Partia jonë, që do ta udhëhiqte popullin shqiptar në betejat më të mëdha të të gjithë historisë së tij. Ajo lindi nga gjiri i popullit, nga zjarri dhe nga dufi i tij revolucionar, i pashuar në shekuj, lindi si një diell i ndritshëm në errësirën e kobshme të skllavërisë dhe të terrorit fashist, që kishte mbuluar popullin dhe atdheun.»

Në libër shtjellohen ngjarjet e mëdha njëra pas tjetrës, duke rrjedhur pa vështirësi nga faqja në faqe e nga kapitulli në kapitull. Kjo lehtësi e të lexuarit të bën të mendosh sikur libri është shkruar brenda një dite. Por dihet një gjë nga përvaja e përgjithshme e krijimtarisë se, sa më shumë mund e djersë të derdhësh në një libër,

aq më lehtë lexohet. Kështu, kapërcimi nga një temë në tjetrën ka një natyrshmëri të habitshme. Kur kalojmë nga themelimi i Partisë dhe hidhemi në krijimin e Rinisë Komuniste, filli që lidh këto dy evenimente pothuajse nuk ndihet, pasi gjithë materiali është në një unitet gatimi. Përshkrimi i atmosferës së një ngjarjeje, dhënia e konsideratave politike në libër shpesh gërshtohet me vizatimin e portreteve të figurave historike që luajnë rol në arenën e ngjarjes. Këto vizatime janë shumë shprehëse, me detaje, nga më të imëtat dhe njëkohësisht të kursyera, me qëndrime dhe gjykime realiste dhe objektive. Ky objektivitet nuk është i thatë, por me ngarkesë emocionale. Me një realizëm të thellë dhe në të njëjtën kohë me plot emocion autor i përshkruan portretin e Qemalit, Misto Mamës e të tjerëve. Vecanërisht, i fuqishëm është momenti i lajmit të vrasjes së Qemal Stafës. Dua të citoj një pjesë: «Si mund të mendoja unë se e putha dhe e shtrëngova për herë të fundit në kraharorin tim shokun, nga më të mirët e Partisë, shokun dhe bashkëluftëtarin tim të dashur, Qemal Stafën?!

Në bazën ku isha, erdhi një shok dhe, duke qarë, më tha:

— Armiku na vrau Qemal Stafën!

Vura duart në kokë dhe nuk i mbajta dot lotët.»

Një nga veçoritë më të theksuara të librit me kujtime «Kur lindi Partia» është pasqyrimi i temës madhore me një stil të zhdërvjellët e të bukur, me anën e të cilit njeriu hyn në kohën dhe ngjarjen pa mundim dhe vështirësi, siç mund të hyjë në një vepër të madhe letrare epike me personazhe dhe heronj, me subjekt dhe konflikte. Dhe duke hyrë në kohën dhe në ngjarjen pajisesh me dituri e njo-huri që nuk mund t'i harrosh, pasurohesh jo vetëm ideo-logjikisht, por edhe estetikisht dhe, siç thotë Maksim Gorki, libri të hap një dritare në jetë dhe ti e ndjen veten më të gëzuar e më të lumtur, ecën në rrugë me një ngazëllim në zemër.

Ne kalojmë nëpër evenimente të tilla si Konsulta e Parë e Aktivit të PKSH, prill 1942; Konferenca e Jashtëzakonshme e Partisë, qershor 1942; Konferenca e Parë e Vendit e PKSH, mars 1943; ne hyjmë në ngjarje si ato për shkatërrimin e fraksionit, maj 1943, etj., dhe dalim me një pasurim më të madh njojurish për luftën e Partisë sonë, për çelnikosjen e unititetit të brendshëm të saj, për

lidhjet e fuqishme me masat, me punëtorët e fshatarët, me intelektualët e ndershëm e me patriotët. Libri me shtetëllimin e ngjarjeve, si në një simfoni, e rrit epicitetin e tij dhe vjen duke u bërë gjithmonë e më solid. Doemos pika kulminante e veprës është themelimi i Partisë. Por kjo pikë kulminante i shtyn ngjarjet drejt zgjidhjes po me atë tension veprimi. Pas pikës kulminante pasqyrohen ngjarjet që kanë të bëjnë me luftën e PKSH dhe Komitetit të saj Qendror, për zhdukjen e mbeturinave të trashëguara nga ish-grupet komuniste, si frysës sektare, lokalizmit, konspiracionit të sëmurë etj. Përmes kësaj lufte do të rritej e çelnikosej Partia dhe do të forconte lidhjet me masat. Nën shembullin e komunistëve, punëtorëve, lules së rinisë shqiptare, që përlesheshin me pushtuesit e tradhtarët, që përlesheshin në demonstrata dhe hidheshin mbi tanke, që torturoheshin nëpër qelitë e errëta e plot lagështi, por nuk epeshin, u zgjua, u frysëzua dhe u hodh në betejat çlirimtare një popull i tërë.

Ndër beteja Partia rritej e forcohej, fitonte përvojë dhe maturohej. Shoku Enver në kujtimet e tij e pasqyrin këtë ide nëpërmjet luftës për shpartallimin e fraksionit të Sadik Premtes në Vlorë. Me forcën e punës së tij ai jep një galeri të tërë trimash e patriotësh, jep heroin e tipit të ri që tanimë kishte lindur, komunistin, punëtorin, fshatarin, atdhetarin e flaktë. Hysni Kapoja menjëherë pas themelimit të Partisë, u bë shtylla e organizatës së re të Partisë Komuniste që po ndërtohej në Vlorë. «Ai, — shkruan shoku Enver, — mori pikërisht pseudonimin aq kuptim-plotë «Besniku», besnik i Partisë dhe i popullit deri në vdekje.»

Sic e përmenda, shoku Enver, në kujtimet e tij jep një galeri të tërë portretesh komunistësh e punëtorësh, fshatarësh e intelektualësh, nënash e baballarësh, të rinjsh e të rejash. Me këto portrete të vendosura në rrëthana dhe ambiente nga më të ndryshmet, në rrugë e në shtëpi, në çaste rrëziku dhe gjëzimi, ai e gërshton të vërtetën e përgjithshme politike e shoqërore me të vërtetën intime e miqësore. Kjo veçori e librit ia rrit shumë vlerat ideore, publicistike dhe letrare. Krahas portreteve të shokëve Miha Lako, Pillo Peristeri, Esat Dishnica, ne do të gjëjmë portrete të njerrëzve të thjeshtë popullorë, të Bije Vokshit e dhjetëra të tjerëve. Do të gjëjmë takimet e bukurë me Ali Kelmendin e Myslim Pezën, të përshkruara me ngjyra aq të gjalla

dhe me një vërtetësi të rrallë. Autori shkruan për Ali Kelmendin që e pat takuar në Gjirokastër që më 1936: «U prezantuam dhe u ulëm të tre. Qëndruam gjatë. Aliu ishte një burrë i qetë, fliste pak, ishte krejt i përqendruar në bisedë dhe shumë i matur.» dhe më poshtë: «... gjatë kohës që qëndroi në Gjirokastër Aliu s'di nga mësoi se në burgun e kalasë ishte i burgosur një shok i tij komunist, Mustafa Kaçaçi, i dënuar si pjesëmarrës në Lëvizjen e Fierit.

— S'di ç'do të jepja po të takohesha me të, — na thoshte ato ditë, dhe vriste mendjen për gjetjen e rrugëzgjidhjes. Dhe e gjeti vërtet. Jeta e gjatë nëpër burgje e internime e kishte bërë që të njihej edhe me lloj-lloj xhendarësh, me ndonjë prej të cilëve e kishte zgjatur bisedën, bile kishte krijuar edhe njëfarë miqësie.

Një ditë na tha me gjësim:

— Më duket do t'ia dal mbanë. Takova një të njojurin tim të vjetër, që më ka ruajtur në internim. Ka ardhur gardian në kala.

Dhe konspiratori i regjur Ali Kelmendi filloi të vizitonë shpesh e më shpesh kalanë e Gjirokastrës.»

F. Engels, duke folur për tendencën në letërsi, ka nën-vizuar se ajo duhet të jetë e shkrirë me gjithë materialin jetësor të një vepre dhe duhet të jetë e padukshme, e natyrshme, megjithëse mund të ndihet. Në përshkrimet që shoku Enver u bën individëve dhe personave të njojur, atyre që në atë kohë kanë luajtur një rol në arenën e ngjarjeve, çdo gjë duket e natyrshme, megjithëse autorri ka një tendencë të caktuar dhe tepër të përkufizuar. E megjithatë kjo nuk bërtet, nuk duket. Vjen natyrshëm si në rrjedhën e jetës së zakonshme. Të marrim një episod. Qëllimi i komunistëve ishte që të bënин për vete dhe t'i hidhni në luftën e përbashkët e të drejtë gjithë patriotët. Kjo ishte tendenca. Por këtyre patriotëve po t'u flisje në një mënyrë ex cathedra, atëherë nuk i bëje dot për vete. Kështu ishte në jetë Kështu, dhe aq më tepër, është në krijimtari. Tani të vijmë te takimi i shokut Enver me Myslym Pezën, i cili ka një rëndësi të madhe për zhvillimin e mëvonshëm të Luftës Nacionalçlirimtare. Ky takim përshkruhet i natyrshëm e njerëzor dhe këtu qëndron bukuria. Nëpërmjet mikut dhe shokut të tij, Esat Dishniciës, siç e përshkruan vetë, ai u njoh me Myslym Pezën. Autori shkruan: «Dy a tri herë, tok me Esatin e me Mysli-

min, kemi shkuar te kafja e Dem Xhepës, dhe sa herë që shkonim atje, kur uleshim, Myslimi krahët ia mbështeste murit që ta kishte portën karshi.

— Armikun, babë, — thoshte Myslimi, — duhet të shikosh përpara dhe mbaje ngreherur çarkun, zbraze i pari, se, po u lëkunde, ta kalli.»

Dhe pasi autor i tregon këtë ngjarje, lexuesi pret se si do të ecet më tej, ai bëhet kureshtar, ai bie në mendime, ai kërkon që veprimi të shkojë përpara. Atëherë ndërhyr autor i: «Kujtimet e mia pér patriotin e shquar Myslim Peza janë të shumta e të paharruara, sepse, që nga vera e 1939-ës e gjer më sot, ne na lidh një histori e tërë, historia e revolucionit tonë, që i kemi kushtuar gjithë jetën.» E shihni se si autor i kalon kufijtë e asaj kohe dhe hidhet gjer në të sotmen, pavarësisht se ngjarjet kanë të bëjnë me një ditë apo vit të caktuar? Por ai, duke u qëndruar besnik ngjarjeve të atyre viteve, nuk mund ta përqendrojë me imtësi vëmendjen në të sotmen, pasi atëherë kujtimet do të bëheshin si artikuj. Kurse ka mjaft autorë kujtimesh që vuajnë nga një thatësi detajesh, nga një banalizëm agjitativ dhe nga një trajtim aq i njojur i gjërave, sa të hipën mërzia kur i lexon, po të kesh durim t'i lexosh. Të shkojmë më tej në një episod të bukur që, po ta shkruante ndonjë memorialist skematik, do ta kishte katandisur në një agjitation të rëndomtë, duke vënë epitete të tillë si «trima syshtiponjë», «tër s'ua bënte syri» etj. Por shoku Enver ja si e përshkruan: «Mbaj mend se në një nga takimet tona, ndërsa ishim ulur e po bisedonim kokë më kokë, ia dhanë sirenat e alarmit. Hyri me shpejtësi Esati:

— Alarm ajror! — tha, — ç'do të bëjmë?

Vështrova Myslimin që qëndronte gjakftohë e i përqendruar, sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

— Si të dojë Baba, — i thashë Esatit. — Pér mua në daç rrimë, në daç ikim.

— Është gjithë kjo Tiranë, — tha Myslimi, — e kudreqi do na gjejë bumja në këtë copë vend!

— Meqë unë s'kam kokë tjetër, po iki, — na e ktheu Esati me shaka dhe na la vetëm që të vazhdonim. Unë, që e njihja mirë Esatin, e dija se ai s'qe nga ata që u trembezin fishkëllimave. Gjithë merakun e kishte pér ne.»

Le ta shtjellojmë mendimin pér këtë episod, që të trengjmë se me ç'mjeshtëri lidhen gjërat që duken të thjeshta,

gjërat e jetës së zakonshme të njeriut me ato të mëdhatë e sublimet.

«— Unë, or babë, — tha Myslimi, — komunist nuk jam, por komunizmin e dua.

— Ne komunistët, shoku Myslim, — i thashë, — jemi për luftë, për luftë me armë kundër fashizmit. A do të jesh edhe ti me ne?

— Oj, si nuk do të jem?! Pse erdha unë? Për të luftruar erdha, m'u përgjigj Myslim Peza. — Do të jem në ballë të luftës me ju komunistët dhe me të gjithë ata që duan të luftojnë për vatanin.»

Shoku Enver në librin e tij me kujtime, mes ngjarjeve dhe njerëzve që përshkruan, nuk lë mënjanë figurat e luftëtarëve internacionalistë siç është ajo e Miladin Popoviçit, për të cilin flet me dashuri e simpati, si për një revolucionar të vërtetë. Në pjesën e parë të librit ai, duke afirmuar rolin vendimtar të komunistëve shqiptarë në luftën e përpjekjet për themelimin e PKSH, vë në dukje edhe ndihmën që ka dhënë komunisti nationalist Miladin Popoviçi, i cili pak javë para Nëntorit të 1941-së u ndodh në gjirin e komunistëve shqiptarë, që e çliruan nga një kamp përqendrimi fashist. Kur u gjend në gjirin e komunistëve shqiptarë ky nationalist, gjithçka ishte bërë gati dhe roli i tij në këtë ngjarje ishte një faktor i jashtëm dhe nuk ishte vendimtar. Këtë e shpreh edhe vetë Miladin Popoviçi. Në kujtimet e shokut Enver hidhet poshtë pretendimi absurd dhe antimarksist i revisionistëve jugosllavë, të cilët ndihmën e internacionalistik Miladin Popoviçit e quajnë si faktorin vendimtar në krijimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë. Për këtë shoku Enver, duke cituar pjesë nga procesverbali i Konferencës së Parë të Vendit të PKSH, riprodhon fjalët e Miladin Popoviçit:

«— Askujt nuk duhet t'i shkojë ndër mend se Partinë Komuniste të Shqipërisë e kemi krijuar ne, dy të dërguar të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Jo, e vërteta është se Partinë Komuniste të Shqipërisë e krijuat vetë ju, komunistët shqiptarë dhe, nëse duhet folur për rolin tim, ose të çdokujt tjetër të jashtëm, ky rol s'është gjë tjetër veçse ajo që në marrëdhëni midis partive motra quhet ndihmë e përkrahje internacionale, vëllazërore. Partinë tuaj Komuniste ju do ta krijonit siç e krijuat, edhe sikur të mos vinim ne këtu».

Në librin «Kur lindi Partia», megjithëse në qendër janë ngjarje të mëdha, të përshkruara me një epicitet të fuqishëm, ka një ndjenjë humorë të shëndetshëm, që është vëgori e stilit të shokut Enver dhe që vihet re në gjithë veprën e tij. Ndjehja e humorit, e ironisë dhe e sarkazmës është veti e njerëzve të shquar, me dituri e kulturë të madhe, veti që e kanë marrë nga populli dhe e kanë kultivuar në shkallën më të lartë. Në kujtime shoku Enver njerëzve të thjeshtë të popullit u vë në gojë humorin, sarkazmën, ironinë. Kurse individët renegatë, servilë, tradhtarë, frikacakë, sektaristë, lokalistë e bashibozukë ai i satirizon, i fshikullon dhe i vë në lojë me armën e pamëshirshme të përqeshjes. E kam fjalën që në libër kemi dy lloj satirash: njëra që qeshin njerëzit e thjeshtë me armiqtë dhe tjetra që autori vetë i satirizon këta armiq. Ndërsa humorë dhe satira e njerëzve të thjeshtë është popullore dhe herë-herë naive, satira e autorit shkrin në një të vetme humorin popullor me sarkazmën dhe ironinë e dijetarit dhe intelektualit.

Njohja e thellë e gjuhës së popullit, e shprehjeve të gjalla, e frazeologjisë së pasur, e idiomave, e asaj gjuhe plot lëng e me një bukuri të rrallë, dituritë nga letërsia shqiptare dhe nga letërsia dhe kultura botërore, — të gjitha këto kanë bërë që materialit apo brumit t'i japë jetë siç i jep skulptori jetë gurit.

Le të kujtojmë këtu satirizimin që i bën autori Koço Tashkos dhe sarkazmën dërrmuese për Anastas Lulën apo Zoi Fundon. Është rasti që nuk mund të rrimë dot pa cintuar pjesë nga përshkrimet që i bën Koço Tashkos, të cilin e ka të përkryer si një personazh artistik: «Valët e luftës na përpinë të gjithëve, vec Koco Tashkos, i cili bridhte me një kone të bardhë të lidhur me zinxhir, që «të maskohej» si borgjez». Ai pretendonte se ishte «kryetari» i Grupit të Korçës e për më tepër «i dërguar» i Kominternit.... Dhe më poshtë figura zbulohet satirkisht: «Koçoja, një ditë prej ditësh na u fejua me motrën e Stefan Trebickës, ose, siç e thërritnin në Korçë, Stefan Kokëmadhit. Mirëpo nuk mendoi se me çfarë do ta ushqente e do ta mbante familjen. Ndaj, kur e pa veten ngushtë, na u drejtua neve ta ndihmonim, por ne nuk kishim mundësi ta bënim këtë, se ato të ardhura fare të pakta që nxirrin nga dyqani «Flora», na duheshin për luftë, ne nuk mund të mbanim në kurriz edhe një famlje të re. I tha-

më t'u drejtohej vëllezërve të tij, te të cilët jetonte deri atëherë.

— Jo, — tha Koçoja, — kjo gjë s'ka si bëhet. «Kryetari», donte medoemos «ndihmë» që të hapte një dyqan, ku të shiste «këmishka» dhe... të tjera vogëlsira të brendershme për gra dhe të vinte atje si shitëse «zonjën Pavlinë», të zinte një shtëpi me qira dhe «të fitonte» koromanen.» Autori pasi tregon satirikisht se si Koço Tashkoja shkoi në Itali me të shoqen për të blerë gjëra për dyqanin e pastaj për t'i shitur, shkruan: «Dhe, bëri, ç'bëri, shkoi. Kështu Koçoja na u bë me dyqan të modës për gra.»

Libri «Kur lindi Partia» shquhet nga një vërtetësi e madhe e pasqyrimit të kohës dhe të njerëzve. Kjo vërtetësi e reptë e bën librin jo vetëm të besueshëm, por edhe estetikisht të përvetësueshëm. Duke lexuar atë, herë bie në mendime, herë të pushton një mall i madh për shokët e luftës dhe të idealeve të përbashkëta që e ndanin kafshatën e bukës, që mbuloheshin me një jorgan, që hidhëroheshin e gëzoheshin bashkë, herë të hipën urejtja për pushtuesit e tradhtarët, herë mbushesh plot me krenari e optimizëm dhe herë vë buzën në gaz për humorin aq të bukur e aq të shëndetshëm. Nga ky libër mësojnë të gjithë ata që shkruajnë ditare e kujtime për luftën e të sotmen. Mësojnë, pasi shpesh këto ditare e kujtime shkruhen me një gjuhë të thatë plot literaturizma apo agjuracion bërtitës vulgar e banal dhe shpesh me plot pasaktësi dhe mburrje artificiale. Ndonjëherë armikun e nxjerrin frikacak, ballistët syleshë, devijatorët naivë etj. Për këto shoku Enver në librin e tij shkruan: «Gazetat tonë ndonjëherë lejojnë që disa njerëz pa vlerë, që jo vetëm s'dinë të shkruajnë, por as nuk kanë pasur ndonjë aktivitet revolucionar, të botojnë disa shkrime krejt false dhe poshtë emrit të tyre vënë fjalën «veteran». Lexoja një ditë një shkrim të njërit nga këta pseudoveteranë për Ali Kelmendin. «Ta shkruaj, ka thënë ai me vete, se të paktë janë ata që e kanë njohur Aliun, të tregoj se e kam pjekur në Vjenë, kur punonte me Dimitrovin dhe vinte në kafe na edukonte», e të tjera përralla të tilla. Po trillimi duket se, në mes të tjerash, ai thotë që «Aliu ishte një burrë i gjatë si malësorët, me shpatulla të gjera» etj. Krejt në të kundërtën e këtij përshkrimi ka qenë Aliu. Ai ishte një mesoburrë, bile, mund të them, jo i gjatë, me shpatulla aspak të gjera, përkundrazi, me një trup që po ia brente tuberkulozi. Nga trupi ishte njeri i zakonshëm, por

ishte me shpirt të madh revolucionar». Shoku Enver pyet dhe fshikullon me sarkazmën që e karakterizon: «Po pse i bëjnë të tillë njerëz këto gjëra? Kuptohet, për të ngritur veten, për të thënë: «Unë? Ohu, jam që në kohën e Ali Kelmendit!», kurse në realitet nuk ka qenë asgjékundi, si para dhe pas Çlirimt, tundte derën dhe s'ia pa kurrë hajrin Partia. Dhe tash rri e nxjerr simite, ia dërgon edhe gazetës, e cila ia boton si pa të keq, bile edhe me titullin e nderuar të veteranit.»

Për librin e shokut Enver «Kur lindi Partia» mund të shkruash shumë dhe përsëri të ndjesh se nuk i ke kapur të gjitha anët, temat, problemet, formën dhe strukturën e tij. Libra të tillë nuk shkruhen gjithmonë, por lexohen gjithmonë.

1981

NJË VEPËR E FUQISHME PËR NJË EPOPE TË MADHE

(Vështrim mbi stilin dhe gjuhën e veprës
«Titistët» (shënime historike)
të shokut Enver Hoxha)

1

Në vargun e madh të veprave të shokut Enver një vend të veçantë zë libri i tij i ri «Titistët». Ky libër bashkë me «Hrushovianët», «Shënime për Kinën», «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë», «Me Stalinin», «Kur lindi Partia» e të tjerë të gjinisë memoriale pasqyron një epope të madhe të historisë së re të Shqipërisë, të historisë së Partisë sonë. E them këtë, pasi duke i pasur në duar këta libra, ne kemi një kuadër të gjerë të historisë së Partisë dhe të popullit tonë, një kuadër të gjerë të epokës. Përmes faqeve të tyre ne ndiemjë gjëmimet e luftës sonë titanike për përparim e socializëm dhe hapat e fuqishëm të revolucionit; kujtimë përpjekjet, përlleshjet, forcën, këmbënguljen, vullnetin, dëshirën dhe mençurinë e komunistëve, luftëtarëve, militanteve dhe martirëve; shohim kurthet, intrigat, djallëzitë, çndershshmëritë dhe krimet e kundërshtarëve dhe armiqve për të na gjunjëzuar; përfytyrojmë dramat dhe tragjeditë rrëqethëse që janë luajtur në skenat e truallit tonë të zhu-

ritur e të përgjakur; shohim fëmijërinë, rininë dhe pjekuri-në tonë, idealet e ndritura dhe ëndrrat e bëra jetë. Këto vepërë e pasurojnë historiografinë dhe kulturën tonë dhe tregojnë stadin e ri të mendimit tonë intelektual, nga një anë, dhe, nga ana tjeter, mundësitet e mëdha të zhvillimit të këtij mendimi. Madje, ato na flasin se teknika e të shkruarit në kohën e sotme në Shqipëri, teknika e të shkruarit të historisë, shkencës shoqërore, publicistikës, literaturës memoriale dhe, në përgjithësi, letërsisë duhet të kalojë në një hop të ri cilësor, pasi janë pjekur të gjitha kushtet. Këtë e vërteton edhe vetë dalja e librit «Titistët». Mendoj se këtë vepërë na tregojnë edhe një gjë tjeter të rëndësishme, që nuk mund ta lëmë pa e përmendur. Është fjala që mendimi marksist mund të jepet me mënyra dhe forma nga më të ndryshmet dhe me mjete dhe teknika nga më të gjalla+ e më të përparuarat për t'u bërë më depërtues, më përvetësues dhe më veprimtar në njerëzit: Këtë e vërteton, pra, edhe libri «Titistët», i cili ka hyrë me shpejtësi të mahnitshme në gjithë njerëzit, në të mëdhenjtë dhe të vegjëlit, në jetën kolektive dhe në jetën e familjeve.

Në qendër të librit «Titistët» është lufta e ashpër, që arrin deri në konfliktet më të mprehta dhe më kulminante, midis dy politikave, dy ideologjive e dy qëndrimeve krejtësisht të kundërtë me njëra-tjetren. Në një anë janë politika, ideologjia dhe qëndrimi i Partisë sonë dhe nga ana tjeter politika, ideologjia dhe qëndrimi i Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Nga ne është drejtësia marksiste-leniniste, nga ata është padrejtësia shoviniste-revisioniste. Janë dy fuqi që ndeshen. Njëra është me dritë, që sa ka lindur dhe kërkon medoemos të rritet pa marrë parasysh asgjë, vetëm të rritet e të rritet, që të bëjë pastaj mrekullira; tjetra është e errët e ogurzezë, që ndjell kob dhe kërkon të bëjë gjëma, duke u lëshuar si korb mbi të renë që ka lindur. Siç thotë Engelsi në «Ludvig Fojerbahu dhe fundi i filozofisë klasike gjermane», kur lind një filiz i ri, gjithë forcat e errësirës turren ta mbytin. Në libër, pra, që në faqet e para janë vënë përballë njëra-tjetrës këto fuqi. Si mjeshtëri i fjalës dhe i konceptimit epik të gjérave, shoku Enver, si në një dramë, të dy këto fuqi në fillim të veprës i ekspozon në potencë; duket një si heshtje në tension, që diçka zien dhe në këtë zierje parandiehet një gjëmim e një shpërthim, se nisin e grumbullohen re. Në këtë eksposozim personazhet historike, komunistët, militantët e njerëzit e popullit përpiken

e luftojnë kundër pushtuesit fashist; mblidhen, diskutojnë e rrahin mendime se si do ta përballojnë këtë armik të përbashkët; projektojnë të ardhmen, lirinë e Shqipërisë, se tani Partia është themeluar, se tani ka një forcë drejtuese dhe nuk është më ai kaosi para 1939 në shoqërinë shqiptare. Mbretëron edhe shpresa edhe optimizmi, se tani ka edhe parti komuniste në fqinjët, në Jugosllavi, Bullgari, Greqi, që kanë organizuar popujt në luftë kundër fashizmit. Megjithatë, diçka zien. Atëherë në libër shoku Enver sa e ekspozon këtë atmosferë, hedh valën e parë të asaj që ndihet dhe tensioni dramatik fillon. Vjen lajmi që është nisur Bllazho Jovanoviçi, i dërguari i KQ të PKJ-së. Është skena e parë e dramës së madhe. Autori me forcën e fjalës e nxjerr në skenë dalëngadalë këtë personazh, siç do ta shohim. «Morëm të gjitha masat, — shkruan shoku Enver, që ti sigurohej mikut një udhëtim me sa më pak rreziqe dhe, në ditët e fundit të dhjetorit 1942, mbërriti shëndoshë e mirë në Labinot të Elbasanit i deleguari i KQ të PKJ. Ky ishte Bllazho Jovanoviçi.»¹⁾

Ka rëndësi të veçantë të vërehen ngjyrat e fjalës së kësaj paraqitjeje. Fjalët «shëndoshë e mirë» dhe «ky ishte Bllazho Jovanoviçi», të bëjnë të mendosh se ky personazh diçka do të bartë në sensin negativ të figurës së tij. Ka një papastërti ky njeri. Dhe shoku Enver fillon dhe e zbulon para lexuesit, duke treguar se ky sjell edhe një letër të Titos për KQ të Partisë sonë. «... na solli, në mos gaboj, — shkruan autorri, — edhe nja dy broshura, e, padyshim, edhe Dushan Mugoshën.» (Mugosha njihej edhe më parë.) Vënia paralel e «dy broshurkave» me Dushan Mugoshën të ngjall një buzëqeshje, se bashkohen dy gjëra që s'janë të një natyre, sendi me njeriun. Këto në stilistikë quhen paradokse. Këto paradokse këtu marrin një domethënie ideore: në broshurkat janë idetë, në Dushan Mugoshën gjithashtu janë idetë, që do të zbulohen më vonë. Po ç'ishte kjo letra e Titos? Ngjarjet, që përshkruan Titoja në letër kishin ndodhur në prill, fjalët ishin shkruar në shtator, letra vinte në dhjetor të 1942. Tani jepet biseda me Bllazho Jovanoviçin:

«— ... Titoja, duke gjykuar mbi to, na jep një sërë këshillash. Ne e falënderojmë për preokupimin dhe interesimin.

1) «Titistët», fq. 21.

— Vetëm për këto ju vlen letra? — pyeti Bllazhoja me të njëtin ton.¹⁾

Pas formës narrative shoku Enver kalon në arsyetimin publicistik: «Ndoshta s'do t'ia viente ta zija fare në gojë as këtu atë letër, por fakti që më pas propaganda jugosllave e ka ngritur dhe e ka lëshuar atë si një «mesazh shpëtimtar», si një «kontribut të shquar të Titos në favor të Partisë e të Luftës Nacionalçirimitare» etj. etj. më bën të ndalem pakëz edhe një herë mbi këtë dokument, të ash-tuquajtur të shqar.²⁾ Kjo ndërhyrje publicistike ka gjuhën e mprehtë të sarkazmës, pasi vetë interpretimi i letrës nga propaganda jugosllave është hiperbolik. Dhe ne vëmë bu-zën në gaz nga shprehjet «mesazh shpëtimtar» e «kontribut i shqar». Por këtu vëmë re edhe se si autori e thyen njësinë e kohës, si kalon nga 1942 në të sotmen, në propagandën e tanishme jugosllave. Dhe nuk do ta përmbajmë buzëqeshjen, kur shoku Enver ia vë emrin kësaj pusullke: «letër e këshillave të vonuara». Situata bëhet më satirike. Titoja në letër kërkonte karakteristikat e anëtarëve të KQ të Partisë Komuniste të Shqipërisë. Dhe, shkruan shoku Enver: «...ngaqë s'dinim si ta shpjegonim, e gjetëm «arsyen»: i di Titoja këto punë! Ndoshta kështu e ka orientimin!»³⁾.

Njerëzit e shqar, duke njobur vlerat dhe forcën e fjalës së mprehtë e kanë përdorur me zgjuarsi në situata të përshtatshme kundër armikut apo kundërshtarit. Fjala e mprehtë e sarkazmës në momente të veçanta merr domethënienë të madhe e veçanërisht në polemikat me kundërshtarin. Për këtë mendimtari dhe esteti rus Lunaçarski na thotë: «E qeshura i jep goditje djegëse kundërshtarit, e bën të humbë besimin në forcat e veta dhe, veçanërisht, nxjerr 'në pah në sytë e dëshmitarëve dobësinë e tij....»

Po le të kthehem te tensioni i librit, te ndeshja e hapët që pritej përmes zbulimit shkallë-shkallë të Bllazho Jovanoviçit si personazh. Qëndron ky Bllazho tre-katër muaj në heshtje e pa u ndier. «Dhe ja, — shkruan shoku Enver, — tamam ky Bllazho Jovanoviçi, na ngrihet në Konferencën e Parë të Vendit, në mes të delegatëve të ar-

1) «Titistët» fq. 25

2) «Titistët», fa. 26

3) «Titistët», fq. 28

dhur nga gjithë Shqipëria e, fare papritur, na lëshon një xhevalir:

— Partinë Komuniste të Shqipërisë e kanë krijuar dy komunistë jugosllavë»¹⁾.

Vala e parë e fuqishme e ndeshjes filloj. Është vala që përfaqësohet nga një i deleguar jugosllav. Lexuesi tanë pret. Filli i tensionit ndehet, megjithëse vepra është shënimë historike. Ky tension do të kalojë për një çast në një ndërhyrje të karakterit teorik të autorit. Arma e publicistikës letrare pasurohet me armën e arsyetimit të drejtpërdrejtë teorik, se stili i shokut Enver nuk e pranon njëngjyrshmërinë monotone, qetësinë e fjalës. «Në radhë të parë, shkruan shoku Enver në këtë ndërhyrje, pretendimi i titistëve se gjoja ata e paskan krijuar Partinë Komuniste të Shqipërisë nuk qëndron në këmbë nga pikëpamja teorike, parimore. Ai në këtë aspekt është një shkelje me të dyja këmbët e ligjësisë së zhvillimit në tërësi dhe e parimeve mbi të cilat lindin, krijojen e forcohen partitë komuniste në veçanti.»²⁾

Për libra të natyrës shkencore, teorike e historike është karakteristik paraqitja e fakteve dhe argumenteve, pastaj analiza e tyre dhe përfundimi shkencor. Ka autorë që gjithë këtë e shkruajnë disi vështirë dhe, do të thosha, mërzitshëm. Kurse shoku Enver edhe paraqitjes së fakteve, edhe analizës, edhe përfundimit i jep dimamikë, i jep zhdërvjelltësi dhe nuk i than, pasi edhe gjuha e tij është plot lëng, është gjuha jetësore dhe nuk është gjuha e kronikave të thata dhe arkivave të pluhurosura. Fraza e tij ka dy anë: anën e dukshme dhe anën tjetër, që s'duket, por që ndihet, që merret me mend dhe të vë në mendime.

Kur është momenti, formën e arsyetimit teorik autori përnjëherësh e thyen për ta shpënë më tej mendimin dhe për t'i dhënë lëng frazës, e thyen me publicistikën. Në ndihmë vjen arma e ironisë dhe e sarkazmës therëse: «... kur Titoja me shokë na paskëshin qenë kaq të «fortë» e të «zotët» sa të krijonin «nga jashtë» një parti komuniste në Shqipëri, përsë nuk e bënë këtë gjë, ta zëmë, më 1935 apo 1937, më 1939 apo më 1940?! Apo mos vetëm më 1941 «zbuluan» se në kufi me Jugosllavinë na ekzistonte edhe Shqipëria, e cila na priste «krijuesin» Tito të thoshte «të

1) «Titistët», fq. 29

2) * * * fq. 31

bëhet Partia», ashtu si bota, sipas Biblës priste «krijuesin e madh» të thoshte «të bëhet jeta?!»¹⁾

F. Engelsi, duke i dhënë rëndësi të veçantë përdorimit të armës së sarkazmës në luftën politike, i shkruan një mikut të tij për natyrën e artikujve që duheshin botuar kundër Bismarkut e K°: «... duhet shkruar për kundërshtarin, mbi të gjitha, me përbuzje dhe me gjuhë fshikuilluese... Në qoftë se publiku përsëri do të mësohet të qeshë me Bismarkun e K°, kjo do të jetë një arritje e madhe... Kështu që është e çmuashme çdo fjalëz e mprehtë për të gjithë këta zuzarë.»

Në pjesën që cituam nga libri i shokut Enver, ironia dhe sarkazma nuk ngacmojnë e nuk qesëndisin, por thërrresin me zë të lartë, sepseakuza e armikut është e egër dhe e ashpër; shtrembërohen faktet, shkelen ligjet e objektivitetit për hir të përfitimit, për hir të dëshirës për ta bërë 'Partinë Komuniste të Shqipërisë shtojcë dhe shërbëtore të Jugosllavisë së Titos. Fraza këtu gjëmon përmes fjalëve me peshë dhe jo përmes fjalëve fluturake dhe të shabllonizuar. Fjala këtu nuk është guralec i lëmuar lumi, por shkëmb. Pas kësaj ndihet oshëtima e valëve të tjera që do të vijnë. Lexuesi tani i pret, aksioni artistik vrapon, ndërsa koha nuk ndihet, flas për kohën gjatë leximit, gjatë përvetësimit.

Është për të nënvizuar se toni polemist dhe publicist i frazës që cituam, ka në vetvete edhe argumentimin dhe objektivitetin shkencor. Për stilin e shokut Enver është karakteristik toni polemist, me logjikë të hekurt dhe me ngarkesë të madhe emocionale. Duke përdorur këtë stil, ai rrëzon argumentet e kundërshtarit me fakte të palëkundura dhe me gjuhë të kulluar e të gjallë, plot ritëm dhe me një intonacion të papërzier me intonacione të tjera.

2

Personazhi i parë, që heshti për një kohë, e shpërthen ogurin. C'pritet të vijë? Autori tanë do të hedhë valën e dytë. E ndieni strukturën e librit? Kjo nuk është një kro-

1) «Titistët», fq. 32

nologji e thjeshtë, ku të numërohen ngjarjet dhe të jepen disa konsiderata të përgjithshme. Çështja është se autor i brenda parimit kronologjik e jep atë magjinë joshëse, që, siç thotë Tolstoi, të të zërë për xhakete, të të marrë me vete që të mos ndahesh nga libri. Por le ta ndjekim mendimin. Atëherë ne besonim në drejtësinë komuniste të udhëheqjes jugosllave dhe prandaj çuditeshim me sjelljet e këtyre të dërguarve, duke menduar se ata bëjnë me kokën e tyre. E megjithëse besonin, këtyre të dërguarve ne u kundërshtonim. Përmes këtyre kundërshtimeve, që në hapat e parë, fuqia e re, Partia jonë kalitej. Në libër kjo ndihet. E kështu, ne e pamë Bllazho Jovanoviçin. Një skenë e dramës kaloi. Fuqia e re priti një goditje dhe dha një goditje. Fuqia ogurzezë shtrëngon dhëmbët dhe ne i ndiejmë kërcitjet e këtyre dhëmbëve. Vjen vala e dytë. Pas Konferencës së Parë të Vendit një tjetër ogurzi shfaqet në horizontin e thyer të maleve. Ndërkohë shoku Enver është duke korrigjuar rezolucionin e Konferencës. «... papritur, thotë ai, e në rrethana krejt të panjohura, na mbiu në Labinot të Elbasanit një jugosllav. Them «na mbiu» jo aq përfaktin se gjer atë çast as që dinim kush ishte, nga vinte, pse e për ku shkonte ky njeri në ato kohë të vështira, por sidomos për telashet, për ngatërrresat e për akuzat e kurthet e pafund që na krijoi, që nga momenti i njoftes e përvite me radhë më pas»¹). Ky ishte Vukmanoviç Tempoja.

Është një mjeshteri e rrallë të japësh një tablo të tillë, ku të ndiesh edhe një dhembje tjetër për mundimet, vuajtjet e vështirësitë që kalonin komunistët dhe vetë autorë i shënimeve. Fjalët «ku shkonte ky njeri», «ngatërrresat», «akuzat e kurthet e pafund» të bëjnë të ndiesh dhembje e të thuash: «Ç'doni, more njerëz! Na lini të qetë! Shprehjet «kush ishte» e «ku shkonte ky njeri në ato kohë të vështira», krijojnë një pamje plot të fshehta, si në legjendat e rapsoditë e maleve tonë. Edhe prezantimin ky njeri e bën enigmatik e të çuditshëm: «Duke u kthyer nga Maqedonia e zonat greke me itinerar për në Mal të Zi e në Kosovë, mora vesh se ndodheshit këtu. Pa të shohim ç'bëjnë këta shqiptarët, mendova dhe vendosa t'ju bëj një vizitë të shkurtër, — tha rëndë-rëndë e priti, si duket, t'i shprehja falënderimet. Unë vetëm heshta për t'i lënë të

1) «Tilitët», fq. 38

kuptonë se duhej t'i korrigjonte shprehjet... «këta shqiptarët»¹⁾.

Edhe përshkrimi i ardhjes, edhe dialogu përputhen me karakterin, sjelljet e mendimet e këtij personazhi. Që nga fjalët «Ç'bëjnë këta shqiptarët» ndihet jo vetëm megalomania e fodullëku, por edhe prapamendimi i tij. Jo vetëm kaq. Autori atë e vizaton edhe si njeri që megalomania i jep pamjen e një aventurieri. Por prapa kësaj pamjeje, që të bën të qeshësh, fshihet edhe paturpësia, dhelpëria dhe shpirtligësia e tij, fshihet misioni i keq. Unë nuk mund të rri pa dhënë edhe një citat tjetër, për të parë forcën e fjalës së shokut Enver në ndërtimin e kësaj figure: «Mëqë Maqedonia, për vetë historinë e saj të kaluar e aktuale, është çështja «kyç» e Ballkanit, më duhet, në njëfarë mënyre, të merrem me krejt këtë trevë ku ndërthuren Bullgaria, Greqia, Maqedonia, Shqipëria, Serbia. Kohë të vështira dhe probleme tepër të vështira, por s'kemi ç'bëjmë, do t'ua dalim mbanë, — e mbylli hyrjen me po atë ton që e filloj dhe nisi të vërente se ç'efekt na kishte bërë njojja me tërë këtë «barrë të rëndë» që na i kishte lëshuar historia mbi supe këtij 30-vjeçari!»²⁾

Ndërsa të parin, Bllazho Jovanoviçin, shoku Enver e përshkruan të heshtur, këtë Vukmanoviç Tëmpo, e paraqet fjalëshumë, prepotent, mburravec dhe cinik të paturpshëm. Shpeshherë në përshkrime ai përqeshet dhe ironizohet dhe kur vjen çasti goditet rëndë. Përqeshja herë është e hidhur e herë thumbuese e fshikulluese. Dhe është e dyfishtë: përmes fjalëve të veta e përmes ndryshme nga ajo që paraqet Bllazho Jovanoviçin, sepse kemi të bëjmë me dy tipa të ndryshëm, por të një botëkuptimi.

Shkallë-shkallë, në fillim si një personazh i etur për aventura, pastaj si një mendjemadh, më tej si një karikaturë strategu dhe më në fund si një shovinist i tërbuar dhe si një antimarksist i hapur — ky është gradacioni i zbulimit të tij në vepër. Shoku Enver me një sens të hollë shkruan se ai e kishte qejf ta përsëiste fjalën «shabllon». Ky është një detaj i vogël, që më vonë e bën lexuesin të mendohet. Këtu qëndron edhe një anë e mjeshtërisë. Kjo fjalë «shabllon» e nxjerr domethënien e saj. Vukmanoviç Tempoja e quante edhe revolucionin e Tetorit «shabllon»,

1) «Titistët», faqe 38

2) « faqe 39

edhe përvojën e Ushtrisë së Kuqe të Stalinit, edhe madje Dimitrovin. Është edhe një fjalë tjetër, që më vonë e nxjerr domethënien, fjala «Ballkan», e citatit që solla si shembull. Të vëmë re se ku do të dalë kjo fjalë. Të japim dialogun e tij me autorin:

«... — Kam kohë që përpunoj në kokë një ide të madhe. Ajo përfshin Jugosllavinë, Shqipërinë, Bullgarinë e Greqinë.

— Qenka vërtet e madhe gjersa përfshika tërë Ballkanin, — ia prita me një qesëndi të lehtë.

— Po, Ballkanin të tërë — përsëriti pa e përmbajtur kë-naqësinë dhe vazhdoi: — Kam në kokë idenë e një shtabi të madh, e një shtabi, si të them, mbi shtabet, e një organizimi të përgjithshëm, a më kupton?»¹⁾

Po harruam të përmendnim se edhe fjalën «shtab» e përsërit autor i disa herë në gojën e Vukmanovic Tempos. E përsërit, kur ky personazh ngul këmbë në mendimin se duhet sa më shpejt të formohet Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare në një kohë që vendimi është marrë nga Partia. Edhe kësaj fjalë shoku Enver ia nxjerr synimin. Kur hedh idenë e shtabit ballkanik, Vukmanovic Tempoja thotë: «Ta zemë se edhe ju bini dakord. Po si atëherë, do të merrni ju pjesë në të, kur akoma s'keni shtab të përgjithshëm?»²⁾

Ndër të tjera shoku Enver i përgjigjet:

«... — Sa për merakun tuaj të fundit, se mos ju të tjerët hyni në atë «shtab» e ne mbetemi jashtë, ngaqë ende s'kemi shtab të përgjithshëm të ushtrisë, rri i qetë! Pastaj, — shtova po me të qeshur, — pjesëmarrja ose jo e shtabit tonë s'besoj se e prish idenë tuaj.»³⁾.

Në këtë kapitull të librit autor i përshkruan Tempon si një njeri që hyn edhe del e që endet nëpër Ballkan i ngarkuar me «ide të mëdha». Atëherë kjo figurë bëhet si Tartarini i Taraskonës i Dode-së, plus edhe poshtërsinë e Jagos të Shekspirit. Në një nga këto dy udhëtime ai e merr me vete edhe Koçi Xoxen. «— Po na e bën edhe Koçin «ballkanik», — i tha Miladini si me shaka»⁴⁾, shkruan shoku Enver. Dhe ja tani në skenën e dramës shfaqet Koçi Xoxe. Ai sa nxjerr krye. Ogurziu i dërguar nga Titoja fillon e hedh kthethrat. Shfaqja e parë e tij është në plan

1) «Titistët» fq. 47

2) “ fq. 48

3) «Titistët, fq. 49

4) “ fq. 50

komik; është si Šanço Pançoja që i vete pas Don Kishotit nëpër aventurat. Kjo shfaqje është një gjetje e bukur e shokut Enver. Lexuesi tanë pret se si do të vejë puna e Koçit. Edhe sikur mos ta dijë historinë e jetës tradhtare të Koçit, ai e ndien se këtu diçka ka. Në libër po hyn një krah tjetër, që do të zhvillohet bashkë me atë të ogurzinjve për ta mpleksur situatën, për ta bërë më tragjike e për ta tendosur dramacitetin dhe epikën e veprës. Bukuria është se tensioni dramatik në vepër nuk jepet posaçërisht dhe kastile nga autori. Ai nuk ka për qëllim të shkruajë një libër letrar, por një vepër historike. Prandaj tensioni dramatik këtu është i natyrshëm, pa tendencia të shtira letrare. Kjo natyrshmëri ndihmon në përsosmërinë e strukturës së librit.

Vukmanovic Tempoja humb për një kohë dhe si xhind vjen përsëri. Kthimin e tij shoku Enver përsëri e jep me komicitet për ta zbuluar këtë figurë nga gjithë anët:

— E, ç'hotë Ballkani?! (e pyet shoku Enver).

— Zien, — tha Tempoja që dukej sheshit se iu bë qejfi. — Zien e valon!

— Kujdes, se edhe pëlqet — ia ktheva¹⁾.

Dhe ky pasazh përforcohet me një tjetër akoma më të bukur, ku ndihet diapazoni i kulturës së të shkruarit, po edhe i kulturës së asimiluar të autorit:

«Kur fliste e diktonte me fraza të prera mbi «kërdinë» që do të bënte në Ballkan «shtabi èndërr» i tij, të dukej sikur vetë perëndia e luftës kishte zbritur e na kishte ardhur mysafire në Kucakë. Veç «perëndia» që kishim përparrë s'nxirrte nga goja e nga çanta rrufe e zjarr, por urdhëra e direktiva.²⁾

Shprehjet hiperbolike e metaforike: «kërdinë», «shtabi èndërr», «perëndia e luftës», «çanta rrufe e zjarr», i japin frazës një ekspresivitet të fuqishëm dhe një imprehtësi të rrallë. Pastaj paradokset: «perëndia» mysafire «këtu në Kucakë» dhe «perëndia» që «s'nxirrte nga goja e çanta rrufe e zjarr, por urdhëra e direktiva» e bëjnë figurën qesharake për mendjemadhësinë që kishte ky njeri. Ana qesharake rritet akoma më shumë kur jepet ndërhyrja admiruese e Koci Xoxes: — Shoku Tempo e vuri përparrë udhëheqjen

1) «Titistët», fq. 51

2) fq. 55

greke, — ndërhyri aty pér aty Koçi Xoxe. — E çfarë debati e çfarë të mbledhuri. Naa, ua bëri!»¹⁾

E gjithë kjo është një parapërgatitje e një konflikti të ashpér që vjen më vonë. Personazhi Tempo fillon e bën akuza pér «sektarizëm» në Parti e në luftë. Pastaj akuza në një aspekt tjeter: ajo bëhet «oportunizëm» me Ballin Kom-bëtar. Është një nxitje pér përçarje ndërmjet akuzave pér gjëra të paqena. Përsëri kemi përdorimin e dy fjalëve në të njëjtin çast: «sektarizëm» dhe «oportunizëm», të cilat më vonë do të marrin kuptim të plotë në përdorimin e tyre nga armiku. Këto fjalë do të shërbejnë edhe pér fillimin e daljes së një figure tjeter që do të hyjë në krahun e tradhtarëve. Ajo del ngadalë dhe pret të marrë trajtën e saj. Del Sejfulla Malëshova. Ai prezantohet në skenë, kur Vukmanovic Tempoja hedh akuza pér «sektarizëm» dhe «opportunizmin».

«— Diçka që në një moment është sektare, — vazhdoi «profesori», — më pas mund të kthehet në oportunitzëm dhe anasjelltas. Flas në sens të teorisë, se helbete, s'u jam futur çështjeve në praktikë...»²⁾

Në libër situata e atmosfera vazhdon të ndehet, kur akuzat e ndërhyrjet e figurës së Vukmanovic Tempos rriten e zgjerojnë gamën e tyre. Humori e ironia tanë lihen dhe stilë shpreh zemërimin dhe habinë se si të dërguarit e një partie komuniste të jenë kaq të etur pér intriga e djallëzi. Fillojnë letrat e Tempos kundër Partisë e udhëheqjes, të mbushura me akuza shoviniste pér problemin e shqiptarëve në Maqedoni e në Kosovë, gjoja pér ndërhyrjet tona nacionale. Tempoja në këto çaste nuk është prezent, por ai ndihet, ai duket. Ndihet edhe ustai i madh, Titoja, që udhëzon e që drejton akuzat e shpifjet që andej nga thellësitë, i zhytur në mjegullën e madhështisë, si një Zeus rrufedhës. Vepra zgjerohet me ndërlikimin e konfliktit, me hyrjen e figurave e personazheve të tjera historike. Të pasqyrrosh ndërlikimin e konfliktit e maleksjen e figurave në një sfond të gjerë dhe të japësh nëpërmjet kësaj atmosfere dhe ide të mëdha, është shumë vështirë dhe duhet një përvojë e madhe dhe një asimilim krijues i kulturës, i diturisë, i teorisë. Por është pena e fortë prej dijetari e Enver Hoxhës që di t'ia ekspozojë lexuesit me një bukuri

1) «Titistët», fq. 57

2) « fq. 62

të vërtetë e spontane, ku nuk ndihet literatura e publicistika, por rrjedhja e furishme e mendimit dhe fjalës.

Kur éshtë fjala e letérkëmbimit mes Vukmanoviç Tempos, autori shkruan se si ruhen këto letra në arkivin tonë, po edhe e merr me mend që të njëjtën gjë duhet të ketë bërë edhe ogurziu. Këtu éshtë kjo ndërhyrje e fortë dhe sarkastike: «Ndoshta edhe Tempoja, si konservues me damkë i sllavomadhërisë, do t'i ketë ruajtur ato për të bindur pasardhësit se sa e si ka luftuar ai për projektimin dhe për krijimin e perandorisë së «sllavëve të jugut», perandori që, sipas tij e gjithë sllavofilëve, duhej të niste nga valët e Danubit, të rrihej nga erérat e Alpeve, të Karpatave e të Pindit dhe, sidomos, të freskohej nga dallgët e erérat e buta të Detit të Zi, të Egjeut, të Jonit e të Adriatikut.»¹⁾

Ky éshtë një parakalim i një satire sa therëse, por në të njëjtën kohë edhe aq poetike. Edhe se lirizmi këtu éshtë parodizuar me satirën, poetika mbetet. Në këto radhë fjala ka edhe ngjyrë edhe ritëm, por edhe përqeshje të hidhur me një fuqi që të çarmatos.

Për grindjen me Vukmanoviç Tempon dërgohen letra në udhëheqjen jugosllave, se akuzat janë të rënda, janë gjoja për qëndrim «shqiptaro-madhëri» nga ana jonë. Por përgjigjet nuk vijnë. Dhe krijohet një gjendje e nderë, e dhënë në libër me realizëm të thellë artistik. Ndërsa udhëheqja jugosllave nuk përgjigjet në letrat që kërkonim të drejtat ligjitime të shqiptarëve për hir të luftës së përbashkët, Koçi Xoxe hidhet «— Kanë punë të mëdha! — i shfajësonte Koçi Xoxe. — Kanë ngritur një Jugosllavi në këmbë e duhet të manovrojnë»²⁾, shkruan shoku Enver përsëri me fshikullimë.

Pritjen e letrave shoku Enver e përshkruan me një ndjenjë tensioni. Por edhe fillimin e vërvshimit të letrave gjithashtu po me këtë ndjenjë e përshkruan. Për një letër që vjen nga Titoja, autori shkruan: «Pasi në njérën nga letrat na «gëzonte» me shprehjen se në parim nuk ishte kundër që «shqiptarët e Kosovës të kenë të drejtë të shkojnë ku dhe si të dëshirojnë», menjëherë na akuzonte se ne, udhëheqja e PKSH, gjoja mbanim «qëndrimin që mban borgjezia reaksionare shqiptare» (?!)³⁾.

1) «Titistët» fq. 90

2) " fq. 94

3) " fq. 95.

Në vepër përshkruhet situata në çastet kur lexohej kjo letër, veçanërisht gjendja e Miladin Popoviçit, militantit e mikut të Partisë sonë. Shoku Enver shkruan: «I mbante sytë përdhe dhe ishte i zbehur fare.» Pastaj jep fjalët e tij:

«— Ndoshta s'e ka shkruar vetë Titoja këtë letër, — tha, — ndoshta ia kanë bërë të tjerë, ndoshta...»¹⁾

Në këtë vend fraza bëhet me ngarkesë emocionale që pasqyron vuajtjen shpirtërore të një të huaji, Miladin Popoviçit, të cilin i vjen keq përsë bashkatdhetarët e tij të sillen kaq padrejtësish me komunistët shqiptarë e me popullin shqiptar. Përsëritja e fjalës «ndoshta, ndoshta» në gojën e Miladin Popoviçit shpreh një dyshim në drejtësinë e Titos, shefit të partisë së tij. Miladin Popoviçi, pa dërguar Titoja letër, mendonte se Vukmanovic Tempa bën me kokën e vet, kur akuzon e fyeni komunistët tanë.

Dhe ja tani vjen letra e Titos, që përmban të njëjtat akuza. Miladin Popoviçi atëherë pëson deziluzion, duke thënë: «Ndoshta s'e ka shkruar vetë Titoja këtë letër..., ndoshta ia kanë bërë të tjerë, ndoshta...». Evoluimin e Miladin Popoviçit, gjer në deziluzion, shoku Enver e ka dhënë me mjetë të gjalla shprehëse e me një realizëm të thellë, duke pasqyruar në të njëjtën kohë edhe botën e brendshme të militantit.

3

Para valës së tretë të skalioneve ogurzjinj të Titos, skalionit të Velimir Stoinicët dhe Nijaz Dizdareviçit, që erdhën në kohën kur stuhia e Luftës ishte ngritur, në gusht të 1944-ës, më libër është një pikë lidhëse mjaft e rëndësishme për strukturën e veprës: del përsëri figura e Dushan Mugoshës. Nxjerra sérishmi e kësaj figure, bën që materiali historik më libër të lidhet gjer më fund me fije të forta e të pakëputura. Ndërsa me daljen e Vukmanovic Tempos, si personazh real, parapërgatiten figurat e Koçi Xoxes dhe Sejfulla Malëshovës, me shfaqjen përsëri të Du-

1) «Titistët» fq. 98

shan Mugoshës ekspozohen Mehmet Shehu dhe Liri Gega. Historikisht vërtet kështu ka ndodhur, por kjo e vërtetë historike ka marrë edhe formën e së vërtetës letrare e publicistike, duke i shërbyer kompozicionit të librit, strukturës së tij. Në libër ka një pasazh të tillë për Dushan Mugoshën: «Tymi i zi i punës së tij agjenturore me disa nga kuadrot e Brigadës së I, ose aty ku i eci, u duk disa herë në horizontin e Partisë, gjatë gjithë rrugës së saj e gjer në ditët e sotme, sa herë ndeshej kjo me grupe ose me persona antiparti në udhëheqje.»¹⁾

Shprehjet «tymi i zi i punës së tij agjenturore», «u duk disa herë në horizontin e Partisë» jo vetëm që janë të figurshme, por marrin funksionin lidhës të ideve dhe faktave që do të vijnë më vonë me daljen në horizont të Mehmet Shehut, Liri Gegës e të tjerëve. «Si njeri i «terrenit» që ishte, thotë shoku Enver, qysh nga pranvera e 1943-shit, Dushan Mugosha «iu qep» qarkut të Vlorës. Vençanërisht me Mehmet Shehun iu pajtua ylli e, më pas, kur atje dërguam si delegate të KQ të Partisë Liri Gegën, të tre këta u bënë si një pirusti»²⁾.

Krahasimi «të tre këta u bënë si një pirusti» është në funksion të përbajtjes e të ideve të tri këtyre figurave.

Në faqet e librit «Titistët» Dushan Mugosha pasqyrohet siç ishte në realitet, si njeri i veprimeve më të zeza agjenturore, që rekrutoi agjentë të fshehtë në radhët e kuadrove të ushtrisë sonë e të terrenit. Duke i lexuar këto shënimë historike të shokut Enver, neve na përfytyrohet figura e Dushan Mugoshës si e mbuluar me tërë blozën e zezë të reaksionit, të intrigës, të spiunazhit e të cinizmit. Veprimet e tij sektare, që u dënuan që atëherë nga Partia, janë fryshtës së tij agjenturore. «Dushan Mugosha, — shkruan shoku Enver, — meritonte për këto dënimin më të madh, por fakt është se ai nuk u largua nga Shqipëria si i dënuar. Përkundrazi, pasi e kreua rolin që i kishte ngarkuar udhëneqja e tij, duke rekrutuar e fëlliqur kë mundi, Duqi ia mbathi e i la «trashëgim» Partisë sonë, «gabimet nga sektarizmi». të cilat tash i duheshin udhëheqjes së PKJ për të akuzuar udhëheqjen «e paaftë» e «sektare» të Partisë sonë Komuniste»³⁾. Ky arsyetim mbi faktet dhe njëkohësisht

1) «Titistët», fq. 117

2) «Titistët», fq. 114–115

3) «Titistët», fq. 149.

përfundimi logjik mbi veprimet e Dushan Mugoshës gjë shprehjen në gjuhën konçize dhe të konkretizuar. Pastaj shprehjet «ia mbathi e i la trashëgim» Partisë sonë «gabimet nga sektarizmi» formojnë një lidhje të fortë me misjonin e Velimir Stoiniqit dhe Nijaz Diddareviçit, të cilët po me këtë gjuhë do të na akuzojnë.

E kështu, në libër shohim të dalin Velimir Stoiniqi dhe Nijaz Diddareviçi, i pari si shef i misionit ushtarak jugosllav pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë sonë Nacionalçirimitare dhe i dyti si ndihmës i tij. Me daljen e tyre dramaciteti i librit ngjitet në një shkallë të lartë. Konflikti rritet dhe në të marrin pjesë shumë personazhe reale e figura historike. Karakteret zbulohen e fillojnë të vizatohen e të skaliten gjëri në detaje të holla. Situatat ndehen e ashpersohen. Kompozicioni i librit shkon drejt pikës kulminante me shpejtësi. Këta dy të dërguar nga Titoja vijnë me një mision të përpiluar mirë e të plotë. Misionin e tyre shoku Enver e quan «special» se është përqëllime të errëta politike, diversioniste e agjenturore.

Në libër shoku Enver e jep Velimir Stoiniqin menjëherë në sulm kundër Partisë sonë. Synimet e tij shfaqen përnjëherësh, ndryshe nga **Bllazho Jovanoviçi** dhe Vukmanovic. Tempoja që e shprehin shkallë-shkallë agresivitetin e tyre. Që në takimet e para me shokun Enver, ai nxiton «rëndë-rëndë» të na bëjë «vërejtje» përvijen tonë, të na numërojë «gabimet» që paskësh bërë «vazhdimesht». Partia jonë! Ai thoshte se në vijën e Partisë sonë qenkëshin dukur «vazhdimesht» lëkundje «si nga e djathta dhe nga e majta».

Hyrja e Velimir Stoiniqit në skenë është e zullumtë, zhurmëmadhe e plot cinizëm. Autori e paralajmëron lexuesin se ky personazh do të sjellë shumë trazira. Ai e pasqyron këtë tip si njeri që punonte me këmbëngulje përvijen e plotë, që jepte e merrte çdo ditë me radio, i lidhur me «shtabin e Titos» dhe me «organizativin» e Titos, Rankoviçin. Atëherë lexuesi përfytyron edhe Titon e Rankoviçin, që veprojnë diku në malet e Serbisë e që thurrin djallëzira dhe ogure të reja dhe ia transmetojnë Velimir Stoiniqit.

Në këtë atmosferë që ndihet dhe pasqyrohet në libër, Velimir Stoiniqi cakton edhe fatin e Miladin Popoviçit. Ai e përzë bashkatdhetarin e tij të «dyshimtë» në emër të Titos. Shoku Enver e përshkruan me dhimbje largimin e

tij. Mes këtij përshkrimi pasqyrohet dashuria e tij për këtë militant e mik:

— Po përse pikërisht në këto momente?! — i thashë.
— Edhe disa javë dhe çlirohet Shqipëria. Të hyjmë edhe një herë bashkë në Tiranë, jo ashtu ilegalisht, me bomba e nagante në xhep si më 1941 e më 1942, por të lirë, si fitimtarë, pastaj ik. Do të mbledh popullin e do t'i them: «E shihni këtë burrë? Ky është malazez, jugosllav. Por është edhe yni, është edhe shqiptar. Emrin e ka Miladin Popoviç, ne e quajmë Ali Gostivari. Është shoku ynë, vëllai ynë, komunist që për 4 vjet me radhë bashkë me ne e me ju luftoi, sakrifikoit, u rrit me ne, dha gjithë ç'pati për këtë fitore, për lirinë. Tani do të ikë. Putheni të gjithë dhe udhë e mbarë i qoftë!». I flisja kështu dhe Ali Gostivari qante.»¹⁾

Bashkë me gjendjen psikologjike shoku Enver pasqyron edhe tragjedinë shpirtërore të Miladin Popoviçit në atë kohë. Miladini është i bindur se të gjithë këta të dërguar nga Jugosllavia sillen si armiq, por ka një shpresë të mjegulluar te udhëheqja, te Titoja. Ai vetë e shpreh këtë: «Në fund të fundit Tempoja e Veloja dhe dreqi e di kush tjetër, s'janë as PKJ, as KQ i PKJ.»²⁾

Figura e Miladin Popoviçit është nga më të bukurat në libër. Autori ua kundërvë këtë figurë gjithë personazheve negative siç ka ndodhur në jetën politike të asaj kohe. Miladin Popoviç përfaqëson militantin internacionalist, përfaqëson komunistin dhe njeriun e vërtetë, që në sajë të idealeve të tij u ngrit mbi gjithë grindjet nacionale, mbi gjithë mëritë dhe urrejtjet e së kaluarës, që kishin ushqyer shovinistët serbomëdhenj në popujt jugosllavë. Ai e bënte këtë se besonte në komunizmin dhe në idenë se të gjithë popujt janë liridashës në thelbin e tyre. Prandaj edhe u kundërvihet pikëpamjeve, megalomanisë dhe arrogancës së Bllazho Jovanovicit, Vukmanovic Tempos, Dushan Mugshe, Velimir Stoinicët dhe Nijaz Dizdarevicët. Shumë kuptimplotë janë fjalët e tij, kur po ndahej me shokun Enver:

«— Enver, dje nuk të tregova se s'doja të të shtoja mërzinë. Por ti duhet ta dish. Unë po iki, sepse m'i kanë vënë këmbët në një këpucë, në emër të Titos. Nuk janë të kënaqur nga puna ime. Por po të them një gjë: ky Velimir Sto-

1) «Titistët», fq. 132

2) fq. 127

iniçi dhe Nijaz Dizdareviçi po sillen si armiq. Kujdes me ta...¹⁾.

Në libër veprimet djallëzore të Velimir Stoinicit autori i pasqyron në rritje, gradë-gradë. Në fillim me vërejtjet e akuzat e tij në përgjithësi për vijën e Partisë, pastaj me urdhrin për ta larguar Miladin Popoviçin, më tej me përpjekjet për ta goditur vetë shokun Enver. «Natyrisht, shkruan autori, as dija e as më shkonte ndër mend ato ditë se ç'përgatitej e ç'kurdisej rrötull meje, por atmosferën e ftohtë që po krijohej nuk mund të mos e ndjeja...²⁾ Ishte koha kur shoku Enver përgatiste raportin për Plenumin e KQ të Partisë, që pastaj u mbajt në Berat. Velimir Stoinici ndërkohë kishte bërë për vete Koçi Xoxen, Nako Spiran, Sejfulla Malëshovën e të tjera. Kështu ai kishte përgatitur terrenin për të marrë pjesë, bile, edhe në mbledhjen e Byrosë Politike, me gjithë kundërshtimet e shokut Enver. Atje ai lëshon edhe «tezat» e tij për përçarjen e Partisë sonë dhe për të thelluar grindjet pa fund, «që do të na hanin orë, ditë e net të çmuara gjatë tetorit dhe nëntorit të atij viti, kur kishim e na pritnin aq punë në prag të Clirimt». Këtë shoku Enver e zbërthen dhe e konkretizon edhe në tregimin e skenave të gjalla si në një vepër epike klasicke, edhe në paraqitjen e karaktereve të personazheve historike. Ka shënimë historike, kujtime apo libra monografikë, bile edhe reportazhe të gjata që kur përshkruajnë ngjarje historike nuk hyjnë në tregimin e skenave me detaje dhe nuk ndërtojnë tipa e karaktere, po flasin vetëm për idetë në përgjithësi, numërojnë emrat e atyre që marrin pjesë, duke i cilësuar me ndonjë epitet: ky mbante qëndrim armiqësor, ai të lëkundur, ai të poshtër etj. Në këtë rast s'mund të flasësh për karaktere apo figura. Këto lloj shkrimë mund të kenë vlera të rëndësishme, por nuk mund të bëhen objekt studimi në aspektin letrar.

Dhe le të vjmë në skenat e në karakteret që përmendëm më lart. Në një anë autori vë Velimir Stoinicin dhe në anën tjeter bashkëpunëtorët e tij shqiptarë me pozitë në parti. Stoinici hedh «tezat», ata lëshohen herë me kënaqësi e herë me dinakëri për t'i përvetësuar këto «teza». Ai është njeriu që hedh farën e së keqes në një arë, këta ndihmojnë e punojnë fshehurazi që kjo farë të mbijë.

1) «Titistët», fq. 133-134

2) «Titistët», fq. 134.

Veçanërisht, skenat para mbajtjes së Plenumit të 2-të të KQ të PKSH në Berat janë plot me karakterizime të gjalla të këtyre njerëzve të prapaskenave dhe kanë një dinamizëm të fuqishëm prej drame të vërtetë. Ndër të tjera e fortë është skena, ku Sejfulla Maledhova e Nako Spiru bëjnë vërejtje për raportin e shokut Enver. Nëpërmjet vërejtjeve që bëjnë, del edhe karakteri dhe pikëpamjet e tyre. Po japid një nga këto tablo. Shoku Enver shkruan:

— Që në fillim ka ekzaltime, — më thotë Sejfullai, — ka shumë lëvdata për vijën e përgjithshme të Partisë.

— Ku e mbështetni këtë konstatim?! — i pyeta.

— Duhen balancuar drejt të tërë komponentët përbërës të një vije që të përcaktohet saktësish karakteri i vijës — nisi «filozofitë» Sejfullai. — Ju këtu theksoni të përgjithshmen. Por harroni të veçantat, sektarizmën dhe oportunizmën që janë dukur herë njëra, harrë tjetra. Duhen marrë në konsideratë të tëra, sepse s'ka të përgjithshme pa të veçantë.¹⁾

Në këtë fragment përdoren bukur termat filozofikë «e përgjithshme» dhe «e veçantë», që në gojën e Sejfulla Maledhovës tingëllojnë si sofizma prej pedanti, që nuk e njeh fare filozofinë. Kemi të bëjmë me një individualizim të vërtetë të gjuhës së personazhit. Ky individualizim thellohet më tej në tablonë e «korrigjimit» të raportit nga Sejfullai dhe Nakoja.

Autori shkruan: «Sapo shihnin se në vendin e duhur theksoja, për shembull, që «janë dukur edhe shfaqje të sektarizmit e të oportunizmit», hop kërcente Sejfullai:

— Ta bëjmë: «janë shfaqur hapur, shumë herë dhe në mënyrë të dukshme....»

— Në mënyrë alarmuese! — «redaktonte» aty për aty Nakoja.

— Tamam. — binte dakort «filozofi», pra, ta lemë kështu: «Është dukur hapur e shumë herë në mënyrë alarmuese një dozë e madhe si sektarizmi dhe oportunizmi»^{2).}

Kjo është situata që përshkruhet para mbledhjes së Byrosë Politike në Berat, situatë e krijuar nga Velimir Stoinici, duke ndërsyer përkrahësit e tij, situatë e përshkruar si dramë, tërë tension e tërë shqetësim. Në këtë dramë ka mjaft momente vuajtjesh shpirtërore e dëshpërimi, po as-

1) «Titistët», fq. 156.

2) « fq. 159.

pak pesimizmi. Kuptohet që dëshpërimi është i madh, se pse disa nga ata që kanë luftuar bashkë me udhëheqësin kthehen në kundërshtarë dhe lidhen me Stoinicën. Nga pesë anëtarë të Byrosë Politike, katër janë vegla të bindura të jugosllavëve. «Izolimi im u bë i plotë jo vetëm në Byro, por edhe jashtë saj. Vetvetiu punët çoroditeshin gjithnjë e më tepër dhe dita kur do të mbahej Plenumi po afrohej.»¹⁾

Ngjarjet ndodhin në prag të Çlirimit të atdheut, kur mbretëron një gëzim i madh anembanë. E, në këto çaste të gëzimit të përgjithshëm, heroi kryesor i veprës, shoku Enver, është në vuajtje të thella shpirtërore. Kjo atmosferë pasqyrohet nëpërmjet narracionit, ndërhyrjeve publicistike e meditimeve të autorit. Narracioni këtu është një paraqitje e ndërthurur e ngjarjeve historike, ku marrin pjesë personazhe reale; është një paraqitje e synimeve, qëllimeve e raporteve mes tyre. Me pjesët narrative në libër sigurohet paraqitja e vlerësimeve të natyrës së karaktereve dhe rrethanave. Ky narracion, i një mënyre të vecantë, është i përshkruar nga lidhje të brendshme të thella, lidhje që mishërojnë idenë konkrete të veprës dhe botëkuptimin e autorit për historinë, botën, njeriun dhe natyrën; është një narracion i ndërprerë herë pas here nga arsyetimet dhe nga zëri i autorit. Në volumin e këtij narracioni realizohet ajo pjesë e përbajtjes, e cila nuk mund të shprehet plotësisht as me një fjalë të veçuar, as me disa fjalë të lidhura me stilin e thatë.

Dihet se mjeshtrin origjinal mund ta njoftësh nga mënyra e tij e vecantë e ndërtimit të ngjarjeve dhe karakteristikave, me ndërthurjen e të vecantës me të përgjithshmen. Mirépo, çdo ide, ndjenjë e dëshirë mbeten vetëm fakte të jetës personale, më qoftë se nuk mishërohen dhe konkretizohen në ndërhyrjen, gjykimin dhe arsyetimin e autorit, që përbëjnë zërin e tij në vepër. Nga fuqia e zërit dhe qëndrimi emocional e arsyetues të tij varet masa e veprimit shoqëror në lexuesin.

Në librin e shokut Enver edhe përmes narracionit, edhe përmes zërit të autorit, edhe përmes analizës shkencore të fakteve situatat pasqyrohen të ndezura, në dinamikë, në vërshim dhe aspak në indiferentizëm. Ato janë herë tragjike, herë lirike, herë meditative, herë arsyetuese e herë komike. Ai di të japë çaste komike edhe në situatat më tra-

1) «Titistët», fq. 164.

gjike e më kulminante. Kështu, në Plenumin e Beratit, që është një nga pikat kulminante të kompozicionit të veprës, ai pëershkruan një situatë të Koçi Xoxes, duke përdorur mjetet e satirës e sarkazmës: «Në shumë pikëpamje referati i Koçit duhej quajtur «referati nuku!».

— Partia nuku kish një vijë të drejtë, të organizuar, nuku qe në rregull, Fronti nuku punoi, këshillat nuku funksionuan, rinia nuku u udhëhoq, populli nuku u zgjua, gruaja nuku u organizua, këshillat nuku gjëzojnë autoritet, nuku gjëzojnë simpathi, nuku luajnë rol, nuku e nuku.»¹⁾

Përdorimi i nëndialektalizmave në këtë pjesë shërben edhe për individualizimin e figurës së Koçi Xoxes edhe si armë politike e autorit. Ndërsa figura e Sejfulla Malëshovës fshikullohet me një ton tjetër, me argumente të tjera, të përshtatshme për jetën e tij prej emigranti dhe poeti. Për Sejfulla Malëshovën, i cili mban në Berat referatin për momentin politik, shoku Enver Shkruan: «Njeriu që e kishte kaluar luftën heroike të popullit e të Partisë tangent, ai që, jashtë rrezikut, «këmbëkryq përmbi selishtë», ngrohte duart mbi trupin e zhuritur të atdheut, tanë duke u mbështetur te lufta e heroizmi i një populli e një Partie të tërë, gjente rastin të mburrej e të krekojë për atë që s'i takonte.»²⁾

Në këtë portretizim përdoret me shumë sukses vargu i një vjershe të Sejfulla Malëshovës «këmbëkryq përmbi selishtë» që i shkon edhe figurës prej dembeli të këtij personazhi. Menjëherë pas këtij vargu shprehja ngrihet në metaforë: «ngrohte duart mbi trupin e zhuritur të atdheut», që i jep mendimit një mprehtësi të veçantë dhe e plotëson paraqitjen e figurës së Sejfulla Malëshovës.

Duke studiuar strukturën e librit «Titistët», kompozicionin dhe gjithë ndërtimin e tij, vërehet dora dhe mençuria e një mjeshtëri për ta paraqitur materialin historik para lexuesit në dinamikë, për t'i bërë edhe analizat

1) «Titistët», fq. 183

2) «Titistët», faqe 168

shkencore të gjalla dhe për t'i përshkruar situatat, individët dhe personalitetet me një realizëm të plotë dhe me një objektivitet të thellë. Faktet historike, ambientet dhe njerëzit, arsyetimet dhe përfundimet teorike — të gjitha këto janë dhënë me një mendim të qartë e të saktë pa ekilibrim frazash dhe pa ekuivoke. Për këtë, rol të madh ka luajtur gjuha si armë, mjetet e saj të pasura dhe shkathtësia në përdorimin e saj. Këtu ka ndihmuar njojja e thellë e njerëzve, karaktereve dhe sjelljeve të tyre; ka ndihmuar njojja e gjerë e kulturës kombëtare dhe ndërkombëtare. Është e qartë se libri «Titistët» nuk është një veپer letrare. Vetë autori e ka quajtur «shënime historike». Por në të përdoren gjërësisht edhe mjetet e gjuhës letrare. Në literaturën marksiste-leniniste, në përgjithësi, është përdorur fjala letrare me tërë mprehtësinë e saj. Marks, Engelsi, Lenini dhe historianët e shquar i kanë vënë rëndësi peshës së saj. Pak pjesë ka në veprën e K. Marksit, bile edhe në «Kapitalin» ku jepen penelata të tëra letrare, që të duket sikur i ka shkruar një shkrimtar i shquar? Në «Kapitalin», kur K. Marks përshkruan punën e endëseve në fabrikat e tekstileve, të duket sikur je në një orkestër të madhe apo në një laborator. Çdo gjë atje këndon. Me këtë K. Marks trengon se si puna, sado e rëndë që të jetë, është e mbushur plot me poezi. Në librin «Titistët» letërsia ndihmon për të nxjerrë në relief gjithë ngjarjet historike dhe për ta dhënë më të plotë atmosferën e kohës në vepër.

Siq e pamë, gjatë analizës së veprës, ngjarjet e idetë, analizat e përfundimet, vizatimet e figurave historike e përshkrimet e situatave, paraqitja e ndeshjeve dhe konflikteve — të gjitha synojnë drejt pikës kulminante të veprimit dhe drejt zgjidhjes. Valët e skalioneve titiste me Blazh Jovanoviçin, Vukmanoviç Tempon, Dushan Mugoshën, Velimir Stoiničin dhe Nijaz Dizdareviçin goditën me zulm të errët në kalanë fortë të Partisë. Këto valë morën me vete Koçi Xoxen, Sejfulla Malëshovën, Nako Spirun, Liri Gegën e Pandi Kriston. Ato nxorën në sipërfaqe edhe Mehmet Shehun, si të rekrutuar nga Dushan Mugosha. Këto valë të përziera, pasi u ngjitën gjer në Plenumin e Beratit dhe nuk e arritën qëllimin përfundimtar, vijnë të turbullta në Çlirimin e vendit dhe synojnë drejt kulmit. Ky kulm është Plenumi i 8-të i KQ të Partisë, i 1948-ës, ku tensioni dramatik do të arrinë gjer në pikën që nuk mban më. Atje do të vërshojë gjithë lukunia e ugurzinjve, atje do të dalin të qarta gjithë synimet.

Por, para se ta shpjerë veprimin gjer në këtë pikë, shoku Enver në fillim përshkruan një gjendje të qetë në dukje, por që zien përbrenda, «Viti i parë i Çlirimit, bile edhe pjesa më e madhe e vitit 1946, shkruan shoku Enver, në shumë drejtime po na flitnin për një «behar të vogël» në marrëdhëniet me «miqtë» jugosllavë»¹). Vetë shprehja «behar i vogël» tregon se kjo qetësi ziente se, siç shkruan autor, «ajo që na kishte ndodhur në Berat qëndronte si një re e zezë që nuk ishte zhdukur»²).

Mes kësaj «qetësie» në skenën e dramës shfaqet Josif Gjergjia pas largimit të Velimir Stoinicit. Shfaqet ai që, sipas librit, me të «do të na lidhët një histori tjetër e gjatë dhe e hidhur»³).

Këtë të dërguar të Jugosllavisë në atmosferën e vështirësive ekonomike të shtetit të ri, kur ndihmat e «mique» ishin me pikatore, kur njerëzit vuanin për bukë, shoku Enver e përshkruan: «Josif Gjergjia ishte njeri i zgjuar dhe dhelparak, hiqej «popullor», i afrohej kujtdo dhe në këtë drejtim e ndihmonte edhe gjuha, bënte një punë të stërholluar informacioni për Beogradin»⁴). Pamjen dhe karakterin e këtij njeriu shoku Enver e nxjerr të ndryshme nga të tjerët, por idetë dhe synimet janë të njëjta, veçse në kushte të reja. Tani shtohen shtrëngimet dhe presionet në lëmin ekonomik për nënshtrimin e Partisë e për ta bërë Shqipërinë republikë të shtatë të Jugosllavisë. Skalionet titiste tani veprojnë në dy fronte të gjera: në ideologji dhe ekonomi. Ndihmësit e këtyre skalioneve veprojnë brënda vendit, venë e vijnë në Beograd, sjellin «dëshira», udhëzime dhe urdhra nga shefat e Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe presin ditën e banketit të madh. Horizonti i librit tani zgjerohet. Veprimi kalon në sfera politike e ekonomike, industriale e bujqësore, organizative e ushtarake, teorike e diplomatike. Ngjarjet tani zhvillohen në Shqipëri e Jugosllavi, Bullgari e Rumani. Bashkë me këto ngjarje përshkruhen diplomatë dhe udhëheqës shtetesh, rrugë dhe sallone pallatesh, bankete dhe atmosfera diplomacie. Por në qendër të strukturës së librit mbetet lufta mes dy ideologjive të kundërtë: marksizëm-leninizmit që mbron Partia jonë dhe revisionizmit që mbron Partia jugosllave. Në skenat e kësaj

1) «Titistët», fq. 205

2) «Titistët», fq. 205

3) " fq. 206

4) " fq. 206-207

drame të madhe hyjnë e dalin personazhe historike nga më të ndryshmet dhe përshkruhen ngjarje nga më të çuditshmet. Përshkruhen udhëtime dhe përfundime udhëtimesh, herë përmes një polemike të ashpër e herë pér mes sarkazmës dhe ironisë. Le të sjellim si shembull një skenë që pasqyron ardhjen e Koçi Xoxes nga bisedimet me Kardelin e Gjilasiq në Beograd. Kur shoku Enver e pyet Koçin se ç'bisedoi me këta dy shefa, ai përgjigjet:

«— Mos nxiton, — më thanë, — në këtë periudhë se mos përzieni... ecjen e revolucionit!»

— E ecjen? — e pyeta.

— Demek, si thanë, — u përtyp Koçi Xoxe, — dome-thënë, shkallët hapat...

— Etapat e revolucionit, ja ç'të kanë thënë! — korrigjoi Sejfullai me fodullëk.

— Tamam, pér këto më thanë, që të mos i ngatërojmë. Ishte një punë e koklavitur goxha...

— Nëjse, nejse, — e ndërpree me një mospërfillje të hapët kolegun Sejfullai, — është një teori e tërë kjo, do t'ju zërthej ndonjë ditë.»¹⁾

Bashkë me udhëzimet e shefave të PKJ pér kujdesin që duhet të kishim ne në zhvillimin e revolucionit, udhëzime prej «mësuesish të sprovuar», pasqyrohet edhe zelli i pa-përbajtur i lakeive pér ta përvetësuar pa e ditur edhe terminologjinë më të thjeshtë. Njëri nga këta, Koçi Xoxe, s'di as ta thotë fjalën «etapë», tjetri, Sejfulla Malëshova, merr përsipër të bëjë shpjegime, se kjo sipas tij është «një teori e tërë». Zelli i madh pér ta bërë pér vete çdo mendim të jugosllavëve, nga një anë i shtyn në agresivitet dhe nga ana tjetër në komicitet. Po në këto pozita bien edhe vetë të dërguarit e Titos, duke dhënë këshillime në Shqipëri se si duhet të ecë ekonomia. P.sh., ndër të tjera, Josif Gjergjia këshillon se si duhet të mbjellim sa më shumë luledielli, se kjo bimë paskësh leverdi të madhe. Pér këtë shoku Enver shkruan: «E drejta është se disa gjëra pér këtë bimë i dinim, por s'dinim ato që dinte Gjergjia.

— Është një bimë e bekuar! — na «shpjegonte» ky. — Prej saj prodhohet vaj, vaj vegjetal... Lulja e diellit çan dhenë, çan edhe tregjet me valutë.»²⁾

1) «Titistët», fq. 221-222

2) «Titistët», fq. 280

Një faqe më poshtë shoku Enver bën një kalim me një figuracion të fuqishëm e tërë lëvizje, duke shfrytëzuar me mjeshtëri shprehjet popullore. Ai thotë: «Për të treguar shkallën më të lartë të vuajtjeve dhe të mundimeve populli ynë ka një fjalë të urtë: «Të heqësh të zitë e ullirit.» Por «të zitë e ullirit» s'ishte gjë fare, para asaj që hoqëm ne me «të zitë e lullediellit»¹). E vini re këtu se çfarë efekti bën fraza me dy kundërvënie të gjetura me aq mprehtësi, «të zitë e ullirit» me «të zitë e lullediellit»?

Edhe për ata që e dinë historinë e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, edhe për ata që nuk e dinë, kur hyjnë në atmosferën e librit «Titistët», jetojnë të rrëmbyer nga ngjarjet, faktet dhe arsyetimet e autorit dhe bien në mendime, duke harruar edhe vrapimin e kohës. Atmosfera në libër qëndron gjithmonë e ndezur, se gjithmonë zbulohen tablo të reja e të papërsëritura. Sa i afrohemë Plenumit të 8-të të KQ të Partisë, aq më të ndezura bëhen ngjarjet e konfliktet në strukturën e librit. Nga një anë hyjnë figura të reja rjerëzish, nga ana tjetër zbulohen elemente të reja të karaktereve të personazheve të njoitura. E kështu, vjen Savo Zllatiçi për të këmbëngulur në unifikimin e çmimeve në ekonomi e për të shpejtuar bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë. Ky, thotë shoku Enver «në përfytyrimet e udhëheqjes jugosllave, luante rolin e mëkëmbësít perandorak në provincën shqiptare»²).

Autori, si mjet për individualizimin e Savo Zllatiçit përdor edhe gjuhën amëtare të këtij të dërguari:

«— Tako je! Tako je! — miratoi Zllatiçi gjithë xhentilecë të shtirë.»³)

Por kjo «xhentilecë» në figurën e tij ndërron, kur shoku Enver e kundërshton për unifikimin e çmimeve. Në këtë moment ai e përshkruan kështu: «Megjithatë, diplomacia bën çudira. Zllatiçi diti t'i mbërthente buzët e të mos nxirre asnjë fjalë nga goja.»⁴)

Është me interes të madh të ndjekësh evoluimin e figurave me afrimin e pikës kulminante të konfliktit. Koçi Xoxe bashkë me budallallëkun e tij shton edhe agresivitetin. Nako Spiru lëkundet në besimin ndaj udhëheqjes jugosllave dhe, kur e sheh që po goditet, vret veten. Sejfulla Ma-

1) «Titistët» fq. 281

2) « » fq. 300

3) « » fq. 306

4) « » fq. 310

lëshovës, kur është duke u përjashtuar nga KQ i Partisë, i bie fodullëku prej profesori. Pandi Kristo, megjithëse mendërisht i kufizuar, fillon të marrë revan dhe të kërcasë dhëmbët. Bashkëluftëtarët e një krahу fillojnë e grinden: Koçi, Nakoja, Sejfullai, Mehmeti, Shulja, Pandi. Ky ishte vërtet realiteti, por zotësia është që këtë realitet ta japësh të gjallë në libër, dmth ta bësh realitet libri. Për evoluimin e figurave, që përmenda pak më lart, le të japid një shembull. Është fjala për momentin, kur kthehen Mehmet Shehu dhe Shulja nga Beograd, ku udhëheqja jugosllave kërkon unifikimin e dy ushtrive dhe krijimin e një komande unike. Këtë tablo shoku Enver e përshkruan:

«— E mban mend ç'i the shokut Tito kur e takuam në Beograd, — iu përgjigj pa u turbulluar Shulja, — «nën udhëheqjen dhe komandën supreme të shokut Tito, ushtri-të tona do të bëhen të papërballueshme!» Ja, këtë the!

Mehmet Shehet i hipi gjaku në fytyrë dhe s'dinte ç'të thoshte. Pastaj duke mërmëritur shtoi:

— Ajo qe një dolli! Në dolli thuhen edhe gjëra të tęperta. Por edhe për shokun Enver ngrita dolli...

— Mos na folni për dollira këtu! — ndërhyri Koçi Xoxe. — Dhe ti Mehmet Shehu të mbledh mendjen. Ti më këto që nxjerr ngá goja do të na armiqësosh më tepër me Jugosllavinë mike! Kur vete në Beograd i bën qejfin Titos, këtu ia bën Komendantit. Të dyve ua ke me hile. Të njoh mirë unë ty, të njoh me dhëmbë e me dhëmballë, ashtu si edhe Nako Spirun.»¹⁾

Nuk është vështirë të vihet re në këtë fragment nga një anë agresiviteti i Koçi Xoxes dhe nga ana tjetër mbrojtja me fanatizëm e Jugosllavisë nga ana e tij. Po në këtë fragment shumë e gjallë jepet edhe grindja mes të njëjtë stan.

Në libër ngjarjet pasurohen me figura ekspertësh ekonomikë e diplomatësh, ideologësh e ushtarakësh dhe të gjithë përshkruhen në detaje të imëta, gjer në skalitjen e karaktereve të tyre. Çdo gjë tani është në lëvizje. Përgatitet sulmi përfundimtar nga Jugosllavia dhe nga lakejtë. Vjen nga Beograd bashkë me Kristo Themelkon e Beqir Ballukun edhe gjenerali Kupreshanin me mesazhe e me harta. Dhe këtu jepet një nga skenat më të bukura të librit: «Më në fund shokët erdhën. Veçse këtë radhë nuk ishin as ve-

1) «Titistët», fq. 403

tëm, as duarbosh. Me ta kishte ardhur një gjeneral jugosllav me një emër të rëndë, që kur e dëgjoje të krijonte përshtypjen që lë goditja e çizmeve me gozhdë në trotuar, «krup-krup». Ky ishte gjenerali Kupreshanin. Me vete kishte sjellë një suitë të tërë kolonelësh e majorësh dhe, në adresën time, një mesazh «tepër urgjent e të rëndësishëm» prej vetë Titos»¹⁾.

Pasi përshkruhet fjala e këtij gjenerali për gjendjen në Ballkan, për Greqinë e të tjera, shoku Enver vazhdon në libër: «Heshti një moment, pastaj iu drejtua një ushtaraku jugosllav që e kishte me vete:

— Hartën! — i tha.

Sakaq u shpalos një hartë e madhe e Ballkanit...»²⁾.

Më në fund vjen Plenumi i 8-të i KQ të Partisë. Atmosfera në libër përshkruhet e nderë dhe me një dramacitet të fuqishëm. Flas nga ana letrare, pa hyrë në idetë e mëdha, e në përfundimet ideologjike e politike. Titistët edhe gjatë përgatitjes së këtij Plenumi, edhe në kohën kur ai zhvillohej, thurrën lloj-lloj djallézish, kurthesh e intrigash. Ashtu si në Berat, synimi kryesor ishte të merrej në dorë Partia, duke rrëzuar shokun Enver. Në Plenum, siç shkruan shoku Enver, thuhej: «Mos u përqëndroni vetëm te grupi i Nakos. Kritikoni më tej udhëheqjen, se ajo ka përgiegjësi të mëdha!»³⁾

Shoku Enver i përshkruan me hollësi dhe të gjalla gjithë skenat brenda dhe jashtë Plenumit. Në përshkrime jepet edhe gjendja shpirtërore e tij, edhe atmosfera në përgjithësi, edhe intrigat e djallézitë e Koçi Xoxes me shokë. Në të njëjtën kohë në libër pasqyrohet me emocion të fortë dashuria dhe besimi që kishte shoku Enver të Partia e të pulli.

Pas pikës kulminante të strukturës së librit fillon zgjidhja me sulmin kundër revizionizmit jugosllav dhe pastaj edhe atij sovjetik hrushovian e me radhë. E vërteta triumfon. Ogurzinjtë me zullumet e tyre shemben. Valët e tjera të skalioneve të tyre janë të pafuqishme. Partia është rritur. Është pjekur. Është thinjur në llogoret e luftërave ideologjike, por ka mbetur e re.

Shoku Enver e jep si në një dramë të fuqishme tablonë e mbledhjes së Byrosë Politike, në çastin kur lexon letrën e

1) «Titistët» fq. 404

2) « » fq. 405

3) « » fq. 419

KQ të PK të BS, drejtuar udhëheqjes jugosllave. Kjo skenë pasqyron me forcë artistike fitimtarët dhe të humburit. «Për herë të parë pas kaq vjetësh me grindje, debate e shpesh me sherre pa kuptim, ra një qetësi e plotë dhe e thellë në Bvronë tonë Politike. Ndërsa lexoja, dëgjohej edhe fryshtësuarja e shokëve. E dija se përshtypjet dhe reagimet që ngjallte çdo paragraf e çdo frazë e letrës, ishin të ndryshme në shokë të ndryshëm. Hysniu dhe Gogoja dëgjonin gjithë seriozitet e preokupim, por vihej re edhe qeshja e ndriçimi në fytyrat e sytë e tyre; Bedriu e Tuku kishin mbetur të çakerritur përpara çudisë që dëgjonin. Sa për Koçi Xoxen, Pandi Kriston, Kristo Themelkon, Nesti Kerenxhin e Xhoxhi Blushin, këta kishin varur kokën e merrnin fryshtësuarja e shokëve.»¹⁾

Ky ishte fundi i tyre. Më tej, në luftë të hapur me revizionizmin dhe me gjithë agjenturat e tjera, marrin fund komplotet titiste-hrushoviane, merr fund edhe poliagjenti Mehmet Shehu me bandën e tij.

Duke e studiuar strukturën e librit të shokut Enver «Titistët» vihet re harmonizimi i përkryer i shtrimit të gjithë materialit historik, zgjerimi i tij në kohë e në vende të ndryshme dhe inkadrimi i tij përsëri në një njësi kohe të caktuar. Dy kapitujt e librit, i fillimit «Duke u ngritur mbi armiqësitë e vjetra» dhe i fundit «Në luftë të hapur me titistët» janë panorama të gjalla dhe udhëtime nëpër historinë e kaluar dhe të sotme, janë analiza faktesh e situatash, digresione në kohë dhe përfundime shkencore. I pari parapërgatit lexuesin duke i lidhur ngjarjet e hershme historike me të sotmen dhe i fundit bën përgjithësimë dhe përfundime për kohën, situatat dhe historinë e ndeshjeve të mëdha me revizionizmin modern dhe imperializmin. Edhe gjuha dhe gjithë mjetet e saj janë në harmoni me materialin dhe me përbajtjen e veprës.

5

Gjatë analizës që i bëmë strukturës së librit, situatave të përshkruara, figurave reale dhe historike dhe formës në

1) «Titistët», fq, 449

përgjithësi, folëm edhe për gjuhën dhe stilin e autorit. Para mbylljes së këtij vështrimi mbi librin e shohim të udhës të themi edhe diçka tjeter për formën. Shoku Enver librin e tij e quan «shënime historike.» Shënimet historike në përgjithësi e kanë rrezikun e copëtimit mozaikal të materialit, e ndarjes dhe shpërndarjes së ngjarjeve dhe kohës. Por në librin «Titistët» shënimet historike përbëjnë një unitet të plotë, unitet që përshkohet nga një tension i fuqishëm i tregimit të ngjarjeve, i dinamikës së dialogëve, i vizatimit të personazheve historike, i rindërtimit të skenave të historisë, i ndeshjeve dhe konflikteve. Materiali i librit synon drejt zgjidhjes me shpejtësi, si një përrua që vrapon drejt fushës. Kjo dinamikë, siç e thamë, jepet me një gjuhë plot ngjyra, me një gjuhë të kulluar e të pasur në shprehje, të mprehtë, të individualizuar, me thënie popullore dhe me shprehje dhe aforizma intelektuale, si rrjedhim i asimilimit krijues të kulturës botërore.

Pra, në libër kalimet nga një kohë në tjetrën janë aq të natyrshme, sa nuk ndihen nga çdo lexues. Kalime të tilla ka në çdo kapitull dhe të gjitha janë të shkathëta dhe në unitet me tërë materialin, idetë dhe formën e tij.

Me forcë sugjestionuese përshkruhen situatat dhe ambientet. Dhe këto përshkrime janë plot variacione me njërat-jetrën. Herë kanë një trishtim e mall, herë një meditim, herë një ironi e sarkazëm dhe herë zemërim e urrejtje. Shikoni si e përshkruan pritjen në pallatin e Titos, duke e dhënë si të gjallë saltanetin e atmosferës, sa të duket sikur ke qenë edhe vetë në ato sallone:

«Ne veshëm rrobat «zyrtare», por kur hymë në pallat ç'të shikonim? Ishte plot me gra, burra, oficerë, diplomatë. Të gjithë ishin të veshur me uniforma të mëdha, me smokinge, gratë me rroba të mëndafshata, me stoli, me gjokse të hapura, me rroba të gjata, disa me pelice në supe, oficerët me dekorata. Titoja na priste në krye me «grand uniformë» me dekorata, me gjoks të fryrë, të nxjerrë përpara; në gisht mbante një unazë me gur xhevahiri që vezullonte.»¹⁾

I gjithë ky përshkrimi është i gjallë, i shoqëruar me një fill ironie që të vë buzën në gaz. Këtu del pompoziteti në kundërshtim me formën e frazave komuniste të «fismikëve» të rinj. Por sa i dhimbshëm është përshkrimi tjetër, kur niset shoku Enver nga Shqipëria në Beograd me aeroplan:

1) «Titistët», fq. 264

«Duke shikuar nga dritarja e avionit tokat e Malit të Zi e të viseve të tjera të Jugosllavisë, mendoja me dhimbje të thellë e me respekt të madh pér shokët e mi partizanë që u vranë në këto anë, me qindra, duke luftuar kundër nazistëve gjermanë... Me mijëra u kthyen nga këto luftime heroike, me qindra ranë në fushën e nderit në territorin e Jugosllavisë, me qindra nëna shqiptare, mendoja në ato çaste, presin nga ne t'u sjellim eshtrat e shenjta të bijve të tyre.»¹⁾

Në libër përshtypje të veçantë të bën dialogu, i cili nuk është thjesht një këmbim dhe ndeshje mendimesh, por edhe një individualizim i personazheve reale, një portretizim i tyre. Ja, të marrim dialogun e shokut Enver me Nako Spiranë në kohën kur Nakoja akuzohej pér «antijugosllavizëm». Shoku Enver shkruan:

«Nakoja na dëgjoi serbes, ndezi qetë-qetë një cigare... dhe, kur mbaruan, pér habinë time, pasi lëshoi një shtëllungë tymi përpjetë, tha:

— Ashtu? Dhe ju qenki tronditur? Pér dy javë jua bëj unë krejt Shqipërinë projugosllave!

— Si guxon e flet kështu? — i thashë pa e përmbajtur veten. — Çështë, sipas teje, kjo Shqipëri, që ti pér dy javë na e ktheke në «projugosllave» ose në «antijugosllave»?! Dhe kush je ti që qenke në gjendje të na bësh të tilla çudira?!»²⁾

Këtu ndeshen edhe mendimet, jepet edhe portreti i bëshkëbiseduesit.

Kurse në vizatimin e portreteve të veçanta të persona-zheve ndihet një sy i mprehtë vrojtues, që nuk i shpëton as-gjë, ndihet një pasuri detajesh, një vrojtim i gjithanshëm. Këto portrete jepen me një individualitet të çuditshëm, me karakteristika tipike e të veçanta, me përcaktime të sakta. Sejfulla Malëshova karakterizohet: «mik ‘e përkrahës i gjithë politikanëve të kafeneve e të kulisave»³⁾, Koçi Xoxe: «Mendjetrashi Xoxe, «Trashi» e kishte dhe pseudonimin, ish-intendenti i magazinave tonë Panarit, njeriu i errët i Byrosë e i Qeverisë, tashmë po fryhej si bretkosa e përrallës»⁴⁾.

Pér gjuhën, stilin, formën e në përgjithësi pér gjithë mjetet shprehëse të librit të shokut Enver «Titistët» mund

1) «Titistët» fq. 253

2) “ fq. 347, 348

3) “ fq. 228

4) “ fq. 421

të flasësh gjatë e mund të bësh tema të veçanta. Por unë dua të theksoj përsëri edhe diçka për humorin, sarkazmën dhe mprehtësinë e fjalës që janë veti mjaft dalluese të këtij libri dhe librave të tjerë të shokut Enver. Satira dhe sarkazma e shokut Enver është e një tipi të veçantë, me mendim intelektual që përdoret me mprehtësi në sferën e luf-tës politike. Kjo satirë i shfrytëzon gjerë shprehjet popullo-re, duke i shkrirë dhe harmonizuar me aforizmat e fushave politike, publicistike e letrare dhe duke i dhënë dialogut me lexuesin një ton të fugishëm polemist. Le ta ilustrojmë këtë edhe me një shembull tjetër. Në faqen 298, ku shoku Enver bisedon me Zllatiçin, të dërguarin e KQ të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, për dhitë, deshët e cjejet që kër-konin jugosllavët nga Shqipëria për t'u marrë brirët e për-të bërë me ta tregti, është ky dialog:

— ... përse ju duhen brirët (pyet shoku Enver).

— Si, përse na duhen?! — pyeti i skandalizuar nga «padija» ime Zllatiçi. — Ata krehërat e bukur e karficat që ju shesim edhe jüve, me brirë bëhen!

Qesha për një çast vjetvetiu, por e mbloedha shpejt vëten. Vecse u gjëzova që «padija» ime në këtë fushë më shtyu të mos lejoja të bëheshin kurban dhitë, deshtë e cjejet e Shqipërisë ngaqë miqve u duheshin brirë.¹⁾

Në mjaft dialogë të librit «Titistët» ndërron gjendja nga sarkazma e ironia në revoltë dhe ndonjëherë në keqardhje. Kështu, në bisedë me Kraigerin dhe përfaqësues të tjerë jugosllavë për planet dhe kontratat ekonomike me Jugosllavinë, është një dialog me një variacion e lëvizje të gjendjes shpirtërore, dialog që ka edhe sarkazmën e hidhur, por edhe zemërimin e keqardhjen.

— Shikoni se ç'ndodh, — ngriti zërin jugosllavi. — Na vijnë nga pala juaj kërkesa të papërballueshme. Marrim, për shembull, piskatoret. Na keni kërkuar 70.000 piskatore për një vit! Ky është kulmi! E zbrazët tregun jugosllav!

— Mund të ketë edhe kërkesa të padrejta! — iu drejtova jugosllavëve, — por për veglën në fjalë s'mund t'ju përgjigjet. Në ç'degë të ekonomisë përdoret?!

Papritur atmosfera e rëndë e takimit ra për një moment në qetësi. Përkthyesit nisën të flasin kokë më kokë me jugosllavët për t'u sqaruar për veglën në fjalë. Koçi Xoxe kishte mbështetur kokën mbi duar, kurse Zllatiçi po bënte

1) «Titistët», fq, 298

gjeste prej të marri: shkulte me majat e gishtave vetullat dhe diç donte të tregonote. Më së fundi enigma u zgjidh:

— Fjala është, — nisi të më sqaronte përkthyesi, — përnjë copë teneqe elastike, të kthyer më dysh që përdoret nga gratë për të hequr qimet e vetullave.

Nuk ishte momenti për të qeshur, por për të bërtitur:

— Turp për ju që përmendni të tilla marrëzira! — iu lëshova jugosllavëve. — Gratë e vajzat tona s'u dinë as emrin veglave që thoni ju e jo t'u shkojë ndër mend të heqin vetullat! Ato akoma s'kanë bukë të mjaftueshme, s'kanë rroba të vishen e këpucë të mbathin, kurse ju na ankoheni se ju paskemi zbrazur tregun nga teneqeçkat e vetullave...»¹⁾.

Në librin «Titistët» ka me qindra shprehje metaforike, idiomatike dhe të tjera në formën e aforizmave. Në gjuhë gërshtohet me mjeshtëri fryma popullore gojore me shprehjet intelektuale të publicistikës së lartë dhe të letërsisë.

Me një sens të rrallë artistik shoku Enver di t'i japë kontrastet e karaktereve dhe ambienteve. Për të vërtetuar këtë që thamë, mjafton të kujtojmë përshkrimet që i bën Titos, pallatit e darkës që ai shtron, me tablonë që jep kur takohet me Dimitrovin. Atje është pompoziteti e saltante, këtu thjeshtësia. Po jap disa tablo të shkurtra paralele nga libri. Te Titoja, kur pinë kafe pas darkës: «Atje drितat ndriçonin gjithçka, qilimat e shtruar, kolltukët, tryezat e ngarkuara me piye, me fruta, me ëmbëlsira e me piye freskuese.»²⁾ Te Dimitrovi, kur hanë darkë: «Para se të fillonim fjalimet dhe të hanim, Dimitrovi një të grumbulluar numrin e madh të lugëve dhe të pirunëve të shumëllojtë që kishte përpara dhe i thotë garsonit:

— Merri këto, se nuk kam nevojë për 20 copë, më mjaf-ton një thikë, një lugë dhe një pirun.»³⁾

Në pallatin e Titos: «Rreth e rrotull pallatin e ruanin roje të veshur me uniformë «fringo», të armatosur me automatikë. Pse gjithë këta roje? — thosha me vete...»

Në automobilin e Dimitrovit: «Dimitrovi, unë dhe roja ikém përpara nëpër borë. Karvani mbeti shumë prapa.

— Škemi rojet e sigurimit, brate, — i thoshte shoferi Dimitrovit.

— Ngaje se na ruan populli, — i përgjigjet Dimitrovi.»⁴⁾

1) «Titistët», fq. 442-443

2) « fq. 265

3) « fq. 375

4) « fq. 379

Në automobilin e Dezhit: «Kur hyra në makinë, m'u duk se s'isha në një veturnë, por si në një arsenal të vërtetë: edhe në anën time, edhe në anën e Dezhit kishim nga një njëzetëshe gjermane me nga dy karikatore rezervë pér secilin, nën këmbët e mia dhe të Dezhit nga një tjetër njëzetëshe gjermane, me të tjerë karikatorë e, sigurisht, po aq kishin edhe roja me shoferin.»¹⁾

Nga këta shembuj del qartë se ç'rol luajnë kontrastet në një vepër qoftë në forcimin e idesë, qoftë në shtimin e larmisë së formës. Shoku Enver është një mjeshtër i shquar i antitezave dhe kontrasteve, të cilat ndihen jo vetëm në veprën «Titistët», por në gjithë librat e Tij. Doemos, këto kontraste janë të shpérndara në gjithë librin dhe nuk duket fare se janë vënë me ndonjë tendenciozitet të caktuar. Ato i zbulon vetë lexuesi, i zbulon dhe bie në mendime. E theksoj këtë, pasi në libër asnjëherë nuk thuhet: ky më priti kështu, ndërsa ai ashtu. Në libër vetëm tregohet.

Libri «Titistët» është një vepër e një rëndësie të veçantë jo vetëm pér lëmin e historisë, ideologjisë, politikës dhe edukimit, por edhe pér fushën e letërsisë pér idetë e mëdha, pér gjuhën e kulluar e të pasur, pér strukturën dhe pér formën në përgjithësi. Kjo vepër, ashtu si të tjerat, e pasuron kulturën tonë dhe është një ndihmë e madhe edhe pér shkrimtarët. Nga libri mëson shumë histori e shumë kulturë, njihesh imtësisht me rrugën e Partisë sonë, me militantët e saj dhe me armiqtë e saj; njihesh me jetën e pasur, me luftrën e përpjekjet e shokut Enver pér ta rritur e brumosur Partinë dhe shtetin e ri shqiptar; njihesh me udhëheqës shtetesh, shikon mënyrën e jetesës së tyre, pikëpamjet, qëndrimet sjelljet gjer te gjérat më të imëta. Libri i shokut Enver «Titistët» na jep shembull edhe se si mund të shkruhet historia në një mënyrë të gjallë dhe jo të mërzitshme, siç ndodh shpesh me librat e kësaj natyre; na jep shembull se si mund të shkruhen shënimet historike, kujtimet dhe në përgjithësi edhe veprat letrare. Nga ana tjetër libri, tek e lexon, ta rrit ndjenjën e dashurisë kombëtare dhe të ngjall një krenari të madhe pér Partinë dhe të bën të thash: «Jam i lumtur që jetoj në epokën e saj»!

1) «Titistët», fq. 472

BOTA E FËMIJËRISË DHE E RINISË SË HERSHME

(*Mendime për librin «Vite të vegjëlisë»*)

Ka libra që, me të dalë nga shtypshkronja, hyjnë me shpejtësi të çuditshme te njerëzit dhe krijojnë një atmosferë festë në shtëpi, në rrugë, në kuvene dhe kudo ku merr frymë jeta. Me këta libra bisedohet sikur ata të janë njerëz të vërtetë me histori të pasur, njerëz që me mençurinë e diturinë e tyre të marrin përdore dhe të shpien vend më vend e shtëpi më shtëpi, sokak më sokak e kuven më kuven, dhe të tregojnë për jetën dhe shoqërinë, për punën dhe trimërinë, duke të mësuar të vërtetën, duke të zbuluar shpirtin e begatë të njerëzve dhe bukurinë e thjeshtë të tyre. Këta libra nuk janë pako letrash, por janë njerëz të gjallë ku ti dëgjon se si në çdo fjalë rreh zemra njerëzore dhe pulsi i trurit njerëzor. I tillë është libri i ri i shokut Enver «Vite të vegjëlisë». Në këtë libër zien bota e fëminjërisë dhe e rinisë së hershme të autorit, bota e qytetit të tij të gurtë, Gjirokastrës së mahnitshme me historinë e saj të pasur, të lashtë dhe të re, e kësaj luleje të çuditshme të mbirë në gjoks të Malit të Gjerë në jug të Atdheut të shtrenjtë. Faqe pas faqeje duket sikur çahen gurët dhe dalin para nesh

moshatarët e vegjëlisë dhe të djalërisë së shokut Enver: studentët, furrëxhinjtë, kovaçët, e muratorët, punëtorët e gurit, hekurit e zjarrit; faqe pas faqeje duket sikur hapen portat e oborreve dhe zbresin në sokakë prindët, nënët e motrat e dashura; faqe pas faqeje duket sikur ngrihen para nesh

trimat e patriotët e hershmë: Çercizi, Bajoja, Mihali, Koto Hoxhi, Idriz Guri e baba Çeni; faqe pas faqeje duket sikur tingëllon zilja e shkollës dhe shfaqen para nesh nxënësit e mësuesit, dhe kalldrëmet mbushen me ftyra të njohura prej vitesh; faqe pas faqeje duket sikur fjalët këndojnë këngët e bukura popullore dhe vjershat e Naimit, Çajupit, Mjedës, Nolit; faqe pas faqeje duket sikur edhe shkronjat lundrojnë në detin e dashurisë për popullin e thjeshtë, për gurët e drurët, për malet e luginat, për barin dhe lulet. Ja, kështu do të dalin këto ftyra të dashura e këto vende të shtrenjta nga faqet e librit të shokut Enver «Vite të vegjëlisë». Pena e këtij libri nuk vjen erë bojë shkrimi, por vjen erë mendimi, ndjenje, emocioni, malli dhe dashurie, e cila të rrëmbej dhe të hedh në botën që përshkruan autorin. Dhe ti atëherë, duke e lexuar, thua: «Të falemnderit, Autor, që më dhe një kënaqësi kaq të bukur shpirtërore, të falemnderit që më bëre më fisnik seç kam qenë!»

Libri i shokut Enver «Vite të vegjëlisë» është një këngë malli e dashurie për qytetin e lindjes dhe atdheun. Ai nuk është autobiografi e thjeshtë e një njeriu, por është biografia e një qyteti, biografi që rrezaton në të gjithë Atdheun. Ky libër, përmes kujtimeve, tregon me forcë emocionuese dhe vërtetësi të plotë ideore e artistike se si formohet karakteri i njeriut të dalë nga populli. Kujtimet në këtë libër nuk ndrydhen në kornizat e një gjinie tradicionale biografike. Shoku Enver, duke u mbështetur në faktet dhe ngjarjet e jetës së vet, krijon një vepër, që ngrihet gjer në karakterizimin e një epoke të ekzistencës së popullit dhe të një brezi që po hynte në shoqëri me èndrra të mëdha për të ardhmen, një brezi që po përgatitej të thoshte fjalën e tij në transformimin e botës. Dhe ky brez nuk i përkiste vetëm Gjirokastër, por i përkiste gjithë Shqipërisë. Përshkrimi i Gjirokastër, jetës së vet dhe bashkëkohësve të tij të vegjël e të rinj, të rritur e të moshuar, shërben për mësimet që nxjerr autorin. Shoku Enver flet për dy realitetë të atëhershme shqiptare: për atë realitet që e edukoi me ndjenjën e dashurisë, patriotizmit dhe përparimit, dhe për atë realitet që e ushqeu me ndjenjën e zemërimit dhe të urrejtjes. I pari realitet duhej përkrahur, ndërsa i dyti duhej luftuar. Në të parin janë njërejt e popullit, punëtorët dhe qytetarët e thjeshtë; familja dhe prindët, miqtë dhe intelektualët, shokët e bankave të shkollës dhe moshatarët e lagjeve, të cilët bartin edhe dashurinë edhe respektin për Gjirokastër, për avllitë dhe so-

kakët, pér kalldrëmet dhe strehët. Në të dytin është varfëria, janë pushtuesit, shërbëtorët e të huajve, të regjimit, të errësirës dhe të shtypjes, të cilët nuk e duan Gjirokastrën. Me një fjalë, në libër janë dy pamje: jeta e arsyeshme e njerëzve të ndershëm dhe jeta absurde e mikroborgjezëve dhe njerëzve të shitur. Dhe pesha e madhe e librit anon nga jeta e arsyeshme, nga ajo jetë që të bën optimist dhe të mbush me mall e dashuri pér njerëzit. E them, pesha e librit anon nga pasqyrimi i jetës së arsyeshme, i patriotizmit, i etjes pér përparim e dituri dhe i atdhëdashurisë, pasi shoku Enver, duke përshkruar Gjirokastrën, njerëzit dhe mqediset ku u irrit, do të tregojë se të parën dashuri pér atdheun ne e nisim me dashurinë e vendlindjes, se, siç thotë Çajupi:

*Mëmëdhe quhetë toka,
Ku më ka rënurë koka,
Ku kam dashur mëmë e atë,
Ku më njeh dhe guri i thatë.*

Atdheu në vendlindje e merr konkretësinë e tij, pastaj kjo konkretësi zgjerohet dhe merr kuptimin filozofik e historik. Është vështirë që një njeri që nuk e do vendlindjen e tij, të dojë atdheun. Vendlindja të thërrret edhe në gjumë dhe kjo është thirrja e atdheut, thirrja e tokës, e maleve, e luginave, e fushave, e njerëzve.

Libri «Vite të vegjëlisë» na jep një shembull të shkëlqyer të dashurisë pér vendin e lindjes dhe shokët e vegjëlisë, shokë që autori kurrë nuk i harron, kudo që të ndodhet. Ai, kur i takon, u flet me emër, kujton fëmijërinë, bën shaka e këndon me ta. Për këtë ai vetë shkruan: «Kur shkoj vetë në Gjirokastër, ndiej një gëzim të madh, e ndiej veten ndryshe, më duket sikur njerëzit i njoh të gjithë. Kur pyes ndonjë që nuk e njoh, se është i ri, i kujt është e nga ç'soj është, dhe ai më përgjigjet, një mijë mendime e kujtime më mbulojnë, ndiej kënaqësi të veçantë, pse më kujtohen njerëzit që kam njohur, jeta e tyre, më del përpara edhe digka e vogël, e parëndësishme, po ta mendosh në vetvete, por që merr proporcione të mëdha. Malli nuk pakësohet, por më shtohet.» Kjo është dashuria e vërtetë pér vendlindjen.

Por ka njerëz që edhe përgjegjësinë e një skuadërkoman-danti të marrin, mezi u flasin shokëve të fëmijërisë, madje

edhe emrat ua harrojnë. Këta njerëz edhe në vendlindjen e tyre me vështirësi shkojnë ose nuk shkelin kurrë, se vënë me mendimin e Kuranit, që thotë: «Në vendin tënd nuk bëhesh profet». Përkundrazi, po të jesh pér t'u bërë profet, në radhë të parë, të bën vendlindja, se po s'të bëri ajo, kurë nuk bëhesh!

Ka libra autobiografikë të shkruar edhe nga personalitetë të shquara, edhe nga shkrimtarë të mëdhenj, të cilët mbyllen në jetën personale, që e qëndisin frazën me kuriozitetë sentimentale dhe që dashurohen me vetveten. Por ka libra që autorët e vënë veten në mes të njerëzve dhe përshkruajnë gjithë mjediset dhe shtresat e shoqërisë, gjithë ndikimet e bukura pér jetën e tyre, pér formimin e tyre. Libri i shokut Enver «Vite të vegjelisë» bën pjesë në ato libra të rrallë, ku autori nuk qëndron larg pér të soditur të tjerët, por jeton me njerëzit, éshtë vetë pjesëmarrës në endrrat e tyre, në hallet dhe gëzimet, në trishtimin dhe varférinë; në përpjekjet dhe luftën pér përparim dhe jetë të lirë. Në mes të këtyre njerëzve ne shohim edhe rritjen e autorit. Kjo rritje merr shtytje nga familja, nga baba Çeni e miqtë e tij patriotë, nga furrëxhinjtë e kovaçët, nga muratori të mjeshtrat e gurit, nga i revoluari Idriz Guri e nga mësuesit përparimtarë; kjo rritje merr shtytje nga librat e autorëve të shquar të enciklopedistëve francezë, nga librat e tregimet pér Robespjerin dhe pér heronjtë e revolucionit francez, gjersa arrin zgjimin nga librat e Leninit dhe pér Leninin. Dhe kur arrin gjer në zgjimin nga librat e Leninit, atëherë edhe përshkrimi në vepër merr një ritëm të veçantë, duket sikur bashkë me autorin éshtë zgjuar edhe qyteti, duket sikur ndjen nëpër sokake tingujt e internacionales «Ngrihuni ju, o të munduar! Ju të urët sklevër anembanë!»

Éshtë i mrekullueshëm mendimi që nxjerrim duke lexuar librin «Vite të vegjelisë», mendimi se si autori fëmijë dhe i ri kalon ngajeta në libër dhe nga libri në jetë. Ai ashtu siç kërkon njerëzit, ashtu kërkon edhe librat. Hyn në karakterin e tij që në fëmijëri komunikimi drejtpërdrejt me njerëzit, drejtpërdrejt me librin, të cilat nuk do ti' ndahen kurrë në jetë. Mësim nga njerëzit, mësim nga libri. Me mjeshtëri të rrallë ai di të zbulojë filozofinë e njerëzve të thjeshtë.

Po përmend këtu një ngjarje me sahatçinë Abaz Çuci, kur shoku Enver i flet atij me dashuri pér xha Koli furrxhiun:

«— Dëgjo këtu, o djal i vogël i Gjulos, — më tha xha Abaz Plaku. — Në botë ka njerëz të mëdhenj e të vegjël. Këta janë si aletet e sahatit që punon. Unë i njoh mirë këto alete, më kanë dalë sitë duke punuar... Këto alete të vogla janë shpirti i sahatit, jo pllakat e mëdha. Sahati pa aletet e vogla nuk punon, po u thie «qimja», s'punon sahati, po u çà pllaka e madhe, as prish punë shumë, sahati prap ecën. Kola është «qimja». Ja pse e dua unë furrxhi Kolën», — më tha xha Abaz shurdhi e mendjemprehti.» Dhe shoku Enver përfundon: «Tash, i dashur dhe i nderuar xha Abaz Çuç. të kujtoj me mirënjohje të thellë, kujtoj dhe kuptoj filozofinë e thellë të fjalëve të tua të thëna në gjuhën e popullit, mbi vlerën e madhe dhe vendimtare në zhvillimin e shoqërisë dhe të përparimit të shtresave të vegjëlisë, të popullit. Mirënjohje të pafund nga unë, për ty dhe për shumë të tjerë si ti, që më mësuat qysh kur isha i ri të dua vegjelinë dhe t'i shërbej asaj me besnikëri deri sa të kem jetë.» Ky është një përgjithësim i madh filozofik që bën shoku Enver duke u nisur nga mençuria e një njeriu të thjeshtë, përgjithësim që jep edhe një nga idetë kryesore të librit.

Për mençurinë popullore shoku Enver ka një dashuri e një respekt të thellë. Kjo vihet re jo vetëm në përdorimin e thënieve të mençme të njerëzve të popullit, por edhe në shfrytëzimin e vargjeve të bukura të këngëve të rralla popullore. Këto ai di t'i përdorë me mjeshtëri atje ku dëshiron të plotësojë një mendim, atje ku do t'i japë shprehjes një gjallëri të veçantë dhe një forcë elektrizuese. Atëherë me këto shprehje ambientet tipizohen dhe njëkohësisht individualizohen dhe marrin një ngjyrë krejtësisht origjinale, marrin ngjyrën e kohës dhe të epokës.

Libri «Vite të vegjëlisë», i përshkuar nga ndjenja e thellë e dashurisë për Gjirokastrën, për atdheun, për natyrën, për njerëzit, për duart e mjeshtërve të mëdhenj, të arkitekturës popullore, për historinë, për folklorin e për gjithë pasurinë shpirtërore të popullit, është shkruar me një gjuhë të pasur, plot ngjyra e plot lirizëm. Fjala në këtë libër bën çudira, i jep gurit jetë, bën të këndojnë sokakët, bën të nusërojë Kucullën, bën kalanë e Argjirosë të lundrojë si një kryqëzor madhështor në dallgët e shtëpive, bën si pëllëmbë dore Gjirokastrën, pëllëmbë të trupit të madh të atdheut, bën t'i shohim të gjallë patriotët, dijetarët dhe poetët tanë të Rilindjes dhe bën të ngrohet me frymën e dashurisë Ma-

lin e Gjerë. Kjo është fuqia e fjalës së Enver Hoxhës, fuqi që e kemi parë në gjithë librat e tij.

Libri «Vite të vegjëlisë», ashtu si vargu i madh i veprave të shokut Enver, hyn në kulturën tonë me një origjinalitet të veçantë, i ndryshëm nga librat e tjerë të tij, por me të njëjtin ideal e të njëjtën frymë militante e komuniste. Dhe këtu qëndron edhe bukuria e një vepre.

1983

KUR MENDOJMË PËR «ZËRIN e POPULLIT»

Sa kujtojmë luftën, përfytyrojmë krismën e armëve, vërvshëllimën e plumbit dhe të hekurit. Ky është zeri i parë që na vjen në kujtesë nga largësitë e viteve. Por lufta përliri ka edhe një krismë të fuqishme, ka edhe një zë tjetër të plotpushtetshëm — zërin e armës së fjalës që gjëmon nga kolonat e gazetës dhe nga rreshtat e traktit. Kjo do të thotë se në sheshin e betejës nuk ka qenë gjithmonë vendimtar vetëm metali, por edhe gjëmimi i fjalës së shkruar. E ndiejmë edhe sot këtë gjëmim të armës së fjalës nga kolonat e «Zërit të popullit» të epokës së madhe të Luftës Antifashiste e Nacionalçlirimitare. Vërvshëllimat e plumbave të partizanit të asaj epoke nuk janë të regjistruara në aparatura të posaçme, që t'i dëgjonim edhe sot kur t'i donim. Ato i dëgjojmë përmes fjalës së «Zërit të popullit» të atyre viteve, «Zërit të popullit» partizan që qëndron para nesh si monument i pavdekshëm, ku është skalitur një histori e lavdishme, ku janë derdhur në bronz anketat e biografisë sonë.

Në ballin e këtij monumenti të gjallë janë fjalët-lapidarë që i gdhendi themeluesi i tij, i pari redaktor dhe i pari publicist mendjendritur i shtypit tonë komunist, Enver Hoxha. «Zëri i popullit» do të grumbullojë rrötull tij të gjitha energjitet e atyre që e kanë marrë vesh një herë e mirë:

*Se liria fitohet,
por nuk dhurohet»*

Kështu, më 25 gushtin e 1942-së në qellin e yjeve partizane shkëlqeu një yll i madh në kapelën e partizanit komunist me emrin «Zëri i popullit». Atëherë filloi një epokë tjetër në historinë e shtypit tonë, epoka e shtypit të Partisë, epoka e shtypit komunist. Shtypi veshi rrrobat partizane. Rilindi fjala dhe fitoi tjetër peshë, shkronjat e alfabetit formuan një shkrim të ringjallur të një mënyre të re, të një tingëllimi të padëgjuar ndonjëherë. Enver Hoxha udhëhiqte një luftë të re, të një stili të ri, Luftën Antifa-shiste Nacionalçlirimtare, revolucionin popullor. Ai harmonizonte stilin e luftës dhe stilin e të shkruarit. Duhej shkruar ashtu siç luftohej. Gjuha e gazetave të shkonte në harmoni me gjuhën e armëve të luftëtarëve të revolucionit. E shtëna e fjalës të barazohej me të shtënën e pushkës së partizanit. Kjo fjalë qëlloi edhe mbi kështjellën e kalbur të shtypit të zbukuruar zyrtar të reaksionit dhe të mbretërisë së errësirës. Ajo dilte nga fletët e thjeshta të shtypura në shaptilografë dhe shtypshkronja të vogla nga duart e tipografëve patriotë e revolucionarë. Kalemxhinjtë me pantallona të hekurosura dhe me flokët me brillantinë, para djemve e vajzave të zgjuara të revolucionit që thoshin fjalën e re, ngatërronin frazat dhe përzienin fjalët e mpira, duke harruar si në amnezi gjuhën shqipe. Fjala e këtyre kalemxhinjve ishte e vyshkur, e trashë dhe banale. Lindte një gazetari e re me gazetarë të rinj, me mendim të ri. Universitarët para këtyre gazetarëve ishin si guakë trutħarë, që mezi ndértonin një frazë. Universiteti i parë i gazetarisë së re komuniste shqiptare u bë «Zëri i popullit» me profesor Enver Hoxhën. Ai nuk jepte mësim nga katedra, por jepte mësim me letrën dhe lapsin përpara, duke shkruar dhe redaktuar. Mësimin e parë në këtë universitet ai e filloj me kryeartikullin e numrit të parë të «Zërit të popullit», më 25 gusht 1942, me këto fjalë: «Ka një mision, ka një qëllim....» Universiteti i gazetarisë komuniste nuk pranonte hyrje me fraza të mjegullta. Kërkonte frazën e kristaltë: «Ka një mision, ka një qëllim...». Publicistët e rinj duhet të mësonin të mendonin në mënyrë komuniste në universitetin e luftës. Dhe ai që udhëhiqte këtë universitet shkruante gati në çdo numër të «Zërit të popullit». Unë po marr nënstorin e 1942-së. Vetëm në këtë muaj shoku Enver ka shkru-

ar dhjetë artikuj. Në çdo tri ditë shkruante një artikull! Ka pasur e ka njerëz që jetojnë vetëm me profesionin e gazetarit dhe mezi shkruajnë një artikull në muaj!

Me këtë prodhimitari krijuese Enver Hoxha përhapte flakën e revolucionit, shpinte në popull dhe te luftëtarët zërin e Partisë dhe njëkohësisht e mësonte plejadën e re të gazetarëve se si duhej shkruar. Mendimet e tij të thella përmes fjalës së gjallë, të zjarrtë dhe të bukur e gjenin rrugën shumë shpejt në zemrat dhe mendjet e njerëzve dhe besimi në fitoren rritej dita-ditës. Përmes fjalës së tij rizbulohet historia, rivlerësohet trimëria dhe patriotizmi, ringjalleshin faqet e librave të lexuar dikur. Çdo gjë merrte një kuptim të rj nën dritën e revolucionit. E përsëris: luftë e tipit të ri, shkrim i tipit të ri; krisma e fjalës në harmoni me krismën e armëve të revolucionit!

Zëri i popullit» e mbajti të pasuar zjarrin e epokës së luftës pér liri e socializëm, shpirtin mobilizues, virtytet e agitatorit të madh kolektiv dhe pasionin e tribunit të vërtetë militant. Në çdo vatër shqiptare ai ka gati gjysmë shekulli që çon idetë ngadhënjimtare të Partisë dhe mësimet jetëdhënëse të shokut Enver. Në faqet e tij vjen jeta e Republikës, vijnë mendimet dhe ëndrrat e punëtorëve, fshatarëve, intelektualëve dhe ushtarëve. Përmes këtyre faqeve shkëlqen viaja e kristaltë e Partisë dhe lufta e saj parimore pér mbrojtjen e marksizëm-leminizmit kundër armiqve të tèrbuar imperialistë, revisionistë dhe deviatorëve. Pranë kësaj tribune të fjalës së Partisë gjithmonë ka qenë kujdesi i drejtpërdrejtë i shokut Enver, udhëzimet dhe këshillat e tij pér të ngritur nivelin e shkrimeve dhe pér të kërkuar nga herë mendime të freskëta. Edhe nën zjarrin e luftës, në ilegalitet dhe në marshime ai këshillonte që «Zëri i popullit» të thoshte fjalën e tij të zgjuar dhe luftarakë dhe e kërkonte ngaherë ta kishte me vete: «Mos harro që të më çosh në Elbasan edhe «Zërin e popullit», që doli kur ika unë...» — i shkruante Gogo Nushit në qershor të 1943-së, me t'u kthyer nga Vlora, ku shpartalloi fraksionin e Sadik Premtes. «Kujdesuni pér «Bashkimin», që të shkruhen artikuj në mënyrën dhe frymën e artikullit të «Zërit të popullit», numri i fundit.» — e këshillonte Bacën më 20 shtator 1943. «Pra, duhet sa më parë të dalë «Zëri i popullit», ku të shtypet ky artikull që po të çoj dhe ai që po bën ti...» — i shkruante Nako Spirut më 29 shtator 1943. «Letrat tonë dhe artikujt e «Zërit të popullit» e të «Bashkimit» të mos janë

për shokët artikuj sa pér të shkuar kohën, por artikuj direktë, të cilët duhet të punohen.», — i udhëzonte komitetet qarkore të Partisë më 1 tetor 1943. «Për këtë trakt këndoni dhe «Zërin e popullit» të ardhshëm dhe i lexoni artikujt jo veresie, por si artikuj ku jepen direktivat e punës.» — porosiste Qarkorin e Gjirokastrës po më 1 tetor 1943. «... Shokët që merren me shkrime, duhet të mësohen pér të mbushur «Zërin e popullit» dhe të mos mësohen duke pritur që t'ua përgatitë tjetri që nga fillimi deri në fund.» — jepte udhëzime në nëntor të 1943-së. «Jemi duke përgatitur artikuj pér të përcaktuar vijën pér shumë çështje, por na shkruaj ç'bëni me të famshmet gazeta «Zëri i popullit» e «Bashkimi».» — i shkruante Nako Spirut në mars të 1944-ës e me radhë. Bile, edhe pér gjëra që ndonjërit mund t'i duken të vogla, nuk harronte t'i kujtonte shokët: «Në gazeten «Zëri i popullit» duhet të shtonit «Viti i 2-të» që keni harruar ta vini.» — i shkruante Gogo Nushit në tetor të 1943-së.

Me këtë kujdes dhe pasion e rriti shoku Enver «Zërin e popullit», shtypin popullor dhe gjithë gazetarët. Vitet kalonin. Shqipëria ngjitej në shkallët e socializmit. Redaksitë gumëzhinin. Linotipët 'trokisin' dhe rrrotativat zhurmonin, duke palosur mijëra e mijëra kopje gazetash, por shoku Enver gjithmonë qëndronte pranë shtypit, gjithmonë këshillonte, gjithmonë shkruante, gjithmonë luftonte që të rritej pesha e fjalës. E kush e ka vlerësuar misionin e gazetarit më lart se ai? E paktë është ajo që ne gazetarët na quan arkitektë të mendimit revolucionar të masave? Ky ndërim duhet të na bëjë ngaherë të mendohemi!

«Zëri i popullit» ka një mision, ka një qëllim...». Ne jemi rritur me «Zërin e popullit». Atë mision dhe atë qëllim kemi edhe ne, misionin: të ndërtojmë shoqërinë e re socialistë dhe komuniste...

GJURMË TË PASHLYERA

1

Personalitetet e mëdha politike e shoqërore, udhëheqësit, dijetarët dhe shkrimtarët e famshëm gjithmonë kanë lënë gjurmë të thella në jetën e atyre bashkëkohësve që i kanë njojur nga afër. Ka bashkëkohës që këto gjurmë nuk i kanë lënë të fshihen, por i kanë hedhur në letër dhe ua kanë bërë të njoitura njerëzve të kohës së tyre dhe brezave që kanë ardhur më pas. Kujtimet e tyre për këto personalitetë na mahnitin dhe na zgjojnë mendimin dhe fantazinë për epoka të tëra historike, për kohën dhe njerëzit. Duke i lexuar sot, ne padashur themi: «Ç'fat kanë pasur! Kanë qenë bashkëkohës të këtij ose atij njeriu të madh!» E çmund të thoshim ne, sikur të ndodhët një mrekulli dhe të gjenim, fjala vjen, kujtimet e një boshkëkohësi të Skënderbeut ose të Naim Frashërit? Dhe le të ishte ky bashkëkohës edhe një njeri fare i thjeshtë dhe fare i zakonshëm! Në sytë tanë ai do të merrte përmasa të mëdha.

Unë dhe moshatarët e mi, që hymë në epokën e shoqërisë së re jo përmes Luftës Antifashiste Nacionalçirimitare, pasi atëherë kemi qenë të vegjël, përsëri patëm fat të jemi bashkëkohës me Enver Hoxhën, udhëheqësin, mësuesin dhe

njëkohësisht shokun tonë të frontit të madh të socializmit në një nga epokat më të mëdha dhe më epike të historisë së Shqipërisë. Shumë nga ne ruajmë kujtime të paharruara se kemi pasur çaste në jetë që të jemi takuar dhe të kemi folur e kuvenuar, ashtu si mijëra bij të thjeshtë të popullit. E them këtë, pasi takimet me shokun Enver nuk janë privilegji një qarku të ngushtë njerëzish. Një veti e tij e bukur është të takohet e të kuvenojë me dashuri me të gjithë njerëzit, që nga bariu më i thjeshtë i dhenve e gjer tek akademiku më i shquar. Një nga devizat e tij në jetë është: «Gju më gju me popullin».

Në cilëndo fushë të veprimtarisë shoqërore të jenë këta njerëz, me të cilët shoku Enver takohet, ai di tu flasë me gjuhën e tyre, pasi ua ndien shpirtin dhe ka njojuri për gjithë sferat e jetës dhe të diturive njerëzore. Edhe këta njerëz të popullit kanë kujtimet e tyre, pavarësisht se nuk i shkruajnë të gjithë. Por ata dinë të tregojnë bukur me gjuhën plot lëng dhe plot ngjyra.

Si shumë moshatarëve të mi, që na ka ndodhur të punojmë në gazeta ose në sfera të kulturës, të artit dhe të veprimtarisë shoqërore, më kanë lënë gjurmë të thella të gjitha takimet që kam pasur me shokun Enver. Tani që rri dhe shfletoj fletoret e hershme me shënimë, tani që sjell në mend çastet e takimeve, përfytyroj bisedat, thëniet, këshillimet, shokët dhe veten time. Shpesh kam dashur t'i rishkruaj e t'i zgjeroj këto kujtime, sado të pakta, por kam pasur druajtjen se vallë do të mundja ta jepja të plotë atmosferën dhe gjendjen e kohës kur janë bërë bisedat. Megjithatë, vjen një çast kur nuk mund të rrish dot pa shkruar. Diçka e brendshme të shtyn dhe duket sikur ta vendos vetë letrën dhe lapsin në tryezë. Dhe atëherë fillojnë e ziejnë vitet, fillojnë e trokasim mendimet. Por, të themi atë që është: të shkruash kujtime nga çastet e jetës së një udhëheqësi nuk është një punë e lehtë, se kërkohet vërtetësia e mendimit dhe saktësia e fjalës, se kërkohet fraza e zgjuar, e shkarkuar nga propaganda e rëndomtë dhe agitacioni bërtites. Vetë shoku Enver nuk i do dhe nuk i pranon këto fraza dhe shpeshherë ka folur kundër tyre edhe në bisedat edhe në fjalimet, edhe në librat e tij me kujtime.

Për herë të parë e kam takuar shokun Enver më 16 tetor 1963. Atëherë kisha gjashtë vjet që punoja në gazeten «Zëri i popullit». Më njoftuan se do të shkonim në shtëpi t'i uronim 55-vjetorin e lindjes. Mua më pushtuan emocio-

net, se ishte hera e parë që merrja pjesë në një takim të tillë. Mezi rrija në redaksi dhe një e një shikoja orën që të vinte afër dhjetës, kur do të niseshim. Unë kisha ëndërruar të takohesha me shokun Enver, ashtu siq ëndërojtmë sot të gjithë, siç ëndërojnë fëmijët tanë, të rintjtë e të moshuarit. Më dukej vetja sikur isha përfaqësuesi i gjithë shkrimtarëve e gazetarëve të rind, sikur më dërgonte gjithë qyteti, sikur më përcillte gjithë fshati im, ku kalova fëmijërinë dhe ku e dëgjova për herë të parë emrin e tij, nga komunistët dhe partizanët. Sa herë kisha shkruar në vjersha dhe në artikuj për të! Sa herë e kisha dëgjuar zërin e tij në radio! Sa herë i kisha lexuar fjalimet në gazeta dhe i kisha parë foto-grafinë! Sa herë e kisha parë në mitingje e në mbledhje të mëdha! Dhe ja, tanë vija ta takoja, kur isha bërë gazetar në «Zërin e popullit», njeri i letrave dhe i kulturës! E ndjeja veten edhe më të rritur, sikur të kisha qenë pranë tij partizan në male! Por përsëri nuk më largohej emocioni. Dhe ky emocion nuk m'u hoq ndonjëherë. Edhe sot, kur takohem, më ndjek emocioni, megjithëse i kam kaluar të pesëdhjetat.

E kështu, shkuam në shtëpinë e shokut Enver. Në hyrje kishte edhe shkrimtarë të tjera, ishin Dhimitër Shuteriqi, Shevqet Musaraj, Llazar Siliqi dhe dy-tre moshatarë të mi. Unë u qetësova pak kur pasië se edhe ata kishin emocione. Kur hymë, të gjithëve na zuri përdore, duke buzë-qeshur. Ai qëndronte para nesh i gjatë, i ciltër, i veshur me një kostum blu të errët e me kravatë vishnje. Dhimitrit, Shevqetit e Llazarit u fliste me emër dhe bënte shaka me ta.

— Po këta cilët janë? — tha ai për ne të rintjtë.

Shevqet Musaraj e Dhimitër Shuteriqi i folën pak për ne si gazetarë e shkrimtarë të rind. Unë u skuqa i téri, kur shoku Enver përsëriti emrin tim të gjatë. Kisha frikë se mos e shprehte gabim këtë emër të vështirë, por ai e shqiptoi me saktësi, sikur të më kishte njojur.

Ato ditë, për dreq, ishte botuar në «Zërin e popullit» një artikull imi me një titull sensacional: «Galeri arti apo depo grumbullimi» ku kritikohej drejtoria e galerisë dhe Ministria e Arsimit dhe e Kulturës për pakujdesinë që tregonin për veprat e arteve figurative, të cilat po i prishte lagështira dhe nuk merreshin masa as për restaurimin e tyre. Unë nuk do të kisha dëshirë që ai artikull të ishte botuar ato ditë! «Po sikur ta ketë lexuar shoku Enver dhe të mos i ketë pëlqyer, dhe ja, tanë, i del autorit ballë për ba-

llë? C'm'u desh t'i vija këtë titull!» — mendoja dhe më rriddhnin djersët nga balli, aq sa e humba dhe s'dija se këtë ulesha.

— O, — tha shoku Enver, — këta që nuk na e mbushin syrin tani, janë si floriri që është i vogël, por ç'vlerë ka se! — dhe qeshi duke na shikuar me dashuri ne më të rinjtë. Pastaj shtoi: — E këndova atë artikullin për Galerinë e Arteve. Mirë ua kishe bërë edhe atyre të Ministrisë së Arsimit e Kulturës, edhe të tjerëve. Po ata nuk skuqen se u është bërë lëkura si shollët e opingave të... — shoku Enver qeshi dhe përmendi emrin e një opingari gjirokastrit, që nuk më kujtohet. Dhe pastaj foli se si ruhen pikurat nëpër galeritë e arteve nga lagështira, kujdesin që duhet të kemi për ajrosjen e tyre dhe se si herë pas here kanë nevojë për restaurim.

— Këto janë vlera të mëdha dhe vlerat duhen ruajtur. Të bëjmë kujdes, — tha Ai.

Atëherë unë mësova që shoku Enver e përdor shprehjen «të bëjmë kujdes» dhe «jo të kemi kujdes», siç flasim ne. Kjo ishte një hollësi që zakonisht e vënë re vetëm shkrimitarët. Mua sakaq m'u largua druajtja. Shoku Enver di t'u krijojë njerëzve gjendje të mirë shpirtërore me mënyrën e komunikimit të lirë e të gjiltër, si një mësues i kujdesëshëm dhe si një shok i vërtetë.

Atë ditë mua më bëri përshtypje të thellë, jo vetëm kujdesi i tij i madh për artin, po edhe leximi i çdo artipak të njobur. Në atë kohë unë isha një poet dhe një gazetar fare i ri. Gjer atëherë ndofta nuk kisha menduar aq thellë për ndjenjën e përgjegjësisë qytetare të atij që shkruan në gazetë ose në libër. Që atë ditë filloi të më rritej kjo ndjenjë dhe sa herë shkruaja, thosha me vete: «Vërtet këtë do ta lexojnë qindra njerëz, por do ta lexojë edhe shoku Enver!»

Por ndonjëherë, sado kujdes të ketë njeriu, i vjen e keqja padashur. Në 12 prill të 1964-ës botova një artikull bëjnë të qeshim?» Ngaqë aq ma preu, në artikull, ndër të tjera, aludoja që disa estrada, meqë nuk i ngopim dot me material letrar, duhej t'i mbyllnim! Kjo ishte me të vërtetasë një lajthitje dhe një mungesë pjekurie, që sot quditëm se si e kam shkruar! Pas katër ditëve të daljes së këtij artikulli, ndodhi që u mbajt një mbledhje e Sekretariatit të KQ

të Partisë, ku merreshin në analizë estradat. Atje shoku Enver tërroqi vërejtjen që shkrimtarët duhet të shkruajnë pér estradat dhe të mos i nënveftësojnë. «Shkrimet pér estradë, — tha Ai, — kanë rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Shkrimtari mund të shkruajë në gazetë, po një skeç i shkruar prej tij dhe i vënë në skenën e estradës do të bëjë një efekt shumë më të madh pér edukimin e masave. Ai mund të bëjë një kritikë në «Zërin e popullit», por kjo kritikë nuk mund të ketë efekt të tillë, siç mund të kishte në një skeç të estradës.» Artikulli im nuk përshkohej nga këto ide të shokut Enver, por merrej me mjaft gjëra anësore pér estradat. Shoku Enver nuk e kishte pëlqyer edhe pér fryshtën nënveftësuesë. Prandaj, me të drejtë, kishte thënë afërsisht: «Këta artikuj, mua, këtej më hyjnë, këtej më dalin.» Kjo nuk ishte një gjë e lehtë pér mua. U dëshpërova dhe u mërzita që e kisha humbur pér një çast mendimin e mirë pér artikujt e dikurshëm. Por shoku Enver ka një vëmendje të madhe pér njerëzit e letrave dhe arteve. Ai e ndjek krijimtarinë dhe shikon evolucionin e tyre, shikon si shëmangën dobësitë, shikon si zhvillohet talenti. Kur e vë re këtë evoluim, ai të nxit me forcë, paçka se mund të të ketë kritikuar më parë. Kështu ndodhi edhe me mua. Pak më vonë, pér një artikull timin, ku kritikoheshin tekstet e këngëve, në Plenumin e 15-të të KQ të PPSH më 26 tetor 1965, Ai tha: «Vjershat banale të disa poetëve që Dritëro Agolli i godiste me të drejtë me kamxhik në një artikull të «Zërit të popullit», preferohen prej muzikantëve tanë dhe mbi to bëjnë muzikën.» Pas kësaj u bëra me krahë dhe m'u thelluan bindjet se kritika e Partisë gjithmonë është konstruktive dhe të bën që të vështrosh përparrë.

2

Njeriu kur takohet me shokun Enver jo vetëm që ndien një kënaqësi të thellë, por edhe pasurohet shpirtërisht. Ashtu siç mëson nga librat e tij, mëson edhe nga bisedat dhe këshillat e urta, mëson pér fushën e veprimtarisë ku punon dhe pér fusha të tjera të jetës. Në fjalët e tij ndien kulturën universale dhe mbushesh me optimizëm pér

mundësitë që ka mendja e njeriut në përvetësimin e diturive që ka grumbulluar njerëzimi. Ai gjithmonë është mësues, me veprën e tij të madhe e të pavdekshme është mësues, me takimet e këshillimet është mësues. Me të e ndien vëten të lirë e të pafrikshëm, sikur ke rrëth teje kështjella të panumërtë dhe armata të tëra. Siç thashë, në fillim tronditesh dhe impresionohesh, pastaj qetësohesh si pranë një shoku të ngushtë, të njojur prej kohësh.

Mua më ndodhi të drejtoja një seancë në Kongresin e 7 të Partisë, në nëntor të 1976-ës. Kam ndenjur një orë e gjysmë krah tij. Atë pasdite ai ishte plot humor. Përpara kishte një fletore, siç kishim edhe ne delegatët e Kongresit. Në fletën e parë kishte shkruar me shkronja të mëdha «Kronika e Kongresit». Kishte mbushur faqe të tëra me mendime për Kongresin, për atmosferën dhe për diskutanët. Unë e pyeta:

— Ku i mbani shënimet ju, shoku Enver, në fletore apo në fletë letre të një formati të vogël?

Shoku Enver qeshi, se ndofta iu duk si e çuditshme pyetja ime. Por unë doja të dija ç'do gjë gjer në imtësitë.

— I mbaj në fletore, se letrat e palidhura shpërndahen dhe humbin, — tha ai po me atë buzëqeshje.

Bisedën na e ndërpren kryetari i delegacionit të Partisë Marksiste-Leniniste të Belgjikës, të cilit ia dhashë fjalën më e drejtoja seancën. Tek dëgjonim belgun, i them shokut Enver:

— Këta belgët kanë një poet të madh, i cili ka krijuar në fund të shekullit të 19 dhe në fillim të shekullit tonë.

— Em'l Verharnin! — tha ai pa e mbaruar frazën unë.

— Atë desha të thosha, — bëra unë.

— Është poet i madh. Ka shkruar për punëtorët, për varférinë, për qytetin e proletarëve... Kur kam qenë në Belgjikë, kam lexuar shumë nga Verharni. Kam jetuar ca kohë në Belgjikë, tha ai i menduar, sikur donte të sillte në mend vargje nga të Verharnit.

Unë për një çast u ndodha ngushtë, se pata frikë mos më pyeste se ç'vjersha dija nga Verharni. Vërtet e kisha lexuar këtë poet, por konkretisht, vjershat nuk më kujtohen.

— Ka një vjershë për punëtorët e varfër që rrinë pranë mureve të pallateve të mëdha..., — tha shoku Enver.

Unë pohova me gjysmë zëri, se vjersha nuk më kujtohej. Ndërkohë belgjiani e mbaroi diskutimin dhe duhej t'ia

jepja fjalën një tjetri. Dhe kështu shpëtova nga turpi që po më kanosej. U ngrit të diskutonte një nga Amerika Latine, por këtë radhë unë nuk përmenda ndonjë poet të këtyre vendeve, nga druajtja se mos papritur ndodhesha në padituri...

Në dukje ky është një episod i thjeshtë, por ka një domethënie të gjerë që të vë në mendime. Shoku Enver ka një njojje të gjithanshme dhe të thellë për letërsinë kombëtare dhe botërore, duke filluar që nga antikiteti dhe gjer në kohët e sotme. Këtë njeriu e vë re menjëherë në librat e fjalimet e tij, në takimet dhe bisedat me historianë, shkrimtarë, artistë e intelektualë. Mund të ndodhesh edhe në vështirësi, pasi mund të mos e kesh lexuar ndonjë shkrimtar të njojur, për të cilin të flet ai. Në këto çaste është më mirë të heshtësh, ose të thuash që nuk e ke lexuar, sesa të tundësh kokën dhe të shtiresh sikur e di. Vetëm një njeri me kulturë të gjerë letrare mund të shkruajë libra që të rrëmbejnë përnjëherësh që në faqet e para, libra si «Hrushovianët», «Kur lindi Partia», «Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë», «Titistët» e të tjera, dhe gjer te më i freskëti, «Vite të vegjelisë», ku fjalë është e mbrujtur me mendim të thellë dhe vlon me emocionin dhe ngjyrën e gjallë. Edhe në librat, veprat e tij politike dhe ideologjike nuk mungon kurrë fjalë e kulluar letrare dhe lëngu i ligjëratës plot mençuri popullore, ose sentenca e mprehtë intelektuale, që shpreh kulturën e pasur filozofike.

Mua, si shkrimtar, më vë në mendime edhe një gjë tjeter: Fjala e shkuar e shokut Enver përputhet me fjalën e bisedës, e cila mban po atë kolorit dhe po atë bukuri që ka edhe në libër. Ajo, sa shprehet, menjëherë zë vend në ndërgjegjen e bashkëbiseduesit, sikur të jetë lexuar me vëmendje në faqet e librit, zë vend pasi bart me vete origjinalitetin dhe të papriturën e bukur.

Por le të kthehem përsëri në bisedën për poetin belg. Me sa duket, shoku Enver mori shkas nga vjershat e Verharnit, që pasqyron varférinë dhe degradimin e njeriut në borgjezi, dhe më foli për një dramë që kishte dhënë televizioni ato ditë. Dramën e kishte vënë në skenë Teatri Popullor. Ajo zhvillohej në Myzeqenë e paraçlirimit dhe trengonte vuajtjet e njerëzve dhe revoltën e tyre, por gjithçka përmes një varfërie të tmerrshme, ku shpirtërisht çdo gjë degradonte.

— Njerëzit zvarriten nëpër baltë, si robër, — tha shoku

Enver, — janë krejtësish të dërrmuar. Para Çlirimt ata vërtet kanë qenë të varfër, por nuk kanë qenë robër. Fshatarësia jonë nuk ishte bujkrobe, ajo ishte e lirë. Kishte në odë edhe një rrobe të pastër e të bukur. Nuk është e goditur drama. Të jemi më realistë...

Kjo thënie për mua kishte një kuptim të madh për problemin e pasqyrimit të njeriut si tip social në kushtet konkrete, historike të pasqyrimit me vërtetësi. E them këtë, pasi ne shpesh për të treguar ndryshimet e mëdha të shoqërisë sonë me të kaluarën, i 'varfërojmë shpirtërisht njerëzit që kanë jetuar në epokën e paraçlirimt. Nga një bisedë e shkurtër njeriu mëson një të vërtetë të plotë, që ndonjëherë nuk e gjen në librat teorikë dhe në kritikën letrare.

Pastaj shoku Enver pyeti për letërsinë, se ç'po shkruanin shkrimitarët, duke përmendur edhe emrat e tyre. Atëherë Ismail Kadareja e kishte botuar romanin «Dimri i vëtmisë së madhe», për të cilin lexuesit kishin vërejtje, me gjithë temën e rëndësishme të kësaj vepre.

— Para se ta ribotojë, — tha shoku Enver, — kujdesuni që ta përpunojë edhe një herë. Ai roman ka një temë tē mirë, luftët kundër revizionizmit. Ismaili do t'i kuptojë drejt vërejtjet. Ta ndihmoni njëri-tjetrin. Tani është rritur lexuesi. Ja, i dëgjon sa bukur diskutojnë edhe njerëzit e thjeshtë?

Unë u preka nga interesimi i gjithanshëm i shokut Enver për krijimtarinë e shkrimitarëve, për vëmendjen e tij të veçantë edhe për vepra konkrete edhe për emra autorësh. Për një çast rashë në mendime për veten e për kolegët e mi, që ndonjëherë jemi të pavëmendshëm ndaj jetës dhe krijimtarisë së njëri-tjetrit. Prandaj, thashë pak më lart në këto shënime, se takimet dhe bisedat me shokun Enver të zgjojnë mendime e tē mësojnë, ashtu si librat e tij.

Shoku Enver i ndiqte me një interes tē madh diskutanët në Kongres dhe herë pas here shënonë në fletoren e tij.

— Ka mendime shumë tē mira, — tha ai. — Është rritur kultura e njerëzve. Ne kur diskutojmë në kongrese nuk duhet tē mbyllemi në guaskën e temës. Është mirë që ta shtrijmë mendimin, se kështu i shohim gjërat më mirë. Ja, njëri këtu foli për arritjet në rrëthin e Përmetit, për thekren që bëhet në Frashër. Bukur. Po Frashëri është vendindja e Naimit, e Abdylit, e Samiut. Ai duhet ta lidhëte diskutimin me këta rilindës tē mëdhenj. Mirë që bëjnë thekér,

por thekér në Frashër kishte edhe në kohën e Naimit. Apo jo! — qeshi shoku Enver.

Unë heshta. Mendja më fluturonte nëpër kohëra, nëpër Shqipëri, nëpër njerëz. Mendoja se si duhen marrë gjërat në kompleksitetin e tyre, në ato që duken dhe në ato që nuk duken, siç i merr filozofia. Filozofia!

Unë kam bindje të plotë se në thellimin e filozofisë marksiste-leniniste, në përvetësimin e materializmit dhe dialektikës, teorisë së kulturës dhe të artit, rol vendimtar për ne ka luajtur vepra poliedrike e shokut Enver. Kur them në përvetësimin, kam parasysh zbatimin konkret në jetë, se nuk mjafton t'i mësosh këto dukuri për kulturë të përgjithshme dhe për stoli intelektuale që të tregosh zgjuarsi në dialog me një bashkëbisedues. Ne i lexuam dhe i lexojmë veprat e Marksit dhe të Leninit, që janë thesarët dhe armët tonë. Por ky lexim do të ishte i pamjaftueshëm, sikur të mos kishim një mësues për të na drejtuar si t'i zbatonim këto mësime. Ky mësues, Enver Hoxha, marksizëm-leninizmit nuk na e dha përmes grumbullit të fjalëve, sofizmave dhe dogmave të ngurtësuarë, por na e dha në lëvizje, në zhvillim të pandalshëm dhe në vlim të përhershëm. Kjo është arsyja që e përvetësuam marksizmin.

3.

Si njeri i letrave, kur jam takuar me shokun Enver ose e kam shoqëruar si gazetar, gjithçka më ka bërë përshtypje. Më ka bërë përshtypje të veçantë edhe dashuria e tij për natyrën, për malet e thinjura dhe pyjet e kaltra, për lumenjtë dhe lëndinat, për fshatrat dhe oxhakët që tymojnë. Dhe këtu kam zbuluar shpirtin e tij prej poeti të vërtetë. Kjo dashuri ndofta ka ndikuar në frazën dhe fjalën e tij aq me kolorit, aq me poezi, aq me ngarkesë emocioni. Për natyrën ai flet gjithmonë, flet edhe në raporte kongresesh, pale pastaj në librat me kujtime, ku pasazhet janë të mahnitshme. Kam qenë në ekspositën etnografike «Kultura popullore shqiptare» më 23 maj të 1977-ës, kur erdhi për vizitë shoku Enver. E ndiqja me vëmendje kur shikonte maketet e kasolleve të staneve, çezmat, këmborët e dheneve, kërrabat e barinjve, kur dëgjonte në magnetofon fyellin e çobanit dhe

të lehurat e Balos. Ai çmallej para tyre dhe e ndiente bukurinë gjer në shpirt. Duke i shikuar kasollet, tha:

— Kur udhëtoj dhe shikoj fshatrat rrëzë maleve ose fushave të gjelbëruara, them me vete: «Ja atje dua të futem, dhe të mos më gjejë njeri, të rri atje nga 15 ose 20 ditë!» — dhe m'u kthyesh mua: — Bën shumë mirë që vete tamam në këto qoshe e shtëpi. Vendi ynë është i bukur, por këtë bukuri duhet ta njohësh, ta studiosh, që ta pasqyrosh me vërtetësi.

Ai bukuritë e natyrës i ndien edhe përmes veprës apo kujtimeve, apo rrëfimeve të shkrimitarëve nëpër biseda. Tek shikonim në ekspositën e kulturës popullore ikonostasin e famshëm të Leusës së Përmetit, tha:

— Unë nga Leusa kam kujtime të mira. A e dini nga më vijnë këto kujtime? Nga Epaminonda Bulka, se nga Leusa ishte. Nonda qe njeri i mirë i dashur, optimist dhe demokrat, pastaj ai bëri përparime dhe u lidh ngushtë me Partinë e me popullin. Kam fjetur në internatin e Korçës tok me të në një dhomë. Që në atë kohë Nonda bënte poezi të mira.

Dashurinë e shokut Enver për natyrën ndofta më mirë se çdo herë tjetër unë e vura re në udhëtimin që bëri në veri, në Kukës, Tropojë e Pukë në maj e qershor të 1970-ës. Pas fjalimeve, takimeve dhe bisedave me malësorët, punëtorët e intelektualët dhe pas orëve të lodhshme, çmallej duke parë malet dhe lumenjtë, veçanërisht Valbonën dhe grykën e Dragobisë. Dukej sikur e përkëdhelte dhe kuvençonte me natyrën dhe donte që t'i thuheshin kësaj në këto çaste vetëm fjalë të bukura. Atje në grykën e Dragobisë, qëndroi përballë majës së Kollatës, që dielli i kishte dhënë ngjyrën e kafes së pjekur pak.

— Pa eja? — më tha. — Si të duket ty kjo maja e Kollatës? — dhe qëndroi i menduar me kokën lart drejt Kollatës.

— Më duket si një krëhër fishekësh ose si një akull i ngrirë që synon drejt qiellit, — i thashë.

Heshti pak e tha:

— Mua më duket si një çokollatë e madhe!

Unë e ndjeva frazën time letrareske dhe u mundova të thosha një fjalë tjetër:

— E èmbël!

— E èmbël! — qeshi shoku Enver.

Por mbi të gjitha në atë udhëtim, që ishte një nga këna-

qësitetë më të mëdha të jetës sime, unë ndjeva dashurinë e pafundme që ka shoku Enver për njerëzit. Përqafonte malësorë të mogëm e të rinj, dhe ata humbnin në gjoksin e tij, Dhe të gjithëve që kishte takuar vite më parë, u fliste me emër. Ne gazetarët habiteshim me kujtesën e tij. U bëmë kuriozë dhe gjurmonim ndonjërin që mund t'i vinte pas dhe t'ia kujtonte emrat e malësorëve, por nuk zbuluam gjë, se asnjeri nuk i afrohej për këtë punë. Njerëzit që bisedonte prekeshin dhe u shkëlqenin sytë, se shoku Enver u fliste për historinë e krahinës së tyre, për ngjarje të lashta dhe të reja. E lidhte bisedën edhe me histori të vendeve dhe popujve të tjerë. I dëgjonte me vëmendje të madhe të gjithë dhe dukej sikur bënte dialog me një histori të tërë. Unë mendoja për veten time si gazetar, mendoja për kolegët e mi, që shpesh kur shkonim nëpër krahina të vendit, pak përgatitje bënim për të mësuar historinë, natyrën dhe njerëzit. Në këto çaste erdhë një malësor i shkuar në moshë, i gjatë, me një xhaketë të zezë lëkure, që shoku Enver e njihte dhe ia dinte emrin. U ulën të dy në bar përballë shpellës së Dragobisë. Filloi kuvendimi. Ne gazetarët mbanim shénime. Atëherë nuk kishte magnetofonë dhe duhej të dëgjonim me vëmendje çdo fjalë.

— Ba me na prekë kush, — tha malësori, — flakë merr dheu, e flakë merr bari, e flakë merr guri!

Shoku Enver qeshi me zë të lartë:

— Flakë të gjitha! — tha dhe e shtrëngoi me krahun e tij.

Një pjesë të këtyre njerëzve ai e takoi përsëri në një darkë që u bë në qytetin Bajram Curri në një palestër të madhe. Atje, në dollinë që ngriti, iu drejtua më të moshuarve, duke i quajtur «baballarë të dashur».

— Për ju ka shkruar një poet një poemë. Ky poet ka ardhur këtu. Ja, atje e kini, në mes tuaj! — tha shoku Enver dhe unë u ngrita nga vendi. Atëherë kisha botuar poemën «Baballarët».

Ky ishte prezantimi më i nderuar që më bëhej dhe m'u duk sikur brenda kafazit të gjoksit tim nuk kisha zemër, por një zog që do të më fluturonte nëpër grykën e Valbonës gjer në majën e Kollatës, të cilën shoku Enver e kishte krahasuar me çokollatën.

Po gjatë atij udhëtimi shoku Enver u ndal në Pukë. Pas mitingut u shtrua një drekë, ku kishin ardhur njerëz të thjeshtë e kuadro të Partisë dhe intelektualë. Mua një nga

autoritetet e qytetit nuk donte të më linte të hyja në sallën e drekës. Ndofta iu duka i tepërt.

— S'ka nevojë për gazetarë! Kjo është një drekë! — tha ky autoritet.

— Do të pendohesh më vonë! — i thashë dhe po ikja, kur erdhi shoku Pali Miska, që në atë kohë ishte sekretar i parë i Komitetit të Partisë të rrëthit. Unë atë e njihja prej vitesh dhe shumë herë kishim ndenjur bashkë.

— Hajde, — tha, — ku shkon?

— Ku më le ky të futem? Nuk e sheh si ka nxjerrë nga këllëfi pallën? — i them, duke treguar me kokë atë që më ndaloi.

— E more! Ia ka ngenë ky! — tha shoku Pali.

Ne gazetarët zumë një tryezë në një qoshe të sallës. Shoku Enver para se të ngrinte dollinë hodhi vështrimin nga tryeza jonë e tha:

— Për herën e parë po ju lutem juve gazetarëve. Nuk ju jam lutar ndonjëherë. Ato që do të them këtu, t'i mbani shënim e t'i shkruani në gazetë! Të shkruani për popullin dhe të vërtetën e popullit. Edhe gjérat e vështira t'i shkruani.

Ai foli pa letër për gruan pukiane, për luftën e saj për emancipimin, për endogaminë dhe eksogaminë dhe gjithçka që ishte karakteristikë për rrëthin e Pukës. Në atë kohë në Pukë ishte problem eksogamia. Vajzat e djemtë nuk martoreshin brenda fshatit dhe fisit, edhe sikur të ishin kushërinj prej shtatë brezash. Shoku Enver e shpjegoi shkencërisht këtë dukuri, shkencërisht dhe thjesht.

Kur mbaroi dreka dhe dolëm, e takova autoritetin që i priste palla dhe i thashë:

— Ku do të futeshe ti, or mik, sikur të ishte bosh ajo tryeza e gazetarëve? Si do t'i thoshe shokut Enver, kur të mos shikonte asnje nga gazetarët? Me siguri do t'i thoshe që nuk donim të vinim.

Me këtë ngjarje dua të tregoj për vëmendjen e madhe që ka shoku Enver ndaj njerëzve të shtypit dhe ndaj vlerësimit të punës së tyre, që shpesh kjo harrohet ose nënvleftësohet nga disa njerëz. Ai vetë është themeluesi i shtypit të ri revolucionar dhe e di vlerën dhe peshën e tij në shoqëri.

Tregova pak në hyrjen e këtyre shënimave për gjendjen dhe atmosferën që u krijon shoku Enver njerëzve, kur takohet edhe për punë, edhe rastësisht. Ai bën çmos që t'ua heqë druajtjen. I kuption me një të parë ata që kanë druajtje dhe, si psikolog i vërtetë, i qetëson, bën humor, tregon ndonjë ngjarje a ndonjë histori. Kjo gjë ka ndodhur shpesh me mua, por kam vënë re se edhe me të tjerët është përsëritur. Më 20 dhjetor 1974 Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve ishte në analizë në Sekretariatin e KQ të Partisë. Ne kishim përgatitur një raport të gjatë. Ç'është e vërteta, rapporti kishte shumë fjalë dhe problemet humbnin përmes frazave të përgjithshme. Unë dilja për herë të parë në një mbledhje të një niveli të lartë. E ndieja që raportin e kisha të hallakatur. Hyra në mbledhje me ndjenjën e një «faji». Me mua ishin edhe nja dy sekretarë partie rrëthesha. Më kujtohet, ishte Hajro Zeneli, si sekretar i Komitetit të Partisë në rrëthim e Durrësit për atë kohë. Shoku Enver buzëqeshi, e hapi dosjen që mbante materialin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, më pa mua me buzëqeshje, pastaj u vrenjt pak:

— Nga këto materiale nuk marrim vesh ndonjë gjë të madhe. Kjo është punë e aparateve. Lëri këto punë, dhe na fol për poezinë që je një specialist i mbaruar! — dhe qeshi përsëri.

Në fletoren time kisha të tjera shënime, por e hapa sikur doja të mbahesha përfletësh, si ai që mbahet nga dega e një peme, kur është në rrezik të bjerë.

Shoku Enver më ndiqte me një vështrim të butë atëror.

— S'ka gjë! Hidh ndonjë mendim sa të flasin këta shokët e tjerë.

U ngrit Hajro Zeneli dhe foli për punën e Partisë me letërsinë dhe artet në Durrës.

— Shoku Hajro, më mirë fol ulur. Kur flet ulur flet më mirë, se je më pranë tokës. Ajo të mbron e të jep zemër. Ja, edhe unë ulur rri, jam pranë saj. Ulur në tokë i bën edhe populli kuvendet, — tha shoku Enver.

— Jo, shoku Enver, më mirë në këmbë! — tha Hajroja.

— Më mirë ulur, — përsëriti shoku Enver.

— Por jo në këtë rast! — tha Hajroja.

Dhe atëherë u krijuat një atmosferë e ngrohtë dhe e bukur. Përnjëherësh shkrinë edhe mendimet e mia që kishin zënë akull, shkrinë si në pranverë.

Fjala e shokut Enver në këtë mbledhje u botua dhe u bë e njohur në gjithë shkrimtarët dhe artistët. Ajo ishte një nxitje dhe një udhërrëfye për ta çuar më përpara letërsinë dhe artet. Atëherë shoku Enver i quajti shkrimtarët dhe artistët ndihmës të Partisë.

Kujtimet që kemi nga takimet me shokun Enver ne i tregojmë kur mblidhemi bashkë, vecanërisht në ditë festash, siç është 75-vjetori i lindjes së tij. Dhe këto kujtime bëhen shumë, se vijnë duke u plotësuar. Kujtime kanë më të vjetrit, të cilët e kanë njohur që në ilegalitet e që në luftën partizane, kur gjëmonte revolucioni, kujtime kemi më të brezit të mesëm, por kujtime kanë edhe më të rinxjtë. Secili thotë një gjë të veçantë, paçka se mund të jetë e shkurtër dhe e thjeshtë. Por ne shkrimtarët kemi fatin të dëgjojmë kujtime edhe nga njerëz të thjeshtë të popullit. Atëherë ato marrin forma dhe ngjyra të plota. Më vjen në mend një çast kujtimi i fotografit të vjetër Vasil Ristani. Ai në nëntor të vitit 1944 shkon t'i bëjë shokut Enver një fotografi zyrtare. Pasi bën pozën e parë, i lutet që të buzëqeshët pak se do ta fotografonte edhe një herë. Shoku Enver i kthehet: «Kaq mund të buzëqesh, o Vasil! Sa kemi dalë nga lufta. E kemi vështirë më shumë!»

Takimet e shokut Enver me shkrimtarët dhe artistët kanë luajtur dhe luajnë një rol të madh në zhvillimin e letërsisë dhe arteve. Përmes bisedave janë ngritur probleme të rëndësishme dhe janë dhënë orientime udhërrëfye përmisionin e letërsisë dhe arteve, për raportin e tyre me shqërinë, për pasqyrimin me vërtetësi të jetës, për marrëdhëniet dialektike të traditës dhe novatorizmit, për evoluimin e metodës së realizmit socialist, për gjuhën dhe figurën. Ato kanë inkurajuar shkrimtarët dhe artistët dhe kanë krijuar një atmosferë të shëndoshë shoqërore e krijuese, kanë pasuruar jetën intelektuale të krijuesve dhe kanë forcuar unitetin e radhëve të tyre. Shumë nga këto biseda janë botuar dhe janë bërë pronë e shkrimtarëve dhe artistëve, duke i shërbyer formimit botëkuptimor dhe edukimit ideologjik dhe estetik të tyre. Bisedat dhe takimet e botuara janë edhe një bazë e shëndoshë për pasurimin e mëtejshëm të estetikës sonë marksiste-leniniste dhe në veçanti të teorisë së letërsisë dhe arteve.

1983

PËR NAIM FRASHËRIN

Në 75-vjetorin e vdekjes

Poetë e mendimtarë si Naim Frashëri janë përfundime epokash të mëdha, janë lindje përmes dhembjesh të forta, pas një grumbullimi të lodhshëm energjish e cilësish të larta përmes gjakderdhjesh, përpjekjesh e mundimesh për të parë «pakéz dritë», për të parë lirinë e përparimin. Por ai nuk punoi dhe luftoi vetëm si individ i shkëputur nga të tjerët, si talent i veçuar apo kalorës kokëkrisur. Ai luftoi bashkë me rilindësit e tjerë, me shokët e tij të armës dhe të qëllimit.

Ai e gjeti gjuhën dhe poezinë shqipe të rrethuar me hanxharë e syngji të gjakosura, e gjeti, kur dhespotët dhe klerikët e tjerë të errët ngrinin mjekrat dhe mallkonin e, duke mallkuar, mohonin dhe vrisin. Atëherë Naimi ngrinte zérin e tij me guxim të padëgjuar:

Ti Shqipëri më ep nderë, më ep emrin shqipëtar.

Me Naim Frashërin nis poezia e re shqipe, poezia moderne me kuptimin e vërtetë të kësaj fjale. Me këtë poezi të gjërë ai futej në zemrat dhe mendjet e njerëzve dhe u jepte dritë, duke ringjallur kohërat epike të Shqipërisë dhe duke mëkuar dashurinë për atdheun, dashurinë dhe respektin për gjuhën e pastër. Kjo dritë e poezisë së tij ndriti shtigjet për të ecur Çajupi, Mjeda, Gramenoja, Asdreni, Noli e plot

poetë të tjerë. Vargjet e tij kanë qenë abetaret e para që mësoheshin pa bankë shkollash, që mësoheshin në odat përdhese të popullit. Germa A ende nuk ishte mësuar, por vargu: «Ti Shqipëri më ep ndërë» shkonte gojë më gojë në popullin tonë.

Naim Frashëri është nga të parët poetë tanët, që e bëri poezinë një poezi qytetare, militante, politike. Kur ai krijonte, kishin lindur *izma*, me simbolizma e natyralizma, kishin lindur mërzirat poetike në Evropë, por ai kurrë nuk e ktheu fare poezinë në modë, se Shqipëria donte liri, donte përparim, donte kulturë. Çunat kërkonin këndime e në këndime kërkonin vjersha ngajeta shqiptare, kishin etje përgurgullimën e burimit të fjalës shqipe të lirë.

Naim Frashëri është i pari në poezinë shqipe që krijoi poemën-sintezë, pomën pa personazhe e episode, si «Bagëti e bujqësi» dhe «Bukuria». Ai me këto ishte një nga poetët më novatorë. Në këto poema-sintezë ai nuk ishte një soditës, por një pjesëmarrës aktiv në jetën shqiptare. Me gjuhën e kulluar, me mjete shprehëse, me ndjenja e mendime të thella, përmes një dashurie të gjërë, të pakufishme, në poemën famëmadhe «Bagëti e bujqësia» i thur një himn nga më të bukurit Shqipërisë dhe shqiptarit. Vargjet e gjera gjashtë-mbëdhjetërrokëshe shtrihen si krahë të përmallshëm për të përqafuar malet e fushat e pér tu larë pastaj në lumenjtë e kulluar. Me dhjetëra poetë janë ulur mbi këtë poemë, kanë mësuar e janë frymëzuar prej saj për t'i kënduar nënës Shqipëri. Dhe nëna Shqipëri është bërë një motiv i madh gjithnjë në përtëritje për tërë poezinë shqiptare të kohërave. Edhe në poemën «Bukuria» Naim Frashëri guxoi të flasë përgruan, për bukurinë, dashurinë dhe hirjet e saj në një kohë të errët, kur femra përbuzej, kur ishte turp të flisje përgjëra të tillë.

Poeti ynë i madh çeli shtigjet e para të vërteta në poezinë tonë dhe bashkë me këto shtigje vuri gurët në themëlet e gjuhës letrare kombëtare. Ai këtë nuk e bëri me traktate e rregullore të thata, po me shembuj konkretë me veprën e tij, duke provuar si në laborator se ç'bukuri e ç'fuqi ka fjala shqipe. Ai gjeti atë pikë të çuditshme ekuilibri në fjalën shqipe, që në të ardhmen të mos vjetrohej, të mos arkaikizohej, por të mbetej e re. Edhe tani ajo është pothuaj gjuha jonë letrare me pak ndryshime. Dhe këtë mund ta bënte një njeri me një talent të fuqishëm dhe me

një nuhatje të fortë të perspektivës në kohë. Ne mahnitemi duke lexuar Naimin dhe themi me vete: «Si nuk është vjetruar gjuha e tij!». Këtë ai e bëri në radhë të parë për qëllime patriotike kombëtare, për hir të bashkimit të shqiptarëve në një qëllim të vetëm, me një gjuhë të njësuar.

Naim Frashëri është një nga poetët tanë më kompleksë, më të gjithanshëm. Ai është filozof, mendimtar, politikan dhe pedagog. Duke i ngritur lart idealet kombëtare, éndërroi për krijimin e një shteti demokratik dhe për një shoqëri të pérparuar, të arsimuar, të kulturuar. Mes errësirës, që dilte nga kalbja e Perandorisë Osmane, ai përhapte edhe realizimet e shkencës dhe gëzohej për arritet e njërrëzimit në këtë fushë. Dëshira e tij për të arsimuar bashkëatdhetarët e shtynte të fliste edhe për origjinën e njeriut nga majmuni, edhe për fshehtësinë dhe dukuritë e natyrës. Në këtë përpjekje ai kishte besim se në Shqipëri do të lindnin poetë e filozofë, dijetarë e shkencëtarë, që do t'ia shtonin famën. Është e çuditshme, se, megjithë që thelbi i filozofisë së tij është idealist, nuk mund të heshtte e nuk mund të mos entuziazmohej nga zbulimet dhe arritet e shkencës. Por kjo ishte një kontradiktë e lindur nga vetë koha, nga vetë kushtet kur jetonit Naimi të cilat doemos e kufizonin.

Poeti ynë kombëtar është ndofta i pari në poezinë tonë që himnizoi punën, që e lavdëroi atë pa rezerva, me gjithë shpirt: «Punë, punë natë e ditë, që të shohim pakëz drithë». Kjo mbeti si një maksimë ardhur gjer te ne përmes dhjetëra vjetësh. Një lavdërim i tillë i punës i shkonte shumë Naimit, se ai ka qenë një punëdashës i madh, nga më punëdashësit e kohës së vet, se ai është shkriрë si qiriri, duke mos kursyer as trupin e vet të dërrmuar nga turbku-lozi. Me këtë ai ngrihej disa pashë lart mbi ngathtësinë dhe plogështinë e atmosferës së Perandorisë Osmane në kalbje.

Nga vepra e madhe e Naim Frashërit, kultura dhe letërsia shqiptare gjithnjë kanë mësuar. Partia, duke e vlerësuar lart këtë pasuri të gjallë, na ka porositur vazhdimisht që ta studiojmë thellë, se gjithnjë do të shërbejë për edukimin patriotik dhe estetik të njerëzve. Është për këtë arsyë që librat e tij janë botuar, botohen e do të botohen me dhjetëra herë e qindra herë. Dhe ne i mësojmë përmendsh vargjet e tij dhe kjo kalon brez pas brezi.

NË KRAHËT E KËNGËS

*Jam i gjallë e jam në jetë,
jam në dritë të vërtetë*

Naim Frashëri

Kënga e popullit këndohet dhe fluturon anembanë vendit. Me krahët e saj të pandalur ajo i ngre lart emrat e pavdekshëm të të rënëve për liri, të atdhetarëve, të trimave, të komunistëve dhe të njerëzve të shquar. Ajo është histori që këndohet dhe që nuk qëndron e heshtur nëpër librari e biblioteka. Libraritë e bibliotekat e saj janë zemrat dhe buzët e njerëzve që e marrin me vete dhe e shpien në rrugë e në sheshe, në kuvende e në vatra, atje ku udhëtojnë, punojnë e jetojnë. Ai njeri i mirë që hyn në këngën e popullit mbetet përjetësisht i dashur nga populli. Atë e përkëdhel kënga si të gjallë dhe ai jeton. Hysni Kapoja rron në këngët që ngri- ti bashkëkohësi i tij, ashtu siç rron edhe në zemrat dhe mendjet e bashkëluftëtarëve dhe ndërtuesve të socializmit, rron si njeri, si komunist, si udhëheqës dhe si besnik i Partisë.

Dikur krahina të veçanta kanë kënduar këngë për ata njerëz që patën treguar trimëri e patën bërë akte patrio- tike apo që patën mishëruar vyrtyte të larta njerëzore. Të shumtën e rasteve këto këngë i kanë kënduar vetëm kra- hinat që i njihnin ato figura dhe që u patën lënë mbresa

të thella. Këngët për Hysni Kapon, si ndodh edhe për një-rëz të tjerë të shquar, i këndojnë të gjitha krahinat e Shqipërisë, secila sipas mënyrës së vet, Labëria e Mirdita, Kolonijska e Shkodra, Gjirokastra e Korçë, Vlora e Përmeti, Kukësi e Lezha... Përcillen me lahitë e me qifteli, me fyell e me klarinetë... I këndon rapsodi vetëm dhe i merr grupi me të kthyer e me iso në polifoni. Dhe të gjitha i përshkon një ide e përbashkët, ideja e njeriut me zemër të gjerë, e të palodhurit për çështjen e socializmit, e revolucionarit të vendosur për vijën e Partisë, e nxënësit, shokut dhe besnikut të Enver Hoxhës:

*Ty besnik të lindi nëna,
besnik të rriti Partia,
me trima e bij të tillë,
ballin lart ngre Shqipëria.*

Në këngët popullore që i kushtohen Hysni Kapos përzihet krenaria, fisnikëria, malli dhe dhimbja për humbjen e parakohshme të tij dhe ngrihet gjithçka e lartë, sublime dhe njerëzore. Atje rrëfehetjeta e tij prej komunisti e militanti, gjithmonë e lidhur ngushtë me veprimtarinë e shokëve të vet, me punën dhe luftën e Partisë në frontin e madh të lirisë dhe të socializmit. Figura e tij në këngë kurrrë nuk del e vetmuar, por përherë mes njerëzve, përherë e shtrenjtë dhe e dashur. Për figurën e Hysni Kapos, ka tri valë këngësh të lidhura ngushtë ndërmjet tyre nga ideja e përgjithshme, por të ndryshme nga intonacioni, nga gjendja shpirtërore dhe nga nuancat e ndjenjave që shprehin. E gjithë kjo varet nga periudhat që pasqyrojnë dhe nga stilet e mënyrat e këngëtarëve që i kanë ngritur. Në valën e parë janë këngët e kënduara, kur ai ishte gjallë, në të dytën, kur ai vdiq dhe në të tretën janë ato që flasin për kujtimin e tij të paharruar. Të tria këto valë këngësh e jepin të plotë personalitetin e tij. Në to ndërthuret lufta dhe puna, mençuria dhe principialiteti revolucionar; në to hyjnë edhe elemente intime të jetës së tij, por gjithmonë në funksion të çështjes së përgjithshme të komunizmit. Kështu, për figurën dhe misionin e tij në kohën e Luftës Antifashiste Nacionalçirimitare, poeti popullor, që sipas stilit njihet se është Selim Brati, këndon:

*Komunistët me Hysninë
në Vlorë bëjnë kërdinë.*

Në një këngë tjetër, po ky poet, para se të flasë për plagosjen e Hysni Kapos në luftën e Drashovicës më 1943, jep një tablo të sintetizuar të ngjarjes me rrrokje e fjalë të vendosura në vargje, si thika e bomba.

*Moj Mavrovë e Drashovicë,
bobo ç'hoqe atë ditë,
partizanë me nazistë,
bomb' në bomb' e thik' më thikë!*

Këngët për luftërat për liri dhe për trimat Hysni Kapoja i donte shumë dhe i këndonte edhe vetë. Kur ndonjëri këndonte ndonjë këngë që bënte fjalë edhe për Hysni Kapon ai i thoshte me thjeshtësi, siç e kishte zakon:

— Ja, lëre! Të këndojmë një tjetër. T'ia marrim asaj të bilbilenjve:

*Bilbilenjtë trembëdhjetë
vanë në litarë vetë.
— Ngreu, Bilbil, e hidh litarë!
— Dale, bej të ndez cigarë,
se s'jam çanaku me dhallë,
po jam Bilbili me pallë.*

Dhe pastaj të gjithë hynin në këngë pranë tij. Ai këndon-te dhe i vështronte me dashuri me sytë e tij të pastër e të gjiltër. Këtë e kam provuar edhe unë, që po bëj këto shë-nime. Më 1974-n ishim në festën e 30-vjetorit të Kongresit të Përmetit. Ziente i gjithë Përmeti. Me Shevqet Musaranë e me këngëtarë e me shokë të tjerë në mbrëmje kishim zë-në një qoshe në kafen e qytetit dhe po këndonim këngë labë. Papritur në mes tonë erdhi edhe shoku Hysni. Ne e ndërprenë këngën për një çast, por ai na tha të mos e linim përgjysmë. Iu lutëm të këndonte, dhe ia mori:

*Moj Parti, t'u shtoftë nami,
s'u tunde nga istikami.
Në fillim si pak e zure
me ca të rralla kobure,
me djem e vajza si nure,
ato që veshën poture,
me dyfek me sakature...*

Këto ishin këngët e tij të dashura të popullit të tij të shtrenjtë. Dhe populli e bëri atë hero të këngëve të veta. E thamë pak më parë një gjë të njojur për të gjithë, se kur populli të do, të mban në krahët e këngëve të tij.

Në vargjet popullore që tregojnë për ditët e rënda të ndarjes nga njerëzit dhe shokët që i donte aq shumë, shprehet dhembja dhe pikëllimi i thellë njerëzor. Kjo dhembje dhe ky pikëllim vërtet janë të rëndë, por poeti popullor i lehtëson me mendimin se vepra e Hysni Kapos do të rrojë mes të gjithëve:

*Gjaku nga gjaku nuk ndahet,
o zemra e zemrave,
në shekuj ti do të mbetesh
bir i gjithë nënave.*

Vargjet që shprehin gjendjen e dhimbshur nuk mbeten vetëm rrëth një çasti të pikëlluar. Ato kalojnë nga një gjënjëdje në tjetrën, duke evokuar kohën partizane, duke kujtuar luftën kundër revizionizmit hrushovian, duke folur për bashkëluftëtarët, shokët, të dashurit. Poeti popullor, si të thuash, e plotëson tematikën, duke marrë shkas nga momenti dramatik dhe tregon për veprimitarinë e gjërë revolucionare të heroit. Ai kujton edhe ngjarje të tjera që kanë të bëjnë me jetën e Hysni Kapos. Këto ngjarje jepen menjë gjuhë të gjallë e plot lëng, me krahasime, epitete e metafora të thjeshta e spontane që rrjedhin vjetveti. Kjo gjuhë poetike duket sikur e ledhaton heroin dhe e mbësh-tjell në gjirin e dashurisë së pakufishme:

*Nise rrugën për në male,
malet të mbajtën në gjë,
ishe stralli nga stralli i tyre,
bir i maleve Hysni.*

Në traditën e elegjisë sonë popullore është pjesëmarrja e natyrës në dhimbje, pjesëmarrja e gurëve dhe drurëve, maleve dhe detit, barit dhe zogjve. Atëherë elegjia bëhet më solide dhe rrit peshën e saj. Ky është tipar i elegjive të Veriut edhe të Jugut. Të vëmë re dy strofa nga dy këngë për Hysni Kapon, një e kënduar në Veri dhe një në Jug:

E Veriut:

*Mal më mal shqiponja ndalet,
përmbi shkëmb hedh deti valët,
nga pikllimi çahet guri,
gjysmështize rri flamuri.*

E Jugut:

*Në mbëngjes, sapo ra drita,
i hodha syté nga Çika,
nxinte sterr e i ra pika,
i derdhi lotët mbi pisha.*

Populli për heroin e këngëve të veta është gjithmonë krenar dhe kurri nuk bie në dëshpërimin pesimist, kurjeta e tij ndërpritet. Kjo veti është e ndjeshme dhe e dukshme, veçanërisht në këngët që ngrihen në epokën e socializmit. Këngëtarë popullor duket sikur u thotë të dashurve të heroinit: ai vdiq për një çështje të madhe, ju duhet të jeni krenarë! Me thjeshtësinë dhe ciltërsinë e zemrës këngëtarë popullor këndon:

*Të deshi Partia
si nëna evlanë,
të deshi Enveri
si vëllai vëllanë.*

Në katër vargje fare të thjeshta dhe të ngrohur si me frymë shprehët me gjuhën e drejtëpërdrejtë të popullit dashuria e Partisë dhe e shokut Enver për Besnikun e shtrenjtë dhe në të njëjtën kohë ndihet një mall i patreguar, që na vë në mendime: «Hë, si nuk e kemi pranë». Fjalët «si nëna evlanë» e si «vëllai vëllanë» krah emrave Parti dhe Enver këtu krijojnë një gjëndje plot emocion, plot sinqeritet. Është zemra e gjérë e popullit poet.

E kështu kënga me krahët e saj të hapur e ngre lart veprën e njerëzve të pavdekshëm. Ata mbeten të gdhendur në librin e madh të pafundmë të vargjeve të popullit. Nga ky libër i kënduar vepra dhe emrat e tyre kalojnë nga brezi në brez dhe këngët pasurohen e shtohen me emocione e mendime të reja. Është i lumtur ai që gdhendet në këtë libër.,

NDERIM SHKRIMTARIT TË SHQUAR MILITANT

Me kohë na është lejuar të themi se në muret e kështjellës së kulturës shqiptare të shekullit të njëzetë emri i Shevqet Musarajt është gdhendur me shkronja të mëdha krah njerëzve të tjerë të shquar të vendit tonë. Kjo nuk është një frazë e shprehur presidiumeve jubilare, ku lejohen shpeshherë edhe thënie patetike, por është një e vërtetë me themel të palëvizur. Veprimitaria politike, shoqërore dhe letrare e Shevqet Musarajt ka luajtur një rol të ndjeshëm në ndërtimin dhe pasurimin e kulturës së gjallë dhe aktive të Shqipërisë së re. Ka gjysmë shekulli që ai vepron dhe shkruan, duke pasqyruar jetën e popullit dhe duke ndjekur gjurmë pas gjurme historinë, luftrën, përpjekjet, brengat dhe gëzimet e tij. Kur themi «kanë ndjekur gjurmë pas gjurme historinë», e kemi fjalën për një tipar të veçantë të Shevqet Musarajt: ai nuk ka pritur që të ndodhë historia, pastaj të rrijë ta shkruajë, por ka marrë pjesë vetë në këtë histori krah popullit.

Shevqet Musaraj është nga pionierët e parë të letërsisë shqiptare të realizmit socialist dhe njëkohësisht nga përfaqësuesit kryesorë të saj. Realizmin socialist nuk e përqafon në ndonjë kongres shkrimtarësh, por luftoi në revolucionin popullor me pushkë dhe me penë për t'u lindur e përt'u afirmuar kjo metodë e re letrare. Prandaj ai nuk është në gjethet dhe fletët e pemës së realizmit socialist, por në rrënjet dhe trungun e saj; është në atë që studiuesit i thonë

gjenezë. Në rrënjet dhe trungun e kësaj poeme do ta gjejmë të pavdekshmen poemë «Epopeja e Ballit Kombëtar». Ballistët të gjitha gjérat e këqija i kanë bërë. Ata vanë e u harruan! Vetëm një gjë të mirë kanë bërë: e «ngacmuan» Shevqetin të shkruante «Epopenë e Ballit Kombëtar» dhe t'i linte poezisë sonë një xhevahir të paçmueshëm.

Disa nga ne kanë qenë në një nahie të bukur në prehrin e malit të Tartarit e përballë Çipinit dhe që quhet Smokthinë. Atje është edhe fshati Matogjin. Ka shumë gurë, po ka edhe bar e pemë, se gurgullojnë shumë burime. Në këtë nahije ka shumë këngë e histori të çuditshme. Ka pasur këngëtarë me nam, që kanë kënduar një polifoni labe të veçantë nga të tjerët. Doemos, atje ku ka këngë të pasura ka edhe trimëri të shquara. Në atë Matogjin të vogël të Smokthinës së Vlorës, më 27 prill të 1914-s lindi Shevqet Musaraj, dy vjet pas shpalljes së Pavarësisë. Shkrimtari i ardhshëm pati një fëmijëri të pasur plot ngjarje e përshtypje, por njëkohësisht edhe të vështirë. Shumë herët, që në moshën katërvjeçare, i vdiq e éma pastaj, kur po mbushte nëntë vjeç, i vdiq edhe i ati. Ç'do të bëhej vallë me këtë djalë, sikur të mos ishte Halim Xhelaja, patrioti dhe revolucionari i dëgjuar? Falltarë nuk bëhem, por edhe mund të mbetej nëpër Labëri dhe sot mund të ishte një vjershëtor popullor i famshëm si Selim Brati. Halim Xhelaja, që ishte martuar me të motrën e Shevqetit, e mori me vete nën kujdestari në Himarë e pastaj në Vlorë. E kështu, edukatori i parë i ndjenjave patriotike dhe revolucionare për Shevqet Musaranë e vogël ishte Halim Xhelaja.

Në Vlorë Shevqet Musaraj hyri në Shkollën Tregtare, që ngrihet larg qytetit, në Ujin e Ftohtë. Çuditërisht, ajo shkollë kishte një atmosferë të pasur letrare. Atje ishin nxënës Andrea Varfi, Aleks Çaci e të tjerë që më vonë u bënë luftëtarë, komunistë e personalitete të shquara të vendit tonë. E kam fjalën, që Shevqet Musaraj hyri në një ambient ku vlonin ndjenjat patriotike, demokratike dhe revolucionare, që ka të bëjë shumë në formimin e një shkrimtari.

Pas mbarimit të Shkollës Tregtare, më 1929 ai u vendos në Tiranë, ku punoi si nëpunës në institucionë të kryeqytetit. Në Tiranë ai nuk u hutua dhe nuk u çorodit në klubet e «elitave» intelektuale e llafazane, që shoku Enver i përshkruan aq bukur në librin «Kur u hodhën themelët e Shqipërisë së re». Meqë kjo lidhet me çka po flas, nuk mund të rri dot pa cituar një pasazh që bën fjalë për kafenenë e

Tiranës së atëhershme «Bela Venecia», ku vinte «elita» e kryeqytetit. Shoku Enver shkruan: «Atje dëgjoje të fliteshin lloj-lloj gjuhësh, sipas klaneve, dhe shqipja flitej përzier me fraza të tëra në gjuhë të huaja, ashtu siç kemi lexuar te Tolstoi për aristokracinë ruse, e cila përziente rusishten me frëngjishten. Në këto rrrethe flitej për «politikë të madhe» e bisedohej për artin. Aty dëgjoje gjykime të dhëna me një «kompetencë absolute» për Çembërlenin, për Tituleskun, për Hitlerin, për «Zarathustrën» e Niçes, për «Faustin» e Gëtës, për Nibelungët, por asnjë fjalë nuk flitej për mjerimin e fshatarit të Myzeqesë që e rripnin Zogu, Vrionët e Vërlacët dhe e vdiste malarja» (f. 61-62).

Afërsisht në këtë kohë, kur këto «elita» flisnin për «Zarathustrën», Nibelungët dhe artin e kulluar, Shevqet Musaraj shkruante poemën «Bujku i Hanko Hallës», ku jepet një tabllo realiste e fshatit të atëhershëm shqiptar nga pozita demokratike. Si shkas i krijimit të kësaj vepre u bë poema e Ali Asllanit «Hanko Halla». Ali Asllani vërtet e tallte Hanko Hallën, që e kujtonte zamarin e shkruar, por kjo tallje ishte përkëdhelëse, të bënte vetëm të vije buzëm në gaz. Shevqet Musaraj po me atë varg të Ali Asllanit e vuri bujkun ta fshikullojë Hanko Hallën.

Krijimtaria e Shevqet Musarajt zë fill me ardhjen e tij në Tiranë. Vjershën e parë e shkoi më 1929, por si poet që jepte shpresa e tregojnë vjershat e viteve 30, veçanërisht gjysma e dytë e tyre. Në këto vite ai filloj të ndjejë kontradiktat e shoqërisë dhe të hyjë në lëvizjet politike, shoqërore dhe letrare. Ai në Tiranë vinte nga universitetet e vështira të fëmijërisë dhe rinisë së hershme, nga Smokthina, Himara e Vlora ku e kishte parë varférinë dhe e kishte ndjerë vetë. Atë e bënjin për të qeshur llafazanët dhe fodullët e «Bela Venecias». Gjuha e tij nuk vërtiste nëpër qieillëz «Zarathustrën», por labin që kishte bërë Luftën e Vlorës dhe kërkonte përparim shoqëror. Prandaj, duke shkruar vjersha u lidh me grupet komuniste, bashkëpumoi në shtypin përparimtar të kohës, si më revistën «ABC» e të tjera.

Me gjithë dëshirat e përpjekjet, me gjithë tendencën demokratike e revolucionare, krijimtaria e viteve 30 e Shevqet Musarajt kishte një tematikë të kufizuar, e varur kjo nga vetë koha dhe domosdo edhe nga mosha e tij. Ajo që do t'i jepte horizont të gjërë, me tematikë e problematikë të pasur e të mprehtë, ishte Lufta Nacionalçlirimtare. Menjëherë Shevqet Musaraj përqafroi idealet e socializmit

dhe të komunizmit, dhe që me themelimin e Partisë, më 8 Nënëtor 1941, u bë anëtar i saj. Shoku Enver në librin «Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re» tregon për lidhjet e tij të hershme me shkrimtarin militant Shevqet Musaraj, «i cili, — shkruan shoku Enver, — më vonë u bë anëtar aktiv i Komitetit Qarkor të Partisë të Tiranës dhe me punët e shkrimet e tij dha një kontribut të shquar për propagandën e Partisë e të Luftës Nacionalçirimitare» (f. 62).

Në fillimet e Luftës Nacionalçirimitare Shevqet Musaraj iu dhe krejtësisht punës së Partisë, punoi për «Zërin e popullit», «Bashkimin», «Kushtimin e lirisë», shkroi artikuj e trakte. Të gjitha këto përgatitën pastaj të paħarruarën «Epopenë e Ballit Kombëtar». Kjo poemë që doli malit partizane u shkrua në prill të 1944-ës dhe u botua në maj të atij viti ilegalisht në një shtypshkronjë të Tiranës me 2500 kopje. Ajo disa herë u shumëfishua, u shaptilografua dhe u shkrua në fletore nga vetë partizanët. Idetë e saj të fuqishme me partishmëri të fortë, gjuha popullore plot ngjyra, ironia, sarkazma, vargu spontan dhe i paforcuar e bënë të mësohej përmendsh nga të gjithë që e lexonin. Në librin «Kur u hodhën themelet e Shqipërisë së re» shoku Enver, duke folur për krerët e Ballit që po linin kolltukët e Tiranës dhe po «vraponin» në mal, kujton: «Është fjala për atë episod në historinë tragjikomike të krerëve tradhtarë të Ballit, në fund të verës 1943, që tashmë e njojin të gjithë e që aq bukur, saktë e me humor e përshkroi pak më vonë shoku dhe bashkëluftëtari ynë, shkrimtari revolucionar Shevqet Musaraj në të famshmen «Epopeja e Ballit Kombëtar».

Shumë vargje të kësaj poeme aq popullore kanë mbetur si aforizma që shpesh i flasim me njëri-tjetrin edhe sot: «Do ngrihen këmbët t'i bien kokës», «Do bëjmë luftë, de, more, de!» e të tjera. Ne, kur nuk na del mirë ndonjë vepër letrare, shpesh themi, duke qeshur:

*Do bëjmë vepra
De more de
Si lum ti Lidhje
Mezi na ke!*

Këtë poemë e shkroi historia. S'kemi se ç'të zgjatemi. Le ta analizojnë studiuesit e le të zbulojnë gjithmonë vleratë reja!

Shevqet Musaraj mori pjesë drejtpërsëdrejti në luftë, me armë në dorë, në batalionin «Dajti» të Brigadës së 5-të Sulmuese. Atje shkroi edhe dy këngë që tanimë janë të njohura, si «Marshi i Divizionit të Parë» dhe «Himni i Korpamatës së Parë». Edhe këto u bashkuan me këngët partizane të Fatmir Gjatës, Kolë Jakovës, Andrea Varfit e të tjerëve, që edhe sot i këndojmë me një mall e një dashuri të madhe. Një herë bisedonim me Fatmir Gjatën pér këngët partizane dhe ai tha: «Çudi e madhe! Ballistët asnjë këngë nuk bënë dot, megjithëse me ta kishte edhe shkrimitarë jo pak të njo-hur»! Ballistët lindën pa këngë. Kush nuk interesohet pér popullin, humb talentin e vet. Merr fund. Harrohet.

E shfletojmë veprën e Shevqet Musarajt një pjesë e së cilës është përmbledhur në gjashtë vëllime. Ajo është një veprë e pasur e lidhur ngushtë me jetën e popullit, me luftën dhe punën e tij. Ne na vë në mendime gjuha e tij e kullaar, e begatë dhe e mbushur me lëng, si një pjeshkë e arrirë. Në romanet, tregimet e novelat e tij është tematika dhe problematika e vendit, është lufta pér socializëm e komunizëm. Kjo është e përgjithshmjë. E veçanta është koloriti i Labërisë, tipat lebër si Çobo Rropushi, Mato Labi e me radhë. Çobo Rrapushi i novelës me të njëjtin titull tani është bërë tip. Do të dëgjosh njerëz që thonë: Ç'më je bërë si Çobo Rrapushi!» Kur njerëzit thonë kështu, atëherë vepra ka marrë përpjeste të gjera.

Një nga kyçet e rëndësishme të krijimtarisë letrare të Shevqet Musarajt është romani — epope «Para agimit». Romani është një kronikë e gjërë e luftës në Tiranë, e veprimtarisë së popullit të udhëhequr nga komunistët dhe e kundërshtarëve të drejtuar nga fashizmi e tradhtarët. Në këtë roman pasqyrohet lufta e klasave, qëndrimet e tyre në momentin kyç të historisë. Me vërtetësinë e një historiani Shevqet Musaraj zbulon thelbin shoqëror të klasave shfrytëzuese që po u ikën pushteti dhe nxjerr vitalitetin e ideve të klasës së re punëtore, të përfaqësuara nga komunistët. Vepra ka vlera të mëdha jo vetëm artistike, por edhe njoħeše; ka fakte historike, ambiente, tipa intelektualësh, veprimitari të palodhur dhe përpjekje vetmohuese të komunistëve. Romani «Para agimit», ndër të tjera është edhe autobiografik, megjithëse autor i me modesti u largohet faktave të jetës së tij të vërtetë në luftë. Por ai edhe sikur kastile të nisej e të shkruante një autobiografi, lexuesi do ta priste më kënaqësinë më të madhe dhe nuk do t'i dukej aspak si një mburrje, pasi jeta e Shev-

qet Musarajt përputhet plotësisht me luftën dhe veprën e tij. Menjëherë pas çlirimit të atdheut ka qënën drejtor i gazetës «Bashkimi», sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës Popullore, pastaj nënkyetar i Komitetit të Kulturës, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve, sekretar i përgjithshëm i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve; ka qënë deputet i Kuvendit Popullor në disa legjislatura dhe është Hero i Punës Socialiste.

Shkrimtarë ka plot dhe njerëz që shkruajnë ka shumë. Ka talentë të shquara që me veprën e tyre luajnë një rol të ndjeshëm në edukimin e njerëzve me frymën militante. Por, të mbash titullin moral militant, është vështirë, pasi këtë titull, kur ta shqiptosh, duhet të jetë i besueshëm për popullin. Shevqet Musarajt kur i themi: shkrimtar militant, e shqiptojmë më plot gojën dhe populli e beson plotësisht se i tillë është.

1985

PERSONALITET I SHQUAR I ARTIT SHQIPTAR

Artistët e mëdhenj janë pjesë e traditës, që është biografi e popullit. Populli ata i nderon, se nderon biografinë e tij. Një nga këta artistë të shquar, që ka hyrë në biografinë e popullit, është dhe Odhise Paskali, të cilit para pak ditësh i festuan në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve 80-vjetorin e lindjes.

Udha e jetës dhe e krijimtarisë së tij është e gjatë, pothuajse shekullore, por i përhershëm do të jetë udhëtimi i veprave që krijoj. Para tyre kanë qëndruar me nderim brezat që shkuan e që jetojnë dhe do të qëndrojnë me nderim brezat që vijnë. Monumentet e tij në sheshe e në rrugë, ku gjëmoi historia e lashtë dhe e re, e përgjakshme dhe e djersitur, kanë hyrë në jetën e përditshme të njerëzve dhe janë bërë simbole të qyteteve. Sa herë që sjellim në mend Korçën, kujtojmë «Luftëtarin Kombëtar» me fustanellë e pushkë; sa herë që mendja na shkon në Gjirokastër, na del përpara «Çerçiz Topulli» në bronz përballë Malit të Gjerë, sa herë marrim rrugën për në Përmet, shohim «Partizanin» në këmbë...

Është i lumtur ai artist që nga balta e vendit të vet gattoi me dashuri e respekt bashkatdhetarin që hyri në histori, bashkatdhetarin e shekujve të shkuar dhe bashkatdhetarin e shekullit të socializmit. Në këtë baltë ai vuri shpirtin e vet, mendjen dhe ndjenjat, duke krijuar vepra me origjinalitet të papërsërithshëm kombëtar dhe në të njëjtën kohë me frymë dhe vlera universale. Kështu, me veprën e tij ai u bë pionieri i

skulpturës së vërtetë shqiptare dhe sot është fëmijëria, rinia dhe pjekuria e saj. Brezat e skulptorëve shqiptarë veprën e tij e bënë shkollë me klasa e auditore dhe shkollë të hapur: me sheshe e rrugë, atje ku janë monumentet.

Odhise Paskali, si intelektual i artit, është një nga ata shembujt e rrallë që tregon forcën e plotpushtetshme të ideve të socializmit. Socializmi atë e gjeti në çerekun e rrugës krijuarës dhe në moshën e pjekurisë. Në çerekun e kësaj udhe Odhise Paskali nuk i bëri vetes pyetjen: «Ku të shkoj?», por vazhdoi udhën si bashkudhëtar i socializmit. Atëherë vepra e tij u përtëri me një shkëlqim të ri, me dritën e ideve të socializmit. Me këtë dritë ai gatoi «Vojo Kushin» në Tiranë. «Partizanin» në Përmet, «Vellezërit Frashëri» në Frashër, «Partizanin fitimtar» në Mathauzen e me radhë. Mbi të gjitha, me një mjeshtëri të mahnitshme artisti ynë i shquar gatoi bustin e shokut Enver, ku shprehet nderimi dhe dashuria e pakufishme e popullit për birin e tij të madh.

Vepra e shquar e Odhise Paskalit sjell erën e mjeshtërisë dhe të punës. Çdo njeri tek e shikon, mendon se ç'është e zonja të bëjë puna. Ajo e bën baltën dhe bronzin të flasin me gjuhën kombëtare, me mendimet dhe idetë humane e socialistë. Një nga vetitë kombëtare të veprës së tij, është pasqyrimi i bukurisë së trimave. Trimat populli i do të bukur. Në këngë ata janë të bukur. Edhe në skulpturën e Odhise Paskalit janë të bukur. Ata nuk janë të raskapitur, por krenarë. Shkojnë para vdekjes me ballin lart. Edhe para vdekjes kanë hije. Me këtë hije nuri ata e imposhtin vdekjen. Le të kujtojmë bustet e dy heroinave të Gjirokastrës, Bule Naitit e Persefoni Kokëdhimës, që u duken litarët në qafë si gjerdanë. Armiku donte t'i shëmtonte me litarët në qafë. Fantazia e ktheu litarin e shëmtuar në gjerdan. Dhe ne kujtojmë se ato kanë gjerdanë.

Odhise Paskali jetoi dy periudha të realitetit të popullit tonë: realitetin që ishte në kontradiktë me èndrrën, në kohën e regjimeve shtypëse dhe realitetin që është në harmoni me èndrrën, realitetin e sotëm socialist. Por ai ishte gjithmonë me èndrrën edhe atëherë kur èndrra ishte e mjegullt.

E përsëris atë që thashë në fillim: artistët e shquar janë pjesë e traditës që është biografia e popullit. Ata hyjnë në biografinë e popullit. Le ta bëjmë këtë biografi edhe më të pasur!

NJË UDHËTIM I SHKURTËR NË POEZINË E ALI PODRIMJES

1

Thirrjen e vargjeve të Ali Podrimjes ka një çerek shëkulli që e kam dëgjuar. Ajo vinte nga fletët e librit të tij të parë «Thirrje», që doli në dritë më 1961. Ishte një thirrje e bukur, që lajméronte lindjen e një poeti, siç lajmëron zëri i një fëmije lindjen e një burri. Atëherë edhe Ali Podrimja nuk ishte një burrë i pjekur, por një djalosh nëntëmbëdhjetëvjeçar, që sapo i kishte lënë lamtumirën fëmijërisë. Nëntëmbëdhjetëvjeçarët rrallë hyjnë në kështjellën e poezisë me libër të veçantë. Poezia vërtet fillohet që në rini e hershme, por botimi i librit të parë zakonisht vjen më vonë, pas moshës njëzetvjeçare. Ndonjëherë librat e parë të poetëve nuk janë siguri për të ardhmen e poeziës së tyre. Unë, kur kam ndjekur për herën e parë akrobatin në tel, kam pasur frikë dhe kam menduar: Po sikur të rrëzohet? Edhe kur kam lexuar librat e parë të poetëve fare të rindë kam pasur frikë se mos rrëzohen nga një tel mijëra herë më i tmershëm se i akrobatit. Kur lexova vargjet e para të Ali Podrimjes në librin «Thirrje», asnjë ankth të tillë nuk pata. Kisha një parandjenjë të besueshme: në pyllin e poezië shqipe mbinte një pemë që do të rritej e shëndetshme.

Nga se vinte kjo parandjenjë? Vinte ngaqë përmes var-
geve të «Thirrjes» ne shikonim shenjat e poetit të vërtetë të
ardhshëm siç shikon zoologu trajtat e një zogu të rrallë, du-
ke gjetur vetëm një pendë diku mes pemëve në një vend të
pashkelur. Këto shenja, si: sensi poetik i përfytyrimit të botës
përmes figuracionit, mendimi i gjerë përrënjet dhe historinë
e shqiptarëve, ritmika e vargut dhe struktura e poezisë në
vështrim të ri bashkëkohor e të tjera na bënин ta merrnim
me mend rrugën e poetit që po hynte në poezi

Dhe kështu nisi karvani i librave të Ali Podrimjes:
«Dhimbë e bukur», «Folja», «Credo», «Drejtپeshimi», «Lum
Lumi» e me radhë, që na jep të plotë gjer tani shtegtirin e këtij
udhëtarë të palodhur dhe pérherë të shqetësuar të poezisë. Në kë-
të rrugë ai nuk u ra zilkave të vockla të rimave varfanjake
të njobura dhe as dajreve të zbehta arkaike të ritmeve
monotone të vargjeve. Por nuk u ra as daulleve pompoze
të fjalës së fryrë retorike të optimizmit falsiv. Në poezinë
e tij është lidhja organike e fjalëve, e figurave, e ndjesh-
mërive të ndryshueshme dhe e mendimeve të freskëta herë në
kundërvënie dhe herë në pajtim me njëri-tjetrin. «Të pe-
së shqisat e poetit duhet t'i marrin vesh të gjitha horizontet.» Kjo është një thënie e Pablo Nerudës. Këtë Ali Po-
drimja mbasë nuk e ka lexuar. Po edhe sikur të mos e ke-
të lexuar, vetveti ka synuar që të pesë shqisat poetike
t'ia marrin vesh të gjithë horizontet dhe jo vetëm një ha-
pësirë e ngushtë mes dy malesh! Ç'marrin vesh horizontet
nga kjo poezi?

Në të ndihet që nga nënvarjet dhe që nga mbivargjet
historia tragjike e shqiptarëve që nga shekujt e lashtë dhe
gjer në shekujt e rindj, ndihetjeta e përditshme dhe e ka-
luara e munduar Poetin nga njëra anë e drithëron dhe e
mundon e kaluara e njerëzve dhe nga ana tjetër e fton da-
shuria e tyre. Dhe ai hyn në dhimbjen e së kaluarës dhe në
dashurinë e sotme të tyre. Të dyja e mundojnë: dhimbja
dhe dashuria. Dhe të dyja e bashkojnë:

*Toka jonë varret tona pa emër,
Toka jonë e gjokseve të shteruar,
Toka jonë e shurdhët, e mallkuar;*

*Toka jonë e dashurive tona, e këngëve tona,
Toka jonë e fëmijëve të palindur,
Toka jonë dielli ynë i pikëllimit, dielli ynë i
gëzimit. Besimi ynë.*

Dhimbja dhe dashuria në vargjet e Ali Podrimjes janë në unitet dialektik dhe nuk qëndrojnë as njëra dhe as tjera veç e veç, as nuk shkojnë paralelisht si dy gjëra që nuk takohen:

*Shtëpia ime prej kashte, prej balte;
Shtëpa ime prej vuajtjeje;
Shtëpia ime prej gëzimi;
Shtëpia ime me një bisht dhije.*

Jo nga çdo poet mund t'i ndiesh pikat e shqetësimit dhe dashurinë që pikojnë nga vargjet. Vetëm një poet i vërtetë, që di të krijojë vizione të plota të bën që t'i ndiesh këto pika, të shqetësohesh dhe të gëzohesh me të. Në katër vargjet që citova shikoni se në ç'unitet dialektik janë fjalët «shtëpi», «kashtë», «vuajtje», «gëzim» dhe «bisht dhije». Të gjitha këto janë të zakonshme, lidhja poetike nuk është e zakonshme. Dhe ajo që i përzien dhe i trondit këto fjalë dhe që i shpie nga realiteti gjer në mit dhe nga miti zbrit në realitet është paradoksi poetik «bisht dhije». Vetëm këto fjalë «bisht dhije» shprehin të plotë një vizion me një originalitet kombëtar të mahnitshëm. Shtëpia e shqiptarit me një bisht dhie! Me këtë metaforë jepet gjendja e varfëruar, mqedisi dhe mënyra e jetesës së njerëzve, që i kanë rrënjet në lashtësi dhe që i kanë qëndruar kohërave plot rrebeshe. E gjithë kjo ka një dendësi të madhe përbajtjeje dhe në të njëjtën kohë një intensifikim të ndjeshëm emocional. Dhe Ali Podrimja shquhet pikërisht për intensifikimin emocional, për shprehjet metaforike të koncentruara, por njëkohësisht të shkallëzuara, që përhapen në gjithë vargjet, në gjithë strukturën e poezisë. E them këtë, pasi ka poetë që e lëshojnë gjithë përruan e metaforave në një vjershë dhe të mërzitin me to. Ali Podrimja i shpërndan metaforat, ashtu siç shpërndahen sheperi dhe arrat në bakllava dhe nuk hidhen vetëm në një thelë të saj, se atëherë do të na velnin.

Shprehjet metaforike të Ali Podrimjes, duke iu nënshtruar konceptit të dhimbjes dhe dashurisë për njerëzit, për historinë dhe jetën e përditshme të tyre, shpesh janë si afornizma dhe si mendime filozofike:

Toka jonë — orë e kohrave.

*Ne niseshim gjurmëve të një kalorësi
pas një nuseje të plakur në përrallat tonas.*

*Tërë jetën çela varre
dhe ngrita kulla
majë ëndërrash.*

*Nën dritën e hënës
të lashtat e mia
i preu drapéri i ndryshkur i të huajit.*

*Para shtëpisë sime
më vratë —
unë qesha.*

2

Zakonisht poetët në poezinë e tyre kanë tri vizione: e djeshmjë, e sotmja dhe e nesërmja. Ali Podrimja të dukshëm ka pasur vetëm dy prej tyre: të djeshmen (historinë) dhe të nesërmen (atë që do të hyjë në histori). Vizioni i së sotmes deri para pak kohësh ka qenë i nënkuqyteshëm, ka pasur vetëm konturet e tij. Në librin «Lum Lumi» vizioni i së sotmes doli i plotë në vargjet e poetit. Kjo ndodhi pas një dhimbjeje të madhe tronditëse dhe tragjike. Poetit i vdiq biri i tij i shtrenjtë. Në një mënyrë ose në tjetërën ai nuk mund të mos ta shprehte këtë realitet të dhimbshëm dhe nuk mund të mos e lidhte dhe të mos e shkrinte edhe me dukuri dhe ngjarje të përafërtë tragjike ose të një natyre pikëllimi. Kështu, ai gjen forca të dalë nga pikëllimi personal dhe të kalojë në revoltë dhe në rebelim kundër padrejtësive, dhunës, varfërisë dhe tjetërsimit të njeriut. Evropën

ai nuk e vështron në sipërfaqen, në lustrën dhe në reklamën, por në barkun e saj dhe në brendësinë e saj. Në këtë brendësi gjen edhe dramën e njeriut dhe forcat për të dalë nga kjo dramë. Atëherë poeti hidhet edhe në lash-tësi, në Ulisët dhe në Hamletët, në Skënderbetë dhe në Gjergj Elez Alisë. Njeriu, dhe në këtë rast shqiptari, ka rrënë të thella, dhe këto rrënë, bashkë me trungun dhe degët, nuk lejojnë që të mbytet në dhimbjen dhe pikëllimin. Dhe kësh-tu pikëllimi përzihet me revoltën, zemërimin dhe urejtjen:

*Atje poshtë Evropa shikohet në pasqyrë, dhëmbët pastron,
ha me qen, fle me qen, dëbohet me qen, vdes me qen,
tek një krua gjak i pikojnë duart,
dhëmbët prapë i shkëlqejnë, dikund një vashëz mbyll drितaren.*

Këtu Ali Podrimja kalon në përgjithësimin e vuajtjes universale të një realiteti të hidhur. Në Evropën që «shikohet në pasqyrë», që «tek një krua gjak i pikojnë duart», ka njerëz që vuajnë e që vdesin. Në këtë gjendje njeriu tjetërsohet dhe humb personalitetin e vet. Poeti këtë e vë re, prandaj herë pas herë i kthehet dramës së tjetërsimit, an-kthit dhe rreziqeve në botën plot kontradikta dhe kërra shpirtërore. Në këtë botë për poetin edhe lindja është e vështirë, edhe vdekja është tragjike. Megjithatë, ai nuk dë-shiron ta pranojë vdekjen, pasi vizioni i së nesërmes është gjithmonë më i fortë në poezinë e tij. Për këtë ai shprehet qartë dhe me konçizitet në pak vargje:

*Mbi tavolinë —
fletë e bardhë. Aty do shkruar:
Lum Podrimja vdiq më 29 shtator 1982;
por unë nuk mund të nënshkruaj vdekjen tënde,
kushdo le të thotë çka të dojë,
në qënie të ndjej si lëviz e si merr fuqinë,
të shoh gjithkund në jetë...*

Mendimi, ndërtimi, ritmi dhe figuracioni i vargut të Ali Podrimjes i nënshtrohen këtyre tri vizioneve që përmenda

pak më parë. Ritmika herë është e shpejtë dhe herë e ngadalte dhe e rëndë; vargu atje është i ngjeshur me metafora dhe epitete metaforike dhe këtu i shtrirë me fjalë të zakonshme të prozës, si: «vdis më 29 shtator 1982». Të duket sikur poeti nuk dëshiron në këtë rast ta poetizojet vdekjen. Ndryshe ritmika dhe figuracioni në motivet që kanë dritë ose që përzihet drita me hijen:

*Një takim me ty
është një këngë
më tepër në jetë —
flakë e dashurisë.*

*Një ndarje nga ti
është një këngë
më tepër në jetë —
shi i dhimbës...*

Ali Podrimja është i njojur për lakonizmin poetik, për kursimin e fjalës. Kjo shprehet edhe në një vjershë të shkurtër, edhe në një poemë të tërë. Prandaj ndonjëherë vjersha nuk është e lehtë për t'u kuptuar aty për aty. Nga vargu në varg ai kalon pa lidhëza të shumta. Poezia në përgjithësi nuk i pranon lidhëzat e tepërtë. Këtë e vëmë re edhe në këngët popullore. Ndonjëherë kjo e vështirëson kuptimin, por nuk e hermetizon përbajtjen. Duke i reduktuar lidhëzat dhe duke e dendësuar përbajtjen, Ali Podrimja nuk e ngushton kuptimin dhe nuk ia heq ndjenjën dhe emocionin poezisë. Me një fjalë, me lakonizmin e tij nuk kalon në racionalizëm të thatë. Poezia e tij ka lëng jete. Është si një pemë e lëngshme dhe nuk është një konservë e thatë. Me mjeshtëri prej poeti të ndjeshëm, duke njojur dhe përvetësuar teknikën e poezisë bashkëkohore, ai edhe në një vjershë me pak vargje jep një përfytyrim të plotë për dukurinë që i drejtohet. Për shembull, e gjithë vjersha «Mos më harro» ka vetëm njëmbëdhjetë vargje të shkurtra, por në të pasqyrohet një gjendje e tërë shpirtërore e trazuar dhe e shqetësuar:

*Në sy të mi
s'ka lot,
ka zjarre;
në duart të mia —
gjurmë zinxhirësh,
kafshime gjarpërinqsh;*

*në fjalë të mia
s'ka lutje,*

*tërmete
ka
kala.*

Të japim një shembull tjetër për ta plotësuar këtë mendim, duke cituar të plotë vjershën «Emrat tanë»:

*Herë nata
i merr nëpër këmbë,
herë dita
i kërkon me pishë.*

Brenda koncizitetit, poezia e Ali Podrimjes ka ritëm muzikor, ka aliteracione dhe ndonjëherë papritur edhe rima dhe asonanca, megjithëse të rralla, pasi në përgjithësi vargu i tij është i lirë. Por edhe në vjershën që citova, përsëritja e fjalës «mia» dhe vendosja e vargjeve:

*tërmete
ka
kala,*

bën ta ndiesh jo vetëm ritmin. Atje e gjen edhe rimën e pavetëdijshme. Ose:

*Te bedenat e tua
mbretër e sultani
ushtritë lanë*

*e kohërat sytë
njëra-tjetrës ia nxorën
me eshtrat tanë.*

Ose:

*A ju kujtohet për në Iliri
për në Albanopol udhëtuam me pishë, me
qiri.*

3

Prirja e Ali Podrimjes në poezi është drejt meditimit Ashtu edhe si disa nga kolegët e tij, poetë të njohur, Din Mehmeti, Azem Shkreli dhe më të rinjtë akoma, ai nuk e pranon deskriptivizmin në poezi. Me mjete artistike bashkë-kohore në përsosje ngaherë, ai përgjithëson dhe sintetizon. Dhe në të njëjtën kohë u jep rëndësi detajeve, fakteve dhe imtësive origjinale dhe të pashfrytëzuara nga të tjerët. Mëson nga poetët tanë, ballkanikë dhe botërorë, e përvetëson poezi-në dhe teknikën e re të tyre, por nuk imiton. Mbetet poet autentik origjinal. Duke medituar, ai nuk e sodit sendin, por hyn në brendinë e tij për të gjetur dramën. Një poet me një vështrim të tillë të dukurisë është i prirë për të filozofuar. Pikërisht vështrimi i sendeve filozofikisht ia ka rritur vlerat poezisë së tij. Për të bërë një përgjithësim bashkëko-hor, ai merr shkas nga një legjendë, nga një proverb ose nga një këngë e gojëdhënë popullore. Me këtë poeti tregon vazhdimësinë e kulturës shqiptare, tregon ekzistencën dhe qëndresën e popullit. Duke e dashur historinë dhe kulturën e popullit, ai i dashuron më shumë njerëzit. Dashuria e tij për tokën e vet, për vendlindjen, për Kosovën, për fushat dhe malet është e thellë gjë që nuk mund të përfundoj. Por dashuria për tokën dhe njerëzit tregohet kur di dhe e çmon historinë e tyre, biografinë e tyre, luftërat, punërat, gjëzimet dhe hidhërimet, kur i njeh vlerat shpirtërore të popullit. Shkrirja e këtyre vlerave nëpër gjithë qelizat e vargjeve i jep poezisë atë originalitetin e papërsëritshëm kombëtar dhe e bën të dashur edhe për popujt e tjerë.

Vazhdimësia e poezisë shqipe dhe fryma origjinale e saj ndihet në gjithë vargjet e Ali Podrimjes, megjithëse

teknika poetike e tij është e ndryshme, fjala vjen, nga ajo e Naimit, Mqedës, Migjenit, Esad Mekulit, Fatos Arapit, ose e Ismail Kadaresë. Duke lexuar vetëm pak vargje nga vjersha «Kulla», menjëherë e ndien identitetin kombëtar të poezisë, gjen anketën e biografisë së saj:

*Për shkak të dashurisë, për shkak të urrejtjes
baba im ka ngritur një kullë
në majë të botës e ka ngritur,
deri në tokë e kanë rrëzuar zotrat.
Motra ime, vëllai im kurban janë bërë,
babai im atëherë perënditë ka sharë,
gurin e rëndë në themel e ka vënë
në shtatë konaqe muratorë ka kërkuar
sa më lart kullën e ka ngritur,
aq më të fortë veten e ka ndjerë.*

Nëse një estet ose një kritik u bën analizën këtyre vargjeve, do të nxjerrë në pah atë origjinalitet të papërsërithshëm që përmenda pak më lart. Këtu di të gjejë edhe frymën e një poezie me strukturë bashkëkohore, edhe ngjyrën e theksuar dhe ekspressive kombëtare si në një qilim të bukur të mjeshtërve tanë. Vargun: «në shtatë konaqe muratorë ka kërkuar» në asnjë poezi tjetër evropiane nuk mund ta gjesh. Mund ta gjesh vetëm në eposin tonë të kreshnikëve, veçanërisht në «Gjergj Elez Alia».

Dhe këtu mbaron ky udhëtim i shkurtër nëpër poezinë e Ali Podrimjes. Edhe të tjerë udhëtime dëshirojmë të bëjmë, pasi kjo është një poezi e begatë dhe përherë në rritje. Ali Podrimja është i ri...

1986

POETI POPULLOR SELIM HASANI

Poezinë popullore e kanë krijuar ata mjeshtër të shquar të vargut që ne nuk ua dimë emrat. Ata kanë vetëm një emër, emrin e popullit poet. Me poezinë udhëton në shekuj shpirti i tyre i madh që mahnit brezat që vijnë njëri pas tjetrit valë-valë. Herë-herë në këtë udhëtim, mes qindra anonimesh, shkëlqen edhe emri i ndonjë poeti që del si kërcu i madh i ndezur, duke e ruajtur të pashuar zjarrin e tij të veçantë.

Njëri nga këta është Selim Hasani nga Brataj i Vlorës. Ai nuk u interesua për emrin, por për këngën. E ngriti këngën dhe e dërgoi nëpër Labëri; kënga hyri shtëpi më shtëpi e stan më stan, fluturoi nëpër çetat, batalionet dhe brigadat partizane; e kënduan djemtë dhe vajzat në shtigjet e lirisë dhe në udhët e revolucionit dhe erdhi kënga gjer në ditët tona. Udhëtoi me këngë në gojë e me dyfek në dorë më 1920-ën, në Luftën e Vlorës, kur Selam Musai «zinte topin nga grika»; udhëtoi në Drashovicë më 1943 dhe zuri istikanin, tek vërshëlljen plumbat dhe predhat duke e plagosur rëndë; udhëtoi me partizanët në Kurvelesh, Lunxh, Zagori e Përmet; eci me Brigadën V në Sulovë, Gramsh e Dumre... Prandaj kënga e tij mbart erën e luleve dhe vërshëllimin e plumbave, gurët e maleve dhe dertet e njerëzve, pikëllimin për shokun e vrarë dhe dufin për armikun e mundur, trishtimin për varférinë dhe mallin për ditët e lumtura, shqetësimin për

gërmadhat e lëna nga pushtuesi dhe besimin në revolucionin dhe socializmin. Me këtë, vargjet e xha Selimit janë dëshmi poetike të ngjarjeve të zakonshme të jetës dhe të ngjarjeve të mëdha historike, ku ishte dhe vetë pjesëmarrës. Këto dëshmi nuk janë regjistrime të thjeshta, por dokumente poetike me një figuracion të pasur të një origjinaliteti të veçantë, me një gjuhë plot lëng me figura të ndezura, me kundërvënje të papritura e plot lëvizje. Tek i lexon vargjet e tij, të duket sikur e ka thithur nektarin e shëndetshëm të gjithë poezisë popullore dhe pastaj, këtë nektar të transformuar përmes sítës së shpirtit të vet, ua ka dhënë këngëve të tij burrërore. Kështu, ai nuk përsërit ato që kanë thënë të tjerët, edhe të bukura të kenë qenë ato. Poeti popullor është krenar. Ai nuk pranon të thotë gjëra të stërthëna. Ato që kanë thënë kolegët e tij anonimë ai i përvetëson që në fëmijëri, siç përvetëson sjelljen, zakonet, mënyrën e jetesës, historinë, kulturën dhe filozofinë popullore. Këngëtar i popullit nuk e mëson këngën, kur është bërë burrë me fëmijë, por rritet me këngë që në vegjeli. Pastaj këtë këngë e do si gruan dhe fëmijët. Dhe këngën e përkëdhel si të voglin. Njëherë i kam folur xha Selimit për një këngëtar. Ai më dégjoi i heshtur me buzën pak në gaz dhe më tha: «Mirë këndon. Vetëm nuk e përkëdhel këngën. Sikur ta përkëdhelte do të merrte më shumë nam. Eh, kënga! Kjo lanete i do përkëdhelitë si vajza!»

Të përkëdhelësh këngën nuk do të thotë ta sheqerosësh, por ta duash dhe ta çmosh; të të burojë nga shpirti vetvetiu. Kënga është si e qeshura dhe e qara. Njeriu nuk qesh dhe nuk qan me urdhër. Ne na mahnit poezia popullore, pasi ka dalë nga shpirti. E qeshura dhe e qara nuk imitojen. Dua të them se Selim Brati këndonte me fjalën dhe zërin e vet. Kjo fjalë dhe ky zë dallohej nga gjithë të tjerët. Atdheut, Partisë, popullit, bijve dhe bijave të tij ai do t'u këndoje me fjalën e vet të papërsëritshme. Janë të një poetike të rrallë popullore vargjet me patos qytetar, si këto:

*E tunde, Parti, e tunde:
Përpara si pak e zure,
Me ca të rralla kobure,
Ca prita, ca mina vure,
Me djemtë e vajzat si nure,
Ato që mbathën poture,
Me dyfek, me sakature,
Me opinga prej lëkure.*

Një poezi lapidarike si këtë, me një origjinalitet të veçantë, me një mendim të qartë e plot lëvizje dhe me fjalë si gurë të rëndë e plot reflekse e ngjyra, nuk mund ta gjesh në poetët e tjerë popullorë; ata kanë vulën e tyre, xha Selimi ka vulën e tij. Këtu qëndron edhe bukuria, pérndryshe do të kishim monotonë, siç ndodh ndonjëherë në poezinë e kultivuar. Poezia e kultivuar ka variacione metrike në vargje, që nga vargjet tradicionale tetërrokëshe, gjashtërrokëshe, dhjetërrokëshe dhe gjer te vargjet jambikë dhe të lira. Por variacioni i metrit nuk të siguron varpcionin e përbajtjes, mendimit dhe ndjenjës. Mund të përdorësh gjithë metrat, dhe mund të mos jesh poet. Është si në pikturë. Mund të dish të vizatosh dhe pikturossh dhe të mos jesh piktor. Poezia popullore i ka të kufizuar metrat e vargut. Shkruhet me gjashtërrokësh, tetërrokësh dhe ndonjëherë dhe dhjetërrokësh ose me variantet e tyre. Por ajo është shumë e larmishme, pasi e ka brenda shpirtin e madh të popullit, shpirtin shumëshekullor. Këto gjëra xha Selimi nuk i kishte mësuar në shkollë, por i kishte fituar në universitetin e folklorit. Prandaj ai nuk pranonte të këndonte vargje standarde, të përsëritura dhe pa fizionomi. Kur ne ia rrëmbenim armët armikut dhe me to e vinim poshtë, Selim Hasani nuk mund të thoshte: «O burra t'ua marrim armët», por do të kushtonte me zërin e tij të pashëmbëllyer me ndonjë zë tjetër:

*Mitralozat me tri këmbë
O djem t'i marrim me dhëmbë!*

Për tradhtarët e vendit, që u bashkuan me pushtuesit, nuk mund të bërtiste dhe të shante me një gjuhë pa ngjyrë, pasi ajo nuk do të bënte efekt dhe nuk do të mbahej mend. Selim Brati do t'u fliste me gjuhën e poezisë therëse, duke dhënë edhe portretin e tyre, duke i nxjerrë ata nga hotelet ku hanin e pinin për t'ia treguar popullit. Ja se cilët janë këta «patriotë»:

*Tradhtarët e vatanit
Vijnë rrëth hotel «Ballkanit»,
Shuan verën e dyqanit,
Vozat e Pavlo Bezanit.*

Selim Hasani i Bratajt, poezinë nuk e shkroi, por e këndoi: Botohej a s'botohej, nuk donte të dinte. Shtëpi botuese për të ishin ata që e këndonin. Nuk vinte ai te redaktorët, vinin ata tek ai. Nuk do të rrinte me laps në dorë për t'i krehur vargjet, se as nuk i kishte shkuar ndër mend një gjë e tillë dhe as dinte ta bënte. Siç i vinte fjala, ashtu e thoshte. Fjala e këngës fluturonte dhe ndoshta edhe këngëtarët e tjerë diçka i shtonin. Prandaj herë-herë ka edhe vargje të tepërtë, ka edhe mbingarkesa me njëfarë agitacioni të kohës. Por të gjitha këto pastrohen nëpër botime për të shkëlqyer më tepër xhevahiri. Është e quditshme, se edhe në këngët më të zakonshme shkëlqejnë ndonjëherë vargje të një force të madhe shprehëse. Po jap një shembull. Për të tre-guar varfërinë e punëtorëve argatë në të kaluarën, ai këndon:

*Ku gdhiji, more të mjerë?
Në mullar keni hotelë.*

Ose le të marrim tre vargje, ku jepet mundja e armiqve. Poeti na thotë se ja ç'u bëri ideali komunist armiqve:

*C'i këpüte bisqe-bisqe,
Mos i nga se i ujdise,
Xhadeve pa gunë i nise.*

ose:

*Po ballistët nga na vanë,
Festebardhë e mantobranë?*

Kënga e Selim Hasanit është anketa e biografisë së tij në mes të ngjarjeve të mëdha të kohës: të Luftës Nacionalçlirimtare, të viteve të para të Çlirimit dhe të fillimit të marshimit të madh të socializmit. Mes gjithë këtyre ngjarjeve ungirit kënga e tij dhe në vargje la gjurmë koha e jetuar nga poeti ynë popullor. Edhe sot ne i lexojmë dhe i këndojmë këngët e tij, që ruajnë freskinë dhe ngjyrën e ndezur të luftrave, trishtimeve, gëzimeve dhe ëndrrave tona. Vargjet e

tij u bënë mësim për shumë poetë popullorë të Labërisë. Ndonjëherë këto vargje merren dhe vihen të pandryshuar nëpër këngët popullore, por ne i kuptojmë se të ç'mjeshtri janë. Edhe po të ishte gjallë, xha Selimit nuk do t'i mbetej hatri, por do të thoshte: «Merrini, bij! U në për ju i këndova! Pasuria private po të ndahet, pakësohet. Kënga po të ndahet, shtohet!» Jam i bindur që kështu do të thoshte mjeshtri i shquar i vargut popullor!

Selim Brati lindi me këngën, u rrit me këngën, udhëtoi me këngën dhe vdiq me këngën. Kur mbylli sytë përgjithmonë, atij i kënduan mbi trup ligje. Dhe pas vdekjes, kur udhëtarë këngëtar kalon andej nga varri i tij, padashur këndon këngët e xha Selimit. Më 1965, kur vdiq Selim Hasani, shoku Enver në ngushëllimin që i jep familjes së poetit thotë: «Le të rrojë kujtimi i tij brez pas brezi në këngët e bukura popullore revolucionare që ai me dashurinë e zemrës thuri tërë jetën e tij për lavdinë e Partisë e të Atdheut dhe që sot ia lë trashëgim të vyer popullit të vet që aq shumë e deshi dhe i këndoi»¹⁾

Ky trashëgim përherë do të shkëlqejë në valët e mëdha të këngës popullore labe, të këngës gjithmonë në lëvizje dhe në shketësim, të këngës plotëndrra stërgjyshore që na ngacmojnë dhe na prekin mendjet dhe zemrat, të këngës që është djepi i parë i poetëve që kanë lindur dhe do të lindin. Selim Hasani tani bën gjumin e përjetshëm, por shpirti i tij, i shkrirë në këngët, udhëton. Atje në Brataj në varrin e tij, thonë se vjen në pranverë mëngjes përmëngjes një zog dhe këndon këngë. Thonë, por këtë zog edhe unë e kam parë. Mbështë një rastësi. Por edhe rastësi të jetë, përpunhet me të vërtetën...

1984

1) Enver Hoxha, «Mbi letërsinë dhe artin», f. 231.

III

ROMANI NË ARRITJET DHE NË KËRKIMET E TIJ

Problemi qëndror është ai i ngritjes së nivelit ideor e artistik, i hopit cilësor që duhet të bëjë romani, i rifreskimit dhe i përtërhitjes së tij me fryshtën bashkëkohore, duke mënjanuar disa mënyra të vjetra e «provinciale» të trajtimit të materialit që na e jep shoqëria jonë moderne, shoqëria jonë bashkëkohore, me ngarkesë të madhe problematike në gjithë fushat e jetës, që na jep njeriu ynë me një shpirt të shqetësuar, njeri që di të vështrojë edhe në thellësi të rrënjeve të historisë, edhe në fryshtë e të sotmes, edhe në filizat e së ardhmes. Kjo shoqëri, që objektivisht nuk është aq e thjeshtë, ky njeri që jeton në gjirin e saj dhe që bart mbi supet e tij gjithë kompleksitetin e jetës shoqërore, psikologjike e morale, nuk mund të kënaqet me trajtime të thjeshtësuara të karakterit deskriptiv, etnografik dhe anekdotik.

Dihet që romani zbulon jetën kombëtare, jetën e shoqërisë, historinë e psikologjinë e njeriut. Dhe këtë zbulim e bën përmes ndeshjes së pikëpamjeve, botëkuptimeve dhe ideeve të heronjve dhe personazheve, në mënyrë që autori të arrijë pikësynimet e caktuara dhe të materializojë idealin e tij shoqëror dhe estetik, në mënyrë që t'u thotë njerëzve: «Unë kam shtruar para jush këtë problem dhe po mundhem ta zgjidh siç e kam menduar, juve si ju duket?» Suksesi i romanit «Dimri i madh» i I. Kadaresë, qëndron në atë nde-

shje të ideve e pikëpamjeve, të psikologjisë dhe moralit të personazheve, dhe në parashtimin dhe zgjidhjen e problemit: a do ta fitojnë idealet komuniste dhe progresi në një situatë të ndërlikuar dhe të vështirë? Përgjigjja është se do të fitojnë, por rruga është e gjatë. Vetë dialektika e moralit dhe e psikologjisë së heroit kryesor, Besnikut, tregonë vështirësinë dhe ndërlifikimet e situatave, lëkundjet dhe qartësinë, guximin dhe dilemën, gjer në mundjen e dobësive të vvetes përballë çështjeve të mëdha. Por kjo ndeshje dialektike e ideve, e psikologjisë në situata komplekse nuk bëhet me anën e rrëfimit të thjeshtë. Duhet të sqarojmë një gjë. Rrëfintari ndryshon nga romancieri i vërtetë. Rrëfintari tregon për trimëritë e heronjve, për marrëzitë e budallenjve, për mençurinë e të urtëve, për dhelpërinë e dinakëve, gjëra që janë mjaft të rëndësishme, por nuk mjaftojnë. Romancieri mes tyre zbulon diçka tjetër, zbulon historinë e shpirtërave dhe rritjen e personalitetit në kushtet e caktuara të shoqërisë. Pra, rrëfyesi mbahet për trimëritë, sjelljet e situatat, romancieri për enigmat e shpirtit, për pasurinë, rritjen dhe zhvillimin e karakterit. E them këtë, pasi në disa romane të autorëve tanë rrëfimi ose shkon paralel me zhvillimin e personazhit, ose nuk përputhet fare me këtë personazh.

Vijmë kështu në disa probleme që kanë të bëjnë me nivelin artistik të romanit tonë. Unë nuk do ti shtjelloj gjerrë problemet e zgjerimit të tematikës e domosdoshmérinë e thellimit të njoħjes së historisë dhe të jetës, pasi këto janë trajtuar vazhdimisht. Do të ndalem në disa anë që trajtohen pak ose rrallë. Cilat mund të ishin këto probleme?

E para, në romanin e sotëm është e domosdoshme të forcohen dy komponentet themelore, ndofta edhe të vetëm të tij: zéri i autorit dhe zéri i personazheve. Roman bashkëkohor ka dy karaktere: autorin dhe personazhet, dmth botën subjektive të autorit dhe realitetin objektiv të pasqyruar. Nga kompleksi i këtyre dy botëve varet edhe niveli i romanit. Autori që ka njoħuri të mëdha, që është shpirtkërkues, që jeton intensivisht me gjithë problemet e ndërtimit të soci-alizmit, që ka një mendje dialektike, që priret për tu thënë diçka njerézve dhe që radhitet ndër personalitetet më të përparuara të shoqërisë, di ta trajtojë realitetin e ndërlikuar dhe ta shndërrojë në realitet artistik. Ne themi të pasqyroj-më temat e mëdha. Një autor me botë të vogël nuk mund të pasqyrojë një botë të madhe. Personazhi i romanit di aq sa c'di autori. Një autor që nuk ka kapërcyer urën e Lanës

nuk mund të bëjë një personazh që kapërcen urën e Bosforit apo digën e Fierzës. Pastaj romani i vërtetë lind në një shoqëri që njeh dhe di kontradiktat e saj jetësore, psikologjike, morale, estetike etj. Pse nuk lindën romane të shquara këtu e pesëdhjetë vjet më parë në vendin tonë? Nuk lindën se shoqëria patriarkale nuk i njihte kontradiktat e saj, megjithëse ato ékzistonin. Proza e folklorit, përralla e rrëfimi që kryenin funksionin e romanit, dhe ata pak shkrimitarë që bazoheshin në folklor nuk mund të bënin analiza sociale e psikologjike. Folklori e merr globalisht njeriun, e merr në model dhe nuk hyn në lëkundjet e imëta shpirtërore siç hyn romani. Folklori është i rëndësishëm për autorin ashtu siç është. Dhe këtu qëndron bukuria. Prandaj për romanin ka rëndësi të madhe ngritja e nivitet kulturor e ideologjik të autorit për të dhënë njeriun e shoqërisë sonë të tërësisë siç hyn romani.

Kur themi që të forcohen dy komponentët e romanit, zëri i autorit dhe zëri i personazhit, kjo ka rëndësi të veçantë. Zëri monoton i autorit i bën monotonë edhe personazhet. Po t'i shohim disa modele personazhesh, do të bindemi për këtë që thamë. Në një pjesë të konsiderueshme të romaneve me temë nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare ne kemi një model komisari, një model komandanti, një model partizani, një model komunisti. Kjo ndodh pasi autori nuk di modele të tjera; ai punon si në rrobaqepësinë e konfekcioneve që ka dy apo tri modele kostumesh. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për romanet me temë bashkëkohore: kemi një model punëtori, një model drëjtori, një model gruaje. Këto janë konvencione të formuara, që mezi i thyejmë. Unë mendoj se kjo e ka burimin në mënyrën e të menduarit të lashtësisë, Në lashtësi trimi përfytyrohej njëlloj për të gjithë, konvencionalisht. Frikacaku njëlloj. I urti njëlloj. Muratori njëlloj. Dhe këto konvencione, këto figura të përgjithësuar ishin të bukura. Por kjo mënyrë është e papërshtatshme për romanin.

Që të thyhen këto konvencione në roman, duhet të hyjë jeta dhe njeriu që e jeton këtë jetë, të hyjë me gjithë ndërlikimet e kontrastet e shndërruara në realitet artistik. Njeriu ynë nuk është i thjeshtësuar dhe mendimi i tij nuk është i skematizuar. Dy njerëz nuk mund të kenë një kokë dhe një zemër. Në romane ka dy njerëz me një kokë dhe një zemër të përbashkët. Ky njeri nuk mendon si shkrimitari dhe redaktori.

Kur flasim për trajtimin më të gjërë të jetës së sh-

qërisë sonë, nuk e kufizojmë kërkesën në paraqitjen e uzinave, kooperativave, kantiereve, familjeve si objekte në vete; por si sfondë ku vepron e jeton njeriu, si fusha ku shpreh personalitetin, zotësinë e vitalitetin ky njeri i pasur shpirtërisht, kulturalisht e ideologjikisht, Mund të pasqyrosh një uzinë dhe përsëri të mos e kesh realizuar temën aktuale në qoftëse të mungon mendimi aktual i njeriut. E pasqyron uzinën me teknikën moderne, por të mungon njeriu me mendjen moderne, shpirtin modern, botën moderne, familjen moderne dhe marrëdhëni modern. Mjaft nga romanet që kanë objekte të jetës aktuale, fabrika e kooperativa, nuk janë aktuale, pasi nuk kanë një problem aktual. Borgjezia shpif mbi socializmin dhe përhap mendimin me mjetet e saj të informacionit se jeta socialiste e varfëron personalitetin e njeriut. Po të ngresh një problem në roman se çmundësi dhe çhorizont hap socializmi për pasurinë e personalitetit të njeriut, do të shohësh se çfarë përqafimi do të ketë kjo vepër! Personalitet të njeriut borgjezia kupton kultin e unit, vetidhullin që mbretëron dhe inondon shoqerinë me elementë të pasioneve narcistike. Ky narcist është njeriu pa ideale, që terrorizon të ardhmen. Ai për të ndjellë ankth të shfrenuar fshihet në geton e unit të tij dhe është indiferent ndaj gjithë shqetësimeve të shqërisë. Narcisti shikon shëndetin e tij, pret me kënaqësi vakancat, mbizotëron shpërthimin e emocioneve. D.m.th. i vetmi preokupim i këtij «personaliteti të pasur» është kuri mi i vvetvete. Duke u përpjekur për të ëmbëlsuar unin e vet, individi borgjez rrezikon të humbasë vvetveten. Këtë gjë e ka vënë re edhe vetë kritika borgjeze dhe unë vëtem se ritregoj ato që kam dëgjuar dhe lexuar. Kurse ne kemi kuptim tjetër për personalitetin e individit. Ai lufton për shndërrimin e shoqërisë dhe në këtë luftë transformon dhe pasuron vvetveten. Ky njeri duhet të jetë më shumë objekt i romanit, nëse kërkojmë ngritjen e nivelit artistik të prozës sonë të gjatë. Brenda kësaj sfere duhen kërkuar edhe teknikat e reja të romanit, për të cilat do të flas më poshtë, sipas radhës së gjérave. A mund të flitet për zbulimin e jetës dhe të personalitetit të njeriut, fjala vjen, në romanin «Harqet e zjarra» të S. Këlliçit, ku heroi kryesor shkon në një uzinë për t'u riedukuar për një gabim që ka bërë dhe vepron si robot për të larë fajin? Kjo është humbje e personalitetit dhe bën efekt të kundërt. Le që problemi është shtruar shtrembër, se ne nuk e kemi metodën e rie-

dukimit. Atë e kanë pasur kinezët. Ne kemi metodën e bindjes. Edhe nëse ka raste të tilla këto nuk janë objekte të artit në formën e mënyrës si janë parashtuar në romanin që përmendëm. Unë mund të mos ndalesha në këtë roman, por e pashë me vend vetëm për shkak të disa simptomave të trajtimit skematik të jetës që duken edhe në vepra të tjetra me temë aktuale. Skematizmi e shkëput ngjarjen nga personazhi dhe nuk i mishëron në një unitet. Dhe tanë vijëmë pikërisht të ky problem.

E dyta, në romanin bashkëkohor ngjarjet nuk duhet të kenë rëndësi të pavarur dhe nuk duhet të shkëputen nga karakteri dhe personazhet. Është i njohur mendimi se dinamika dhe thelbi konkret historik i ngjarjeve shprehët përmes ndeshjes së karaktereve njerëzore. Në disa nga romanet tonë, po të vini re, karakteri nuk e ndjek ngjarjen, nuk shkrihet me të, por qëndron më vete. Është si një njeri në një dhomë të panjohur dhe bën sikur e njeh. Pra, ndodh një shkëputje mes njeriut dhe hapësirës historike. Ngjarjet arrijnë njëra-tjetër pa lajmëruar perspektivën, veçse herë pas here jatin ndonjë sinjal fare të vogël të ndryshimit të kohës. Kjo është një nga arsyet që shpesh në prozën e gjatë nuk ndihet perspektiva. Të ndiesh perspektivën do të thotë të analizosh thellë realitetin e sotëm, të bësh që personazhet ta asimilojnë, ta shprehin mjedisin ku veprojnë dhe të arsyetojnë thellë se ç'do të bëhet më tutje, ku është e ardhmja. Por kjo nuk arrihet me format didaktike të të menduarit. Arrihet me të menduarit figurativ dhe me ato mjete që janë në natyrën e artit dhe jo të propagandës së zakonshme pasi arti është një sferë tjetër e veprimtarisë shoqërore dhe propaganda një sferë tjetër e po kësaj veprimtarie, që ka vendin e vet të nderuar në shoqëri. Për të ilustruar këtë mendim po marr disa shembuj konkretë, në të cilët do të qëndroj pak, pasi kanë të bëjnë me një prirje të përhapur në romanin tonë. Veprat ku do të ndalem nuk janë aq të rëndësishme pér të përqëndruar vëmendjen, por shembujt e vlejnë këtë përqëndrim. E vlejnë edhe pér një arsyet tjetër, që ka të bëjë me kritikën, e cila nuk i trajton problemet konkretisht dhe pér këtë dua të ndihmoj sado pak se si mund të shkruhet edhe në faqet e shtypit letrar, paçka se autorëve mund t'u vijë keq. Ne jemi njerëz me moral të lartë komunist dhe s'ka pérse të dëshpërohem pér një kritikë. Dhe kështu, të marrim romanin e S. Jasës «Tokë e papushtueshme». Tema është e rëndësishme. Tregohet heroizmi

i partizanëve të Pezës të udhëhequr nga babë Myslimi. Në këtë roman tregohet se si erdhi fashizmi dhe se si u lftua. Ngjarjet nuk shprehen përmes lëvizjes së karaktereve, por kanë një rëndësi të pavarur, janë më vete. Atje pothuajse tregohet për gjithë Luftën Nacionallirimtare me gjuhën e një teksti historik dhe nuk kemi analizë artistike as të ngjarjeve, as të personazheve. Analiza shoqërore e psikologjike do të bënte që karakteret të hynin në ngjarjen. Por kjo, me një ndërtim të tillë të materialit, nuk mund të arrihej. Gati çdo kapitull nis nga e përgjithshmjë, nis me një tezë publicistike, ose me një veprim doemos «ideor». P.sh., kapitulli i dhjetë fillon: «Tirana asokohe u bë përsëri një skenë ku po luhej drama shqiptare. Një pamje e saj ishte zgjimi i madh i masave popullore të qytetit e të fshatit.» etj. Kapitulli i njëmbëdhjetë: «Brigjet e Erzenit! Ato, sikur e kanë përcjellë emrin e të birit të tyre..., tejembanë që nga burimi i guvave të malit të Ujëvarës, Malësisë së Shëngjergjit, Shupali i Cermenikës, përtej grykës së Pëllumbasit...» Kapitulli i dytëdhjetë: «Kur Musolini i bën një ftesë të posaçme kryeministrat kuisling, Mustafa Merlikë Krushës për t'u takuar me të në Romë, nga Shqipëria ai mori një informatë të hidhur» etj. Kapitulli i njëzetegjashtë: «Më pak se një ditë pas atyre informatave, njësi të karabinierisë italiane dhe të milicisë shqiptare, rekrutuar me para nga bajraktarët e Veriut, depertuan të mbështetura pjesërisht nga tanket...» etj. Kapitulli i njëzeteshtatë: «Fshatin e çiruan partizanët. Dy çeta dhe njësitetë vullnetare të Pezës i kishin shtyrë forcat e milicisë dhe të karabinierisë italiane tutje zonës së Pezës.» etj. Kapitulli i njëzetetë: «Çeta partizane e brigjeve të Erzenit zbriti si furtunë në bokat e veshura me shkurre, në anën e përtejme të lumit. Ajo zuri pritën dhe vëzhgonte e hetonte çfarë ndodhët...» etj. Kapitulli i tridhjetë: «Pas dështimeve të operacioneve të ushtrisë fashiste kundër Pezës, kundër Mallakastrës, krahinës së Vlorës, Beratit, orçës ghe zonave të tjera të vendit, lufta e popullit shqiptar ishte shtrire e rritur shumë» etj.

Nuk është vështirë për ta vënë re pavarësinë e ngjarjes dhe të personazheve. Kjo pavarësi shtohet kur ngjarja vihet me agjpcionin e zakonshëm. Atëherë edhe personazhi ngarkohet me agjpcion duke u zhveshur ngajeta individuale dhe shkëputja bëhet e plotë. Ata që bënë luftën nuk ishin njerëz të zhveshur nga ndjenjat, nga mendimet, nga kënaqësitë dhe nga hidhërimet. Jo vetëm në romanin që mora si

shembull, po edhe në disa të tjerë mungon jeta private e partizanit, atë e mënjanon krisma e dyfekut, pritat dhe sulmet «Para partizanë!». Nuk mund të bënte tërë ato sakrifica sublime një partizan automat. Ai i bëri këto sakrifica se kishte një botë të madhe shpirtërore. Partizani në romane as fle, as ha, as dashuron, as dëshpërohet; as kënaqet. Po jap një pjesë nga libri «Kur lindi Partia» (kujtime) i shokut Enver Hoxha për të treguar se si përshkruhet njeriu i luftës në gjithë aspektet e jetës. Është pjesa kur shoku Enver biseton me Anastas Lulën, Qorrin: «Si ë pashë se Qorri nuk donte t'i pranonte gabimet dhe se kishte kaluar shumë nata, ia preva:

— Mjaft, s'të dëgjoj më, t'i gënjen dhe s'ke ndër mend të njobësh asnë gabim. Unë do të fle, se kam gjumë.

Dhe, ashtu i veshur siç isha, u tendosa në njërin nga krevatet duke i kthyer krahët Anastasit.

— Si mo, do të flesh? — bërtiti ai.

— E pse të mos fle, — i thashë, — akoma të rri e të dëgjoj përrallat e tua!?

— Çfarë përrallash, — ma ktheu ai, — po si do të të zërë gjumi?

— Pse të mos më zërë? — iu përgjigja. — Ndërgjegjen unë e kam të qetë prandaj gjumi do të më zërë që ç'ke me të!

— Po s'të lë unë të flesh, — bërtiti Qorri, — m'i lëshove gurët dhe m'i le në kurriz.

— Rri rehat, Qorr, — i thashë....»

Ndonjë romancieri tonit edhe t'i thoshe për ta shkruar një episod të tillë do të të përgjigjej: «Nuk flinin në një situatë të tillë komunistët.» Dhe do ta shkruante «E gdhimë tërë natën. Unë i thashë: Do ta paguash shtrenjt, or i poshtër, or spiun e këlysh i fashizmit dhe shporrmu që këtej.» 93

Edhe sikur shkrimtari ta shkruante, ndonjë redaktor do t'ia quante gabim ideologjik e do të thoshte: «Si është e mundur të flinte komunisti, kur ky deviator i Partisë mund ta vriste në gjumë, ose mund ta kallëzonte në kuesturë? Kjo është jashtë realitetit dhe është zbutje e luftës ideologjike dhe klasore.» Atëherë shkrimtari do të detyrohej të thërriste në ndihmë skematizmin për t'i shpëtuar belasë. Pra, ka edhe shkrimtarë, edhe redaktorë që i shmangen pasqyrimi komplex i të ndërlikuar të jetës e historisë dhe kjo ia lë vendin skemës së thjeshtë. Kjo skemë shkëput ngjarjen nga personazhi, gjë që është një nga dobësítë më të theksuara

të romanit. Por pavarësia mund të jetë e formave të ndryshme. P.sh. te romani «Jetë dhe dashuri» i M. Qillerit, që është një roman jo pa vlera, personazhet nuk hyjnë në ngjarjen e dashurisë, ata janë jashtë, vetëm bëjnë sikur hyjnë. Edhe këtu kemi pavarësinë e ngjarjes nga personazhi. Kjo është do-bësi që vjen nga fëmijëria e romanit tonë. Tani që romani është rritur dhe ka bërë një hop të madh cilësor, duke dalë edhe jashtë kufijve të vendit, di ta ndjekë dhe ta njohë mirë këtë defekt.

E treta, është e nevojshme që romani ynë të mos lejojë trajtimet artizanale e «provinciale», por të synojë format e përparuar, strukturat dhe teknikat kontemporane, duke forcuar në të njëjtën kohë përbajtjen dhe origjinalitetin kombëtar. Ndërtimi i socializmit është frontal. Ai e ngre me forcë zhvillimin shkencor të përparuar, e ngre, me forcë nevojën e një teknike të re moderne, e ngre me forcë drejtimin shkencor në të gjitha fushat. Kur kërkojmë teknikë të përparuar moderne në industri, nuk mund të jemi kundër teknikës së re moderne në roman dhe trajtimit bashkëkohor të materialit. «Fryma revolucionare, novatorizmi, — thotë shoku Enver, — janë pjesë organike e vetë realizmit socialist». Vetë socializmi është një sistem shoqëror novator. Por novatorizmin ne nuk e marrim të shkëputur nga përbajtja, përndryshe do të binim në modernizëm, në ndikime të huaja, nga të cilat duhet ruajtur. Në radhë të parë kërkimet, gjetjet e novacionit bëhen në përbajtje, në materialin e në problemin. Trajtimi i temës aktuale dhe asaj të së kaluarës me thellësi e me freski sjell edhe forma e struktura të reja.

Aktualisht, në procesin e zhvillimit të romanit vihet re njëfarë monotonie në strukturë. Pjesa më e madhe nisin nga e përgjithshmja në të veçantën nga masa e materialit kalohet në botën konkrete të njerëzve. Është e natyrshme, që në romanet historike kjo mënyrë do të jetë më e trajtueshme, por në ata që pasqyrojnë jetën e sotme mund të jetë e ndryshme. Rrallë ka romane me vetëzbulim të karakterit e me arsyetime e meditime të heroit. Pak analizohet fakti dhe dilet nga kufijtë e tij. Shpesh mungon motivimi psikologjik dhe moral i reagimit të njeriut ndaj realitetit që e rrrethon. Heroi mendohet pak për rrethanat, për personazhet, për vreten. P.sh., në disa romane të R. Bedos, M. Memisë e të ndonjë tjetri që ka edhe përvojë krijuese, mungon psikologjia, mendimi dhe arsyetimi. Në disa të tjerë mungon portretizimi dhe gjuha e personazheve gjë që bën të humbë

vërtetësia artistike. Ne të gjithë e kemi lexuar librin e shokut Enver «Kur lindi Partia». Libri të habit me pasurinë e materialit, me ndërtimin e tij, me portretizimin e personazheve të vërteta me mendimet, me gjuhën e gjallë plot ngjyra, me vërtetësinë jetësore e artistike dhe me humorin dhe ironinë. E meqë erdhi fjala për humorin, dua të them se një nga tiparet e dukshme të romanit të sotëm është pikërisht prezencia e ironisë. Ironia e romanit ia rrit tonin polemik dhe e bën më kontemporan dhe më dinamik. Dhe këtu nuk e kam fjalën për romanet thjesht humoristike, të cilët, vetëkuptohet, që humorin dhe ironinë e kanë mjetin kryesor. E kam fjalën për humorin dhe ironinë në romanin e zakonshëm. Po ta vini re, romancierët e talentuar dhe të pëjisur me një kulturë të gjërë praktike dhe intelektuale kanë një ironi të hollë që i jep fjalës një shkathtësi të çuditshme dhe e bën ngjarjen të rrjedhshme. Po rrjedhshmëria dhe dinamika janë nga elementët më të domosdoshëm të romanit. Këtë e theksojmë pasi ndonjëherë romani ynë vuan nga dobësimi i dinamizmit të zhvillimit të ngjarjes, nga plogështia e lëvizjes së saj. Kjo ka një kompleks arsyesh, por një ndër më kryesorët është mungesa e mendimeve të freskëta të papërsëritshme, mungesa e polemikës së personazhit me lexuesin, mungesa e problemit të mprehtë shoqëror, mungesa e teknikës origjinale të strukturës dhe informacionit artistik. A kemi bërë ndonjëherë ndonjë polemikë në roman se ç'është arsyja që ka mjaft divorce në disa qytete të mëdha? A kemi bërë ndonjë polemikë se ç'është arsyja që ndonjë kooperativë bujqësore e tipit të lartë ka rendimente më të ulëta se një kooperativë e thjeshtë? A kemi bërë ndonjë polemikë se si punon inteligjencia e fshatit për ngritjen e kulturës së njerëzve? A kemi bërë ndonjë polemikë se ç'kérkesa ka njeriu ynë i ri i qyteteve dhe a ka shenja të nihilizmit apo të jetës së lehtë pa kokëçarje? A kemi bërë ndonjë polemikë se ç'nevoja e mendime ka adoleshenti i fundit të këtij shekulli? Natyrish, unë i bëj këto pyetje në mënyrë pak të vulgarizuar, pasi letërsia nuk do t'u përgjigjej kajq trashë. Ajo do t'u përgjigjej me logjikën e artit. Megjithatë, duhet të jemi të ndërgjegjshëm që letërsia jonë ende pak probleme i ngre shoqërisë. Dhe kjo nuk është në dobi të nivelit artistik të saj.

E katërta, ka ardhur koha që të gjallërohet më shumë mendimi kritik për problemet e romanit dhe të mos i traj-

tojmë globalisht, por të hyjmë në terrenin konkret. Siç u theksua edhe në plenumin tonë, romani ka shumë probleme, por ne atyre u kalojmë përciptazi. Ndonjëherë nuk jemi as konsekuentë në mendime. Për një roman që e kemi kritikuar, papritur e lavdërojmë, ose anasjelltas. Flas përshtypin. Shkruajmë artikuj pa përgjegjësi dhe ndonjëherë shkel e shko. Fjala vjen, në gazetën «Drita», më 20 shtator 1981, kryeartikulli «Vëmendje ndaj arritjeve dhe problemeve të rëndësishme» i trajtonte problemet e romanit me një mungesë njohjeje. Autori shkruan: «Në romanin shumëplanësh kanë pasur suksesë jo vetëm Sh. Musaraj, S. Spase, I. Kadare, T. Laço, S. Drini, A. Cerga, M. Kallamata etj., por edhe të tjerë që janë më të rinj në këtë fushë si S. Krasniqi, J. Dini apo M. Qilleri që sapo kanë dhënë librin e parë në këtë lloj.» Në radhë të parë, e gjithë kjo tautologji nuk është e saktë si tërë tautologjitet, pasi A. Cerga, S. Drini, M. Kallamata, J. Dini, M. Qilleri e T. Laço nuk kanë shkruar romane shumëplanëshe dhe kjo nuk ua humb vlerat. Në radhë të dytë, pionieri i vërtetë dhe kryetari i romanit shumëplanësh J. Xoza me «Lumin e vdekur», «Ju-gën e bardhë» dhe «Lulen e kripës» në artikull nuk përmendet fare. Romani i vërtetë klasik e modern shumëplanësh është në radhë të parë «Lumi i vdekur» pastaj edhe mund të mbetet ndonjë nga ata që përmenden në atë listë. Vazhdojmë me tautologjinë e artikullit: «Romanet më të arrira të viteve të fundit, shkruan autorri, janë dalluar për gjuhë të pasur e të zhđervjellët që nuk pengon synimet ideoartistike të autorëve...». Gjuha e pasur dhe e zhđervjellët nuk mund të pengojnë synimet ideoartistike të autorëve, përkundrazi.

Mendimi kritik duhet të fitojë guxim qytetarie që ta thotë pa druatje fjalen se mjaft proza të gjata që kanë etiketën roman, nuk janë romane, por histori të zvarritura dhe personazhet nuk janë personazhe, por manekene që i bëjnë reklamë materialit në vitrinën e padukshme të kësaj gjинie.

Duhet ta pohojmë me keqardhje se kritika jonë në mjaft raste është e plogësht dhe me zbrazëti të dukshme profesionale. Dobësia vjen edhe nga përpjekjet e pakta për të mësuar dhe për t'u pasuruar me kulturë, nga indiferentizmi ndaj jetës artistike, nga plogështia e ndjenjës qytetare, nga humbja e interesit për të polemizuar e debatuar, nga dembelizmi dhe apatia ndaj letërsisë e proceseve të saj dhe nga një rendiment i ulët krijues. Ka mjaft redaktorë që gjy-

kojnë qindra libra e shkrime nëpër redaksitë e që kurrenuk u del emri në ndonjë artikull për të thënë mendimin e tyre. Ka të tjerë që batojnë një herë në gjashtë hëna. Ka një kategori që shkruajnë shkel e shko sa për të kaluar radhën dhe merren me vogëlsira të përditshme.

Përballë kritikës sonë ka shumë probleme, ndaj të cilave është e dëmshme heshtja dhe indiferentizmi. Por problemet nuk duhen mbetur në darën dhe lakin e frazeologjisë dhe trajtimit tallmudist.

Zhvillimin e kritikës nuk mund ta marrin përsipër vetëm kritikët dhe studiuesit, pasi për vetë kushtet e jetës letrare ata janë të paktë. Në kritikë duhet të kontribuojnë edhe shkrimtarët dhe artistët, të cilët kanë përvojën krijuese dhe kanë mundësi të arrijnë në përgjithësimë me vlerë. Fatkeqësisht, shkrimtarët pak merren me kritikë dhe studime. Ne vërtet i kritikojmë kritikët, por është fakt që ata diskutojnë dhe ata shkruajnë. Duhet thënë edhe një gjë. Kritika varet edhe nga atmosfera letrare, varet nga shkrimtarri dhe lexuesi: sa është i prirë shkrimtari të lexojë vërejtjet dhe dëshirat e kritikut, sa është i prirë edhe rrëthi i shokëve të shkrimtarit për të toleruar. Ne ende shpesh vualjmë nga intoleranca e kritikës, e ruajmë shumë pronën tonë — veprën — që të mos na e cenojnë të tjerët. Dhe kjo kuptohet: është mbeturinë e lashtësisë në ndërgjegjen njerëzore. Pjekuria e një shoqërie vjen kur pranon kritikën dhe auto-kritikën. Një malësor i dikurshëm, po ndonjëherë edhe i sotëm, e ka pasur të vështirë të bëjë autokritikë e kritikë. Ne mbartim disa mbeturina të së kaluarës si, p.sh. intolerancën. Socializmi lufton ditë e natë për të çrrënjosur këtë mbeturinë. Burim tjetër i dobësive të kritikës vjen që nga thellësitë e viteve të fëmijërisë sonë e të adoleshencës kur fillon të formohet njeriu. Në shkolla nuk bëhen herë-herë mirë mësimet mbi gjuhën, letërsinë. Ndonjëherë në shkollë fli-tet me sloganë në këto lëndë. Dobësi kanë edhe leksionet në universitet dhe në shkolla të larta. Këto dobësi bartin edhe kuadrot që vijnë në kritikë. Një burim tjetër është njojja e paktë e jetës nga kritikët. Një kritik që merr përsipër të shkruajë për një vepër aktuale, p.sh.. për fshatin, duhet ta njojë ashtu siç e njeh edhe shkrimtari. Shkak tjetër është plogështia në ndjekjen e proceseve krijuese letrare e artistike jo vetëm nga kritikët, por edhe nga shkrimtarët vetë. Dhe arsyjeja e fundit e prapambetjes së kritikës është mungesa e debatit, e diskutimit, e rrahjeve të mendimeve në faqet e shtypit, në «Drita» e «Nëntori».

Kritika është e domosdoshme të trajtojë edhe probleme të origjinalitetit kombëtar të romanit tonë, duke hedhur poshtë medimet e revisionistëve jugosllavë, se gjoja të flasësh për çështjen kombëtare na qenkësh një anakronizëm dhe një «romantizëm historik». Neve nuk na u lejuaka të flasim për çështjen kombëtare, kurse atyre iu lejuaka! Çdo ditë televizioni i tyre paraqet ansamble këngëtarësh e valltarësh të veshur me kostume kombëtare serbe, malazeze, maqedone, kroate etj. Çdo vit botohen me dhjetëra libra, ku mburren vojvodët dhe kapedanët serbë e malazez, si ata që përshkruan M. Laliçi, D. Çosiç etj. Bile, ka një tendencë në letërsinë jugosllave për t'u hedhur në lashtësinë dhe në bëmat e sllavëve të hershëm e të pararevolucionit. Shkrimtari jo pa emër, D. Çosiç ka botuar një trilogji të tërë shkruar nëpër manastire dhe vende turistike me arkitekturë të lashtë. Në këta libra mburret lashtësia sllavjane, veçanërisht serbe e malazeze. Ndërsa ne, po të shkruajmë një roman për Bajram Currin apo Isa Boletinin, qenkeshim «anakronistë»! Me këtë ata duan t'ua privojnë vëllezërve tanë në Kosovë jetën e heronjve të lavdishëm të lëvizieve patriotike e revolucionare shqiptare dhe për këtë arsyе nisin e teorizojnë në mënyrë banale për problemin e identitetit kombëtar.

Traditën kombëtare gjithmonë ne e vështrojmë në marrëdhënie të ngushtë me të renë novatore. As njëra, as tjetra nuk mund të qëndrojnë të veçuara dhe aq më tepër nuk mund të mohojnë shoqja-shoqen. Tradita është prapavija, novatorja është pararoja në të njëjtin front. Prapavija nuk mbahet dot pa pararojën dhe pararoja nuk mbahet dot pa prapavijën. Kjo është dialektika e problemit sipas shkencës marksiste.

Romani ynë është në procesin e një zhvillimi të dukshëm dhe me siguri shkon drejt pasurimit të gjithanshëm të tij në përbajtje e në formë. Ai ka dhënë prova të vërteta pjekurie të një origjinaliteti të theksuar në ide dhe në strukturë. E ardhmja e kësaj gjini është pa dyshim e madhe, që do t'ia rritë vlerat letërsisë sonë.

1981

DISA MENDIME PËR ROMANIN, STRUKTURËN DHE EVOLUIMIN E TIJ

Romani është nga gjinitë më të përhapura në botë. Ai ka tërhequr vëmendjen e të gjithëve dhe ka bërë pér vete miliona lexues. Në çdo vend, të madh apo të vogël, ai është duke pushtuar njerëz, kolektiva dhe familje të tëra. Pse ndodh ky fenomen? Ky fenomen ndodh, pasi romani është një gjini që ka mundësi t'u përgjigjet kërkuesave të njerëzve më gjierë dhe më gjithanshmërisht se mjaft forma të tjera të letërsisë. Romani ka disa mundësi të tilla si ngjarjen, analizën, arsyetimin, heroin, faktin e informacionin, të cilat e bëjnë të ketë një frymë të madhe demokratike. Pikërisht në këtë frymë demokratike të gjinisë, abuzojnë tregjet e konsumit, abuzon shoqëria e konsumizmit në vendet kapitaliste. Le të kujtojmë se ç'ndodh me romanin detektiv dhe me ata që vënë në qendër problemet e seksit, me ata që merren me psikoanalizën e me gërmimet e ethshme në skutat më të errëta të ndërgjegjes. Ky lloj romani ende nuk e ka humbur tregun dhe doemos përmes tregut shiten edhe eksperimentimet apo përsëritjet e të njëtave forma, por me veshje e sende të reja të konsumit. Duke ndier zhurmën e këtij vërvshimi të romanit konsumist, disa janë marrë edhe me prova pér të treguar se ç'mund të bëjë kjo gjini letrare, në qoftë se vihet në **laboratorët krijues**. Mjafton të përmendim laboratorët e shkollës së «romanit të ri» të Natali Sarot, që bashkë

me Rob-Grijé, veçanërisht me këtë të fundit, mendonin ta kthenin letërsinë në një fushë të shkretë, duke ia shkulur pemët e mbjella nga të parët; që donin t'ia hiqnin romanit principet tanimë të përpunuara nga mjeshtrit e mëdhenj; nga gjuha emocionale, nga personazhi, nga ngjarja interesante, nga tensioni i brendshëm, nga shqetësimet dhe problemet që ka njeriu dhe shoqëria. Mbi fushën e mbjellë nga të tjerët këta eksperimentues nuk donin të vinin pemë të tjera, por t'i prisnin të hershmet dhe të mbillnin të tvrat.

Këto janë peripecitë, zigzaget dhe udhëtimet e gjinisë, të cilës eksperimentuesit përpilen t'ia ndërrojnë drejtimin dhe misionin, duke marrë shkas edhe nga ajo që është një formë e re e artit, në krahasim me poezinë apo dramën. Ata kanë menduar se meqë poezia ka bërë mjaft eksperimete, le të bëjë edhe romanin!

Duke ndjekur peripecinë e romanit, veçanërisht në këta dy-tre dhjetëvjeçarët e fundit, flas për romanin botëror, mund të arrijmë në përfundim se në kohën e sotme ka dy tendencia përfatim e tij.

Njëra tendecë është se romani nuk e ka humbur dhe nuk e humb rëndësinë e tij në letërsi, përkundrazi kërkon rrugë të reja në përmbytje dhe në formë. Tendencia tjetër është se romanit po i kalon koha si gjini dhe ndodhet në një krizë e në një ngecje në vend.

Përkrahësit e avanguardizmit e shpallin romanin realist si të ezauruar, si një formë që ka arritur kulmin në shekullin e 19-të me Balzakun, Dikensin, Tolstoin e Dostoevskin dhe që sot po heq shpirt dhe nesër do të vdesë. Këta parashikues të së ardhmes së kësaj gjinie tradicionale i kundërvënë asaj romanin modernist të Prustit, Xhojsit, Kafkës dhe më të rinxve, i cili, sipas tyre, po i jep një jetë të dytë, po e transformon dhe e shpëton nga vdekja. Në mes këtyre tendecave, d.m.th., e tendencës që romani nuk e humb rëndësinë e tij në letërsi dhe e tendencës që romanit po i kalon koha, është edhe një krah pesimist dhe konservator. Ky krah pesimist mendon se romanin i shekullit të 19-të është model, ndërsa i sotmi është në një pikë pa rrugëdalje.

Mendojmë se në botë nuk është një krizë gjinia, por personazhi, heroi. Romancierët e çoroditur nuk e gjejnë heroin, megjithëse ai jeton në realitet. Mbi kurrizin e heroit sot bëhen eksperimente dhe këto ndikojnë edhe në format e romanit. Prandaj edhe arsyetimet përfundin e romanit nuk

kanë baza reale, as skepticizmi për të sotmen dhe nostal gjia për të kaluarën e tij nuk janë të dobishme. Ne jemi si kundër tendencës se romanit i ka kaluar koha, ashtu edhe krahut që romani është në një pikë pa rrugëdalje. Jemi për një roman me origjinalitet kombëtar, me një strukturë të përparuar e me një formë të lartë artistike që t'i shërbetë njeriut, që ta fisnikërojë atë e që ta ndihmojë për punë të mëdha në transformimet shoqërore. Edhe në botë sot, përveç vërvshimit të romanit të konsumit, jeton edhe një roman i përparuar krah atij të traditës së madhe të krijuar në shekuj. Është e natyrshme, që nihilistë dhe polemikë do të ketë. Por ndërsa bëhet kjo polemikë, romani vazhdon procesin e zhvillimit dhe në këtë proces përsoset e rritet, duke u mbrijtjat me përbajtje të re me forma dhe struktura të përparuara brenda rrethanave dhe kushteve sociale e politike të çdo vendi, brenda frysës kombëtare dhe veçorive të saj. Jashtë këtyre kushteve nuk mund të ketë roman të vërtetë. Nuk e shtrojmë domosdoshmërinë e fizionominë kombëtare si qëllim në vetvete për të frenuar ecjen e romanit, përkundrazi e shtrojmë për ta freskuar dhe nxitur zhvillimin e tij, për ta bërë këtë gjini sa më origjinale mes këtij vërvshimi të prozës së sendëzuar për konsum të gjërë, që ka mbushur tregjet e botës dhe që vepron si drogë në lexuesin mesatar.

Fizionomia kombëtare, konstitucioni shpirtëror i një populli, është i ndryshëm nga konstitucioni i një populli tjeter. Shprehja e këtyre konstitucioneve të ndryshme përmes romanit e origjinalizon gjininë dhe nuk e barazon krijimtarinë e një populli me krijimtarinë e një populli tjeter. Pse ka ngjallur interes në ditët tona romani i Amerikës Latine, romani i Markesit apo Asturias? Përveç të tjerave, ka ngjallur interes, pasi e shpreh konstitucionin shpirtëror të këtyré popujve, origjinalitetin e jetës, e historisë, e legjendave dhe zakoneve të përziera dhe të pleksura me fenomenet e shoqërisë së konsumizmit. Po ta pasqyronte ky roman vetëm elektronikën, tregtarinë, reklamën dhe korruptionin, nuk do të ishte origjinal, pasi këto dukuri janë të njëjlojta në gjithë shoqëritë e konsumizmit.

Të marrim romanin anglez të shekujve të 18-të dhe 19-të. Ky roman kishte për bazë udhëtimin, peripecinë. Personazhet e tij janë në udhëtim. Këtij udhëtimi i nën-shtrohet edhe fabula e romanit. Pse? Jeta angleze e

atyre kohrave e kishte në natyrën e saj udhëtimin, kishte etjen e pasurimit dhe etja kërkonte aventurë. Këto veçori hynë në konstitucionin shpirtëror të popullit. Ky konstitucion u shprehë në roman dhe i dha atij origjinalitet, e bëri të ndryshëm nga romani francez, apo rus. Ndérkohë jeta e Ishullit Britanik ruante konservatorizmin aristokratik, ruante me fanatizëm familjen. Romani anglez e shprehu edhe këtë anë: përpjekjen për ruajtjen e familjes. Edhe kjo i dha origjinalitet të ndryshëm nga romani francez, që pasqyronte shkatërrimin e familjes. Le të kujtojmë «Zonja Bovari» të Floberit, që ka në qendër problemin e familjes që shkatërrrohet. Pse ndodh kjo? Vetë kombi francez kalonte në një fazë tjetër, si pasojë e revolucioneve borgjeze, kalonte në fazën e emancipimit borgjez të familjes. Ky fenomen u bë traditë në romanin francez, u bë veçori kombëtare. E shihni, pra, se çfarë roli luajnë veçoritë kombëtare të një vendi për romanin?

Të marrim romanin shqiptar. Që në lindje të tij ai vuri në themel tokën dhe ekzistencën, etjen për dituri dhe përparrim shoqëror përmes rrugës së flijimit. Nuk duket kjo në romanet e Jakov Xozës e Ismail Kadaresë? Nuk duket kjo në romanet e Sterjo Spasses e Fatmir Gjatës, apo Ali Abdihoxhës?

Romani ynë e ka ngjarjen e tensionuar të mbushur me kontraste, me zbritje dhe kulme, si taborët e hordhive të huaja që vërshonin dhe thyheshin, që përkohësisht fitonin dhe humbnin; e ka këtë ngjarje si çetat e patriotëve dhe brigadat e partizanëve në gryka e lugina: e ka si malet me majë dhe gunga si guva dhe fusha të pakta. Romani ynë e ka fabulën shpeshherë të ndërprerë dhe kohën personazhi e pret të mbarojë me padurim. Është vetë terreni shqiptar, me hapësirë të paktë për udhëtime të pafundme. Nuk është një terren ku personazhi të udhëtojë muaj të tërë nëpër stepa e shkretëtira. Në terrenin tonë ndodhin udhëtime që ndërpriten nga malet; ka pasur bujtina dhe bujtinarë, ka pasur kafexhinj dhe malësorë që të ftonin në shtëpi. Atëherë edhe vetë njësia-kohë është tepër e ndryshueshme. Dita nuk zgjat. Nata zgjat me kuvendi-me e biseda. Dita mjafton për një udhë të shkurtër. Nata e zgjat këtë udhë me rrëfenja e historira. Merrini romanet tona dhe bëni një diagramë të hapësirës dhe kohës, dhe do të shihni si pëershkohet distanca nga personazhi dhe sa zgjat dita dhe nata. Këtë e bën vetë veçoria kombëtare:

mikpritja, besa e respekti pér mikun. Por miku nuk kérkon muhabet ditën, po natën. Romani amerikan e ka ditën të gjatë, pasi është automatizimi i jetës. Merrni romanet «Zgjimi» të S. Spasses dhe «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» të I. Kadaresë dhe do të gjeni këtë që jua them unë. Dhe kjo rrjedh jo vetëm nga veçoria e hapësirës së vendit tonë, por kjo rrjedh edhe nga vetë kultura populllore. Heronjtë e legjendave natën bien në mendim pér të udhëtuar të nesërmen. Siç e shpreh afërsisht një kritik i huaj, natën përgatitet edhe kali, freri, yzengjia, takëmet. Natën bie në mendime edhe heroi. Ndofta më shumë se në çdo letërsi të vendeve të tjera, kjo anë është ruajtur në letërsinë tonë, veçanërisht në prozë, por edhe në poezi. Pse? Sepse industrializimi nuk e ka prishur traditën, sepse respekti pér të është i madh. Vetë socializmi na ka mësuar ta nderojmë traditën. Socializmi e quan traditën si bazë nga ngrihet lart novatorizmi. Ne jemi më afër legjendave se shumë popuj të tjerë. Kjo ka ndikuar në gjithë letërsinë tonë, veçanërisht në roman. Por këto që përmenda nuk janë gjëra të vogla e pa rëndësi. Ato nuk kanë të bëjnë me mençurinë sugjestionuese pér fabulën e një romanit, që të çuditemi e të themi: «Ah, qerratai, sa i zoti! Nuk e nisi nga fillimi, po e nisi nga fundi romanit e tij!» Me këtë mund të çuditën vetëm provincialët. Kryesorja qëndron në kockën nocionale që e mban romanin, në atë kockë sic është te shkrimtari islandez Llaksnesi në «Njerez të pavarur» apo tek I. Kadareja në «Gjeneralin e ushtrisë së vdekur». Të dy këta romane nga dy autorë të ndryshëm në stile e në pikëpamje, të ndryshëm në vende e në kombe, përveç anës ndërnjerëzore të përbashkët, kanë origjinalitetë të veçanta kombëtare. Pér këtë janë edhe interesante. Shkrimtari i vërtetë edhe sikur një element nacional të gjejë, ndërton një të tërë, si zoologu që gjen disa kocka të një dinozauri dhe ndërton një dinozaur të plotë.

Pasi preka kalimthi disa elemente të origjinalitetit nacional dhe të rëndësisë së tyre pér romanin dhe pér format e tjera të letërsisë, dua të ndalem shkurtimisht në ndonjë prirje të romanit tonë në fushën e strukturës së tij.

Në romanin tonë jetojnë të gjitha format: mënyra narrative, mënyra narrative meditative dhe mënyra e thyerjes së narracionit. Edhe këtu qëndron origjinaliteti i romanit tonë.

E themi këtë, pasi, duke ekzistuar të gjitha këto forma,

ai është i pasur dhe nuk është monoton. Romani ynë edhe format klasike i ka rigjallëuar me mendime dhe ide të reja të kohës. Këto forma tingëllojnë të reja nga vetë mendimet e mëdha shoqërore. Ndonjëherë ato janë më të feskëta sesa eksperimentimet e kota formaliste. Romani, ynë është në rrugën e përtëritjes dhe të përsosjes së tij, në rrugën e gjetjes së formave të reja për të shprehur ide të reja. Me sa duket, sot ai gjithmonë e më shumë po u afrohet veprave muzikore me kumbime e me refrene, me largime në hapësirë dhe me afrime. Është si një polifoni. Në romanin tonë të sotëm njeriu nuk zbret në nivelin e sendeve. Është zot i sendeve dhe objekteve, prandaj romancieri nuk i numëron sendet dhe objektet, ashtu siç nuk i numëron simfonia. Po t'i numëronte, do ta bënte heroin rob të sendeve. Romani i sotëm është historia e koncentruar e heroinit ose e disa heronjve. Duke qenë histori, çdo personazh është në të njëjtën kohë edhe tip edhe individ. Heroi i romanit tradicional ka më shumë peripeci, aventurë të jashtme; heroi i romanit të sotëm këtë peripeci apo aventurë e ka më shumë në ndërgjegjen e në mendimin e personazhit. Sa kalon koha, romani po bëhet më shumë autobiografik, pasi vetë shkrimtari jeton intensivisht me jetën e shoqërisë, jeton mes njerëzve, i paizoluar. Autori dhe heroi sa kalon koha aq më tepër po bëhen identikë. Autor e hero afrohen. Pse? Pasi autor i nuk ndien ndonjë ndryshim të madh në pozitën shoqërore me personazhin që pasqyron. Autori nuk është një «ex-catedra».

Duke qenë personazhi zot i sendeve dhe jo skllav i tyre, dhe as soditës kontenplativ i tyre, ka vepruar jo vetëm mbi fabulën, po edhe mbi kohën e ngjarjes, mbi kohën e rrëfimit. Po e shpjegoj pak me se kam mundësi dhe njohje. Koha në romanin tradicional numërohet me orë, numërohet me kalendar, kurse romani i sotëm e merr këtë kohë, i merr këto orë kalendarikë dhe i fut në ndërgjegje, duke i nxjerrë përsëri. D.m.th. nuk e lë kohën jashtë ndërgjegjes, vetëm nëpër sendet. Për këtë arsyenë në romanin e sotëm nuk pasqyrohet koha gjithmonë e një linje. E themi këtë, pasi çdo personazh ka kohën e vet, ka biografinë e vet dhe biografia nuk ndodh jashtë kohës.

Në këtë përtëritje të romanit kanë ndihmuar të gjitha gjinitë e tjera të letërsisë dhe arteve: eposi poetik, vjersha, legjenda, përralla, eseja, muzika. Ndodh ajo që thamë: romani po i afrohet një simfonie. Por këtë e realizojnë ata

që kanë talent. E them këtë, pasi ndodh ndonjëherë, që imituesit marrin disa forma të reja të gatshme, i futin në romanet e tyre pa ndryshuar asnje strukturë. P.sh. thyejnë ngjarjen, d.m.th. narracionin, dhe lënë kohën kalendarike apo ekspozicionin e personazheve të njëllotë me strukturën klasike. Atëherë kemi një bastard... Në këtë rast është më e mirë forma klasike e romanit të shekullit të 19-të.

Romani është një gjini e fuqishme, e plotpushtetshme. Dua të citoj një thënie të Tomas Manit për romanin «Ky është shpirti i fuqishëm dhe i madhërishëm, i gjithpushtetshmi i begatë, si vetëjeta, i pakufishëm si deti zhurmues monoton, në të njëjtën kohë grandioz dhe i saktë, i këndueshëm dhe i mençëm; ai nuk mund të kënaqet me një detaj të vetëm, me një episod të veçantë; atij i duhet tërësia, gjithë universi me episodet e tij të pafuqishme dhe me tërë pjesëzat; ai dhe duke harruar veten, qëndron në çdonjërën prej tyre, sikur çdo episod e çdo pjesë të ishin për të të rëndësishme. Atij nuk i duhet ngutja, ka përpara kohën e pambuar; është shpirti i durimit, besnikërisë, pritjes dhe ngadalësisë, e cila është ngrohur nga dashuria, prandaj jep kënaqësi; ai është shpirti i mërzisë së embël.»

Meqë u ndala në problemet e hapësirës, kohës dhe rrëfimit dhe në disa anë të ndryshimeve që ka pësuar struktura e romanit, dua të shtoj edhe diçka për disa elemente të tjera të pasurimit të mjeteve shprehëse.

Është një veçori e romanit tonë, që po e thekson për herë e më shumë, ironinë. Kjo e bën romanin më të gjallë e më të mënçëm, duke ia forcuar dialektikën e mendimit. Një veçori e tillë është shenjë e njerëzve të zgjuar, e personazheve të zgjuar. që nuk kënaqen me çdo gjë të një ambienti, apo të një kohe, pasi, krahas përparimeve të mëdha shoqërore, ka edhe fenomene që pengojnë. Këtë ndjenjë ironie ne e vëmë re në prozën e I. Kadaresë, T. Laços, F. Gjatës.

Nga ana tjetër, gjuha është bërë më e gjallë e më e zhdërvjellët, me të papritura të çuditshme, ndonjëherë në formën e marrëzive pa të keq. Të papriturat e jashtëzakonshme si ato të plakës Nicë në «Gjeneralin e ushtrisë së vdekur» apo të disa personazheve të N. Rrahmanit, jo vetëm që e dinamizojnë gjuhën, po edhe shqetësojnë ngjarjen, duke thyer monotoninë.

Dhe le të flasim tanë për dinamizimin e ngjarjeve. Romani nuk mund të jetojë një jetë të plotë e të vërtetë

pa atë që unë mund ta quaja sustë apo zemberek që qëndron ngaherë i tendosur dhe i kurdisur për t'i shtyrë përpara veprimet dhe bashkë me to edhe mendimet. Ora, duke u kurdisur, spirali i saj mblidhet dhe tendoset. Kjo e bën që të punojë e të tregojë kohën. Kur ky spiral është i dobësuar, atëherë ora mbetet pas dhe ngadalëson tregimin e kohës. Spirali i romanit (zemberekut) që nxiton veprimin, po të dobësohet, e mërzit lexuesin dhe ia bën atij të gjatë kohën e leximit. Por ky spiral (figurativ) nuk qëndron vetëm në subjektin e ngjarjes që është vendosur në bazë të romanit. Ky spiral qëndron në dialektikën e mendimeve, qëndron në ndeshjen dhe kundërvëni e tyre, në pohimet dhe mohimet origjinale. Ato romane që lexohen me zor dhe që janë të mërzitshme u ngajnjë orëve që mbeten pas, orëve që u është dobësuar zemberekut.

Doemos, para romanit tonë dalin shumë probleme që kanë të bëjnë me përbajtjen dhe formën, më strukturën dhe gjuhën e tij. Në procesin e zhvillimit ai duhet të kapë sfera më të gjëra të jetës së shoqërisë dhe të fateve të njerëzve, duke zbuluar gjithmonë e më shumë anë të patractuara, apo të trajtuara pak të jetës së popullit. Ndërtimi i socializmit në Shqipëri e ka pasuruar botën shpirterore të njerëzve dhe ka nxjerrë në skenë një njeri të ri, të përparuar, me ideale të larta shoqërore. Ky njeri kërkon pasqyrimin e tij më të plotë. Dhe këtë mundësi e ka metoda e realizmit socialist.

Të gjitha letërsitë botërore të përparuara e veçanërisht ato të shekullit të 19 e të fillimit të shekullit të 20, e kanë drejtuar vëmendjen nga njeriu i ri, nga përfaqësuesi i ri i shoqërisë. Le të kujtojmë Stendalin, Tolstoin, Dikensin e Gorkin. Në proceset e sotme të zhvillimit romani ynë duhet ta pasqyrojë më mirë këtë njeri të ri, me veçoritë e tij kombëtare. Kjo duhet bërë përmes gjetjeve të reja, që të jepin mundësi për të medituar e përtë filozofuar.

1981

TREGIMI PËR FËMIJË

Letërsia ka tregime për fëmijët dhe tregime mbi fëmijët. Të dyja këto dukuri janë të dobishme nëse tregimi është vepër arti. Kur tregimi del jashtë sferës së artit, as ai për fëmijë dhe as ai mbi fëmijët nuk kanë vlera edukuese për të vegjëlit.

Tregimi për fëmijë, karakterin që jepet përmes personazhit apo heroit e ka të formuar. Karakteri zbulohet përmes situatave të jashtëzakonshme. Suksesi i tregimeve të Naum Priftit këtu qëndron. Në tregimet e tij karakteri nuk ka lëkundje. Trimi është trim, frikacak u është frikacak. Heroi fiton duke bërë akte të jashtëzakonshme, përdor dhëlpërinë dhe mençurinë për t'ia arritur fitores.

Tregimi mbi fëmijët karakterin e ka në zhvillim e në rritje, herë mes lëkundjeve shpirtërore, herë mes kapercimit të vështirësive. Ky lloj tregimi i pëlqen më shumë të rriturit. Pastaj tërheq edhe të voglin. Këtë tregim e kanë trajtuar me sukses edhe Naum Prifti, veçanërisht atë me temë ngajeta e fshatit në të kaluarën, edhe Dhimitër Shuteriqi, edhe Agim Cerga. Më duket se ky lloj tregimi do ta pasurojë letërsinë përfëmijë, do të mos e thellojë hënëdekun mes letërsisë përfëmijët dhe letërsisë përtërrit. Duhet të jetë një letërsi, por me një ndryshim në destinacion. Ne sot kemi shkrimitarë me kulturë të pasur artistike, prandaj nuk na lejohet që ta ndajmë letërsinë në dy pjesë,

sipas vlerave artistike, sipas nivelist t  saj cil sor; e dob ta t i kaloj  f mij ve, e sh ndosha t  rriturve. F mij t meritojn  nj  let rsi me cil si t  lart .

Tregimi p r f mij  ka rritje n  vitet e fundit. Tregimtar t p r f mij  si Ivoni Reso, Petraq Zoto, Nasho Jorgaqi e t  tjer  u kan  dh n  t  vegj lve vepra me vlera. T  tjer  si Bedri Dedja, Gao Bushaka, Shpresa Vreto, Aristotel Mici etj... vazhdojn  t  shkruajn  proz  me cil si p r edukimin e f mij ve. Megjithat , tregimi p r f mij  dhe mbi f mij t ka dhe disa dob si artistike, q  duhen m njanuar.

E meta kryesore  sht  n  munges n e fabul s interesante, e t  treguarit n  m nyr  interesante. Ka varf ri mjetesh artistike; ka veprim t  zvarritur n  ngjarje, ka skema t  njo-hura, q  nuk e t rheqin f mij n. N  tregimin p r f mij , shpesh mungon fantazia, mungojn   udirat dhe peripecit . Personazhet b jn  trim ri dhe guxim t  njojur dhe t  r ndomt .

Tregimi p r f mij  ka nevoj  p r nj  zgjerim m  t  madh t  sfer s s  tematik s. F mij t tan  kan  interesa shum  t  m dha. Atyre sot u intereson gjith ka. K to interesa ne shpesh, nuk i marrim parasysh. Jemi ambientuar me nj  lloj tematike: me nj  djal  t  sjellsh m, me nj  q  b n nj  gabim dhe ndreqet, me nj  bej q  i b n t  vuajn  t  vegj lit, me nj  partizan t  mitur e k shtu me radh . Kurse jeta e f mij ve n  shoq rin  ton   sht  m  e pasur. Ku jam  marr dh niet prind-f mij , rrug -f mij , qytet-f mij , fshat-f mij , kolektiv-f mij , pun -f mij , shkenc -f mij , histori-f mij , moral-f mij , teknik -f mij ?

Problem tjet r p r tregimin p r f mij   sht  edhe ai i monotonis , i nj lloshm ris  artistike, i struktur s tep r tradicionale. Fjala  sht  q  t  ket  tregime me struktura t  ndryshme e t  shum llojshme. K rkimet novatore nuk jan  vet m p r let rsin  p r t  rritur, por jan  edhe p r at  p r f mij . Por novatorizmi lidhet n  radh  t  par  me p rmbajtjen. T  kemi p rmbajtje t  pasur dhe t  synojm  p r form  t  begat . Moralizimet e p rherershme dhe gati skema pengojn  hyrjen e s res , hyrjen e novatorizmit. I kemi b r  f mij t si robot  morali dhe t  ndrydhur. U themi n  tregime: mos b j k t , mos b j at , mos shko andej. Kjo m yr  nuk edukon, por  edukon, pasi k rkon nj  f mij  mediok r, nj  f mij  t  bindur si kamerier, nj  f mij  kokulur q , kur t  rritet, t i bindet shefit si servil. Me k to lloj tregimesh edukojm  servilizmin dhe burokratizmin.

Tregimi për fëmijë ka nevojë të japë më shumë kulturë, më shumë dituri. Letërsia ka edhe funksion njohës. Kjo munçon. Duhet të ketë edhe tregime me tema në fushën e kulturës dhe shkencës. Fëmijën të mos e nënvliftësojmë. Është më i ditur se sa e kujtojmë. Bile, ka fëmijë që lexojnë më shumë se shkrimtarët. Duke i nënvliftësuar, ne atyre nuk u japim as mitologjinë tonë, as përrallat, pasi i identifikojmë me fenë dhe kemi frikë mos i prishim fëmijët. Mitologji dhe përralla pa mbret nuk ka. Mbreti në përralla dhe mitologji nuk është si mbret në rendin feudal. Mbreti, shpesh është ideali i drejtësisë në përrallë. E kemi shhangur përrallën, pasi nuk duam të përmendim mbretin. Atëherë, përrallat i trillojmë me kafshë. I kemi mbushur me kafshë. Ndërsa përralla jonë popullore është me qeros, është me Dedë Ali, është me bajlozë, është me kreshnikë, është me orë, shtojzovalle dhe kuçedra.

1986

DIÇKA PËR TABLONË KOMPOZICIONALE NË PIKTURË

Zhvillimi i tablosë kompozicionale ka ardhur si rezultat i përparimit të gjithanshëm të arteve figurative, si rezultat i ecjes përpara të gjithë gjinive të tjera, i portretit, peizazhit, skulpturës dhe veçanërisht skulpturës monumentale. Pa ecjen përpara të gjinive të tjera nuk mund të zhvillohej as tabloja kompozicionale. E themi këtë, pasi tabloja kompozicionale është sintezë e disa gjinive të tjera, si peizazhit e portretit. Edhe të metat dhe dobësitë që vihen re në procesin e zhvillimit të tablosë kompozicionale, kanë lidhje me të metat dhe dobësitë e gjinive të tjera.

Përparimi i gjinisë në tablotë kompozicionale është i lidhur ngushtë, gjithashtu, me vetë kërkesat e shoqërisë, me vetë kërkesat e jetës. Kjo gjini ka mundësi të japë mendime më të mëdha për historinë dhe të setmen, për njeriun dhe kohën. Ajo, për vetë karakterin e saj, ka mundësi të japë gjendje të shumanshme shpirtore, me dramacitet epik e me lirizem. Dhe këto mundësi, mendoj se piktorët janë përpjekur ti shfrytëzojnë dhe kanë dhënë vepra të rënësishme në këto tri dekada e gjysmë. Bashkë me veprat janë formuar edhe individualitete artistike, që tanimë zënë vend të palëkundshëm në pikturën dhe në kulturën tonë.

Por mendoj se ky stad, në të cilin ka arritur tabloja jonë kompozicionale, na shtyn të kërkojmë më shumë, na

shtyn që të bëjmë ndryshime cilësore në gjendjen në dukje të stabilizuar. Në art nuk ka gjendje të mbaruar, të përfunduar, të stabilizuar një herë e përgjithmonë. Duke u nisur nga gjendja e tablosë kompozicionale dhe nga gjithë përvoja e fituar mendoj se shtrohet një kërksesë e madhe: të ngremë nivelin artistik të saj përmes rrugës së forcimit të përbajtjes, duke kerkuar vazhdimisht e duke luftuar cektësinë e punës të shpejtuar, pa përgjegjësi artistike, duke rritur ndërgjegjen prej artisti. Përpjekjet për ngritjen e nivelit artistik duhet të na shpien:

Në rritjen e mendimit, në thellimin e vështrimit filozifik të fenomenit të pasqyruar, në trajtimin estetik të jetës. Atyre veprave, që nuk kanë jetë të gjatë e që nuk na pëlqejnë, u mungon ky mendim filozifik, u mungon ky trajtim estetik, u mungon e vërteta artistike. E vërteta artistike nuk qëndron pa një mendim. Në disa tablo kompozicionale ka vetëm njëfarë organizimi të kompozimit, por nuk ka një shikim të thelluar filozifik. Përse piktuohet ky fenomen? Pra, nuk ka ngritje të nivelit artistik, që do të buronte nga një mendim e këndvështrim filozifik.

Ngritia e nivelit artistik të tablosë kompozicionale kérkon mënjanimin e skematizmit, e trajtimit vulgar të realitetit. Duhet të pranojmë që, me gjithë arritjet, janë formuar disa skema që duhen thyer. Këto skema e bëjnë pikturen kompozicionale që të konfondojë ndonjëherë theksimin e idesë përmes formave të jashtme, të ilustruara, siç ndodh me tablonë e Vilson Halimit «Kudo jemi në ballë». Idenë e forcës vepruese të klasës punëtore për atrimin e fshatit me qytetin. Këtu autori e shpreh në mënyrë pllakateske, ngatërrohen gjinitë, pllakati me tablonë kompozicionale.

Të ngresh nivelin artistik të tablosë kompozicionale, është i domosdoshëm lëvrimi i përhershëm i vizatimit, peizazhit dhe portretit. Lëvrimi i përhershëm i këtyre gjinive do të ndihmonte për një hop të ri në tablonë tonë kompozicionale. ~~Ne e nënveftësojmë peizazhin dhe kjo e ka dëmtuar disi tablonë kompozicionale. Ky nënveftësim ka dëmtuar, ne përgjithësi edhe poezinë. Poetia jone ka pak peizazh~~ Një tablo kompozicionale e dobët ka një disharmoni mes figurave dhe peizazheve: tjetër gjë kérkon figura, tjetër gjë peizazhi. Figura e punëtorit, fjala vjen, ~~del me muskuj, e krekosur, e pozuar, ndërsa peizazhi përreth jep një gjendje tjetër. Mungesa e portretit sjell moskomunikimin e figurave, sjell statikën, sjell njëfarë eklektizmi.~~

Ngritja e nivelit artistik të tablosë kompozicionale kërkon zgjerimin e tematikës dhe problematikës. Është e udhës të themi se ende i kemi të kufizuarat temat në pikturën kompozicionale dhe kjo dëmton nivelin artistik të saj. Jeta e shoqërisë sonë është e pasur, ka shumë preokupime. Njeriu ynë përballon shumë probleme të mëdha dhe bën një luftë të ashpër kundër armiqve për ndërtimin e socializmit. Prandaj më e gjerë duhet të dalë kjo jetë e shoqërisë në pikturën tonë.

1980

NË KËRKIM TË POEZISË

Ndjenjat e popullit asnjëherë nuk kanë qenë të thjeshtësuara. Dhe sot ato janë bërë më të holla dhe njëkohësisht më komplekse. Ndonjëherë ne poetët gabojmë kur mendojmë se populli e dashka poezinë të thjeshtësuar. Ai e do të thjeshtë dhe komplekse, por asnjëherë të thjeshtësuar. Ndjenjat kurrë nuk janë të kalkuluara dhe aritmëtikore. Ato janë të përziera dhe të trazuar. Edhe poezia është si ndjenjat, e ndërlidhkuar, sado e thjeshtë që të duket në vështrimin e parë. Ndjenja e dashurisë është shumë e thjeshtë në sipërfaqë. Përbrenda është e trazuar. E them këtë, pasi shumë kritikë të poezisë, duke parë anën e jashtme të saj, pa hyrë në brendësi, shpesh nuk mendojmë dialektikisht. Gjejnë një poezi që flet për patat e egra dhe thonë: «poeti e ka kapur mirë temën e gjahut». Shikojnë një poezi për grurin dhe pohojnë kategorikisht me kompetencë: «poeti trajton me lirizëm temën e fshatit!» Por dihet se për poetin objektet grurë, hekur, beton, zog, kallëz, livadh, mushkë, mal, tokë e të tjera janë tramplina për të shprehur mendime për kohën dhe njeriun. Koha dhe njeriu i një shoqërie të caktuar janë në qendër të poetit të vërtetë. Poezia nuk është si proza që e ka të përcaktuar me rreptësi temën. Ajo fluturon nga një mendim në tjetrin, ikën nga qendra dhe kthehet përsëri në qendër: divergon dhe konvergon...

Gjithmonë në poezinë e vërtetë ka një shqetësim, ka një

hall. Shqetësimin dhe hallin e mbart vetë poeti, që e ka marrë nga shoqëria e vet, që e ka në biografinë e tij. Këto shqetësime, mendime, ëndrra e ndjenja bëjnë pjesë në biografinë e poetit, formojnë «unin» e tij. Poezia pa shqetësime nuk jep asnjë element biografik të poetit. Në këtë lloj poezie pa shqetësim, të gjithë poetët janë të njëllorët, se të gjithë nuk kanë biografi dhe të gjithë nuk dihet se c'janë, nga kanë ardhur, çfarë pune kanë bërë prindërit e tyre, me ç'shokë rrinë, nga c'krahina janë, me se merren. Dhe ata shkruajnë letra pa vënë as adresën e tyre, as të atij që do t'i marrë... Prandaj e gjejmë të udhës të themi se në vargje duhet të ndihet jeta e poetit në shoqërinë tonë dhe jeta e njerëzve që e rrethojnë. Dhe kjo ndihet vetëm atëherë kur poeti jeton me jetën e shoqërisë dhe shqetësohet për të gjitha problemet e kohës. Ai poet që nuk jeton me tërë jetën e shoqërisë, me historinë e saj, me ëndrrat e saj, nuk di ta tregojë as veten e vet në vargje, si të thuash, e harron edhe biografinë e tij. Kështu, gjeneratori i madh i poezisë është jeta e shoqërisë dhe e popullit, dashuria për njerëzit, për gurët dhe drurët e vendit, për zogjtë dhe kafshët. Poeti, duke dashur njerëzit, i do edhe punët dhe këngët e tyre. Vëçanërisht ndaj këngëve popullore poeti është qenia më e ndjeshme dhe përpinqet t'i mësojë përmendsh, bile edhe t'i këndojet vetë në dasma dhe në mqedise mës shokëve. Pa e kuptuar edhe vetë, këto këngë shkrihen në poezinë e tij dhe bëhen kocka e saj.

Sot poetë të rinj ka shumë. Në kohën kur unë dhe shokët e mi ishim të rrij, poetët afirmoheshin pak nga pak, një nga një. Në ditët e sotme afirmohen në grupe të tëra: katër-pesë e dhjetë përnjëherësh. Kjo është një gjë e mirë; tregon se kultura është zgjeruar; të gjithë fitojnë dituri dhe kulturë të të shkruarit. Shkolla, rrethet letrare, diskutimet për letërsinë, libri, radiotelevizioni, u japid të rinjve dituri dhe ata mësojnë të shkruajnë. Prandaj edhe poetë të rinj të mirë dhe me kulturë ka plot. Por nga ana tjetër dalja dhe afirmimi i poetëve në grupe të tëra duhet të mos cënojë individualitetin dhe originalitetin, mos i bëjë të njëllorët pjesëtarët e një grupi. Njëllorëshmëria ndonjëherë vjen ngaqë i gjith grupi ushqehet nga një burim, nga një kulturë, nga një mënyrë jetese, nga një poezi. Për shembull, një grup prej shtatë-tetë vetash tërhiqen nga dy-tre prej poetëve tanë ose nga Elyari apo Uitmani, ose mësojnë vetëm nga njëri-tjetri. Në këtë mënyrë grupi do të ketë një fytyrë, një portret

kolektiv. Kështu, është e domosdoshme që të zgjerohen interesat për shumë kulturë, për shumë poezi dhe për një jetë me variacion dhe jo të barabartë për të gjithë. Poeti e asimilon gjithë kulturën kombëtare popullore dhe të përgjithshme. Mbi këtë pastaj vendos kulturën pérparimitare botërore. Për t'u mos jetë shtresa e fuqishme e kulturës kombëtare e popullore, nuk zë vend as shtresa e kulturës botërore, pasi fundoset dhe humb, ngaqë nuk ka taban që ta mbajë. Atëherë vërtet do të ketë njerëz që shkruajnë vjersha. Bile edhe korrekte dhe të mira në sipërfaqe, por më brendësi do t'u mungojë poezia dhe origjinaliteti i papërsëritshëm, «uni» i veçantë.

Dikur është folur shumë për vargun e matur, e çliruar dhe të lirë. Sot nuk flitet, pasi problemi i vargut mendohet se është zgjidhur. Dhe me të vërtetë në poezinë tonë përdoren të gjitha llojet e vargjeve. Poetët e brezit tim më tepër përdorin vargun e rregullt dhe vargun e çliruar, metrik dhe ametrik, por me rima dhe asonanca. Më të rintjtë përdorin vargun e lirë dhe më pak të çliruarin. Me varg të çliruar unë kuptoj vargun ametrik ritmik. Unë më shumë këtë lloj vargu përdor, varg që mbështetet te jambi, duke mos i harruar edhe llojet e tjera. Vargu është çështje e vetë poetit. Veçse duhet thënë që duke përdorur shpesh pa kriter vargun e lirë, ndodh të prishet kufiri mes prozës dhe poezisë. Vjersha bëhet një prozë bombastike dhe euforike, që vetëm në formën e renditjes së rreshtave të kujton poezinë. Vargjet e lira duhet të kenë mendime të freskëta dhe përrrenj metaforash të papritura, përndryshe ata e shkatérrojnë poezinë. Gjuha shqipe është një gjuhë që ka një pasuri kolosalë rimash e asonancash, është një gjuhë pa thekse të caktuara të fjalëve, prandaj nuk është monotone në poezi. Mjaft gjuhë kanë thekse të caktuara, për shembull, në fund të fjalës apo në rrökjen e parafundit. Në këto gjuhë poezia me rimë bëhet monotone, pasi rimat janë të varfra, prandaj një nga shkakat e daljes së vargut të lirë ka qenë thyerja e monotonisë. Ne nuk kemi në gjuhën tonë monotonit theksesh, atëherë pse u dashka medoemos të hiqet dorë nga rima? Populli ynë e ka qejf rimën, e ka qejf muzikalitetin e vargut dhe kthjellësinë e poezisë me të papriturat e çuditshme të figuracionit. Në poezinë e popullit ka rima dhe asonanca të pasura, ka kapërcime nga një varg në tjetrin pa ndihmën e lidhëses dhe fjalëve parazite, ka kursim të madh fjalësh. Rima është e bukur kur zgjidhet me mundim e me rreptësi. Nga rima duhet hequr dorë kur ndihet domosdoshmëria dhe jo kur të rrëmben

inercia. Monotoni sjell ndofta më shumë edhe vargu i lirë, kur përdoret pa kriter dhe pa u menduar. Me këtë varg libri nga fillimi deri në fund del i njëllojtë, pa variacion metresh, ritmesh e rimash dhe të duket sikur nuk ke përpara syve një vëllim me vjersha, por një poemë të rrafshët. Të kompozosh një libër me vjersha nuk është lehtë. Libri kërkon në vetvete një ndërtim të tillë që të ndihet ritmi si në një dramë. Ndërtimi i librit me vjersha është si regjisura e teatrit me tensionin e saj.

Poeti që ecën me hapin e kohës gjithmonë i ripërtërin mjetet shprehëse, përndryshe mbetet pas dhe zhvleftëson poezinë e tij. Një poet nuk mbetet bashkëkohës, nëse do të përdorë ato mjete shprehëse që pati shfrytëzuar tridhjetë apo njëzet vjet më parë. Ngaherë poeti i vërtetë është Kolomb, që zbulon kontinente të reja poetike. Me këtë shpirt Kolumbi e mposht moshën dhe plakjen. Këtë ia detyron rrjedha e kohës, rrjedhë me një shpejtësi të papérmbajtur. Shpejtësia e kohës është e pamëshirshme dhe nuk të pret për sentimentalizëm dhe hatër. Gjërat në kohën e sotme ndryshojnë me vrap të çuditshëm. Aq ndryshojnë, sa ndonjëherë ne biem në konflikt me veten tonë. Unë vetë me Dritëronë e viteve pesëdhjetë sot mund të bija në konflikt për vargun, për poezinë dhe për shumë gjëra të tjera të jetës. Këtij Dritëroi të viteve pesëdhjetë, me vështrimin e sotëm do t'i thosha: «ç'janë këto gjepura që bën!» Ai atëherë merrete dhjetë kuintalë grurë për hektar, unë marr pesëdhjetë. Edhe për këtë pikë do të ziheshim. Ai mbante ende në këmbë kishat e xhamitë, unë i kam prishur. Edhe për këtë do të lindte konflikti... E kam fjalën që ndryshimet në jetën tonë bëhen me shpjetësinë e rrufesë dhe mes këtij vrapimi të kohës ne ndryshojmë vetveten. Kjo shpejtësi duhet ndjekur edhe në poezi. Gjumi në rrugën e poeziës është mbarim. Në rrugën e poeziës nuk ka gjumë, përndryshe poeti vonohet...

POÉTI DHE POEZIA

— *Bisedë në redaksinë e «Zërit të rinisë»* —

— Si ju lindi dëshira për të shkruar poezi?

Ndofta poetë të tjerë e dinë me imtësi dhe e mbajnë mend se kur u ka lindur dëshira për të shkruar poezi. Unë këtë dëshirë nuk e di dhe nuk e mbaj mend se si më ka ardhur. Ajo më ka ardhur pa e kuptuar dhe më duket sikur gjithmonë kam shkruar vjersha, edhe kur nuk e dija abécënë.

Fshtati im është buzë lumit Devoll dhe ka një emër që mua gjithmonë më është dukur i bukur, Menkulash. Atje njerëzit kanë punuar dhe punojnë shumë. Mes tyre unë kam jetuar gjér në moshën gjashtëmbëdhjetë-shtatëmbëdhjetëvjeçare. Mua më tërhoqte shumë humor i dhe kënga e tyre. Ata bënin humor dhe këndonin. E donin tokën, lumin, zogjtë. Në dimër binte shumë dëborë. Toka bëhej e bardhë. Prindërit tanë dhe ne të vegjilit shkonim pasdarke te njëri-tjetri nëpër shtëpitë. Tregoheshin historira nga më të çuditshmet. Pastaj burrat e gratë këndonin. I doja shumë bashkë-fshatarët e mi. Disa pleq tami kanë vdekur. Në Luftën Nacionalçirimitare dolën dhjetëra e dhjetëra partizanë nga fshati ynë. Katër ranë dëshmorë. Ishin nga më të mirët e djemve dhe fytyrat e tyre nuk i harroj kurrrë, fytyrat e Xhevahirit, Hamdiut, Zenelit...

Dy-tri orë larg në këmbë, ishte edhe fshati Vranisht. Atje jetonte këngëtarë i madh i Devollit, që ne e thë-

rрисним Banë Vranishti. Ky ishte Banush Kondi. Këngët e tij të çuditnin. Ai kishte edhe dy nipër Ali Kondin dhe Nevruz Kondin. Edhe këta ishin këngëtarë të shquar. Aliu tani është Artist i merituar (popullor). Zëri i Banë Vranishtit gjithmonë më mahnistë. Vargjet e këngëve popullore në zërin e tij merrnin një bukuri të rrallë.

*O kjo anë e lumit
ka bilbila shumë,
Dale, bandill, dale
Sa të rritem unë...*

*Fusha na bën baltë,
Mali bën furtunë,
Dale, bandill, dale
Sa të rritem unë...*

Edhe sot më vjen në vesh kënga e tij e plotpushtetshme.

*Pas rrëzës së malit
Rrëzohen dy trima
Të dy me martina.*

Në një dasmë njëherë, kur këndonte Bana, ishin mbledhur gratë prapa gardhit të lartë dhe mbanin vesh këngën. Ishin mbledhur të gjitha gratë e fshatit. Atëherë gardhi ra i téri bashkë me gratë. Gratë dolën në shesh, se gardhi tanimë nuk i fshihte dot. Kënga e Banës e shkuli gardhin, kënga e Banës e nxori në shesh bukurinë e grave. Kjo ngjarje më mbeti për tërë jetën në mendje.

Ishte edhe një këngë që mua më pëlqente shumë, kur e këndonte Bana dhe djemtë e fshatit tonë:

*Fustanin e hollë
Zvarrë nëpër shkallë,
Si të ta bëj tynë,
Moj bardhoshkë e bardhë,
Do të bëj një djepkë
Të më rritsh një djalë,
Si të ta bëj tynë,
Moj bardhoshkë e bardhë!*

Ngaqë më pëlqenin këngët, unë shkoja nëpër dasma. Shumë gra të fshatit tim, që sot janë të moshuara, unë i kam parë nuse me duvak të bardhë.

Nga të gjitha këto më lindi dashuria për poezinë. Unë erdha në poezi nga kënga popullore, nuk erdha nga librat. Pastaj hyra në libra. Poezinë popullore, përrallën, humorin dhe gjithë kulturën popullore nuk e mësova, por e jetova.

Në fillim unë shkruaja si populli. Më hynin në vjersha vargjet e këngëve dhe më dukeshin se ishin të miat. Unë nuk mendoja të bëhesha poet. Bëja këngë për t'i kënduar. I këndoja edhe vetë. I vërvshëlleja. Pastaj i harroja të miat dhe këndoja të popullit, se ato ishin të vërteta, të miat ishin të vockla. Dëshpërohesha dhe vërvshëlleja ulët-ulët:

*E kur shtira sytë,
O mbi atë mal,
Qaj moj zemra ime, qaj...*

Kënga popullore më shpuri te Naimi, Çajupi, Asdreni, Lasgushi. Në vegjeli e në rini të hershme këta poetë më trondititnin. Fillova t'i mësoj përmendsh vetvetiu, pa më shtyrë njeri, pa ndonjë qëllim. I mësoja përmendsh që të mos i merrja me vete librat e tyre nëpër ara, por të mbartja në kujtesë vargjet dhe t'i recitoja kur ecja vetë anës shelgjeve pas lumiit, kur vinte erë jonxhë e kositur.

Një herë, më 1947, mora guxim dhe i dërgova një vjershë nga ato që kisha **shkruar**, **gazetës** «Rinia», që sot është «Zëri i rinisë». Kjo ishte gazeta ime e dashur. Vjersha mbante titullin **«Vullnetari i hekurudhës»**. Sapo isha kthyer nga hekurudha Durrës-Peqin, ku kisha qenë vullnetar me nxënësit e shkollës unike (tetëvjeçare) të Bilishtit. Prisja si në ethe ta shihja vjershën time të botuar. Asnjeriu nuk i kisha treguar, se më vinte turp, po të mos botohej. Do të më tallnin shokët. Më mirë të mos e dinin që t'i befasoja. Dhe për habinë time, në një nga numrat e saj, «Rinia» e botoi vjershën **«Vullnetari i hekurudhës»**. U bëra me krahë, sikur të mos kisha shkruar dyshëdhjetë radhë, por «Luftë e paqen» e Tolstoit! Edhe shokët, edhe mësuesit u habitën. Nami im shkoi edhe në fshat. Babai ecte me gazetë në dorë. Bile, e kishte prerë vjershën dhe e kishte vënë në kutinë e duhanit. «Ja, na doli një Naim i vogël në Men-kulas», thoshin bashkëfshatarët e mi të dashur dhe qeshnin.

— C'poetë të tjerë ju pëlqenin në rini?

— Në rininë time të hershme kishte shumë pak përkthime nga poezia botërore. Ne lexonim gjithë përkthimet e Fan Nolit, duke përfshirë edhe Omar Kajamin. Edhe unë të parin poet të shqipëruar kam lexuar Omar Kajamin që më pëlqente shumë. Por babai i mbante me vete rubaitë e të madhit Omar dhe mezi m'i jepte. Kopje të tjera nuk gjenim. «Dy poetë ka bota, — thoshte babai, — Naimin dhe Omarin. Të tjerët s'janë gjë. Badjava shkruajnë!» I gjori baba, vetëm këta njihite! «Ja, thoshte ai, «Qerbelanë» vetëm Naimi mund ta bënte. Edhe Omari mund ta bënte. Po ky persiani i madh mbase do ta kishte zor, se i bën të shkurtër vjershat. Asnjë vjershë të gjatë s'i kam lexuar.»

Më vonë kur shkova në Universitet e kur mësova gjuhë të huaj, fillova të tërhiqesha nga Robert Bérnsi, poeti i madh skocez. Bérnsi më linte pa gjumë, se më dukej si vetja. Edhe ai kishte qenë fshatar dhe shumë vjersha i pati shkruar nëpër ara. Nga Bérnsi, bile, fillova të përkthej. Poema ime e parë «Poemë pér vete e pér babanë» që është botuar në «Zërin e rinisë» ose më 1954 ose më 1957, s'më kujtohet, është e ndikuar nga Bérnsi. Pastaj filloi të më pëlqeijnë Esenini, Majakovski, Lorka, Elyari, Bagricki e të tjerë. Pra, në përgjithësi, këta kanië qenë pér mua poetët e huaj më të dashur. Edhe nga poezia e tyre kam përkthyer.

— C'do të dëshironit pér poetët e rind?

— Poetë të rind ka shumë. Kur isha unë i ri, ishim pak poetë. Të rintjtë tanë vijnë me një kulturë të pasur në poezi. Kanë lexuar shumë. Mjaft prej tyre kanë një poezi të freskët, të figurshme, të pastër e të bukur. Dhe janë nga të gjithë anët e Republikës: nga Tropoja, Saranda, Kukësi, Korça, Gjirokastra, Përmeti, Shkodra, Librazhd, Lezha, Lushnja, Fieri, Elbasani. Kudo ka poetë të rind.

Dëshirat pér një poezi të mirë dhe më të mirë gjithmonë do të mbeten. Poeti ngaherë kérkon e zbulon. Unë do të desha që poezia të ishte sa më e ndryshme, sa më e larme. Dhe kjo arrihet kur çdo poet të ketë «unin» e tij, zërin e tij.

Poeti i mirë jeton me gjithë jetën e vendit, me jetën ekonomike e politike, të brendshme dhe të jashtme. Ai është filozof, mendimtar, dijetar. Pastaj poeti i vërtetë e njeh kulturen popullore, këngën popullore, që është shpirti i popullit. Ai i di përmendsh të paktën gjithë këngët popullore të krahi-nës së vet. Poeti nuk ka qibër të rrrijë me punëtorët fshata-

rët, studentët; të rrijë dhe t'u lexojë vjersha, të mbajë vesh kur këndoijnë, të shkojë në dasma veçanërisht në dasmat e fshatit, se atje ka këngë të vërteta. Mundësisht poeti të këndoje edhe vetë këngë popullore. Siç thashë pak më lart, kultura popullore, sjellja, zakoni, mënyra e komunikimit me njerëzit, morali, është vështirë të mësohen nëpër libra, ato duhet të jenë bërë mënyrë jetese, të kenë hyrë në gjak. Poeti nuk i studion këto që thashë, por i jeton, i ka marrë prej kohësh dhe i ka futur në qenien e tij. Mbi këtë shtresë të fuqishme, të patundur, pastaj vihet kultura e vendit dhe botërore. Vetëm atëherë kjo kulturë mund të qëndrojë. Poeti i sotëm, i epokës socialiste, duhet ta zotërojë thellësisht marksizëm-leninizmin dhe dialektikën. Atëherë me të gjitha këto dhe me talentin e vet, poeti krijon poezi të vërtetë, poezi me jetë të gjatë dhe jo poezi — tullumbækë. Poezia — tullumbækë ngrihet pak dhe pëlqet.

Unë kam besim të patundur se nga poetët e rinj do të dalin mjeshtër të poezisë, që do të na befasojnë me vargjet e tyre plot drithë. Këta djem e vajza që i shohim në shkollë, në rrugë, në punë e në redaksitë, nesër do të jenë zotër të vërtetë të poezisë. Kështu do të bëhet, se poezinë e do populli ynë, e do dhe vetë është një poet i madh, poet që poezinë e tij mezi e nxënë bibliotekat. Është i lumtur ai poet që pi qumësht në gjirin e madh të poezisë popullore. Nuk ka qumësht më të shëndetshëm për poetin se sa qumështi i poezisë popullore.

POEZIA DHE MOSHA E POETIT

— *Bisedë në redaksinë e revistës «Ylli»* —

— A luan rol mosha në krijimtarinë e poetit?

Poeti gjithmonë shkruan. Mosha mund të ndikojë në intensitetin e krijimtarisë, në ngadalësimin e saj dhe në cilësinë e saj. Por mosha nuk e shuan krijimtarinë poetike. Në qoftë se poeti nuk e humb interesin për jetën dhe problemet e saj, për politikën, ekonominë, kulturën, artin dhe letërsinë; në qoftë se ai e mban të ndezur idealin shoqëror dhe estetik, krijimtaria e tij poetike është e gjatë dhe e ndjek gjer në fryshtë e fundit. Vitet ikin. Jeta ndryshon me shpejtësi. Lindin gjëra të reja të papara. Në fushat e veprimtarisë shoqërore hyn teknologji e re e bëhen zbulime të reja; ndërgjegjja e njeriut rritet, kultura e tij pasurohet dhe tok me të zgjerohet horizonti i diturive. E reja që hyn në shoqëri vazhdimi shi duhet të hyjë edhe në poezinë e poetit. Kjo poezi gjithmonë duhet të jetë e etur për evoluim në përbajtje e në formë dhe në teknikën e vargut. Kur hyn vazhdimi shi teknologjia e re poetike, poeti edhe në moshën më të vjetër mbetet i ri në krijimtari, bile bëhet më filozof e më meditativ, pasi jetën e vështron nga majat e urtësisë. Liqenet artificiale, kur e shpenzojnë ujin në verë për ujitje, po nuk u mbushën përsëri në vjeshtë, në dimër e në pranverë nga shirat e déborërat, mbeten të zbrazura dhe nuk kanë se ç't'u japid bimëve në motin e thatë. Edhe «liqeni» i dijeve të poetit, duke u shpenzuar vazhdimi shi në rrjedhën e viteve, thahet po nuk u mbush me kulturë, interes, jetë. Ata poetë

që pushojnë së shkruari në moshën e vjetër, harrojnë t'i hedhin këtij «liqeni» dituri të reja.

— A u ndihmon poezia kur shkruani prozë? Cilën keni më pér zemër? Çfarë lexoni më shumë, prozë apo poezi?

— Poezia hyn kudo. Ne themi: kjo prozë ka poezi, kjo pikture ka poezi. Kjo muzikë ka poezi. Nuk themi: kjo poezi ka prozë! Po të themi se kjo poezi ka prozë, d.m.th, është e pavlefshme, pasi del nga gjinia. E kam fjalën që poezia i ndihmon gjithë artet, duke përfshirë edhe prozën. Ajo ndihmon në pasurimin filozofik të prozës, në ritmin e gjuhës, në zgjedhjen e fjalës dhe në aftësinë pér të bërë sintezë. Por unë kur shkruaj prozë mundohem t'i largohem konceptimit poetik, të jem sa më i përbajtur dhe me gjak-fohtësi të bëj analizën e fakteve dhe fenomeneve. Dhe në këtë largim nga konceptimi poetik, padashur hyn edhe poezia në ndërtimin e prozës, në strukturën e saj dhe në ritmin e saj. Kjo është dialektike: largohesh që të afrohesh! Po u nise me qëllim që të afrosh prozën me poezinë, do të krijosh gjëra të sheqerosura, me fjalë të bukura. Bukuria do të jetë e jashtme. Duhet të jesh i zoti që poezinë ta futësh në imdet e padukshme të prozës, ta bësh atë që të zjejë përbrenda.

Doemos, unë lexoj më shumë prozë. Poezinë e lexoj shumë herë. Dhe e lexoj me zë. Ndonjëherë e flas me vete duke ecur rrugës. Kur është qetësi e nuk pipëtin asgjë, unë lexoj poezi. Si volum lexoj më shumë prozë, romane, tregime, kujtime, histori dhe veçanërisht teori të letërsisë e artit, duke përfshirë edhe filozofinë. Pa e njojur teorinë, nuk mund të analizosh fenomenet letrare e artistike dhe nuk mund të bësh përgjithësime.

— Cili është ndikimi i publicistikës, apo i jetës si gazetar në krijimtarinë tuaj. Mos vallë këtu duhet kërkuar dhe një nga arsyet që ju keni krijimtari të gjithanshme? Ç'vend zëjeta personale në veprat që krijoni?

— Kam punuar mbi pesëmbëdhjetë vjet në gazeten «Zëri i popullit». Në këta pesëmbëdhjetë vjet kam ecur nëpër gjithë Shqipërinë me automobil e me këmbë. Më këmbë kam ecur më shumë, me qindra kilometra kam ecur. Kam ndier lodhjen dhe etjen. Jam njojur me shumë njerëz, me punëtorë, fshatarë, novatorë dhe të prapambetur, punëdashës të flaktë dhe dembelë, drejtues të zotët dhe burokratë, Në këto udhëtime më

është ndezur dashuria pér njerézit. Ndofta prandaj më ësh-të bërë zakon që të mos rri kurrë vetëm, Gjithmonë dua njerëz, Historitë e ngjarjet që kam dëgjuar i kam shkruar dhe i kam mbajtur mend. I kam mbajtur mend fytyrat, shtëpitë, arat, drurët, përrrenjtë, malet dhe kodrat. Shënimet nuk i kam mbajtur në sy të njerëzve, pasi kam pasur frikë mos druheshin. Kështu, kur kuvendonim në darkë rrëth so-frës e tryezës, unë futesha në kuwend dhe i lija njerëzit të tregonin, Njëherë në Pleçisht të Mokrës isha në shtëpinë e xha Mekes. Xha Mekja tregonte bukur. Kishte qenë me Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare. Një shoku im, kur xha Mekja tregonte, nxori fletoren dhe filloi të shkruante. Xha Mekja e pa dhe aty pér aty nxori dhe ai fletoren dhe nisi të mbajë shëname. Ra një heshtje. Dhoma ishte plot me njerëz. Shoku im u hodh e i tha xha Mekes:

— C'bën ashtu, xha Meke?

Xha Mekja i ngriti vetullat e tij të trasha mbi fletore dhe iu kthyte:

— Po pse, vetëm ti di të shkruash, o kolopuç i xha-xhait? Na lër me atë defter e mos na e dreqos muhabetin!

Dhe ne të gjithë qeshëm. E kështu, prandaj unë nuk e nxirrja fletoren. Kur mbaronte darka, i kujtoja bisedat dhe i hidhja në fletore. Atëherë nuk kishte magnetofonë të vegjël. Të gjitha i shkruanim.

Më ndodhi njëherë të shkruaja një artikull pér kuadrot që ndërrohen e zëvendësohen vazhdimi shpa e njohur mirë vendin e punës. Pér këtë temë nuk gjeja ndonjë fakt të bukur e me kripë, siç e desha unë. E kërkova këtë fakt, por nuk më dilte. Rastësisht në një fshat, nuk më kujtohet, në Labëri a në Skrapar, u ndodha në një darkë. Atje kuven-duam e kënduam. Papritur hyn në derë një burrë dhe i thotë kryetarit të kooperativës:

— E hëngri edhe atë!

— Cilin, more? — tha kryetari.

Unë nuk po kuptoja gjë. Burri foli përsëri:

— Brigadierin! E hëngri qeni!

Të gjithë qeshën.

— Si është puna? — u them.

— Eh, more i dashur, — më tha plaku. — Këtu në fshatin tonë brigadierët e blektorisë ndërrohen javë pér javë. Nuk arrin dot t'i njohë as qeni i stanit. I ha i shkreti!

Unë u gëzova sikur të më kishin dekoruar. E gjeta faktin, që kërkoja! Kuadrot, kur ndërrohen shpesh, mund t'i hajë edhe qeni!

Njohje jete është kur ato që sheh dhe dëgjon i mban mend. Mban mend si kuvenojnë njerëzit, mban mend me ç'gjuhë flasin, mban mend fytyrat e tyre, si qeshin, si dëshpërohen, ç'shenja bëjnë, si e vënë dorën në mjekër a në faqe kur mendohen. Mbi këtë mbajtje mend shkrimtarë krijon variante burrash e grash që bëhen personazhe.

Gazeta jo vetëm që të njeh me qindra njerëz, por të bën të jetosh me probleme të vogla e të mëdha, politike edhe ekonomike, kulturore dhe shoqërore. Gazeta të fut në fushën e luftës ideologjike. Të bën të mprehtë, të pajis me një stil të shkathët e me një gjuhë konçize dhe me një frazë konkrete dhe me substancë. Këtë kam mësuar nga gazeta.

Jeta personale luan një rol të madh në krijimtarinë e poetit dhe shkrimtarit. Sa më e pasur të jetë biografia e poetit me ngjarje, me mendime, me gëzime dhe hidhërimë, me shqetësimë shpirtërore dhe me trazira, aq më e fuqishme bëhet krijimtaria. Këtu ka rëndësi fëmijëria dhe rinia. Kur fëmijëria dhe rinia janë të begata me jetë dhe të mbushura me vështirësi, ai që i bie fati të bëhet poet, e ka poezinë me diapazon të gjërë, me brumë të ardhur, me stof të fortë. Unë kam pasur një fëmijëri e rini të vështirë. Kam ndier urinë. Kam parë të vrarë e të plagosur. Kam parë gjak të njomë dhe të tharë. Kam ndier vërvshëllimën e plumbave dhe plasjen e bombave të aeroplanëve. Atje ku rrithesha unë më 1940 ishte fronti i Luftës Italo-Greke. Kufiri me Greqinë ishte gjysmë ore në këmbë. Në atë lugine të Menkulosit të Devollit kam parë ushtri që sulmojnë dhe ushtri që thyhen. Kam parë në istikame bomba, fishekë e pushkë të lëna, batanije dhe kapota ushtarake të mbeturë. Pastaj erdhë Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare. Atëherë ndjeva se ç'do të thotë dashuria e vërtetë për vendin dhe të ardhmen e tij. Ndjeva këngë partizane. Pashë trimëritë dhe heroizmat. Dhe lotët e nënave e nuseve i pashë.

Edhe shumë gëzime kam ndier. Nëpër dasma kam kënduar dhe kam shkuar me krushqit të marr nuset. Fëmijët e këtyre nuseve tanë janë burra. Ja, Ideal Kadija është kryetar i kooperativës në Miras të Devollit. Në fëmijërinë time Mirasi quhej Bozhigrad. Më i bukur është emri Miras!

Nënën e Idealit unë e kam parë nuse. Kam shkuar me krushqit në Sul dhe e kemi sjellë nuse me duvak në Menkulash. Dasmat i kisha shumë qejf. Në dasma këndoja.

Fshati ynë kishte vetëm shkollë fillore. Shkollë unlike (8-vjeçare) kishte vetëm në Bilisht, tri orë larg në këmbë. E di se ç'do të thotë të bësh gjashtë orë në këmbë në ditë nëpër shi e dëborë, nëpër cingërimë dhe vapë? Që nga viti 1945 e gjer më 1948 rrugën Menkulash-Bilisht e kemi matur këmbë për këmbë me një shokun tim nga fshati. Ai ishte më i madh se unë dhe më jepte zemër. Sikur mos ishte Suloja, shoku im, unë nuk do ta vazhdoja shkollën. — Të falemnderit, o Sulo! — i them gjithmonë kur e takoj, Ishte oficer Suloja. Tani ka dalë në pension!

Të gjitha këto më kanë pasuruar dhe shumë fakte ngajeta vetjake më hyjnë padashur në poezinë dhe në prozën time. Në përgjithësi, unë shkruaj vetëm ato që njoh. Ato që nuk i njoh nuk i shkruaj. Mbështetje nuk di të trilloj!

— C'mendime keni për krijimet tuaja të para kur i shikoni nga lartësitë e pjekurisë së plotë në krijimtari? C'mund t'u këshilloni të rinjve?

— Krijimet e para poeti i shikon siç shikon fëmijët: naive dhe të sinqerta. I shkruan njëherë dhe nuk përsëriten. Por ato janë të dashura se të kujtojnë një kohë, të kujtojnë fëmijërinë, rininë, shokët, poetët e rinj bashkë-kohës. Shumë vjersha prej librave të parë nuk mund të hyjnë në përbledhjet e zgjedhura, se janë kërkime e prova nën ndikimin e poetëve të tjera. Veçse duhet thënë një gjë. Librat e mirë dalin kur ka edhe libra mesatarë. Kishte të drejtë Heminguej kur thoshte se ai kishte veprat mira, pasi kishte shkruar edhe të dobëta. Doemos shkrimtari synon të shkruajë vepra me nivel të lartë artistik. Por ky nivel nuk arrihet gjithmonë.

Në librat e mi të parë me vjersha janë përshtypjet e drejtpërdrejta të jetës. Këto përshtypje vijnë nga thellësitë e viteve fëminore e rinore. Një pjesë e rinisë simekaloi në shkollën e mesme «Asim Zeneli» në Gjirokastër në vitet 1948-1952. Në Gjirokastër unë u njoha me një kulturë më të gjërë, u takova me shokë që kishin filluar si unë të shkruanin, me I. Kadarenë, A. Shehun e të tjera. Ne flisnim gjithmonë për poezinë dhe i lexonim njëri-tjetrit vjersha. Ëndërronim të bëheshim poetë. Kishim edhe një rrëth letrar, ku mblidheshim e diskutonim për vargun, për figurën, për formën e vjershës. Në rethin tonë letrar vinin

dhe mësuesit: i ndjeri Thoma Papapano, Vehbi Bala e të tjerë. Vehbi Bala e drejtonte rrithin letrar, që e quante akademi. Akademia letrare e Gjirokastrës! Thoma Papapanoja, që e dinte aq mirë gjuhën shqipe, na këshillonte si të zgjidhnik fjalën e bukur. Atij ne i thoshim basho Thoma. Një shoku ynë e pyeti një herë:

— Basho Thoma, ku ndryshon poeti nga vjershëtari?

Ai u mendua dhe tha:

— Poeti bën poezi, vjershëtari vargje. Poezia është qiellore, e lartë, sublime. Vjersha është nën qiellin, është e zakonshme dhe nuk është sublime!

— Po Ismaili me Dritëronë janë poetë apo vjershëtarë? — e pyeti shoku ynë.

Basho Thomai u ngrys pak, pastaj vuri buzën në gaz:

— Hëm! Ata, the? Ata janë poetë!

I urti basho Thoma! Donte të na e bënte qejfin. Gjer atëherë ne ishim vjershëtarë!

Në Gjirokastër ne takonim edhe vjershëtarin populor Veip Qorrin. Ai ishte i verbër. Vinte duke trokitur shkopin dhe na këndonte vjersha. Një herë më thurri mua një vjershë:

*O Dritor, more Dritor,
Pa më qenke vjershëtor
Dhe më gjete mua qorr,
Mos i bëj vjershat me zorr,
O Dritor, more Dritor!*

Për hir të rimës, Veip Qorri ma ndërroi emrin nga Dritëro në Dritor. Por s'ka gjë, mjafton që doli vjersha!

Veip Qorri ka kohë që ka vdekur. Shumë vjersha të tij mbahen mend. Shoku Enver në librin «Vite të vegjelisë»

— Kujtime për Gjirokastrën, — shkruan me dashuri për Veip Qorrin, se ishte njeri i mirë dhe vjershëtor i mirë.

C'tu them poetëve të rinj? Ne i duam poetët e rinj! Edhe nga ata mësojmë shumë. Vjershat e tyre të bukura na freskojnë mendjen dhe ndjenjat dhe na nxitin për të shkruar. Unë mësoj nga vargjet e Rudolf Markut, Bardhyl Londos, Ndoc Gjetjes, Qazim Shemes, Petrit Rukës, Ndoc Papplekës, Natasha Lakos e të tjerëve. Ata kanë vjersha të freskëta, me mendime e teknikë bashkëkohore. Nuk është lehtë t'u japësh atyre didaktikë, mësim se si të shkruajnë. Poezia e gjen rrugën vetë. Mësim për të gjithë ne është të jetojmë me jetën, të mos plakemi, të mos

shuajmë kuriozitetin pér gjérat që që na rrrethojnë, të njo him kulturën e popullit, të lexojmë poezi, të marrim dituri. Këngën popullore ta mësojmë përmendsh. Të mësojmë nga Naimi, Çajupi, Mjeda, Noli, Migjeni. Të njo him poetët botërorë e letërsisë më të mirë të botës. Të jemi të rreptë ndaj vetes.

— Nga poetët e traditës cilin keni më pér zemër? Po nga letërsia botërore?

— Më shumë nga të gjithë kam dashur Naimin dhe Çajupin. Babai im vjershat e tyre i dinte përmendsh. Dhe unë me ta jam rritur. I dua edhe tanë që e kam kaluar gjysmën e shekullit. I lexoj dhe i rilexoj. Bashkë me poezinë e tyre, në fëmijëri kam pasur tri dëshira: të punoja tokën, të krasitja vreshtim dhe kur të rriteshë të kisha një grua të bukur si të fqinjitet tonë, që e kishte shtëpinë afër nesh! Ndofta edhe këto dëshira më ndihuan që të bëhem poet.

Nga poetët botërorë më kanë tèrhequr Robert Bérnsi, Omar Kajami, Sergej Jesenini, Vladimir Majakovski, Frederiko Garsia Lorka, Pushkini e të tjerë. Më tepër kam dashur Robert Bérnsin. Ai ka qenë fshatar skocez. Poezia e tij është spontane, plot kolorit, e singertë, me humor dhe nuk ka marifete poetike, nuk ka stisje dhe trillime.

— Cilin nga heronjtë tuaj keni më të dashur? Pse? A keni pasur parasysh në krijimtarinë tuaj tipa realë?

— Kjo është një pyetje e vështirë, pasi përgjigja kam frikë se nuk do të jetë modeste. Do të duket sikur lavdëroj heronjtë e librave të mi. Secili nga heronjtë e librave ka cilësitet e tij. Më shumë më pëlqen Zyloja nga romani «Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo». Ky hero është më i plotë dhe më dialektik. Kur e kam ndërtuar këtë figurë, kam njo him mjaft tipa të tillë. Bile, ua kam mbajtur shënim frazeologjinë e tyre të përditshme. Në këtë roman ka skena të tëra që janë marrë drejtpërdrejtë ngajeta e këtyre njerëzve.

— Me se u pëlqen të merreni gjatë kohës së lirë?

— Në kohën e lirë lexoj, kuvendoj me shokët, kam qejf të dëgjoj historira, të bëj humor. Mbi të gjitha më pëlqen të udhëtoj. Dëshira ime është të shkoj nëpër fshatra e të rri me fshatarët, të eci nëpër arat, të dëgjoj këmborët e dhenvë, të shoh si e përtypin barin lopët. Jonxhën e sapokorrur e dua shumë. Ah, ç'erë e mirë vjen nga jonxha që thahet në diell! Kam qejf të dëgjoj bëlbilit tek këndojnë në mbrëmje e në mëngjes në përrenjtë me pemë.

GJUHA DHE SHKRIMTARI

(Bisedë në redaksinë e revistës «Gjuha jonë»)

— Letërsinë artistike e kanë quajtur kudhër të fjalës. Ne kemi tashmë një gjuhë të njësuar letrare kombëtare. Cili është misioni i shkrimitarëve tanë në këtë etapë ndaj kësaj gjuhe?

— Idetë, personazhet, figurat dhe personalitetin e vet shkrimitari i shpreh dhe i pasqyron vetëm përmes gjuhës. Prandaj thuhet se arma dhe mjeti i punës së tij është vetëm gjuha. Ndoshta nga gjithë mjeshtëritë e njerëzimit ajo që kërkon më pak shpenzime vetjake, është mjeshtëria e shkrimitarit. Të ndërtosh një traktor duhen uzina, çeliku, giza e të tjera. Të ngresh një shtëpi, nevojiten tu-llat, gurët, hekuri, çimentoja, druri e zhavorri. Të kompozosh një simfoni, kërkohet pianoja. Të gjitha këto janë të kushtueshme. Ndërsa shkrimitarit në punën e përditshme i duhen pak gjëra: letra, pena dhe gjuha. Me gjuhën shkrimitari i vërtetë bën mrekullira. Ajo është minierë e pafundme, minierë që nuk shterrom kurrë, edhe sikur të mblidhen bashkë dhe të kërkojnë të gjithë brezat njëherësh.

Shkrimitari në gjuhën e njësuar kombëtare të popullit veçon, zgjedh, gërsheton dhe bashkon mjete të panumërtë të fjalorit, të ndërtimit gramatikor dhe të strukturës sintaksore; përdor mënyra të të folurit të personazheve, kërkon frazeologjinë e rrallë; gjen shprehësinë e tingujve, të forma-

ve dhe shenjave, të shprehjeve dhe ligjératave plot ngjyra. E gjithë kjo pasuri gjuhësore është e lidhur ngushtë me gjinjtë dhe llojet letrare. Ajo ndahet sipas këtyre gjinive dhe llojeve dhe nuk është e barabartë në të gjitha. Është e ndryshme gjuha e romancierit nga e poetit, e tregimtarit nga e dramaturgut, e skenaristit nga e reporterit. Ajo ndryshon në rrafshin semantik dhe në parimet e ndërtimit. E them këtë, pasi ne kemi bërë pak për studimin e gjuhës së veprave letrare, të funksioneve të kësaj gjuhe në gjini të veçanta dhe në shkrimtarë të veçantë. Gjuhën nuk e kemi studiuar sa duhet si gjuhë të letërsisë.

Gjuhëtarët e dinë mirë se studimi i gjuhës artistike të një vepre letrare të jep përfytyrimin e një periudhe të tërë të zhvillimit të shoqërisë, të kulturës së popullit, të fjalës së folur në atë kohë, të mënyrës së jetesës dhe të menduarit të klasave e shtresave dhe grupeve shoqërore, megjithëse gjuha nuk është superstrukturë. Mënyra e jetesës dhe e të menduarit të klasave, shtresave dhe grupeve shoqërore në veprat letrare ka lënë gjurmë, sidomos në ngjyrën shprehëse të fjalës, në ndryshimin e ngjyrimeve sipas kohës. Ato shprehje me ngarkesë stilistike, që kanë qenë të ashpra dhe fyese, ndonjëherë janë kthyer në pozitive, përkëdhelëse, ose, anasjelltas, përkëdhelëset janë kthyer në fyese e të ashpra. Për shembull, përpëra viteve 30 në letërsi fjala harbut ishte fyese dhe përbuzëse, e përdorur nga klasat shfrytëzuese për njerëzit e thjeshtë të popullit. Në vitet 30 kjo fjalë në letërsi mori ngjirim tjetër: harbut u barazua me punonjësin e ndershëm, me kryengritësin. Madje harbut u bë edhe pseudonim për publicistët. Sot kjo fjalë në letërsi u kthye përséri në fyese, pasi u zhduk ndarja e shoqërisë në klasa, si rrjedhim i ngadhënjimit të socializmit. Dhe kështu gjejmë shprehjen «harbut nga goja». Ose të marrim fjalën djall e shejtan. Në letërsinë e Rilindjes këto ishin fjalë fyese. Tani ato përdoren edhe për të shprehur vlera të një njeriu ose si përkëdhelëse: Ishte djalli vetë. Shejtan i madh ka qenë! Në letërsinë e dikurshme, për të treguar bukurinë dhe zgjuarsinë e një vajze të dashuruar, thuhej: moj nepërka pika-pika, ndërsa sot kjo fjalë shprehëse e ka humbur atë përdorim. Nepërkatë nuk mund t'i thuash një vajze të bukur, por një vajze të prapë, një vajze që s'të afrohet, një vajze të ftohtë dhe të pasjellshme: Është një nepërkatë ajo, që...

Thashë se, sipas përdorimit të fjalëve në letërsi, mësojmë epokat. Kështu kur dëgjojmë shprehjet feja e shqiptarit është

shqiptaria, punë, punë natë e ditë, që të shohim pakëz drithë; mbrothësitë, dituritë etj., menjëherë mendja na shkon në epokën e Rilindjes. Kur gjejmë në ndonjë shkrim fjalët: okupatori dhe tradhtarët me zjarr dhe me hekur,... aty për aty kujtojmë Luftën Antifashiste Nacionalçirimitare. Në atë kohë rrallë përdorej fjala pushtues, kryesisht flitej dhe shkruhej fjala okupator. Kur gjejmë shrehjen t'u qepemi maleve dhe kodrave, t'i bëjmë ato më të bukura..., kemi përfytyrimin e fillimit të viteve 70. Shkrimtarët bashkëko-hës ndonjëherë pak rëndësi i vënë gjuhës së përdorur në epoka të ndryshme të historisë sonë. Atëherë ndodh që në një roman ose tregim a dramë me temë nga Lufta Nacionalçirimitare pësonazhet flasin me gjuhën e sotme. Rrjetet e personazheve të veprave me këtë temë janë të kohës sonë, si partizani Artan, komisari Bledar, komandanti Dritan, sekretari Arian etj. Çdo njeri me njëfarë kulture e di se këta emra nuk përdoreshin në kohën e Luftës partizane; në përgjithësi ata janë të mesit të viteve pesëdhjetë dhe gjashtëdhjetë. Ata mund t'i përdorësh, kur shkruan një roman për hekurudhën. Kësisoj, që nga përdorimi i emrave dhe jo pastaj i fjalorit, vepra bëhet e pabesueshme dhe skematike.

Kultura e gjuhës është e domosdoshme për çdo shkrimtar, për çdo intelektual, për çdo njeri. Ai që nderon gjuhën, nderon Atdheun. Përpikëria, qartësia, thjeshtësia dhe koloriti i gjuhës janë aq të nevojshëm për shkrimtarin, sa gjithë veglat e punës për punëtorin. Në etapën e sotme të zhvillimit të gjuhës sonë të njësuar kombëtare detyra e shkrimtarit është ta mbajë atë të pastër dhe njëherazi ta pasurojë me shprehje, me ndërtim gramatikore e kolorit, me shprehësi dhe me intonacione melodike. Detyra e shkrimtarit nuk është të krijojë vijimisht fjalë të reja sipas rregullave të përgjithshme gjuhësore, por të jetë novator në mjetet shprehëse, në pasurimin e gjuhës me mënyra sa më të shumta lidhjesh e gërshtimesh, në përdorimin sa më të përpiktë të fjalës shqipe. Shkrimtari duhet të përpinqet t'i ruajë normat e gjuhës së njësuar kombëtare. Edhe kur të prekë ndonjë, ai është i detyruar ta përligjë estetikisht këtë veprim. Dikush nga gjuhëtarët ka thënë se në art zotëron e drejta e individit, në gramatikë e drejta e kolektivit. Gramatikisht, fjala vjen, për insektet nuk kemi emra mashkullorë dhe femërorë, ashtu si nuk kemi edhe për bimët e pemët. Por në letërsi,

veçanërisht në poezi, ndonjëherë për qëllime shprehëse humoristike, kjo normë thyhet. Për shembull, në poemën «Pleshti» unë kam përdorur shprehjen: pleshti dhe pleshtesa. Për gramatikanin kjo shprehje është absurde, për poetin është normale. Kjo është e njohur. Fjala në poezi jo rrallë e humb kuptimin fillestare. Në varg ajo merr kuptim tjetër. Ne themi Selmani është «luan», megjithëse e dimë që në kuptimin e drejtpërdrejtë Selmani nuk mund të jetë luan, por njeri, megjithatë, në kuptimin e figurshëm, pra, në rrafshin poetik është luan. E shihni si e humbi kuptimin fillestare? Pra, poezia përdor njohjen emotive dhe logjike.

— Shoku Enver Hoxha na mëson se «në popull ne duhet të gjejmë frysëzimin tonë, tingujt e këngës, ritmet e valles, pastërtinë e gjuhës...». Si punojnë njerëzit tanë të fjalës artistike për ta vënë në jetë këtë porosi?

— Burimi i gjuhës është populli, ai është krijuesi i saj. Në gjuhë populli është i gjithpushtetshëm. Edhe sikur gjithë gjuhëtarët e botës të mbledheshin bashkë, nuk do të mund të krijonin një gjuhë. Gjuhëtarët kanë hartuar teoritë e kanë shkruar rregullat, duke u mbështetur në gjuhën e folur dhe të shkruar, kanë mbledhur fjalët dhe kanë përpiluar fjalorët. Shkrimtari e merr gjuhën dhe koloritin e saj që me qumështin e nënës. Për gjuhën e shkrimtarit rol të madh luan fëmijëria. Një fëmijëri e pasur me ngjarje mes njerëzve, jep një gjuhë të begatë, me shprehje, thënie, frazeologji e ngjyrë. Megjithatë, shkrimtari i vërtetë nuk pushon kurrë së kërkuar fjalën në popull. Dhe fjala në popull merret drejtpërdrejt, duke dëgjuar ligjërimin e saj mes njerëzve, merret nga këngët, fjalët e urta, përrallat dhe legjendat, merret kudo ku flitet. Shoku Enver e thotë shumë bukur: «Në popull ne duhet të gjejmë frysëzimin tonë, tingujt e këngës, ritmet e valles, pastërtinë e gjuhës...» Të gjitha këto: këngët, vallet, tingujt dhe ritmet kanë të bëjnë me gjuhën, se në to dëgjohet edhe fjala shqipe. Këtë duhet ta ketë parasysh gjithmonë shkrimtari, nëse do që të mos e thajë gjuhën e tij. Gjuhën duhet ta mbajë me lëng dhe lëngu vjen nga gjuha e popullit. Unë gjithmonë shënoj në fletore fjalë të popullit, shprehje dhe frazeologji. Sa vjen dhe më afër gjuhës së popullit po shkon gjuha e shkruar letrare. Doemos, në lëmin e leksikut ndonjë largim do të ketë nga gjuha e popullit, pasi shkrimtari nuk është mbledhës folklori, nuk është *naturalist* në gjuhë. Ai e ngre gjuhën e popullit dhe bëhet pjesëmarrës, bashkë me

personalitetet politike, shkencore dhe me historinë, në ngulitjen e gjuhës së epokës. Gjuhë të fuqishme dhe të begatë ka shoku Enver Hoxha në veprën e tij të madhe. Pasuria dhe koloriti i saj, fryma populllore dhe njëkohësisht mprehtësia intelektuale e gjuhës së tij të mahnit. Ajo është një thesar i pafundmë. Bashkë me gjuhën e popullit duhet përvetësuar edhe gjuha e Enver Hoxhës.

— Gjuhësia shqiptare ka nxjerrë vitet e fundit një varg veprash normëzuese për t'u ardhur në ndihmë praktikës gjuhësore, veprimtarëve të fjalës, masave të gjera në përgjithësi. Si punojnë krijuesit tanë për t'u njojur me këto arritje, për të hedhur në përdorim të gjerë përmes fjalës së tyre artistike mjetet gjuhësore e stilistike të rralla që i gjemë në këto vepra? Ç'kërkesa e ç'sugjerime do të kishit për përsosjen e plotësimin e tyre të mëtejshëm?

— Gjuhëtarët tanë kanë bërë një punë të madhe për gjuhën. Mjaft vepra të tyre, si të A. Xhuvanit, E. Çabejt, Sh. Demirajt, M. Domit, A. Kostallarit, J. Thomajt, S. Rizës e të tjerëve, bashkë me «Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe» janë ndihmë e çmueshme për çdo shkrimitar dhe njeri të letrave. Me to është vendosur një normë e përpiktë gjuhësore, që po jep frytet e saj. Është e domosdoshme, që shkrimitarët t'i kenë libra tryze këto vepra. Megjithatë, mendoj se ka ardhur koha që të drejtohet vëmendja edhe nga gjuha e veprave letrare. Siç e vura në dukje, janë fare të pakta studimet për gjuhën letrare artistike, për funksionin dhe rolin e saj në kulturën gjuhësore. Nga ana tjetër, në disa artikuj dhe shkrime të gjuhëtarëve, për hir të pastërtisë së gjuhës, që është në thelb një punë shumë e dobishme dhe e frytshme, bëhen edhe teprime puriste. Është një prirje që të zëvendësohen dhe të riparohen fjalët pa ndonjë shkak dhe pa ndonjë nevojë. Duhet të kemi kujdes me këtë veprim, pasi krijojmë një gjuhë konvencionale. Për shembull, në përpunimin e fjalëve, kemi tendencën që shumë mbiemrave dhe emrave t'u shtojmë prapashtesën -ore ose -are, në mënyrë formaliste dhe stereotipe. Kështu, sipas modelit bimore, bëjmë drurore, pjergullore, rrushore (lëng rrushor), thesore (pluhur thesi) etj. Kështu gjuha kthehet në esperanto. Në këtë mënyrë iu qepëm fjalës rrjedhim dhe e bëmë

rrjedhojë, d.m.th. i vumë mballomën -ojë. Fjalët nuk kanë nevojë pér mballoma, Ne themi si rrjedhim dhe jo si rrjedhojë, që ka një tingëllim të shëmtuar. Po të vinim sipas këtij parimi, edhe dy fjalët e tjera të të njëjtë proces: fillim dhe përfundim do t'i meremetonim në fillojë dhe përfundojë, d.m.th. si fillojë, si rrjedhojë dhe si përfundojë. Po një proces ka fillim, rrjedhim dhe përfundim. Pra duhet treguar kujdes me gjuhën! Të mos e bëjmë qesharake, të rrëmbyer nga hovi pér ta pastruar. Në këtë mënyrë ajo nuk pastrohet, por lëpihet!

Vëmendje e veçantë edhe nga gjuhëtarët, edhe nga shkrimtarët u duhet kushtuar disa stampave frazeologjike, të krijuara me kohë, stampa që e burokratizojnë gjuhën. Stampa të tillë, si «në këtë drejtim», «pér sa i pérket», «në stadin e sotëm», «mos e diskuto» etj. e bëjnë abstrakte gjuhën dhe ia heqin koloritin. Dikur në prozë kanë qenë disa stampa, si «dielli ishte ngritur tre hostenë, kur Xha Zeka doli nga plevica...», «ai pinte duhan dhe dridhë mustaqet» etj. Tani kemi stampa të tjera, veçanërisht në gazetari dhe në kritikën letrare, si mozaikë ngjarjesh, copëza jete; me një mendim në ballë, konture ndërtimi, ballëlart e duar plot, zemërzungj, syshqiponjë, me këngë në buzë e të tjera.

— «Gjuha jonë», si një e përkohshme që u drejtohet edhe shkrimtarëve, ka gjithmonë në qendër të vëmendjes edhe gjendjen e gjuhës letrare në letërsinë artistike, — origjinale e të përkthyer, — dhe ka botuar herë pas here shkrime pér këtë çështje. Është e nevojshme që krijuesit tanë të marrin pjesë drejtpërsëdrejti me shkrime në faqet e kësaj reviste, ku të shfaqin mendimet e tyre edhe pér mjeshtërinë e krijuesit artistik në rrafshin gjuhësor, edhe pér çështje të trajtuar nga të tjerët pér fjalën shqipe. Si mund ta bashkërendojmë më mirë këtë punë?

— Revista «Gjuha jonë» jep një informacion të pasur pér gjuhësinë. Ajo ka filluar të hyjë në një publik më të gjërë, edhe te shkrimtarët. Materialet e saj nuk janë thjesht gjuhësore. Megjithatë, më shumë merret me fjalën e drejtpërdrejtë, me rendin gramatikor, me strukturën sintaksore, me pastrimin e gjuhës dhe me fjalorin. Që t'u interesojë më tepër shkrimtarëve dhe publicistëve, është e domosdoshme të zgjerojë edhe më tej tematikën, të merret edhë më tepër se deri tani dhe më drejtpërsëdrejti me probleme të gjuhës letrare artistike, të evolu-

cionit dhe të perspektivës së saj. Unë ndonjëherë rri edhe mendoj pér gjuhën e Naim Frashërit. Vërtet ka qenë gjenial në gjetjen e ekilibrit të gjuhës, në gjetjen e një pike që do të ishte e përbashkët me gjuhën e shkrimtarëve të sotëm. Me këtë ai gjeti perspektivën e zhvillimit të gjuhës sonë. Po t'ua heqësh ë-në disa fjalëve të tij, ke gjuhën e tanishme, një gjuhë të kulluar, të pastruar nga turqizmat dhe nga elementet e tjera të huaja. Naimi është shembull pér të gjithë shkrimtarët. E them këtë në kuptimin që shkrimtari duhet të parandiejë perspektivën e gjuhës, që kjo gjuhë edhe pas njëqind vjetëve, me gjithë ndryshimet, të mos vjetrohet. Po e qartësoj mendimin. Prirja e gjuhës është që ë-ja vjen duke u zhdukur, duam s'duam! Dhe gjuha ka ligje që s'uua parandalon dot veprimin e tyre! Poeti, duke e ndier se ë-ja po zhduket, nuk e numëron në ritmin poetik. Në qoftë se e numëron, pas njëqind vjetësh vjersha e tij do të çalojë nga ritmi, siç i çalon Naimit, si rrjedhim i përdorimit të ë-së me rast e pa rast. Gjithashtu edhe të-ja, që përdoret në kohën e ardhme, mendoj se do të bjerë. Më shumë përdoret do shkoj; do të shkoj nuk është e bukur pér poezinë. Në këngët popullore është trajta do shkoj, sikurse në gjuhën e folur. E kam fjalën pér parandjenjën e perspektivës së gjuhës nga shkrimtari.

Si përfundim, them se revista «Gjuha jonë» mund ta zgjerojë më tepër tematikën dhe problematikën, duke tërhequr edhe mendimin e shkrimtarëve, të kritikëve, dhe studiuesve të letërsisë.

VËSHTRIM I SHPEJTË NË POEZINË TURKE TË SHEKULLIT TË NJËZETË

Në një mbrëmje qershori në Stamboll, dy vjet më parë, tek rrinim në një restorant të vogël në breg të Bosforit dhe tek flisnim për letërsinë dhe rolin e saj në shoqëri ra fjala edhe për poezinë, dhe veçanërisht për vargjet e Orhan Veliut. I pari këtë bisedë e hapi Ataol Berhamoglu, një poet i ri, i gjatë dhe me ftyrë të zeshkët, njeri i zgjuar dhe i shkathët. Ai fliste me një rusishte të saktë, por me një theks të ndjeshëm turk. Nga Bosfori frynte një puhi e lehtë që vinte erë peshk. Ndofta Bosfori që reflektonte dritat, ndofta puhia që sillte erën e peshkut, apo ndofta sirenat e vaporëve dhe zhurma e varkave të peshkatarëve, na bëri që të kujtojmë poezinë dhe Orhan Veliun. Ataol Berhamoglu, megjithëse ishte një dashurues i papërbajtur i Nazim Hikmetit, atë mbrëmje u dha pas Orhan Veliut. Unë e kuptova. Orhan Veliu është një lirik i hollë, një lirik sa qytetar aq edhe intim. Ai ka shkruar për peshkatarët qhe detim, për punëtorët dhe fabrikat, ka shkruar edhe për mbrëmjet në Bosfor me një ndjenjë të lehtë melankolike, Për mundimet e njeriut të thjeshtë në këtë jetë.

— Vërtet ai është një poet i madh! — tha Ataoli. — Dhe poezisë turke i është dashur një rrugë e gjatë gjersatë vinte tek Orhan Veliu dhe Nazim Hikmeti. Ju e njihni poezinë turke? — m'u kthyesh mua.

— Kam një njohje panoramike. Hapi i parë për njohjen janë antologjitë poetike, — i thashë.

Ai u gjallërua. Më premtoi që do të më jepte një antologji të poezisë turke të botuar në gjuhë të huaj. Këtë antologji ai vërtet e solli. Kështu, në atë mbrëmje Bosfori kisha përpara një nga poetët e brezit më të ri të Turqisë, Ataol Berhamoglu, njërin nga qindra këngëtarët e kësaj toke të begatë me këngë e vargje. Me këtë këngëtar ne bëmë një udhëtim të gjatë nëpër poezinë turke, duke u endur nëpër valët e saj, si nëpër valët e atij deti që kishim përpara syve. Poezia vërtet i shëmbellën detit herë të qetë e herë të shqetësuar e të trazuar. Kjo është për poezinë e çdo vendi, por megjithatë krijimtaria poetike e poetëve të çdo populli ka tiparet e veta dhe rrugët e veta të lindjes, të zhvillimit dhe të pjekurisë.

Pikërisht tiparet e veçanta dhe rrugët origjinale të zhvillimit të poezisë së një vendi e bëjnë atë të bukur dhe interesante, por edhe të vështirë për ta karakterizuar në një parathënie si në rastin tonë. Në poezinë turke janë qindra poetë: secili është një individualitet dhe një botë më vete, gërshtetohen shumë kërkime të përhershme në përbajtje, ide e mjete shprehëse. Ajo erdhi në shekullin e njëzetë pas një traditë të pasur gojore e të shkruar, pas një pastrimi të asaj veshjeje që e pengonte të ekte përpara, duke ruajtur gjérat më të qmueshme e më të bukura nga e kaluara. Poezia turke e shekullit të njëzetë, me ndjenjën e theksuar qytetare, me përgjegjësinë personale përfatet e popullit të saj, me fryshtën demokratike u bë e zonja t'i drejtobet jetës me një botëkuptim të guximshëm për problemet-kyçe të shoqërisë. Nuk mund ta arrinte këtë pa lënë mjaft elemente tradicionale orientale dhe ligje të ngurta që e ndrydhnin dhe e frenonin të ekte me hapin e kohës. Por kjo nuk do të thotë se i humbi lidhjet me të kaluarën dhe traditën; përkundrazi, duke hequr teprimet, duke i krasitur degët jopjellore, nxori më në pah bukurinë e identitetit të saj kombëtar.

Siq e pohojnë studiuesit e huaj dhe turq, por edhe personalitete të tilla letrare si Jashar Qemali e të tjerë në bisedat që kemi pasur, kur jemi takuar, lindja e poezisë së re turke është e lidhur ngushtë me kthesat e ndjeshme në fushën e gjuhës. Është i njohur një fakt, se në rrjedhën e gjashtë shekujve, poetët turq kanë shkruar në një gjuhë të përzier turko-arabo-perse, që ka marrë emrin gjuhë osmane. Kjo gjuhë ishte pak e kuptueshme për njerëzit e thjeshtë dhe për popullin. Atëherë c'ndodhë? Poetët shkru-

anin në njëren anë, njerëzit e thjeshtë krijonin nga ana tjetër letërsinë gojore, siç i thonë turqit «Hallk edebijati». Me gjuhën osmane ka shkruar edhe poeti më i madh i kohës së Tanzimatit Namik Qemali (1840-1888), por ai, si të thuash, bëri një reformë në tematikë dhe futi pér herë të parë në poezi fjalët «populli», «atdhe», «liri». Që me Namik Qemalin poezia turke e ndjeu se do të fillonte të kapërcente një hop të ri në përbajtje e në formë.

Ai që qëndron në kufi të këtij hopi është Teufik Fiqreti (1867-1915), i cili u bë filli lidhës së poezisë së Tanzimatit me poezinë e re. Në kulturën turke ai cilësohet si një demokrat dhe humanist i shquar, cilësi që gjetën shprehje dhe në poezinë e tij. Fjalët tradicionale «bilbil», «trëndafil» e «selvi» u larguan nga poezia e Teufik Fiqretit dhe vëndin e tyre e zunë skenat e jetës së peshkatarëve, të qarat e fëmijëve, kopracia e të pasurve e servilizmi i dallkaukëve. Me këtë ai hodhi bazat e frymës sociale e qytetare në poezi, frymë që u thellua më tej nga breza të tjerë. Krijimtaria e tij u ndikua mjaft nga poezia evropiane, duke u çiruar mjaft nga kanunet dhe duke u thjeshtuar në gjuhë. Rëndësi e veçantë iu dha mendimit, të cilin nuk e ka pasur aq të ndjeshëm poezia orientale. Naim Frashëri në parathënien e përkthimit të tij të këngës së parë të «Iliadës» së Homerit ka vënë re një fakt të rëndësishëm që ka lidhje edhe me poezinë evropiane, edhe me poezinë orientale. Ai thotë: «Vjersh’ e Asisë ka bukuri të madhe, shije të shumë, rrjeshtë të mirë, masë të shkëlqyerë, fjalë të zgjedhura e lodra të ndryshme. Po vjersh’ e Evropës ka mejtim më të lartë; ani të gjithë kanë vjeftë më vete».

Për të treguar tendencën sociale të Teufik Fiqretit, le të citojmë katër vargje nga vjersha e tij «Gostia e hajdutëve»:

*Zotërinj, ju lutem, këtu, këtu te tavolina plot ushqim.
Shtrihet në të i vuajturi vendi im,
Populli plot skamje, përbuzje dhe ofendim.
Ndukeni, kafshojeni shpejt! Gëlltiteni, zotërinj!*

Ndikimi i mendimit të përparuar evropian dhe i poezisë evropiane u thellua më tepër në vargjet e dy poetëve të

tjerë pak më të mëvonshëm, Ahmed Hashimit (1885-1933) dhe Jahja Qemalit (1884-1958). I pari, bile, u bë edhe themelues i rrymës simbolike në poezinë turke, sipas shembullit të poeziës franceze. Kurse Jahja Qemali i gërshtetoi format tradicionale orientale me mendimin filozofik perëndimore. Që të dy hynë më shumë në botën e fantazisë, duke u arratisur nga realiteti me mendimin se në këtë botë nuk ka as gjë të mirë për ta pasur lakmi. Mund të themi se ata e përvetësuan disi formalizmin evropian, duke ia përshtatur kushteve të realitetit turk. Por lexuesi nuk mund t'i ndiqte, pasi në vargje u mungonte jeta e vërtetë.

Reformat, transformimet e evoluimet në poezinë e gjithë këtyre poetëve që përmendëm, Namik Qemalit, Teufik Fiqretit, Ahmed Hashimit dhe Jahja Qemalit, megjithatë nuk ishin të plota. Përsëri gjuha e tyre mbetet e vështirë për popullin, me pak lëng dhe e stisur. Duhej të vinin Mehmed Emini (1869-1944) me bashkudhëtarët e tij, që të bënин një reformë të re më të përparuar edhe në përbajtje, edhe në formë. Mehmed Emini me shokë kthyen fityrën në sistemin popullor të vjershërimit, në sistemin e këngëtarëve të thjeshtë turq, sistem që quhet hexhe. Këta poetë konkretisht e treguan me krijimtarinë e tyre se gjuha popullore bashkë me hexhe-në do të ishte baza për krijimin e poeziës së vërtetë kombëtare. Çështë e vërteta, u përpoq edhe Ahmed Hashimi të përpunonte një variant vjershërimi për t'iu afruar gjuhës së popullit, por nuk ia arriti. Ai vetëm bëri një variant të aruz-it tradicional, variant që quhet mustazad. Me këtë sistem alternoheshin vargjet e gjata dhe të shkurtra dhe kaq.

Le të vazhdojmë udhëtimin tonë për ta shpënë më tej mendimin dhe për të ardhur te përbysjet më të mëdha që ndodhën në poezinë turke. E kemi fjalën përvitet 20 të shekullit tonë, të cilët bënë një revolucion të tërë në poezinë turke. Ky revolucion lidhet ngushtë me emrin e Nazim Hikmetit (1902-1963). Nazim Hikmeti hyri në poezi si poet i parë i klasës punëtore, i masave të gjera të popullit turk, i revolucionit. Ai i dha poezië mendim të ri e formë të re, megjithëse në vitet e fundit të jetës së tij pati edhe luhatje, veçanërisht në ideologji e politikë. Në poezi atë mund ta quajmë një novator të vërtetë dhe një personalitet të shquar, të letërsisë botërore. Që në poezi të para të tij ai i thërriste botës:

*Jam poet,
vërvshëllima ime e çelikte
çan rrufe
muret e shtëpive.
Sytë e mi
në dyqind mëtra larg
dallojnë dy zhuzhakë
të kapur njëri me tjetrin.*

*Vallë köta sy
nuk janë të zotët
të mos shohin
mes territ dhe acarit të natës
botën dykëmbëdhe,
botën dysh të ndarë?*

Në këto vargje dallohet ideja e misionit të poetit në shqëri. Kjo është jo vetëm përgjegjësia e tij ndaj shoqërisë, po edhe guximi dhe lufta për të vërtetën.

Nazim Hikmeti pati një ndikim të madh në poetët turq, veçanërisht në poetët e rinj, të cilët edhe sot e ndjekin si një shenjt.

Me kalimin e viteve poezia turke rritet. Yj të rinj fillojnë e ndritim në qellin e saj. Dhe gjithmonë është në kërkime të reja për të përsosur shprehjen, për të pasqyruar më gjërë jetën dhe problemet e saj. Kështu, në fillim të viteve 40 poetët Orhan Veli, Oktaj Rifat dhe Melih Xhevdet Andaj nxorën një vëllim të përbashkët të titulluar «Garib» («E pashembullt»). Ky vëllim, për idetë dhe drejtimin i shëmbëllen një manifesti poetik. Në të ndihet një protestë e fuqishme kundër temave të «fryra» e pompoze. Ata ngulin këmbë për pasqyrimin e jetës së njeriut të thjeshtë, të ëndrrave dhe shpresave të tij. Këtu e gjenin edhe poezinë e vërtetë. Në këtë vëllim Orhan Veliu shkruan për jetën e të varfërve:

*Me vrimal fanella, me vrimal kaftani,
me vrimal mënga, me vrimal xhepi,
Me vrimal këmisha, me vrimal pizhami,
Mos je kafaz, o vëlla fatkeqi?*

Poetët e vëllimit «Garib», që si grup u quajtën «trekëmbësi», kërkonin mendimin e lirë dhe nuk i vinin rëndësi metrit, rimës dhe metaforës. Ishte diçka e re që sillnin në poezi, prandaj idetë e tyre u përqafuan nga një varg i madh personalitetesh poetike si Behxhet Nexhatigil, Sabahatin Kudret Askal, Nexhati Xhumalli, Orhan Murat Ariburun, Metin Eloglu etj. Për të ilustruar tendencën e tyre, po japim një vjershë të Orhan Murat Ariburunit për jetën e njeriut të vogël:

*Shpresa — buka e fukarait,
Barku — ngushëllimi i tij.
Ha, Mehmed, ha,
Ha, Mehmed, ha!*

Kjo rrymë në poezinë turke mori emrin «Noviteti i parë». Doemos, poetët e kësaj rryme sollën gjëra me vlerë dhe me interes të ndjeshëm, por më vonë ata i thjeshtësuan mjete shprehëse dhe e varféruan formën. Mjaft poetë e kundërshtuan me forcë rrymën «Noviteti i parë». Njëri nga këta ishte Atila Ilhan, që i kritikoi për varfëri mjete shprehëse. Ai vetë shkroi në një formë të re, duke e pleksur frymën e thellë qytetare me mjete të pasura artistike. Shpesh Atila Ilhan i kthehet traditës me forma të reja shprehëse e me plot të papritura novatore.

Në gjurmët e Atila Ilhanit, me kritikë kundër «Novitetit të parë», ngrihen edhe disa poetë të viteve 50-të, që e quajtën veten «Noviteti i dytë». Duke i kundërshtuar të parët, ata u dhanë shumë pas formës dhe veçanërisht pas metaforës. Përfaqësuesi më i shquar i tyre ishte Xhemal Sureja. Ndërsa të parët e thjeshtësuan jashtë masës poezinë, të dytët kalanë në ekstremin tjetër, duke e vështirësuar kuptimin e saj.

Në kohën e këtyre drejtimeve dhe rrymave poetike kritikët poetë të tillë të njojur si Ahmed Muhip Dranas, Xhahit Sitki Taraxhi, Bedri Rahmi Ejuboglu, Umit Jashar Oguşhan etj. I gjithë ky varg poetësh me individualitet të ndryshëm poetik i dhanë poezisë turke një origjinalitet të veçantë dhe e pasuruan fondin e saj. Kjo pasuri është e vështirë të jepet goftë në një antologji, goftë edhe në disa shënimë të shpejta. Megjithatë, mund të përfytyrohet një idë e për-

gjithshme. Mendojmë se edhe kjo sjell dobinë e saj. Por le të vazhdojmë.

Në vitet 60, sidomos në fillim të tyre, kur në shoqérinë turke lindën kushte të reja ekonomike e politike dhe kur po-tët patën mundësi të botojnë gjithnjë e më shumë, u përhap një rrymë tjetër e re e quajtur «topllunxhu» (pasqyrim i temave shoqërore). Në ballë të kësaj rryme ishtë një nga poetët më të mëdhenj turq Fazell Hysny Dagllarxha. Ai ishte edhe një personalitet i shquar në luftën shoqërore-politike. Në vargjet e tij flet për shtypjen dhe dhunën, për papunësinë dhe varfërinë, për shpresën dhe lirinë. Poezia e tij ka një diapazon të gjerë në tematikë dhe në ide. Dagllarxha i këndon fshatarit turk:

*Tokë, a më dëgjon, dua të ha!
Jam i uritur unë dhe kau im i zi.
Kau i largon mendimet e tij
Mua mendimet e zeza më japin uri.*

*Tokë, a dëgjon, dua të ha unë i ngrati
Urinë e ka ngritur në këmbë xhelati.*

Përfaqësues të tjerë të «topllunxhu» dhe afër saj radhitën Omer Faruk Toprak, A. Kadir, Rifat Yllgaz, Fahri Erdine, Tahsin Sarac. Të gjithë shkruajnë për Anadollin e tyre të dashur, për njerëzit e natyrën. Flasin për fshatarin e thjeshtë, për tokën dhe Anadollin Lindor. Poezia e tyre ka nerv të fortë dhe dinamizëm. Këtu mund të themi ndër të tjera se është për t'u dalluar poezia e Tahsin Saracit me gjallërinë dhe figuracionin e saj dhe me ndjenjat e holla qytetare. Para dy vjetësh ai ka qenë edhe në vendin tonë dhe është përkthyes i disa poetëve shqiptarë në turqisht.

Poezia e çdo populli është e pambaruar, është si deti. Ikën një valë dhe vjen një valë tjetër poetësh dhe poezia gjëmon përherë, thérret përherë. E tillë është edhe poezia turke. Një valë tjetër poetësh të rinj kanë hyrë në gjirin e saj, siç janë Qemal Ozer, Xhan Junxhel, Gylten Akën dhe miku ynë i bregut të Bosforit, që kishte dëshirë të fliste e të polemizonte për poezinë, Ataol Berhamoglu.

Në atë mbrëmje qershori në breg të Bosforit, tek e shfletoja antologjinë e poezisë turke në gjuhë të huaj, Ataol Berhamoglli buzëqeshi e tha:

— Kërkon emrin tim?

— Po! — iu përgjigja.

— E kam andej nga fundi, — qeshi ai.

Më shkuuan sytë në një vjershë me vargje të gjatë të Ataol Berhamoglluit dhe nga kureshtja e lexova aty pér aty. Titulli ishte prozaik: «Një herë tjetër». Ai shkruante:

*Sot dashurova dhe isha i dashuruar, pastaj mes
demonstruesve çava.*

*U lodha. Vjen pranvera. Në verë duhet të mësojmë
të mbajmë pushkën në duar.*

*Librat janë bërë vandak. Po më rriten balluket;
gjëmim alarmi ngado.*

Jam i ri. Hëpërhë. Dua të shoh botën.

*Të puthem, bukur edhe ta mendosh!
Do të fitojmë një ditë patjetër!*

*Do të fitojmë një herë patjetër!
Hej, eunuk harem! Hej, kryevezir! Hej, fajdexhi
i kohëve të vjetra!*

Edhe në këto pak vargje ndihet temperamenti dhe vrulli poetik i një poeti të ri, ndihet pasioni pér të transformuar botën.

— Plot temperament, — i thashë i menduar.

— Pasionet e një të riu! — buzëqeshi ai.

Edhe unë e vështrova me buzëqeshje.

— E thamë që poetët janë si valët e dëtit. Vala e fudit, kalon koha dhe del e para! Ka kohë! Do të rritet vala, — thashë.

— Ndofta! — u mendua ai.

Po le ta lëmë Ataolin e le të vijmë përsëri te poezia turke, që përfshihet në këtë përbledhje. E thamë edhe më lart se është vështirë të ndërtosh një përbledhje, por akoma më vështirë të japësh në përkthim shpirtin e poezisë origjinale. Kjo ka qenë vështirë në gjithë kohët, është edhe sot, megjithse poezia është çliruar nga shumë kanune të sistemit të saj poetik. Por mendoj se poetët dhe shqipëruarit Fatos Arapi, Bardhyl Londo e Zana Lito kanë bërë një punë të mirë e të dobishme. Edhe pse në përgjithësi nuk

u janë përmbajtur metrit, rimës dhe ritmit të origjinalit, pasi kjo ishte një gjë e vështirë, ata e kanë dhënë origjinalitetin poetik dhe mendimin e çdo poeti të shqipëruar.

Botimi i kësaj përmblehdjeje do t'i ndihmojë dashamirët e poezisë dhe lexuesit për të hyrë në një botë poetike relativisht pak të njojur nga ne. Duke hyrë në këtë botë poetike do të ndiejmë zërat e poetëve, do të kuptojmë mendimet e tyre dhe do të mbajmë vesh tingullin e fjalës së ngarkuar me emocion. Atëherë do të shtohet më shumë miqësia me popullin që i ka lindur këta poetë.

1982

VEPRA E NJË PERSONALITETI TË MADH TË LETËRSISË TURKE

Në folklorin turk është shumë e përhapur legjenda e «Djalit të qorrit». Sipas saj, një sovran i kërkon shqytarit të tij t'i gjejë kalin më të mirë në botë. Shqytari erdhi dhe i solli një gërdallë të vërtetë. Atëherë sovrani, i tërbuar nga inati, tha: «Ti tallesh me mua? T'i nxirren sytë këtij jeziti, që të mos shohë dritë kurrë!» Dhe shqytarit ia nxorën sytë dhe e përzunë nga pallati. Por ai e mori kalin dhe ia shpuri të birit duke i thënë: «Merre, bir, këtë kalë, se ky bën çudira!» I biri i qorrit, hipur në këtë kalë, luftoi kundër të gjithë të fuqishëmve në botë dhe u bë një hero popullor.

Kjo legjendë i shkon edhe legjendës së jetës së Jashar Qemalit, legjendës së penës së tij dhe të frysimeve të tij. Fshatarët e Silisies, malet e Taurusit e fushat e Çuçur-Ovës i dhanë fjalën e mahnitshme të tyre dhe i thanë: «Merre, bir, këtë fjalë, se kjo bën çudira!» Dhe ai e mori këtë fjalë, luftoi kundër të gjithë të «fuqishëmve» dhe u bë një shkrimitar i madh popullor, duke i përhapur emrat e Silisies, Taurusit e Çuçur-Ovës në të gjithë botën. Po edhe në paramjen e jashtme Jashar Qemali u shëmbëllen heronjve të legjendave; i gjatë, me fytyrë të djegur nga dielli, me këmbë të fuqishme, që me një të shtyrë mund të lëvizin shkëmbinj nga majat e Taurusit, me krahë të fortë, që janë gati të shkulin një lis në fushën e Çuçur-Ovës, me gjoks si shpellë,

që zien nga përrenjtë e fjalëve, tregimeve, ngjarjeve dhe historive të pambaruara plot ngjyra e tinguj të çuditshëm. Ai duket si një rapsod udhëtar i ardhur nga grykat e fushat e Anadollit, që mbart me vete të gjitha këngët dhe legjendat, që të gjitha i di dhe të gjitha i tregon. Është një enciklopedi e vërtetë gojore, pa futur këtu ato që ka shkruar. Një njeri që e ka parë dhe që ka ndenjur me të, e ndien se ato që tregon dhe që mendon janë më të shumta, dhjetëra herë më të shumta se ato që ka shkruar. Dhe, duke e dëgjuar tek tregon, thua me vete: «Sikur t'i shkruajë të gjitha, c'ka për të ngjarë?» E them këtë, pasi unë kam ndenjur me të një javë të tërë, kur ishte mysafir i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve në Tiranë, para nja dy vjetësh. Nga tregimet e tij unë mësova për Turqinë, dhe pasuritë shpirtërore të saj më shumë se nga librat që kam lexuar. Ai nuk rresht së treguari dhe ka qejf gjithmonë të ecë e të ecë; edhe në kafe ecën, edhe në dhomë ecën, edhe në rrugë ecën. Po të kishte mundësi, ai do të ekte edhe duke shkruar. Në një intervistë me një gazetar të gazetës «Xhumhurijet», në tetor të 1982, në pyetjen «Si ju lindi dëshira për të ecur», ai përgjigjet: «He, atë do të të tregoja. Të thashë që kam qenë rojtar i ujërave. Që nga 1947 e gjer 1951 kam qenë rojtar i lumit Savrun në Kadirlı. Dy herë në javë shkoja dhe kthehesha deri te burimi i lumit, 59 kilometra. Në atë kohë shkrova tregimin «Foshnja». Mendoja rrugës dhe shkruaja në çadër kur kthehesha. Edhe tregimet e tjera kështu i kam shkruar. «Memet Imcakun» e shkrova duke u menduar në rrugën Xhallollu-Beshikëtash në Stamboll.»

Ndoshta ky zakon i ka mbetur që nga fëmijëria e rinia e hershme. I lindur në Gérçkeli pranë Adanasë, në krahinën e Silisies më 1923, mbetur pas katër vjetësh jetim, pas vrasjes së të atit, i rritur me mundime, ai u mor me lloj-lloj punësh. Lëroi tokën, punoi shkrues në çifligun e pambukut, u bë rojtar ujërash, traktorist, këpuçar, rojtar bibliotekë e të tjera. Por në çfarëdo pune që ka bërë, është joshur nga letërsia. Kur ka qenë rojtar, bibliotekë në Adana, ka lexuar shumë dhe është njojur më mirë me shkrimtarët turq dhe botërore. Letërsinë ai nuk e mësoi në universitet, pasi ka mbaruar vetëm shkollën fillore. Universitetet e tij kanë qenë rrugët, arat, lumenjtë, uzinat dhe profesorë kanë qenë njerëzit dhe librat, veçanërisht fshatarët dhe rapsodët me

këngët dhe historitë e tyre. Ai, sikur të mos ishte bërë shkrimtar do të bëhej një rapsod i madh. Që në moshën njëmbëdhjetëvjeçare ka konkuruar me rapsodët më të njo-hur të krahinës së tij. Madje edhe në shkollën fillore shkoi për të mësuar shkrim e këndim dhe për t'i shkruar dhe ruajtur të gjitha tregimet dhe këngët popullore që dëgjonte dhe që dinte përmendsh. Edhe krijimtarinë letrare e filloj me përpunimin e këngëve popullore. Këta tinguj e fjalë do ta ndiqnin pas tërë jetën dhe ai do t'i përkëdhelte dhe ato do ta përkëdhelnin. E kështu, më 1943 boton «Këngë vaji» dhe 24 vjet më vonë, më 1967, «Tri legjenda anadolliane». Por më e rëndësishmja është se kjo pasuri shpirtërore e popullit është shkrirë në indet e të gjitha tregimeve, romaneve dhe dramave të tij, duke u dhënë atyre një origjinalitet të pa-përsëritshëm.

Në veprën e Jashar Qemalit pasuria shpirtërore e popullit, këngët, përrallat, proverbat, anekdotat e legjendat nuk qëndrojnë më vete, por shkrihen me jetën e zakonshme e të përditshme të heronjve e personazheve dhe formojnë një të tërë e të pandarë. Lexuesi e merr këtë tërësi dhe nuk do ta ndajë në pjesë dhe as që bën pyetje se ku fillon legjenda dhe ku mbaron e vërteta e jetës. Këtu qëndron edhe një nga anët e fuqishme të mjeshtërisë së Jashar Qemalit. Me një fjalë, në veprën e tij nuk ka stisje e marifete moderniste, si në mjaft krijime të shkrimtarëve të sotëm perëndimore, të cilët i marrin mitet dhe legjendat e popullit, i shkëputin nga materiali jetësor dhe bëjnë me to lloj-lloj trillimesh për të çuditur njerëzit me novatorizmat e tyre. Ata me këtë shpërdorojnë pasurinë e popullit. Jashar Qemali pasurinë e popullit nuk e shpërdoron: atij i vjen keq, e do dhe e mbrohet një thesar. Dhe mbrojtja më e mirë është pasqyrimi i jetës së vërtetë të popullit, i hallevë, shqetësimëve, vuajtjeve, gëzimeve, tragedive dhe dëshirave të mëdha për përparimin njerëzor. Në të gjitha këto tragjedira e dëshira shkrihen edhe legjendat edhe mitet, shkrihen tërë pasuritë shpirtërore të popullit.

Jashar Qemali është një shkrimtar i madh i letërsisë turke, që del jashtë kufijve të vendit të vet në një kohë kur një pjesë e kulturës artistike në botë është shkëputur nga populli dhe ka rënë në monotoni temash e mendimesh, në monotoni kërkimesh të pafundme në skutat e errëta të ndërgjegjes dhe të shpirtit. Edhe Jashar Qemali kërkon, në kompleksin e jetës së popullit, në kompleksin e njeriut dhe në

raportin e këtij njeriu me njerëz të tjerë të shoqërisë. Ai dëshiron ta shohë këtë njeri të çliruar nga mizerja, shtypja dhe dhuna dhe nuk ka asnje dëshirë ta shohë të gjymtuar mendërisht dhe moralisht. Mjaft shkrimtarë të sotëm në botë e gjymtojnë njeriun, vënë në qendër të librave të tyre idiotët, të marrët, psikopatët, kriminelët dhe prostituat dhe në shpirtin dhe trurin e tyre gjerryejnë dhe futin turjelat e zanatit të tyre për të bërë eksperimente letrare. Jashar Qemali është jashtë kësaj kopejeje eksperimentuesisht marifëçinj, të cilëve u është atrofizuar truri në këtë epokë të kibernetikës. Mes kësaj morie eksperimentuesish të atrofizuar Jashar Qemali qëndron i freskët, prandaj vepra e tij ka terti-hequr vëmendjen e lexuesve të botës, të lodhur nga monotonitet letarë dhe të hutuar nga heronjtë dhe personazhet psikopate. Ai ende ka shumë për t'i thënë këtij lexuesi, prandaj edhe e qorton veten, duke thënë se ka shkruar pak. Në intervistën që përmendëm pak më lart ai thotë gjysmë me të qeshur, gjysmë me të vërtetë: «Sëmundja jonë e madhe, sëmundja e ne shkrimtarëve, është dembelizmi. Prandaj e admiroj Aziz Nesinin, se është më punëtor nga ne. Ende shkruan. Ka shkruar 72 libra. Unë do të dëshiroja të isha më punëtor. Më thonë se shkruaj shumë. Nuk shkruaj shumë. Duhej të shkruaja tre romane në vit. Po u afrohem të gjashtëdhjetave. Kam botuar 26 libra. Nuk janë të gjitha romane, ka edhe përbledhje tregimesh, artikujsh... Janë pak për një romanier. Dembelizëm... Ndoshta jam shkrimtarë më dembel në botë. Në kokë kam tema për 15-20 romane. Dhe jo vetëm tema. Romani nuk është vetëm tema. Edhe atmosferën e romanit e kam. C'të bëj, ë di shumë mirë, por nuk shkruaj. Jam një njeri dembel». Ndërkaq gazetari e pyet:

«Edhe sot puna që dëshironi më tepër është të shkruani romane?»

Dhe ai përgjigjet:

«Dua të shkoj në Adana dhe të punoj tokën me traktor deri në mëngjes. Këtë punë e kam bërë kur kam qenë i ri. Ditën ishte nxehjtë, prandaj punonim tokën natën, deri në mëngjes. Në mëngjes aroma e tokës së lëruar është një mrekulli e natyrës. Nuk kam dashur asgjë kaq shumë sa aromën e tokës. As detin nuk e kam dashur aq shumë. Njeriu fluturon nga gjëzimi. Nuk kam mundur më ta shijoj atë ndjenjë. Një ndjenjë të tillë të ngjashme shijoj kur botohen librat e mi të rinj.» Jashar Qemali ka të drejtë. Edhe të lërosh

arën e fjalës është një gjësim i madh. Këtë gjësim ai ka ndier kur ka botuar romanet «Teneqeja» (ose «Orizi i Anadollit»), 1955, për revoltën kundër shfrytëzimit, «Çakircali Efe», 1972, me temën e heroizmit, trilogjinë «Shtylla», «Tokë e hekurt», «Qielli i bakërt» dhe «Bati që nuk vdes», 1960-1968, ku pasqyrohetjeta e fshtarësisë nën thundrën e çifligarëve të mëdhenj, me vuajtjet dhe protestat e të varfërve, me mitet e vjetra dhe të reja; «Legjenda e malit Agridagi», 1972, që ka si sfond legjendat popullore dhe tregon historinë e një dashurie fatkeqe ndërmjet shtresave të pabarabarta; «Legjenda e një mijë demave», 1971, ku pëershkuhetjeta deri në shpërbërje e një fisi nomadësh. Një roman tjetër i Jashar Qemalit është edhe «Vrasja në pazarin e kovaçeve», i botuar më 1973 dhe i përkthyer në shumë gjuhë të botës. Ky roman është quajtur nga kritika evropiane si një nga veprat më të fuqishme të autorit. Atje pasqyrohen në mënyrë realiste tablo të fuqishme të jetës dhe zbulohet një realitet i ashpër dhe rrëqethës. Në qendër të romanit është një histori e gjatë armiqësie ndërmjet dy klanesh të forta: të Demir beut dhe të Mustafa beut. Përmes kësaj historie jepen fatet e njerëzve të thjeshtë dhe pangopësia e të pa-surve, çifligarëve dhe agallarëve.

Vepra të rëndësishme që mund të përmendim janë edhe «Turtulleshë, turtullesha ime», 1975, «Një re kalon lart», 1974; «Shtegtuan edhe zogjtë», 1978 etj.

Në gjuhën shqipe nga Jashar Qemali është përkthyer vetëm romani «Shtylla», që ka bërë mjaft jehonë në lexuesin tonë, dhe disa tregime të botuara në revistën «Nëntori» dhe në gazeten «Drita». Romani «Memet Imcaku» është i dyti që i jepet lexuesit shqiptar dhe s'ka asnjë dyshim që edhe ky do të pritet me entuziazëm. Në qendër të romanit është historia e ashpër e me ngarkesë emocionale e një kacaku që del malit, i shtyrë nga padrejtësítë shoqërore, nga shtypja çnjerëzore e agait të fshatit. Ky është romani i parë i Jashar Qemalit, i shkuar me një spontaneitet të habitshëm, pa teknicizma, pa trillime e pa poza letrareske. Ai i shëmbëllen një toke që punohet për herë të parë, një toke që nuk njeh teknikën dhe mjetet moderne. «Memet Imcaku» është edhe roman, edhe legjendë, edhe këngë dhe, tek e lexon, nuk je në gjendje të vësh një kufi se ku është letërsia e shkuar dhe ku letërsia gojore. Po ta kesh njojur Jashar Qemalin, tek e lexon këtë roman, të duket sikur dëgjon zërin e tij, duke treguar historira. Autori me një da-

shuri të madhe flet për Memetin¹⁾ e imët, Memetin e vogël, që ka punuar tokën sa filloj të bariste dhe që atëherë ndjeu kamxhikun e Abdi agait pas kurrizit. Për të toka ishte lumburia dhe fatkeqësia e tij. Ishte lumburia e tij, se ai shkelte mbi të dhe ndiente erën e dheut dhe të grurit, por ishte fatkeqësia e tij, se mbi këtë tokë ecte edhe agai dhe atje e shtrinte për ta rrahur.

Memeti i imët del kaçak, pasi vret të fejuarin e së dashurës së tij dhe plagos rëndë aganë. Dhe ky njeri që nuk ia priste mendja askujt që të bënte veprime të tilla, fsheh në vetvete energji të pashtershme dhe bukuri të rralla shpirtërore, guxim, trimëri, urejtje, dashuri dhe èndrra. Ai bëhet mbrojtës i njerëzve të thjeshtë, i njerëzve të varfër dhe të shtypur, bëhet mbrojtës i dashurisë dhe i èndrrës së tij. Nuk del kaçak për të zhveshur njerëzit dhe për t'u marë paret e rrobat, por për të vrarë padrejtësinë, aganë dhe agallarët, që kërkon ta shohë tokën e dashur pa këta vampiri. Jashar Qemali, përmes kësaj figure, dëshiron të na vërtetojë se ç'trima kapedanë mendjendritur fshihen në mes të popullit, që, po të kenë kushtet, bëhen udhëheqës të mëdhenj për përparimin njerëzor.

Në roman, mes stofit të fortë realist, gërshtohen elementë e personazhe si të përrallave dhe gojëdhënavë. Vetë Memeti është një kompleks i tillë. Ai është i imët dhe i dobët, si ata personazhet e përrallave, që papritur e pa kujtuar bëjnë çudira. Por ky element nuk është vënë kastile nga Jashar Qemali, ky as që ndihet dhe këtu qëndron bukuria. Me këtë Jashar Qemali do të thotë se nuk është e domosdoshme që çudirat t'i bëjnë viganët. Ka viganë mbi viganë: janë njerëzit e thjeshtë. Më tutje të vijmë te një figurë tjetër, tek Ali Çali. Edhe ky u shëmbëllen personazheve të tregimeve popullore. Ky është një njeri i çalë, një fshatar i zgjuar, që di të njohë gjurmët dhe të zbulojë ku është fshehur një i arratisur. Po pa gjurmë, edhe sikur ta ketë mik të arratisurin, ka dëshirë ta zbulojë. Dhe nga kjo dëshirë ndonjëherë i sjell edhe fatkeqësi atij që ndjek. Lufton me veten që të mos i sjellë fatkeqësi, që të mos e zbulojë, por zanati nuk e lë të qetë, e shtyn për zbulim. Por Memeti i imët edhe këtë e mund me shpirtin e tij, e bën mik.

1. Në romanin origjinal Memed, sipas shqiptimit popullor të emrit Mehmed ose Muhammed.

Figurat e njerëzve të thjeshtë, të burrave dhe grave, përshkruhen me dashuri të thellë, ndërsa ato të agallarëve, pasanikëve dhe vrasësve pasqyrohen me një zemërim dhe urrejtje të madhe. Urrejtja e ashpër e ndjek Abdi Aganë, çifligarin Ali Safa beun, kryecubin katil Marrakun e të tjerë. Me ndjenjën e dhimbsurisë dhe të dashurisë përshkruhen figurat e grave, ajo e Hatixhesë, së dashurës së Mehmetit, e së burgosurës teze Irazit, e nënës e plot të tjera. Edhe toka në roman është kthyer në personazh, në figurë, e pasqyruar me adhurim e dashuri. Janë të rrallë ata shkrimtarë që e njohin dhe e duan kaq shumë tokën si Jashar Qemali. Ai e përkëdhet tokën me dorën e padukshme të fjalës dhe të duket sikur përpinqet dhe dëshiron t'ia heqë të gjithë gjemba. Vetëm një njohës i hollë mund të vëré re të tilla hollësira për tokën: «Ku janë tokat më të shkreta e më të ashpra, atje mbijnë gjembaçët. Ku mbijnë gjembaçët, toka zbardhon si pëlhirë, atje s'mbin bar, as pemë madje as fiku i Barbarisë.»

Jashar Qemali çdo gjëje që ka të bëjë me atmosferën e romanit, me jetën e heronjve dhe personazheve, i jep shpirt dhe e gjallëron. Edhe në një palë çorape të thurura nga një grua e dashur ai fut këngën dhe shpirtin popullor. Të japim një shembull. «Edhe këto çorape të qëndisura janë si puna e këngës. Ato janë thurur me harenë, me të cilën këndohet kënga. E verdha, e kuqja, e blerta, e qiellta, e portokallta, gjithë këto ngjyra, që pleksen e lodrojnë, atje, sjellin një ngrohtësi e ëmbëlsi bashkë. Sjellin diçka nga vetë dashuria, nga vetë dhimbsuria...»

«Në këto çorape dashnorësh do të gjesh patjetër dy zogj të qëndisur. Të mbështetur sqep më sqep, këta dy zogj duken sikur puthen. Pastaj do të shohësh edhe dy drurë të shkurtër. Çdo dru ka një lule vetëm, po shumë të madhe. Edhe këta dy drurë janë pranë, thua se po puthen. Ndërmjet këtyre dy qëndismave rrjedh një vijë uji e bardhë qumësht, me ca shkëmbinj të kuq anës brigjeve të saj të këndshëm. Ngjyra e drita harbojnë atje si të dehura.» Kjo është dashuria për punën dhe fantazinë e njeriut, për perin e leshit e përlulen, për ujin, pemën dhe grurin. Të gjitha këto na flasin dhe na tregojnë me gisht njeriun: ai është zoti ynë, ai na vuri fjalën në perin e leshit dhe peri këndon me ngjyrat e tij këngën e gruas turke!

Në romanin «Memet Imcaku» pasqyrohet jeta e fshatarëve, e cubave, e agallarëve dhe e çifligarëve, e grave të burgosura, e padrejtësive të gjykatësve e të prokurorëve, mjesidet e pazarëve dhe haneve. Dhe të gjitha këto janë në funksion të heroit qendror, Mehmetit të imët. Një vend zënë edhe dy gratë e burgosura të dënuara në bazë të faktave të trilluara e të gjenjeshtërtë, Hatixheja, e dashura e Memetit, dhe Irazi, një grua që ia vrasin birin e vetëm dhe që kërkon të djegë shtëpinë e vrasësit. Por jeta e këtyre grave në burg pasqyrohet zbehtë dhe do të thosha është pjesa më e dobët e romanit, që ia humb ritmin. Ndoshta Jashar Qemali nuk i ka dhënë ndonjë rëndësi, se aftësitë për përshkrimin e jetës së burgjeve atij nuk i mungojnë, pasi atë e njeh mirë, se ka qenë edhe vetë në këta «konakë» jo aq të këndshëm. Ndryshtë puna, kur këto dy gra i glijron Memeti dhe i shpie në një shpellë në malin e Aliut. Atje përshkrimi është i gjallë dhe me ngarkesë të madhe emocionale. Në shpellë e shoqja e Memetit, Hatixheja, lind një djalë. Kjo është një lindje që kthehet në simbol. Ajo lidhet me diçka tjetër rrëqethëse. Xhandarët e rrethojnë Memetin në një dimër me dëborë, dhe ai, pasi i mbaron fishekët, dorëzohet. Atëherë rreshter Asimi, që drejton këtë operacion, shkon te gryka e shpellës dhe ia hedh prangat Memetit. Në shpellë është Hatixheja, fëmija dhe teze Irazi. Dhe përshkruhet kjo skenë: «Memeti heshtëte. Ai zgjati duart drejt prangave. Po Irazi, që nga vendi ku ishte, u lëshua si shigjetë.

— Dëgjo këtu, o rreshter! — tha. — Pandeh se ti po e shtie në dorë të gjallë Memet Imcakun?

Ajo u sul andej nga fundi i shpellës dhe tërhoqi qilimin që mbulonte foshnjën. U duk foshnja me sy të myllur.

— Ja kush e kapi Memet Imcakun! E kapi ky këtu! Dhe ma mbani veten për burra!»

I munduri këtu kthehet në fitimtar. Rreshteri ia heq prangat Memetit dhe ikën. Është triumfi i së plotpushitet-shmes grua dhe i lindjes. Është edhe triumfi i heroit. Për këtë gjetje çdo shkrimtar i heq kapelen Jashar Qemalit.

Edhe pak fjalë. Natyrisht Jashar Qemali ka edhe kufizimet e tij, veçanërisht në ndonjë mendim të shprehur në ndonjë deklaratë të botuar në shtypin e huaj. Fjala vjen,

ne konceptin e realizmit dhe t  e natyralizmit ndihet nj fa-r  konfuzioni. Ai v  shenj n e barazimit nd rmjet tyre. Ai thot  se  sht  «si kund r natyralizmit, ashtu edhe kund r realizmit». N  fakt n  vepr n e tij letrare ai  sht  besnik i realizmit. Por k to, fundja, jan  deklarata. Deklarat t ikin e fluturojn , veprat mbeten.

Dhe le t i mbyllim k to sh nime me disa mendime t  Jashar Qemalit, q  m i ka shprehur kur e takova n  Ti-ran  dhe q  disa prej tyre i ka dh n  edhe n p r inter-vista t  botuara n p r revista e gazeta. «Un  nuk dua k rr , — thot  ai, — t  imitoj jet n. Ekzistenza s sht  gj  tjet r ve se nj  krijim i p rhersh m, nj  ripasurim i pand rprer : n   do sekond  q  shkon ka nj  pem  m  shum , mij ra insekte, nj  flutur m  shum , disa brezare m  shum  n  plaj n e Cukur-Ov s. N  librat e mi un  p rp q m ta ri-nd rtoj k t  ripasurim... Un  mendoj q  imagjinarja nuk ek-ziston ve se ushqehet nga ky ripasurim i p rhersh m. T  marrim nj  shembull: un  dua t  p rshkruaj nj  kopsht p -shk sh. E mir , un  pranoj t  shikoj gjith  aspektet e jet s s  k tij kopshti, si  sht  shfaqur fleta e par , si gjuajn  fluturat ushqimin, si ngjitet dielli mbi pem t, si v rtitet uji, si jetojn  fshatar t q  merren me kopshtin etj... Duhet q  un  t  ripasurohem, t  ngopem p r nj  koh  t  gjat  nga kjo reale, n  saj  t  s  cil s krijimi im merr gjith  gjer -sin  e vet. Un  besoj se realja dhe imagjinarja jan  t  lidhura, t  pandara... Ne nuk mund t  kuptojm  asg j  nga njeriu, n  goft  se nuk e konsiderojm  nj  t resi, real dhe imagjinar.  sht  nj  k ries  q  jeton, q  fle, q  ha, por specifika e tij e madhe  sht  pik risht kapacit ti i krijimit edhe n  p rgjith si, edhe n  fush n e m tit... Un  jam nj  njeri i nj  kulture t  fjal s dhe, pra,  do fjal  e d rgoj n  nj  bot  reale dhe imagjinare dhe  do fjal   sht  nj  form  dhe nj  p rmbajtje. Mrekullia e krijimit  sht  pik -risht t  arrish t  luash me k t  dualitet. T  flas sh,  sht  nj  mrekulli. Ai q  b n fjal n,  sht  gjithashtu magjik si ek-zistencia. Tradita gojore, ky krijim i mij ra njer zve, u p r-k t t  gjith ve. Dhe  do njeri mund t  marr  p r hesap t  vet. Un  jam nj  paralele nd rmjet fjal s gojore dhe fjal s s  shkruar. Kur shkruaj, un  i drejtohem tradit s gojore, por gjuha ime prej shkrimitari  sht  p rpara gjuh s sime vetjake. Kur tregoj nj  epope, jam i dashuruuar pas fjal s. Si shkrimtar, b hem i dashuruuar pas gjuh s.»

K shtu kishte qejf t  tregonte Jashar Qemali, megjith -

se nuk është ndonë teoricien arti. Dhe, kur unë i kundërshqoja ndonjë mendim, ai nxehet e thoshte: «Jezit axhami!» Pastaj qetësohet, qeshte dhe këndonte këngën e Pir Sulltan Abdallit, një bardi të lashtë popullor turk. Mendimet e tij për letërsinë, traditën e kulturën janë mjaft interesante, se janë fryt i përvojës dhe i asimilimit të trashëgimisë letrare turke dhe botërore. Traditën ai e respekton thellësisht dhe për të është gati të të flasë pa u ndalur dhjetë orë të tëra. Dhe jo vetëm flet, por edhe këndon si rapsod. Ai e do popullin e vet, prandaj për atë, gjer tanë, ka ngritur njëzet e gjashtë përmendore me njëzet e gjashtë librat e tij.

POL ELYARI DHE POËZIA E TIJ

1.

Poezia e Pol Elyarit, ka kohë që udhëton nëpër botën e mbushur plot me shqetësime dhe ëndrra. Në këtë udhëtim ajo i thërret njerëzit në luftë për përparim shoqëror kundër padrejtësisë, shfrytëzimit, dhunës dhe tiranisë, duke ngjallur shpresa dhe ndjenja të larta njerëzore. Krijuesi i saj hyn në plejadën e poetëve francezë që ndriti me një shkëlqim të veçantë në qellin e madh të poezisë në periu-dhën e dy luftërave botërore dhe në epokën e revolucioneve socialiste dhe lëvizjeve çlirimtare. Kjo plejadë i dha një shtytje të fuqishme poezisë së atëhershme. E themi këtë, pasi fillimi i shekullit të 20-ë e gjeti poezinë disi të hutuar e me busull të humbur, në udhëkryq e në krizë. Žjarret e reklamave të ekspositave industriale, që tregonin progresin ekonomik të borgjezisë, i hutonin disa poetë entuziastë, duke i ushqyer me iluzionin e paqes së përjetshme dhe mirëqenies shoqërore; ndërsa disa të tjera i shtinin në pesimizëm, pasi ata vinin re ndërtimin e padrejtë të botës me ligjet e pashpirta të shoqërisë ku jetonin. Këta të fundit, që ndikohen nga brezi i «poetëve të mallkuar» të shekullit të kaluar, nëmnin botën dhe jetën, duke mos e ndier epokën e ngjarjeve të mëdha shoqërore që po vinte. Por, nga ana tje-

tër, kishte edhe mjaft poetë të rinj, që ndienin tronditjet e nëndheshme të shoqërisë, të cilat sa vinin e bëheshin më të ethshme. Ndër ta ishte edhe Pol Elyari, që jo vetëm e ndieu tërmelin shoqëror, por u bë edhe vetë pjesëmarrës në të.

Në kohën kur krijonte ai, jetonin dhe punonin Majakovski, Lorka, Kuazimodo, Tuvini, Nezali, Nazim Hikmeti, Rilkeja, Pablo Neruda, Maçadoja, Hernandesi dhe shumë poetë të tjerë, të cilët më vonë do ta pasuronin poezinë botërore dhe do ta ngrinin në majë të larta me cilësi të reja shprehjeje. Por për ta ngritur në këto lartësi, rruga ishte shumë e vështirë, me plot kthesa dhe të papritura të rrezikshme. Në këtë rrugë mjaft poetë të talentuar u hutuan, u lodhën dhe mund të themi se e humbën talentin aq të premtuar.

Pol Elyari lindi më 14 dhjetor të 1895-ës në Sen-Deni. Rinia dhe pjekuria i kaloi nëpër frontet dhe llogoret e dy luftërave botërore. Në të parën ishte thjesht ushtar, thjesht mish për top, në të dytën ishte partizan i Frontit të Rezistencës Franceze, i ndërgjegjshëm për misionin e tij si poet dhe luftëtar për çlirim, kundër nazizmit dhe tradhtisë. Dhe të gjitha këto peripeci ai do t'i pasqyronte më vonë në poezinë e tij.

Poeti kishte shkruar vjersha që para Luftës së Parë Botërore, ashtu siç mund të shkruante atëherë një djalë i ri për vuajtjet shpirtërore dhe për një dashuri të parakohshme. Vargjet e para të njoitura, të botuara më 1917, shprehnin gjithë ankthin dhe shpresën e njerëzve të atëhershëm. Ato gjithashtu, janë një zbulim i gjendjes shpirtërore të shokëve të tij, poetë të asaj kohe. Nëpërmjet theksit personal të këtyre vargjeve tejduket karakteri i të riut që kaloi përmes baltës dhe pluhurit të frontit, nën qiellin e çarë nga plumbat. Tejduket edhe ai malli dhe dashuria për shokët e tij të frontit, të dërrmuar dhe të sfilitur, të lodhur dhe të mbetur pa gjumë:

*C'na thua, vëllaçko, a shtrihemi?
Të flemë gjer në mëngjes me rripa zërthyer.
Lëre, lëre! Të vjen keq për të tjerët,
Që natën me pushkë në krah e kalojnë,
Por mos u mërzit, ata kanë fjetur ditën.*

Operimi mjeshtëror me një gjuhë të shkathët dhe muzikore, në të cilën duken edhe nuancat më të holla, shtrihet edhe në sferën e temave që pasqyrojnë vuajtjet e njerëzve, vuajtje që i provoi në fizik dhe në ndërgjegje mes mizeries shoqërore ku ishte futur edhe vetë. Kjo mizerje e përbashkët do ta frymëzonë në vargjet e hershme dhe domosdø do ta bënte të shpresonte. Kështu, libri i tij i parë «Poemat e paqes», që u botua më 1918, është plot me imazhe të dhimbshme, por njëkohësisht edhe plot shpresa delikate. Ai kthehet nga fronti dhe shikon se si shokët e vet të dërrmuar nga lufta, ndiejnë ngrohtësinë e shtëpive të tyre:

*Gratë e lumtura prapë i takuan burrat.
Ai vjen nga dielli i téri i ngrohtë,
Qeshë embël e butë,
Tungjatjeta, thotë
Dhe mrekullinë e tij përqafon.*

2.

Aj, si Uollt Uitmani në «Fijet e barit», libër të cilin e pat lexuar dhe rilexuar, ndien edhe shketësimet më të imëta të njerëzve dhe i pasqyron në poezi, duke i filtruar nëpërmjet shpirtit të tij të gjerë, pa rënë në vogëlsira egoiste. Babëzinë, vetëkënaqësinë dhe pangopësinë ai nuk i duronte, por i urrente, Në librin «Duke u kredhur në jetë» për të babëziturit shkruan:

*Ata ngaherë hanë e hanë,
Llupës, janë, të babëzitur janë,
Edhe kur qeshin të ngopur s'kanë
Dhe bëhen më tepër grykanë.*

Këto vargje jahë shkruar 14 vjet pas bredhjeve të tij nga një llogore në tjetrën, i veshur me kapotën e ushtarit,

me gavetë në brez. Njerëzit e kënaqur dhe të pangopur përsëri do të përgatitnin tragjedi të rea. Pol Elyari e ndiente se po këndonin përsëri «vjollcat e mortjes». Prandaj më 1934 në librin «Trëndafili për të gjithë» shkruan:

*Në fushën e trazuar
As të mirë, as të keqe,
Kalben rrënjet e rënkimeve,
Palosen gjelbërimet,
Grumbull të shembura,
Si libra të vjetër
Dhe vjollcat e mortjes këndoijnë...
Por prapë të qeshurat mbi tokë trokasìn:
Premtimet e brezit të ri brohorasin.*

Poeti mes kësaj tabloje të zymtë të jetës nuk mund të mos shikonte rrezet e drithës, se përndryshe do të ekte në gjurmët e Bolderit dhe të Meterlinkut dhe do të vinte re vetëm të zezën pa shkëndijat e shpresës. Pol Elyari ndjen si «brohorasin premtimet e brezit të ri». Kjo ishte ajo shpresë që e ndoqi hap pas hapi gjersa vdiq, pasi ka qenë një poet me një shpirt të madh, që e njihte thellësisht edhe jetën, edhe poezinë. Ai nuk ishte një poet pozash dhe pompoz. Studiuesit e tij thonë se më 1924 në qarqet letrare të Parisit u përhapën fjalë se një poet i ri me emrin Pol Elyar vdiq papritur, ca të tjerë thoshin se vau veten si i dëshpëruar. Parisi nuk e dinte se poeti nuk ishte vrarë, por ishte zhdukur pa lënë gjurmë në udhëtime të largëta. Kur pëshpërteshin këto fjalë, ai endej në Tahiti, në Panama, në Zelandën e Re, në Indonezi, në Cejlon. Dhe në krijimet e tij pas këtij udhëtimi nuk gjen asnje shenjë të jashtme ekzotike me palma e banane, me tigra e krokodilë, me peizazhe të jashtëzakonshme për të habitur njerëzit. Duke qeshur, ai thoshte se nuk e bëri këtë udhëtim të largët për hir të «gjetisë poetike». E bëri se donte të njihte popujt dhe vendet, në radhë të parë, si qytetar, pastaj si poet, sepse ishte njeri me ndjenja të mëdha shoqërore. Dëshmitari më i mirë i këtij shqetësimi është poezia e tij e pasur. Pol Elyari i donte njerëzit me një dashuri të pakufishme, me një dashuri të shqetësuar:

*O vëllezërit e mi të humbur!
Unë shkoj drejt jetës, unë kam pamje njeriu,
Që të vërtetoj se bota
Është bërë pas shtatit tím
Dhe unë s'jam i vetëm,
Se mijëra fytyra të mia shumojnë
Dritën time...*

Mjaft poetë dhe prozatorë të shquar perëndimorë pas Luftës së Parë Botërore imperialiste, veçanërisht gjatë viteve 20 dhe në fillim të viteve 30, u bënë përfaqësues të «brezit të humbur». Në veprat e tyre ndihej një frysme e theksuar pacifiste dhe herë-herë tepër pesimiste. Ata mundoheshin të pasqyronin lodhjen dhe rraskapitjen e njeriut që kaloi llogoret e luftës, endjet e kota të tij udhëve pa fund e krye. Pol Elyari, megjithëse i kishte provuar tmerret e luftës, nuk ra në pesimizëm dhe nuk u bashkua me përfaqësuesit e «brezit të humbur», sepse e kuptonte misionin e poezisë, mision që i shërben zgjimit të ndërgjegjes së njerëzve, luftës së tyre për përparim shoqëror. Në fund të viteve 30 ai shkruante me optimizëm e besim te gjeneratat e ardhshme, te njeriu i ri që po vinte:

*Plajat e mia — vend i aventurave të mia,
Gjelbërimi i shtrenjtë — vlagë e qyteteve,
Në krye njerëzit do të vijnë t'ju prijnë.*

*Njerëz, njerëz! Nën ju ka djersë dhe lot,
Por prapë korrni një krah éndrrash të lumtura!*

*Unë shoh njerëz të mirë,
Që flakin nga supet barrën e mjerë si vdekja
Dhe prehen plot gaz nën shushurimën e diellit.*

Ky besim i përshkonte edhe vjershat e thjeshta, edhe peizazhet poetike, megjithëse ai e përdorte rrallë peizazhin. Meqë erdhi fjala, është e udhës të themi se Pol Elyari njihte shumë piktorë dhe mjaft prej tyre i kishte miq të ngushtë.

Si mik i piktorëve, ai e donte pikturën dhe peizazhin, por në vjershat e tij ka pak peizazh, ka pak tregim; në to ka parashtrim mendimi dhe sintezë. Megjithatë tek-tuk mund të ndeshemi në peizazhe të gjalla poetike, të gatuara me një gjuhë transparente dhe plot dritë:

*Dhe vesa që drithërohet
Ka një të vetmë dëshirë;
Të çelin lulet e freskëta
Në barkun e butë të livadheve.*

Në vitet 30 Pol Elyari e ndjeu shkrofëtimën e përbindëshit fashist që vinte nga Gjermania dhe Italia dhe i pa retë e zeza mbi Evropë. Tronditjen e parë të shpirtit të tij human ia dha Spanja. Gjakderdhjet në vendin e Servantesit e të Lorkës, në vendin e luftëtarëve dhe brigadave internacionale nuk mund të mos e prekkin Elyarin — poet, Elyarin — qytetar. Më 1936 ai shkroi me dashuri për Spanjën dhe meurrejtje për armiqtë e saj:

*Madrit, qytet i zemrës
Për ata që kanë vuar
Nga varfëria e llahtarshme,
E cila nevojitej kaq shumë aty
Që më tepër të shkëlqente
Kamja e të tjerëve...*

Dymbëdhjetë vjet më vonë ai do t'i rikthehej temës spanjolle dhe do të shkruante vargje akoma më emocionuese:

*Në ka në Spanjë një pemë ngjyrë gjaku,
Kjo është pema e lirisë.
Në ka në Spanjë një gjuhë të paheshtur,
Kjo flet për lirinë,
Në ka në Spanjë një kupë të pastër me verë
Populli këtë do ta pijë.*

Tema internacionale në poezinë e Pol Elyarit, me rrjedhjen e kohës, do të vijë duke u pasuruar, pasi sferat e interesave të poetit do të rriten. Në përgjithësi, poetët dhe shkrimtarët përparimtarë francezë e kanë në traditë fryshtës internacionliste, por Pol Elyari mund të themi se është nga artistët më internacionalistë. Në ato vende ku ka qenë, ka ditur të trajtojë ngjarjet më të rëndësishme historike, duke lënë mënjanë vogëlsirat dhe etnografinë. Fjala vjen, duke u hedhur në Spanjë, ai mund të shkruante për vallet e spanjollëve apo për ngjyrat e panaireve dhe për trimëritë e mundësve të demave, por atë e interesonte lufta e Republikës së re, spanjolle, qëndresa e saj.

3

Biografia poetike e Pol Elyarit është shumë e pasur. Ai jo vetëm që ka botuar mijëra vargje, por ka marrë pjesë aktive në rrethet artistike të Francës dhe ka njojur me qindra poetë, piktorë e artistë të rrymave të ndryshme. Kur u kthyte nga fronti pas Luftës së Parë Botërore, në Francë mbretëronte po ajo fryshtë e luftës dhe ishin po ata faktorë që përgatitën kasaphanën. Në këtë atmosferë një pjesë e madhe e intelektualëve filluan të ambientoheshin dhe të pajtoheshin me gjendjen e përgjithshme politike dhe shpirtërore të shoqërisë. Disa të tjerë, për të ruajtur veten, gjetën ndonjë qoshe të qetë mes sendeve shtëpiake. Një pjesë, që vuajti nga varfëria ose që e ndjeu peshën e luftës botërore fizikisht dhe shpirtërisht, filloi të urrejë dhe të përbuzë gjithçka në shoqëri, bile edhe kulturën me tërë traditën e saj të vjetër dhe të re. Në këtë qark intelektualësh bënin pjesë ata që e quanin veten «kryengritës». Por ky shpirt kryengritësish ishte i vogël, egoist, anarkist. Mbrojtësit e këtyre të revoltuarve në letërsi u bënë dadaistët, të cilët krijuan rrymën e dadaizmit, ku bënin pjesë poetët e piktorët bohemë, që bërtisin e shanin, që betoheshin ta «digjinin gjer në themel tempullin e kulturës». Ata në vjersha grumbullonin fjallë pa kuptim, si belbëzimet e fëmijëve, prandaj edhe kjo rrymë u quajt dadaizëm. Themeluesi i kësaj rryme ishte Tristan Cara, rumun me origjinë, por që banonte në Zvicër. Ai u ftua më 1920-ën në Francë

nga qarqet letrare të drejtuara nga Andre Bretoni, Lui Aragoni dhe Filip Supoi, të cilët nxirrnin revistën «Literatura» në Paris. Rreth kësaj reviste, qendër e dadaizmit, u grumbulluan poetët me sjellje skandaloze dhe me art poetik skandaloz. Pol Elyari që kërkonte rrugë shpëtimi, menjëherë hyri në këtë rreth poetësh skandalozë. Kështu që vitet e dadaizmit për Elyarin ishin vite kërkimi, vite vuajtjesh shpirtërore, vite krize të ndërgjegjes. Ai më 1920 nxjerr revistën «Proverba», e cila ishte më tepër një laborator gjuhësor. Revista dilte me epigrafin e Apolinerit: «O fjalë, njeriu tani është në kërkim të ligjërimit të panjohur, të cilin nuk ia japid gramatikanët e kohërave të shkuara.»

Poetët dadaistë gjithçka në shoqëri e shikonin të deformuar, duke krijuar tablo të tmerrshme me vargjet e tyre. Ata më shumë se çdo gjë i mundonte mendimi për moralin dhe për të ardhmen e tij. Në një vjershë të librit të P. Elyarit «Të vdesësh nga ajo që nuk vdes», thuhet:

*Gjithçka më në fund është sharruar,
Gjithçka ndryshon, shkrihet,
Thyhet, zhduket,
Më në fund
Bota vetë humb natyrën e saj,
Bëhet yll i nxehtë, kafshatë e uritur,
Humb fytyrën
Dhe ngjyrat.
I verbëri i heshtur
Është ngaherë i njëjtë dhe bosh.*

Diku në një vend tjetër, duke parë gjithë këtë atmosferë, por edhe duke e pasqyruar atë, Elyari shkruan: «Unë e ndiej veten të varur në pemën e moralit.»

Por Pol Elyari e ndjeu shpejt dobësinë e dadaizmit dhe u zhgënje prej kësaj rryme. Kjo është arsyaja që më 24 mars 1924, një ditë para se të dilte libri i tij «Të vdesësh nga ajo që nuk vdes», fshehurazi nga prindërit dhe shokët, u zhduk nga shtëpia dhe mori arratinë nëpër botë për të «gjetur poezinë», siç treguam pak më lart në këto shënimë.

Edhe dadaistët e tjerë u deziluzionuan nga rryma që krijuan dhe menduan ta kërkonin të vërtetën në fushën e ndërgjegjes, në thellësitë e shpirtit, në éndrrën. Ata mendonin se po-

ezia do të fitonte cilësi të reja kur të çlirohej shpirti një-rëzor nga «prangat e gjykimit». Sipas tyre, duhej lënë të vërvshonte ajo që fshihej në ndërgjegje, në shpirt të vërvshonte pa logjikë, si në kllapi. Në këtë mënyrë lindi surrealizmi, i kryesuar nga Andre Bretoni. Kështu, më 1924, kur Pol Elyari ishte zhdukur nga Parisi, doli revista surrealistë «Revolucioni surrealist». Më vonë, si u kthyte nga udhëtimet, Pol Elyari u bashkua edhe me surrealistët dhe u bë përkrahës i tyre i zjarrtë. Por, më gjithë dëshirat e Pol Elyarit, surrealizmi nuk mund të shfrytëzohej pér qëllime të mira, me gjithatë ai gabimisht përpinqej ta përdorte këtë rrymë në dobi të luftës kundër akademizmit dhe sentimentalizmit në poezi, pér ta afruar me jetën, pér t'ia shtuar vitalitetin. Bile, një nga parrullat e njohura të surrealistëve ishte «Poezia është krijimtari e të gjithëve dhe jo vetëm e njërit». Edhe revista që nxirrnin ata mbante një emër të çuditshëm: «Surrealizmi në shërbim të revolucionit».

Megjithëse Pol Elyari ishte një nga frymëzuesit kryesorë të surrealizmit francez, në vjershat e tij të asaj periudhe nuk ka gjurmë shumë të theksuara të kësaj rryme. Surrealistët thoshin se te njeriu ekziston ajo që quhet iracionale. Por, si pas mendimit të tyre, dhe kjo iracionale është reale, bile «mbireale».

Surrealizmi në të vërtetë mohon objektivitetin e njohjes, mohon rolin e gjykimit dhe të përvojës në art, duke e kërkuar burimin e krijimit në «sferën e ndërgjegjes», në instinktet, èndrrat, përcartjet dhe aluçinacionet. «Manifesti i parë i surrealizmit» doli më 1924 në Paris, i hartuar nga A. Bretoni. Përveç Elyarit, në surrealistët bënin pjesë edhe mjaft shkrimitarë e piktorë të tjera. Por qendra e surrealizmit në vitet 30-50 të shekullit tonë kaloi në Amerikë me Salvador Dalinë në krye etj. Pol Elyari e njihte dhe e kishte mik Salvador Dalinë, bile ky i fundit i pat ilustruar mjaft vjersha. Surrealizmi sot e ka humbur ndikimin e vet dhe është një rrymë që po jep shpirt, një rrymë e mbështetur në mistikën fetare, prandaj nuk e vlen të zgjatemi. Vetëm do të shtojmë se në veprën e Pol Elyarit nuk ka përcartje dhe aluçinacione si te surrealistët. Megjithatë, pjesëmarrja e tij në këtë shkollë ia ngushtoi pér një kohë tematikën e poeziës. Veç kësaj, surrealizmi i la ndonjë gjurmë, si hermetizmin dhe animizimin, që shpesh e vështirësojnë kuptimin e vargjeve.

Fakti që surrealistët u ndanë në dy kampe armike: Pol

Elyari në një krah dhe A. Bretoni në krahun tjetër, tregon se bindjet e poetit në këtë rrymë nuk kishin rrënje aq të thella. Shkëputjen e Pol Elyarit nga surrealistët e shpjetgon më qartë deklarata e tij më 1936: «Ka ardhur koha, kur të gjithë poetët duhet të hyjnë thellë në jetën e njerëzve të tjerë, në jetën shoqërore.»

Ky mendim e ka ndjekur gjithnjë Pol Elyarin, por ai shkëlqeu me tërë bukurinë e tij në kohën e pushtimit fašist dhe të Rezistencës në Francë. Atëherë poezia e Pol Elyarit u bë «bombë e flamur», siç thoshte dikur Majakovski për vargjet në përgjithësi, sepse shprehte mendimet dhe ndjenjat e popullit francez të asaj kohe. Të citojmë këto vargje për Gabriel Perinë, një nga heronjtë e Rezistencës Franceze:

*Fjala «fëmijë» e fjala «nderim»,
Pastaj ka emra lulesh e pemësh
Dhe fjala «guxim» dhe fjala «zbulim»
Dhe emra të tjerë për vende e fshatra
Dhe emra grash e miqsh.
Këtyre t'u shtojmë një emër të ri,
T'u shtojmë emrin Gabriel Peri.
Ai ka vdekur që ne të jetojmë
Dhe s'duhet t'i flasim me «ju» po me «ti»
Gabriel Peri.*

Fjala e Pol Elyarit në vjershat e kohës së luftës u bë më e larmishme dhe më ekspressive. Mendimi tanë edhe në vjershat e vogla, nuk fshihej, por zbulohet i téri. Pol Elyari nuk e thjeshtonte vargun me ndonjë qëllim të caktuar. Vargu dilte vetëvetiu i qartë, sepse poeti jetonte me vuajtjet dhe burrërinë e njerëzve që luftonin. Koha e provës së madhe për popullin francez nuk do të pranonte një poezi maineriste. Nëpërmjet thjeshtësisë maksimale të vargjeve burronë një dhembje e thellë për njerëzit dhe për vendin e pushtuar. Por bashkë me këtë dhembje shpërthente urejtja për pushtuesit dhe ndriste shpresa për ditë të mira. Për shembull, për Parisin e pushtuar ai shkruan:

*Ti shpatë e paepur e gjilpërë e hollë
Dhe zemërmirë dhe i zgjuar,
Nuk njeh një kaos më të keq se ky i sotmi;
Po ti, Paris, nga kaosi i lirë do të jesh.
Parisi im i drithëruar, yll i largët,
O shpresë jonë e pashuar,
Nga dhimbja dhe nga ndotja do çlirohesh.
Vellezër, burrërohuni!*

4.

Edhe pas Luftës së Dytë Botërore Pol Elyari nuk ra në qetësi, por luftoi me gjithë energjitet e tij kundër luftënxitësve. Ai e kuptoi se ende nuk kishte paqe mbi tokë dhe njërit jetonin të shqetësuar. Bashkë me poetë të tjera ngrinte zërin në kongreset dhe konferencat e paqes në Francë, Itali e gjetiu.

Ka studiues e kritikë që mundohen ta paraqitin krijimtarinë e tij të viteve të Pasluftës së Dytë Botërore thjesht si një testament për paqen, thjesht si një lutje për paqen, pa vlera poetike. Në të vërtetë, vargjet e kësaj periudhe jo vetëm që kanë vlera poetike, por nuk janë aspak lutje për paqen. Pol Elyari vinte me medimin se paqja nuk lypet, por fitohet. Fitoren e paqes ai e shikonte në luftën e proletariatit, në përpjekjet e përbashkëta të gjithë forcave përparimtare kundër errësirës. Në «Fytyra e paqes» më 1951 ai shkruan:

*Njeriu që për pagen digjet
I lumtur gjithnjë buzëqesh
Pas zjarrit të luftës...
Ne bëhemë të fortë së bashku me përpjekjen,
Me vuillnetin tonë që të zhdukim hijet,
Me hovin e rrufeshëm të dritës së re.*

Ai e ndiente si komunist se përderisa ekziston kapitalizmi, padrejtësia dhe shtypja, etja për fitim dhe dhuna, nuk mund të ketë paqe të përjetshme. Premtimet për «paraj-së» ai i quante gënjeshtra dhe hipokrizi.

*Fyerja e minatorëve
Posi një hije rritet
Në ndot e varfëri,
Në turp e në tèrbim.*

*Profetët e errësirës gënjejnë,
Kur na premtojnë parajsën.*

Poezia, sa më hapësirë të ketë në tematikë, mendime, formë e ritmikë, aq më shumë përvetësohet dhe aq më e pasur bëhet në shprehjen e jetës. Duke hyrë në pyllin e poezisë së Pol Elyarit, në pyllin e dendur e plot jetë, me të parpritura të çuditshme, do të ndiesh përnjëherë pasurinë dhe thesarin e saj. Mes gjithë kësaj begatit do të ngrihet me madhështi figura e gruas, e vështruar me një singjeritet të mahnitshëm dhe me një zemërgjerësi të pakufishme. Ai e vështron gruan në gjithë kompleksin e saj dhe përmes kësaj figure kërkon të gjejë burimin dhe domethënien e jetës. Poeti e identifikon atë me madhështinë e natyrës, me pasurinë e saj dhe me përtëritjen e përhershme edhe shekullore. Vjershat për gruan kanë përpjesëtim të madh mendimesh dhe nuk shprehin vetëm një dashuri zbavitëse. Ai u largohet zbavitjeve të çastit edhe në ato vjersha që në dukje kanë një ndjenjë erotike. Këtë e bën se do të hyjë në filozofi dhe në meditim edhe për gjérat që e rrrethojnë gruan si qenie dhe si njeri.

Për poetin të gjitha qeniet e natyrës janë të dashura dhe në të gjitha mundohet të zbulojë raporte dialektike. Natyrën, pemët, barin, fluturat, kafshët dhe zotërit e gjithçkaje, të plotfuqishmit njerëz, në çdo shenjë e në çdo veprim të tyre ai i poetizon dhe u thurr himne. Me këtë kërkon të tregojë se ç'është e zonja të bëjë poezia, me këtë kërkon tu thotë poetëve se vargu nuk njeh kufizime dhe fjala mund të bëjë çudira. Prandaj, çdo temë, të vogël apo të madhe, ai e trajton me ndjenjën e përgjegjësisë së lartë poetike.

Çdo ngjarje në jetën e njeriut dhe në jetën e shoqërisë bënte një efekt të madh në ndërgjegjen poetike të Pol Elyarit. Kjo duket në poezinë e tij, e cila është biografia më e mirë e poetit. Por për një kohë të gjatë tema e luftës kundër fashizmit dhe e ringjalljes së instinkteve të vrasjeve dhe krimave u bë nga më të rëndësishmet në poezinë e tij.

Kështu, pas vitit 1945, tema qëndrore e poezisë së Pol Elyarit ka qenë ajo e luftës për paqen. Por, megjithatë, ai nuk la mënjanë temat e tjera që nxirrte jeta e vendit të vet. Brenda për brenda kësaj teme të madhe poeti goditi hipokritët, tradhtarët, vrasësit dhe shfrytëzuesit e punëtoreve dhe të atyre që mbajtën mbi shpatulla luftën. Vrasësit e djeshëm kërkonin «ndjesë» për veten e tyre e për të tjerët që lanë duart me gjak. Poeti nuk mund të pajtohet me ta.

*Ata që të kegen harruan në emër të së mirës,
Ata që s'kanë zemër, na predikojnë ndjesë,
mbrojnë katilët se u duhen,
«Bota — thonë — duhet të ketë nga të gjithë».*

Me ankth të madh ai ndiqte luftën e popullit grek më 1948 e 1949, siç ndiqte më 1936 revolucionin spanjoll. Për të qenë pjesëmarrës në dhembjen e këtij populli të vuajtur, poeti shkoi vetë në Greqi, në malet, ku luftonin partizanët. Poeti vizitoi Gramozin dhe shkroi pastaj vargje të mrekullueshme:

*Agimi zgjat kupën e tij
Dhe ja, shikoni
Një gjak të ri tek po mbush
Qiellin e Greqisë.*

Poezia e Pol Elyarit është tendencioze dhe e partishme. Për këtë partishmëri shprehet edhe vetë në një vjershë drejtuar «shokëve të mi të rreptë». Këta «shokë» e akuzonin poetin se është tepër i angazhuar dhe tepër politik. Për ta konkretizuar këtë le të kujtojmë vjershën e tij programatike «Qëllimi i poezisë...»:

*Sikur t'ju them se dielli fshehur pyllit
I ngjan një barku gruaje në shtrat,
Ju më besoni dhe dëshirën ma ushqeni.*

*Sikur t'ju them se kupa e kristaltë e shiut
Kumbon në plogështinë e dashurisë,
Ju më besoni dhe me mua çastin e dashurisë zgjatni*

*Po sikur rrugës t'i këndoj pa marifete
Dhe vendit tim si rrugës t'i këndoj,
Ju s'më besoni, por largoheni shkretëtirës,*

*Se bridhni kuturu pa njohur njerëzit,
Që duan të bashkohen, të shpresojnë, të luftojnë
Dhe botën ta zberthejnë e transformojnë.*

Akuza që i bënин Pol Elyarit në fakt ishte një thirrje për ta mënjanuar nga lufta. Estetët modernistë, si atëherë edhe sot, përpilen ta fshehin karakterin e partishmërisë regrutive në artin e tyre, duke e quajtur këtë art si pannjerezor dhe mbiklasor. Përderisa ekzistojnë klasat dhe lufta e klasave në shoqërinë njerëzore, përderisa ekzistojnë padrejtësitë, nuk ka dhe nuk mund të ketë art të papartishëm, të paangazhuar. Në kohën e Pol Elyarit, sikurse edhe sot, ka pasur seri të tëra librash që mburrnin firmat e fabrikantëve dhe industrialistëve kapitalistë, që u thurnin lavde dyqaneve, fustaneve dhe sytjenave të grave, që u bënин reklamë pijeve dhe konservave. Këta libra i shkruanin edhe shkrimitarë të njohur. Po vallë këta shkrimitarë kanë qenë të paangazhuar? Përkundrazi, kanë qenë shumë të angazhuar, se përndryshe do të mbeteshin pa ngrënë. Ajo kocka që u vë përpara borgjezia duhet paguar me atë art gjoja të paangazhuar. Përderisa ekzistojnë paratë, shtypshkronjat, pronarët e librarive, shtëpitë botuese dhe tregu, nuk mund të ketë art të paangazhuar. Prandaj Pol Elyari revoltohej ndaj miqve, kur e quanin të «angazhuar» se këndonte «troç tërë rrugën», «tërë vendin».

Pol Elyari vdiq më 18 nëntor 1952 në moshën 57 vjeç në kulmin e potencës së tij poetike. Dy-tre vjet para se të vdiste, kur shkoi në Gramoz për t'u takuar me partizanët grekë, erdhi edhe në Shqipëri kalimthi. Nuk dimë nëse shkroi

për vendin tonë, por dimë se kur është takuar me njerëzit tanë, ka folur me dashuri, si internacionalist dhe mik i vërtetë. Edhe në këtë vend, ku poeti u çlodh disa orë apo një natë, erdhë poezia e tij. Për njerëzit tanë ai nuk është i pannjohur, edhe pse gjer tani nuk i është botuar ndonjë përbledhje me vjersha, me gjithë përpjekjet dashamirëse që janë bërë nga përkthyesit dhe poetët. Dhe arsyja është se poezia e tij është shumë e vështirë të përkthehet. Tipari kryesor i vjershave të tij është nga një anë thjeshtësia dhe nga ana tjetër lakonizmi i jashtëzakonshëm. Ngjeshja e tepërt e fjalëve ndonjëherë e bën vjershën të pakuptueshme. Përveç kësaj, kalimi nga një përfytyrim në tjetrin, pa përdorur asnjë hallkë, asnjë lidhëse në sintaksën poetike, e vështirëson leximin. Por vargjet e tij, në përgjithësi, dallohen nga një tejdukshmëri e mahnitshme dhe nga një zhveshje e theksuar e teprimeve. Por Elyari luftonte që ta zhvishte vargun nga fjalori gjoja poetik dhe të vendoste në varg fjalët më të zakonshme. Vetëm mënyra e vendosjes së fjalëve në varg të emocionon dhe të trondit. Pjesa më e madhe e vargjeve të tij nuk ka as metër të caktuar e as rimë. Vjershërimi i tij mbahet në mendimin e koncentruar, në ritmin spontan dhe në gërshtemin magjik të fjalëve. Megjithatë, në vargje ka plot asanonca dhe muzikalitet. Në poezinë e Pol Elyarit ka shumë përsëritje të frazave paralele, krahasime të drejtpërdrejta, detaje të papritura gjer në paradokse. Ka ndonjëherë edhe poezi të thjeshtë, me fjalë të zakonshme të protokolleve, trakteve dhe raporteve, bile edhe të kimisë dhe biologjisë. Kjo e shumë të tjera e vështirësojnë përkthimin. Por e vështirëson edhe vetë rruga poetike dhe biografia e tij, rrugë që kaloi përmes dadaizmit, surrealizmit, dhe rrymave të tjera. E gjithë kjo rrugë, pasqyrohet, tregohet dhe përshkruhet në shumë vjersha në formën e denoncimit të vvetvates. Një përkthyes që nuk e njeh këtë rrugë të poetit, nuk mund ta përkthejë poezinë e tij. Edhe sikur ta përkthejë, do ta bëjë të pakuptueshme pér njerëzit, pasi as vetë nuk do ta ketë kuptuar. Përkthimi rrjedh nga asimilimi i plotë i poezisë së poetit nga i cili përkthen: përkthimi shpreh dashurinë ndaj poetit, përndryshe mbetet i thatë dhe i padobishëm. Le të na kujtohet një thënie e bukur e K. Marksit pér përkthyesin: «Përkthyesi nuk është një dërdëllitës mekanik, që kalkulon germën e origjinalit, por bashkëpunëtor i ndërgjegjshëm i autorit, transmetues i mendimeve të tij pér lexuesin e huaj.» Duke u bazuar në fjalët e Marksit, që pér-


kthyesi nuk është një dërdëllitës mekanik që kalkulon gërmën e origjinalit, mund të themi se edhe metrit të tekstit origjinal të vjershës mund të mos i qëndrojmë besnikë, kur e ndiejmë se e cungojmë mendimin dhe bukurinë.

Ka shumë vjet që kam menduar të zgjedh e të përkthej një libër me vjersha nga Pol Elyari, poet që e kam dashur që në vitet e rinisë. Shpesh kam bërë eksperimente dhe kam provuar t'i jap në shqip mendimet dhe ritmikën e poezisë së tij, por edhe unë kam humbur në këtë fushë të betejës së shpatave të vargjeve dhe metaforave. Shpatat e metaforave të mia të përkthyera atëherë kanë qenë nga çelik i dobët dhe janë thyer. Por poetët janë inatçinj dhe kokëfortë. Përsëri fillova t'i provoj shpatat e vargjeve dhe metaforave, duke ndërtuar një përbledhje të vjershave të Pol Elyarit.

Doemos në këto shqipërime është bërë një përpjekje për të qartësuar ndonjë mendim të autorit, siç e dëshiron natyra e gjuhës shqipe, duke iu druajtur banalizimit të vargut.

Siç thashë, Pol Elyari, në përgjithësi, vjershat i ka parimë, por ka mjaft asonanca, ritëm, herë-herë edhe metrikë. Bile, vende-vende ka edhe rima spontane. Në përkthimin tonë jemi munduar t'i ruajmë, me sa kemi mundur, këto vëçori tipike të poezisë së tij. Por është e natyrshme që diçka edhe ka humbur, ashtu siç humb ndonjë veti e një luleje kur e marrim nga toka e saj dhe e mbjellim në një vend tjeter. Megjithatë, ajo që është e përgjithshme mbetet, sido që të bëhet. Në fund të fundit të vërtetën e thotë lexuesi.

Shtator, 1982



P E R M B A J T J A

I

Jeta dhe historia në letërsi dhe arte	5
Mbi specifikën e humorit dhe satirës	42
E ardhmja e letërsisë dhe e artit	54
Letërsia dhe realiteti	67
Epoka socialiste — në qendër të letërsisë dhe artit	74
Kultura e të shkruarit	81
Psikologjia e të ambientuarit me mesataren.	88
Bota e eposit	93
Fëmijët dhe letërsia e tyre	96
Muzika në jetën e fëmijëve	102
Piktura dhe skemat	105
Dy fjalë për koreografinë	109
Koha e lirë dhe arti	112

II

Madhështia e figurës dhe e veprës	119
Historia e gjallë dhe e papërsëritshme	132
Një vepër e fuqishme për një epope të madhe	145
Bota e fëmijërisë dhe e rinisë së hershme	177
Kur mendojmë për «Zërin e popullit»	183
Gjurmë të pashlyera	187
Për Naim Frashërin	201
Në krahët e këngës	204
Nderim shkrimitarit të shquar militant	209
Personaliteti i shquar i artit shqiptar	215
Një udhëtim i shkurtër në poezinë e Ali Podrimjes	217
Poeti populor Selim Hasani	226

III

Romani në arritjet dhe në kërkimet e tij	233
Disa mendime për romanin dhe strukturën e tij	245
Tregimi për fëmijë	253
Diçka për tablonë kompozicionale	256
Në kërkim të poezisë	259
Poeti dhe poezia	263
Poezia dhe mosha e poetit	268
Gjuha dhe shkrimtari	275

IV

Një vështrim i shpejtë në poezinë turke të shekullit të 20-ë ...	285
Pol Elyari dhe poezia e tij	304
Vepra e një personaliteti të madh të letërsisë turke	294

Agolli, D.

Jeta në letërsi. Artikuj dhe
shkrime. [Red.: I. Nelaj] T.,
«Naim Frashëri», 1987.

324 f.

(B. m.) dhe

(B. v.): 891.983.01+

891.983.09+

981.983(09)+

7.01

A 37

Tirazhi 3000 kopje Format 60x88/16 Stash 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1987